SHËNIME BIOGRAFIKE

SI E BËMË LUFTËN

(Pjesa e dytë)

Skender Ibrahim Basha

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

KAPITULLI I DYTË

SI E BËMË LUFTËN

(Kujtime)

Në vend të hyrjes

Mund të thuhet, me vështirësi tepër të mëdha ngase me vështirësi edhe e kishim filluar atë. Si ta marrësh; Mund të thuhet edhe me lehtësinë më të madhe. Ja pse: Thënë përgjithësisht, në Kosovë, nga pak intelektual dhe
~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

numër i konsideruar i të rinjve, në mesin e të cilëve kishte shumë ish të dënuar e të përndjekur politik, ishin bërë veprime krejtësisht të ndara nga politika e të cilat i kishin krijuar shtrat luftës çlirimtare, krejt e pashmangshme për rrethanat e rënda të krijuara nga dhuna dhe terrori i egër serb. Këtu duhet përmendur, veçmas, ndikimin e punës kolosale të Anton Qetës dhe rinisë përparimtare kosovare në pajtimin e gjaqeve dhe mbylljen e ngatërresave të shumta, gjë që qoi në unifikimin e popullit dhe në kthimin e vetëbesimit si dhe në ngritjen e vetëdijes e ndërgjegjes kombëtare si në motet e mëdha para ndërmarrjes së veprimeve çlirimtare.

Ndikim thelbësorë kishte qëndrimi i qartë kur i thoshte faktorit serb e atij ndërkombëtarë se ishim të përkushtuar dhe të vendosur të ndërronim këtë gjendje dhe veprimi politik e diplomatik i fenomenit Adem Demaqi, si dhe shpalosja që i kishte bërë Rexhep Qosja e Ismail Kadare gjithë vuajtjes dhe përpjekjeve të pandërprera, për liri, të popullit Shqiptarë gjatë gjithë së kaluarës duke përfshirë edhe padrejtësitë që na ishin bërë nga faktori ndërkombëtarë. Punë të mirë kishte bërë edhe shkenca historike Kosovare, madje në disa dekada të fundit, ndërsa që na kishin mbajt gjallë shoqëritë e shumta kulturo-artistike, të kohës, në përgjithësi e me këngën e tyre Shkurte Fejza e Ilir Shaqiri në veçanti. Qirinj të ndezur, fanarë të pashuar, udhërrëfyes, shpërndarës të mjegullave e qarës të furtunave ishin veprimtarët e shumtë për kauzën kombëtare, të frymëzuar nga e kaluara historike e popullit tonë, nga jeta dhe vepra e sakrifica më sublime e patriotëve e veprimtarëve të shumtë dhe mbështetur fort në

përfytyrimin dhe në veprat e shtetit mëmë, Shqipërisë Socialiste, Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) dhe udhëheqësit të sajë Enver Hoxha.

Ndikimi i faktorit, të brendshëm, politik e ushtarak

Nga politika ishte bërë fare pak në përgatitjet për luftë, që të mos thuhet aspak. Faktori politik, në tërësi, ishte krejt i pa unifikuar madje edhe i përçarë. S'po gjente gjuhë e rrugë veprimi të përbashkët edhe ai që vepronte në ilegalitet. Secili nga subjektet politik, po vepronte kokë më vete. Bëheshin veprime politike krejt shkapërderdhur. S'kishte një qëllim të caktuar dhe një synim ku donim të arrinim. Po silleshim sikur të kishim shtetin. Imitonim së zbatuari sistemin shumë partiak të qeverisjes, ndërsa që kishim shkapërderdhë energjitë që kurrë si kishim të shumta sa për të na mjaftuar.

Partitë politike në Kosovë
Lidhja e Komunistëve të Kosovës (LKK)

Gati secili komunist kosovarë, që kishte fare pak ndikim, ishte i lidhur ngushtë dhe ia kishte shitur shpirtin OZN-as e më pas UDB-së serbe. Ndryshe s'mund të shpjegohet, fillimisht, revidimi i vendimeve të Konferencës së Bujanit, në Konferencën e Prizrenit; dhe, më pas, qëndrimi i tyre politik ndaj të gjitha nismave dhe përpjekjeve të shumta të popullit tonë dhe bijve e bijave të tij për çlirim e bashkim kombëtarë gjatë gjithë kohës së udhëheqjes së tyre këtu. Ç'të thuhet për krye- komunistin, Fadil Hoxha, i cili s'kishte mundë ta krijonte aradhen e tij partizane as edhe në fshatin më të thellë malorë të

Kosovës, por të cilën e kishte krijuar në Malet e Sharit, dhe i cili më pas e kishte gjuajtur me topa serb Shaban Polluzhen dhe shokët e tij trima.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

I ishin koklavitur gjërat me opsionet e shumta të mundshme, varësisht nga ajo se si do të rridhnin gjërat si rezultat i zhvillimeve kur po shpërbëhej ish Jugosllavia. Më e drejtë është të thuhet se s'bënte politikë e as veprim konkret fare. Nëse themi se e bënte njëfarë politike; Ajo ishte politikë e ndejës, e vënies në gjumë të masës dhe e frikësimit të sajë deri në atë se çfarëdo kundërvënie dhunës do të thoshte shfarosje për ne. Kreu i sajë, ishte krejt konfuz dhe i pa sinqertë edhe me vetveten. Mbanin "poste" dhe bartnin emërtime të thuash se e kishim bërë shtetin, ndërsa edhe të mirat nga këto i gëzonin. Këto, në rrethana kur gjëmonte çdo gjë shqiptare në këto troje. Gati sa s'na ishte vrarë shpirti; Ishim krijuar krejt frikacak dhe të tillë qe flisnim me krenari e pa aspak turp, madje edhe publikisht, se si na kishin rrahur a torturuar polic serb a të tillë që ishin në shërbim të pushtetit. S'kishte vullnet e vizion të kanalizohej e shndërrohej në rezistencë tërë ajo energji e popullit që shprehej pakuptimshëm në protestat e demonstratat e përgjakshme ku kërkohej demokraci në vend se të kërkohej liri dhe barteshim gjithandej nëpër varrimet vajtuese, gati të përditshme, të atyre që po na vriteshin nga dora gjakatare serbe krejt pafajshëm vetëm e vetëm se ishim shqiptarë. Ç'të thuhet për "Presidentin historik", Ibrahim Rugova, i cili në fillime të sajë guerilen shqiptare po e quante dorë të zgjatur të Serbisë, kurse më

pas në vend se ti dilte në krye ushtrisë që kishte hapë vija fronti e kishte krijuar zona të lira, e kishte sjellë veten në situatë që pushtuesit "ta ruanin" nga ushtria që po ia çlironte vendin, ndërsa që në vendin e tij do të kthehet "triumfalisht" pesë muaj pasi që ky vend të jetë çliruar; Dhe i cili s'mori mundin të vizitoj, Prekazin, që simbolizon sakrificën e fitoren tonë.

Subjektet tjerë politik në Kosovë, të pa vetëdijshëm se ishim nën okupim klasik, imitonin veprime krejt të pa efektshme të shoqërisë civile nga bota e qytetëruar, kurse partitë politike shqiptare në Maqedoni, në Malin e Zi dhe ato të Kosovës Lindore ishin kthyer kah "dielli" që s'po ngrohte vetveten dhe po kënaqeshin me lidhjet krejt të pasinqerta e jofunksionale që kishin krijuar me ne këtu.

Ilegalja në vendet Perëndimore, dhe këtu në Kosovë

Ilegalja, në vendet Perëndimore, me gjithë përpjekjet e sajë të vazhdueshme, asnjëherë s'kishte arritur të organizohej mirëfilli. Si pasojë e së kaluarës historike, duke qenë e ngjyrosur politikisht, dhe e ndarë në planin socio-ekonomik, ndiqte rrugë të ndryshme dhe ishte e ndarë, ndërsa s'ishte përkrahur kurrë, nga askush, madje as nga shteti amë. Në përpjekjen e parë serioze të sajë, për tu unifikuar, dora kriminale e shërbimit sekret serbo-sllav, vret Vëllezërit: Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekën dhe e lë pa kokat gjeniale atë. Më pas, kishte nga ata që mund të iknin nga kthetrat e shërbimit sekret serbo-sllav dhe nga organet tjera të ndjekjes këtu, kur po rrezikoheshin të burgoseshin; Por, as edhe njëherë, s'kemi një lider i cili do të unifikonte këtë lëvizje.

Këtu në Kosovë, ilegalja, në vazhdimësi ishte përndjekur e persekutuar rëndë, dhe gati gjithherë dëmi më i madh do ti shkaktohet nga mercenarë e kolaboracionist të shumtë të pushtetit okupues. Sa e sa burrave e vajzave do t'iu vënë pranga për t'iu pamundësuar veprimi atdhetarë, sa e sa të tjerë do të martirizohen. Djemtë më të mirë do të flijohen nën dhunë të egër e në përballje me armë fytafyt me armikun. Mendoni këtu: Fazli Graiqevcin, Tahir Mehën, Rexhep Malën, Nuhi Berishën, Zija Shemsiun, Malë Morinën, Ali Ajetin, Xhemajli Berishën, Ukshin Hotin, Enver Topallin, Xhavit Hazirin, Zenel Sadikun, Mehë Ukën, Afrim Zhitinë, Agron Rrahmanin, Fadil Vatën, Fahri e Bahri Fazliun, Besim Ndrecën e shumë e shumë të tjerë.

Guerilja

Me sa dukej, sidomos në fillim të veprimit të sajë, guerilja po vepronte tepër vëmendshëm. Kjo, për faktin që kishte përzgjedhur njerëzit e sajë me tepër kujdes dhe se po vepronte nga pozita të ilegalitetit dhe konspiracionit të thellë, ndërsa edhe këta më pas do ti mbërrijë dora e zgjatur kriminale. Kjo, para se gjithash ngase ishte e ndarë duke qenë e krijuar nga dy organizime politike (LPK dhe LKÇK) dhe e udhëhequr e dirigjuar nga dy qendra të vendosjes. Ishte e ditur se do të kishte vështirësi veprimi pos të tjerash edhe për shkak të hapësirës së ngushtë për veprim meqë bëhej fjalë për veprime luftarake, ndërsa edhe mundësitë për dekonspirim të tyre ishin të mëdha. Mbi të gjitha, i mungonte përfaqësim i mirëfilltë e i denjë

politik mbështetur e krahasuar me seriozitetin e veprimeve që zhvillonte në teren.

Ndikimi i faktorit të jashtëm politik e ushtarak

Faktori politik e ushtarak ndërkombëtarë, fuqitë e vendosjes në bote, duke e parë se: Me gjithë dëmet dhe vuajtjet e shumta që kishim pësuar në të kaluarën shumë shekullore si pasojë e mësymjeve të një pas njëshme të hordhive të shumta barbare të fqinjëve tanë grabitqarë e të perandorisë turke, përkrahur padrejtësisht nga shtetet e Evropës me idenë për të na copëtuar, ndarë e shuar përfundimisht; Ne kishim rezistuar trimërisht, kishim mbijetuar dhe s'po i pushonin përpjekjet tona për të qenë të lirë e të bashkuar; Kishte vlerësuar, siç vlerëson edhe tani se: Çështja kombëtare shqiptare duhet shtruar për zgjidhje dhe se duhet zgjidhur ajo. Aq më tepër tani kur po përputheshin interesat e tyre gjeopolitike e gjeostrategjike me ato të shqiptarëve dhe kur ishin krijuar parakushte e mundësi realizimi të tyre meqë ishte shkatërruar tërësisht ish blloku komunist i lindjes, ndërsa krijesat sllavo-komuniste e ortodokse sovjetike e serbe po binin si kulla prej letre e po bëheshin gërmadhë. Këtu gjërat do të marrin rrjedhë.

Ndikimi i së kaluarës sonë historike

Fillimisht, në Kosovë, ishte vendosur "Vija e kuqe" e Presidentit Amerikan Bush. Që do të thoshte se këtu s'do të kishte luftë; Dhe ishte bërë mirë që s'ishim përfshirë në luftë të parët, por të fundit në ish Jugosllavi, edhe pse këtu po vlonte dhe se ne ia kishim bërë varrin ish Jugosllavisë.

Ndërkohë, në vitin 1997, do të shkoi në amshim Nëna Terezë, ndërsa kjo i kishte sjellë në kujtesë botës se shqiptarët kanë dhënë edhe Gjergj Kastriotin që për dekada me radhë kishte mbrojt pos lirisë së shqiptarëve edhe krishterimin dhe qytetërimin Evropian nga hordhitë otomane turke dhe nga po këta barbarë sllav që kishin lidhë aleancë me ta vetëm e vetëm që të na ndanin e sundonin me qëllimin e fundit, të na zhduknin tërësisht nga faqja e dheut. Do t'iu bien ndërmend edhe gjithë ata Papë e figura të ndritshme që i kishim dhënë Papatit në Romë, krishterimit e qytetërimit të hershëm Evropian, por edhe gjithë ata tridhjetetre kryeministra, për gjatë gjithë së kaluarës, Perandorisë Otomane Turke, përfshirë këtu edhe Enciklopedinë e parë turke si dhe Rektorin e parë të universitetit Turk (Sami Frashëri), themeluesin e Turqisë moderne (Mustafa Kemali) duke shkëputë kështu këtë fuqi botërore nga e kaluara e sajë pushtuese, si dhe Himnin e Turqisë moderne (Mehmet Akifi). Do të jenë ndihmesë e madhe për ne, porosia e Papa Pavlit të II- të, Vojtila, dhënë Presidentit Amerikan Klinton: "Që të mos lejohej të shuhej ky popull, i cili ka dhënë kaq shumë" e edhe Nënën Terezë së fundmi; Ecejaket e diplomatit Amerikan Gelbard, sa për të vringëlluar armët këtu, dhe ato të diplomatit Hollbruk që ne ta fitojmë luftën e me këtë edhe lirinë.

Ti kthehemi gjendjes së atëhershme, të para luftës këtu, njeriut tonë dhe rrethanave në të cilat vepronte ai, për të bërë pjesën tonë të punës, ngase rezistenca duhej vazhduar madje këshilloheshim ta bënim këtë me mjete të tjera. Thjeshtë këtu duhej të vringëllonin armët. Dhe këtë po na e thoshin në vazhdimësi, madje krejt hapur, diplomat

të shumtë, miq tanë perëndimorë. Pati edhe të tillë që, ngase ne s'po kuptonim nga ç'na thuhej, do të na e thonë në sy të botës se: "Nuk mund të pritnim një supermen të na i zgjidhte problemet".

Politika e ndejës dhe pritjes këtu duhej ndërruar me atë të veprimit dhe kjo: Sa më parë aq më mirë. Pritja mbyste, ndërsa që ne po degradonim.

Kudo në Ish Jugosllavinë që po binte kishte zhvillime. Shumica e këtyre zhvillimeve po përcilleshin me tragjedi njerëzore. Ne ishim në grykë të ujkut e shpëtimi mund të gjendej vetëm nëse dalim nga aty. Asgjë s'ishte e lehtë, ndeja paraqiste fatalitet.

* * *

KRONOLOGJIA E NGJARJEVE

Krijimi i sistemit shumë partiak në Kosovë

Në fillim të viteve të nëntëdhjeta, në kohën e "demokratizimit" të ish Jugosllavisë, kur po vendosej sistemi shumë partiak i jetës politike dhe i qeverisjes; Në Kosovë ishte krijuar Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e më pastaj edhe ndonjë subjekt tjetër politik, të cilat gjithë herë do të mbesin minore dhe në margjina të kohës e zhvillimeve për faktin se, sikur, LDK ua kishte zënë rendin, meqenëse ishte krijuar e para dhe se e kishte "heqë" nga skena politike përfundimisht Lidhjen e Komunistëve (LK). Me këtë "demokratizim", do të lirohen (disa prej tyre, deri në burgosjen tjetër) numër i madh i të dënuarve politik, që deri atëherë kishin vuajtur dënime të rënda burgu në të gjitha burgjet e ish Jugosllavisë, të cilët

jo vetëm që do të anëtarësohen në LDK për të vepruar bashkërisht për të drejtat tona të përgjithshme, por edhe do ta ndihmojnë atë që në fillimet e sajë: në themelim, në rritje dhe në krijimin e strukturës organizative. Dhe këtë do ta bëjnë "me një marrëveshje" për ta ngritë e fuqizuar, për ti dhënë fuqi e shpirt, duke derdhë djersë e mund, deri në realizimin e të drejtave tona për çlirim e bashkim kombëtarë.

Shumë shpejt, kështu s'do të mendojnë struktura të LDK në përgjithësi e individ në këto struktura në veçanti. Prandaj, nga frika të cilën vetëm ata e dinë; ndaj ish të burgosurve dhe ish të përndjekurve politik, do të filloi një "luftë" tepër e ashpër speciale, me të cilën fillimisht synohej diskreditimi i tyre moral e mandej edhe përndjekja e tyre deri në largim nga radhët dhe strukturat udhëheqëse të sajë ose edhe më keq, do të dekonspirohet pjesë e veprimtarisë së tyre dhe do të jenë të përndjekur, të burgosur e të dënuar e persekutuar sërish nga pushteti i egër e barbarë serb.

Thënë të vërtetën, këta ish të dënuar e ish të përndjekur politik, kishin krijuar autoritet në masa dhe gëzonin respekt të madh në popull, sa për të kaluarën e tyre plot vuajtje e sakrificë, po aq edhe për mundin dhe punën e madhe që bënin në teren, në realizim të detyrave konkrete, që dilnin si nevojë e kohës në kuadër të veprimit në LDK, madje duke realizuar, gati gjithë herë, ato detyra që konsideroheshin me më rrezik, si: ato të sigurisë, ato të krijimit të regjistrave me emrat e të rinjve që mendohej të dërgoheshin në akademi përkatëse në Shqipëri për të krijuar kuadro të nevojshme ushtarake e policore për

ministritë përkatëse që synoheshin të krijoheshin dhe për të ardhmen e vendit, si dhe punët e sigurisë kur mbaheshin zgjedhje ose kurë është mbajtur referendumi për tu pavarësuar. Por, edhe në kuadër të organizimeve tjera, që të shumtat i kishin krijuar, mu këta, për të plotësuar gjithë nevojat, ose së paku ato nevoja që mund ti plotësoheshin popullatës së terrorizuar skajshmërish në ato rrethana; për të realizuar të drejta qytetare e njerëzore duke përfshi këtu ndihmesa e shërbime nga më të ndryshme, madje edhe duke ngjallë jetën kulturore. Me gjithë tërë këtë punë kolosale, këtë mund e djersë të derdhur; Meqenëse krejt kjo ishte e porositur dhe e inskenuar mirë nga kolegë të tyre- aktivist të tjerë të LDK, shpeshherë do të sulmohen edhe publikisht se gjoja ishin futur në LDK, siç thoshin: "Për ta marrë kalanë nga brenda". Kështu, duke qenë shpesherë edhe të etiketuar në forma të ndryshme, në të shumtën e rasteve ishin të detyruar të mbroheshin ose të mbylleshin pafajshëm në gëzhojën e tyre dhe të ndiheshin keq.

Është shumë e ditur dhe krejt e kuptueshme, që numër i madh i këtyre veprimtarëve të devotshëm, të mos themi të gjithë, ishin edhe pjesë e ilegales dhe se këtu, në LDK, ishin për të dhënë kontribut e ndihmesë, por edhe për tu kamufluar në sy të armikut. Këtu, kryenin legalisht, ashtu haptazi dhe në sy të okupatorit një numër të konsiderueshëm të detyrave nga qëllimi i programit të tyre, ndërsa asnjëherë me veprime të tyre s'e kanë dëmtuar "punën" dhe "imazhin" e LDK, ngase kështu më së miri edhe mbronin veten, përkundrazi janë mu këta djem e vajza, burra e gra që po bartnin tërë peshën e barrës

kryesore në organizim dhe në kryerje të detyrave më me rëndësi për veprim të suksesshëm politik e çlirimtarë-kombëtarë.

Dalja publike e UÇK

Në fund të vitit ’97, me daljen publike të UÇK, siç thotë populli: “Ndahen dhentë e dhitë”; Dhe këtu fillon liria për të gjithë çlirimtarët. Me gjithë, tërë atë mund, djersë të derdhur e punë të bërë, ishte derdhur edhe shumë gjak krejt i pafajshëm, ndërsa gjendja edhe më tej ishte përkeqësuar; ngase ishte në realizim plani serb për shfarosje në masë, mundësisht, të krejt asaj që ishte shqiptare ose së paku dëbimi masiv i yni përtej Bjeshkëve të Nemuna dhe kjo ishte bërë krejt e ditur, madje publikisht, në gjithë arsenalin e mediave serbe të kohës; por edhe nga zëra çetnikësh serb në instanca të larta shtetërore të organizimit politik e ushtarak serbo-sllav në Serbi e në ish Jugosllavi, kurse realizimin e këtij plani, e shihnim çdo ditë në vrasjet dhe dëbimin që po na bëhej në plan individual si shoqëri e si komb. Ishte tepër e dhimbshme, se edhe ne shqiptarët, ishim degraduar ndjeshëm madje edhe në planin moral dhe se rreziku i shkrirjes, i asimilimit dhe tjetërsimit të një numri të konsiderueshëm prej nesh ishte shumë i mundshëm dhe potencial, ndërsa që kishte raste të izoluara në shoqërinë kosovare që kishte ndodhur e që po ndodhte kjo.

Vet dalja e UÇK, na kishte ringjallë, na e kishte kthyer dinjitetin e humbur e të nëpërkëmbur. Tani më s’kishim as edhe një arsye të mos ishim të lumtur. Thënë

thjeshtë: Na e kishte ndritur mendjen e na i kishte mbushur zemrat plot freski. Në fund të fundit edhe mund të humbnim, ama tani, fillimisht, mund ta humbnim luftën e tek pastaj të humbnim ne, ndërsa i takonte së kaluarës dhe kishim të drejtë edhe të harronim drojën se po humbnim në heshtje, në mënyrë krejt qyqare. Edhe humbja e luftës s'do të më vinte më rishtuese se sa ajo ikja e madhe, krejt heshtur, për në Perëndim dhe ai dorëzim aq qyqarë para së keqes së madhe që po na ndodhte të humbnim atdheun e kur po bëheshim hiq. Por ja që kishte pishtarë lirie që po rrinin ndezur, dhe këtu po shembej e keqja e po lindte agu i lirisë.

Sakrifica e Komandantit Legjendarë Adem Jashari dhe vetëflijimi me përmasa legjendare i familjes Jashari, e kishte bërë të gjëmojë tokën e Kosovës e të viseve shqiptare. Ata që e dëgjuan këtë gjëmë; Ata që e kishin dëgjuar zërin e atdheut, shumë shpejt i plotësuan e i shtrënguan radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës atje ku ishin të krijuara dhe i krijuan me shpejtësi rrufeje atje ku si gjeje. U vërtetua, për të satën herë, se në gjene të atij që ka gjak shqiptari lexohet qartë fjala liri dhe se shqiptari, sa herë paraqitet nevoja, e bën vdekjen si me le.

Ndërprerja e aktivitetit politik në LDK

Në fillim të veprimit publik të UÇK, sapo kisha organizuar e mbajtur zgjedhjet në nëndegën e LDK, në Vraniq, ku isha kryetarë i kësaj nëndege e njëkohësisht edhe kryetarë fshati për disa vite me radhë; në të cilat zgjedhje s'kisha pranuar, me gjithë insistimin e madh të

njerëzve të jem pjesëmarrës e as i zgjedhur i tyre; kisha pushuar veprimin dhe aktivitetin tim në të. Meqenëse ajo (LDK) s'po e pushonte aktivitetin e saje politik; me marrëveshje, e kisha lënë Bislim Muqën, të mbante lidhjet tona të nevojshme, për të realizuar detyra, në rrethana të reja të luftës, kurse shokët nga kryesia e re e fshatit më kishin lutur që mundësisht, edhe unë të jem i pranishëm, madje në çdo takim të tyre dhe kështu ishte vendosur e do të veprojmë kështu, derisa unë të mos kem kohë për "ndeja" të tilla, ndërsa Bislimi "fillon ti pengojë" dhe "ju bëhet i tepërt". Më pas, lidhje krejt labile me LDK do të na i mbaj Musli (Hasan) Muqa).

Fillimet e aktivitetit politik- ushtarak

Në pjesën e dytë të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998, do të jem në kontakt të vazhdueshëm me Hysen Gegën, Halil Krasniqin, Ilaz Kadollin, Gafurr Elshanin, Haki Gashin e me shokë të tjerë dhe do të shqyrtojmë mënyra të veprimit në rrethana të reja të krijuara në Kosovë.

Angazhimi në UÇK dhe krijimi i njësitit ushtarak në Vraniq

Më 15 maj 1998, në shtëpinë time vije stafi komandues i njësisë së UÇK "Çeliku 50", përkatësisht komandanti i këtij njësiti, Habib Elshani "Graniti" dhe Ilaz Kadolli, të cilët shtëpinë time do ta caktojnë bazë të parë ushtarake, ndërsa mua më japin detyrë të krijojë e të

komandojë njësinë e parë të UÇK në këto anë, në gjithë pjesën Jug-Lindore të Komunës së Suharekës. Gjatë marsit të atij viti, unë, së bashku me Bislim (Rrustem) Muqa, Azem (Miftar) Kolgeci dhe vëllain tim Enver (Ibrahim) Basha do të krijojmë bërthamën e më pas njësitin në përbërje të te cilit do të veprojnë dy skuadra, të cilat i komandonin Bislim Muqa dhe Azem Kolgeci, kurse në përbërje të njësitit kishte shtatëmbëdhjetë ushtarë, të gjithë të armatosur e të cilët deri në qershor do të bëjnë roje vëzhgimi. Ky njësit ushtarak deri në fund të muajit qershor, kur ishte krijuar komanda e Brigadës 123 dhe komanda e Batalionit II; do të veprojë në kuadër të njësitit "Çeliku 50" e nën komandën e komandant "Graniti", ndërsa që deri në këtë kohë, ishim në pritje të ardhjes së një oficeri, ngase kështu ishim marrë vesh me "Çeliku 50".

Për të arritur këtë, në ndejat tona, të cilat edhe ashtu ishin gati të rregullta, do të përflasim në njëfarë mënyre shumë njerëz në fshat, për të cilët mendonim se mund të kishin armë e që do të donin të na bashkoheshin; dhe qeshtë e vërteta, në asnjë rast s'kemi dështuar. Ka pasur dy raste që njerëzit s'kanë qenë të hapur me ne, ndërsa me kalimin e kohës njëri prej tyre na e ka dhënë armën, kurse tjetrit i është mobilizuar arma pas ligjit për mobilizim. Rritjen numerike të njësisë e bënim në mënyrë të vazhdueshme dhe shkonim duke e gjetur dhe angazhuar njëri tjetrin. Katërshes së parë, fillimisht, i ishte bashkuar Sali (Adem) Llugaxhiu, i cili pos të tjerash, merr detyrë të aftësojë stanin e tije në bjeshkë për nevoja lufte. Më pas, shumë shpejtë na janë bashkuar, sipas radhës: Haki (Kadri) Muqa, Milazim (Bajram) Kolgeci, Rrahman (Ismajl)

Muqa, Sadik (Brahim) Kolgeci, Sedat (Xhemajl) Muqa, Besnik (Avdyl) Basha, Destan (Ramadan) Llugaxhiu, Haki (Hazir) Llugaxhiu, Besim (Sherif) Muqa, Sherif (Imer) Shehu... , kurse rritja ishte e shpejtë dhe s'kishte të ndalur.

Si kudo tjetër edhe këtu kishte ndikuar uniteti që kishim krijuar, veçmas pajtimi i brendshëm i arritur vite më parë kishte mundësuar të frymonim shqip e të dilte në pah krenaria njerëzore dhe ajo kombëtare që tani do të thoshte guxim për t'iu kundërvu dhunës, terrorit, tendencës të na shuanin dhe nëpërkëmbjes e përbuzjes që po na bëhej shekuj me radhë si njerëz e si komb.

Bërthama e njësitit të parë të UÇK, në Vraniq, dhe në pjesën Jug-Lindore të Komunës së Suharekës: Bislim Muqa, Skender Basha, Azem Kolgeci dhe Enver Basha.

Veprimi i njësitit ushtarak në Vraniq

Kishim caktuar dy vende roje e vëzhgimi në të cilat ruhej e vëzhgohej natën e ditën, pandërprerë. Njëra ishte caktuar në fund të lagjes së Llugagjive, në hyrje të fshatit Vraniq nga ana e Suharekës, ndërsa tjetra në hyrje të

fshatit, nga ana e Popolanit. Ishte ideja të përcillej çdo lëvizje në rrugët që binin në Vraniq, kurse mendonim të alarmonim banorët e fshatit në rrethana të pazakonta dhe të rrinim në mbrojtje të tyre me mundësitë që kishim. Disa prej nesh kishim armët tona, ndërsa për ndonjërin, me shumë vullnet, do të na i japin armët e tyre: Isuf (Ramadan) Kolgeci, Fadil (Bafti) Krasniqi nga fshati Maqitevë etj.

Vizita njësitit "Pëllumbi" në Drenicë

Në ndërkohë, për të parë përvojën e shokëve tanë dhe të luftës, do të shkojmë në Drenicë, në Vuqak, te një shok i Bislimit, Ferat Shala, i cili me njësitin e tij "Pëllumbat", në atë kohë, po e mbante të mbyllur e të pakalueshme për forcat serbe Grykën e Llapushnikut; Dhe në shtëpinë e Jakup Krasniqit ku do të bëjmë një ndejë të shkurtër me plakun e tij: Unë, Bislimi, Azemi, Enveri dhe Salihu. Këtu do ta kemi fatin të shohim armatim të shumtë, të rëndë këmbësorie përfshirë minahedhës e raketahedhës dore, pushkë- mitraloz të rëndë e kundërajrorë si dhe topa pa dridhje e municion dhe predha të shumta, që sapo ishte sjellë nga Shqipëria; Do të mësojmë mënyrën se si organizoheshin për të shkuar për armë e municione në Shqipëri e si e bënin jetën në rrethana lufte e në vendin ku po luftohej për liri. Do të na mbetet në kujtesë një grup luftëtarësh të cilët i kishin lënë armët nën hije, ndërsa ata po mihnin misër. Si idealist që isha krijuar, do të më pëlqejë pa masë gjithë kjo që pamë, sidomos qëndrimi e thjeshtësia e komandantit Ferat Shala, por edhe

përkushtimi dhe mënyra se si ju kishte qasë luftës ky yll, tamam tribun popullorë. Në mendje më pat ardhur Malë Morina i Lubeniqit të Pejës dhe krejt urtësia e tij për mikun e urrejtja për armikun. Ndjeja se fitorja ishte në duart e çlirimtarëve, se liria po vinte shpejt dhe se atë e kishim te pragu. Krejt në prag e kishim luftën që deshe s'deshe duhej bërë, kurse brenda pragut, në vatër, ishte serbi me tërë pushtetin e dhunshëm dhe këtu s'duhej pritur më.

Vizita e parë njësitit të Vraniqit

Gjate kësaj kohe, njësitin tonë do ta vizitojë Idriz Hyseni nga Drenica dhe Avdi Kadolli, me ç'rast së bashku do ti bëjmë një vëzhgim, me shumë kujdes, për së afërmi e gjithanshëm, objektit të Antenës në Maja e Ahishtës mbi fshatin Vraniq, për të parë e për të ditur gjithë potencialin në njerëz e në armatim që kishte armiku aty. Këtu jam siguruar se asgjë s'mund të ndodhte pa dijeninë tonë, pa marrë mendimin tonë, pa përgatitjet e duhura dhe pa angazhimin tonë direkt në veprime. Ne, tashmë, ishim bërë faktor në zhvillime të mundshme në teren, dhe këtë do ta ruajmë deri në përfundimin e luftës sado që sfidat ishin të mëdha e me rreziqe.

Përgatitja e terrenit për veprim dhe shtrirje

Tani më, këtu ishin bërë edhe të gjitha përgatitjet tjera, të duhura, për rrethanat e reja. Unë, do të këshillohem me Bajrush (Sahit) Llugaxhiun e me Sejdi

(Miftar) Muqën, ndonjë herë edhe me Mustafë (Adem) Kolgecin, të cilëve, edhe ua bëja të ditura veprimet tona dhe mënyrën se si i bënim këto veprime. Më pas, do të regjistrojmë vullnetarë të cilët do të na i ushtroj e përgatitë fizikisht, Baki Llugaxhiu i ndihmuar nga Ramiz (Sokol) Kolgeci, ndërsa për anën taktike dhe për mënyrën e të luftuarit do ti përgatitë për luftë "ABI" Afrim Basha. Këto ushtrime e përgatitje të te rinjve vullnetarë ishin të domosdoshme ngase shumica e tyre s'kishin bërë shërbim ushtarak e as ndonjë stërvitje të duhur, ndërsa i mbanin në "Ara e Sutit" mbi fshatin Vraniq. Këtu i provonin armët dhe municionin, por edhe stërviteshin në gjuajtje provuese me armë dhe me bomba e granata dore për tua parë efektin e për të heqë tremën te ushtarët. Do ta caktoj shitoren në objektin e shtëpisë së Hamit (Isuf) Rraqit si qendër për grumbullimin e informatave nga vëzhguesit tanë të shumtë dhe nga banorët e informuar për këtë, ndërsa meqenëse në shitore po rrinte, gati gjithë herë, Hamiti, ia kisha lënë porosinë që ti sistemonte, përpunonte e shkoqiste këto informata dhe të na i përcillte si të tilla.

Në marrëveshje me Velime (Brahim) Loshin kishim vendosë që komanda e njësisë të vendosej në shtëpinë e tyre, kurse po mendoheshim të merrnim për baza ushtarake: shtëpitë e Veli (Xhemë) Muqa me të cilin gjithashtu e kisha biseduar këtë çështje dhe kishim marrë pëlqimin e tij, dhe shtëpinë e Asllan (Hajriz) Matoshi, që të dy këto në lokalitete me hapësirë dhe ambiente të përshtatshme për tu vendosë dhe zhvilluar aktivitete të duhura e të nevojshme ushtarake. Ndërkaq që vend-rojat po mendonim ti tërhiqnim më thellë nga buzë- rruga

kryesore e fshatit siç ishin në shtëpinë e Bislim Muqa e në shtëpinë e Nebih (Durak) Kolgeci dhe ti vendosnim në objekte prej nga mund të kishin qasje të nevojshme (nga distancë pak më e madhe) në rrugë për të realizuar detyrat e tyre por që do të ndjeheshin më komod dhe më të sigurt gjatë dhe pasi të kenë realizuar këto detyra të tyre.

Të përgatiturit, ata që po kryenin ushtrimet, i sistemonim në radhët tona dhe i vendosnim të bënin roje sipas rregullit që kishte krijuar njësiti, të cilin rregull e mbante: Besnik Basha, Milazim Kolgeci dhe Sali Llugaxhiu. Të thuash se të gjithë burrat e fshatit ishin bërë ushtarë dhe gati të gjithë i kishim armatosur.

Ngase ishim rritur, dhe kishim potencial, vendosëm edhe një vend vëzhgimi, nën "Maja e Qukës, të cilin do ta mbajë lagjja Shehu. Roja, këtu ishte e pajisur me dylbi, të mund të shihte në largësi dhe mbante pushkë gjuetie, sa për të dhënë alarmin. Këtu, veçmas do të jenë të angazhuar njerëz të vjetër, të pjekur e të vëmendshëm. Angazhim dhe përkushtim të veçantë, për të bërë roje ose për të ndërruar rojat këtu kishin: Baki (Hysen) Shehu, Ismail (Ramadan) Shehu dhe Rrahman (Beqir) Shehu. Rrahmani ishte përgjegjës në këtë lagje edhe kur na duhej çfarëdo nga aty si dhe kur na duhej fuqi punëtore për të hapë bunker e istikame.

Ardhja e Komandant Sadik Halitjaha, shkrirja në Batalionin II

Në këtë kohë, në fund të muajit qershor, vjen Sadik Halitjaha, i cili kishte marrë detyrë të formonte e të

komandonte Batalionin II. Me të arritur, Sadiku, do të na kontaktojë dhe pasi ta kemi informuar se ne, këtu në Vraniq, kishim një organizim dhe se që moti po vepronim; së bashku do të vendosim që ky njësit, që po vepronte në Vraniq, të ishte Togë që do të vepronte në kuadër të Kompanisë III e cila me veprime të sajë mbulonte territorin e Buzhalës, Bukoshit dhe Vraniqit, e në kuadër të Batalionit II, me komandë në Budakovë. Këtu e këtej ishim sistemuar në Batalionin II dhe do të veprojmë nën komandë të Komandant Sadik Halitjaha.

Ardhja e luftëtarëve nga mërgata e vatrat e dijes

Po në këtë kohë, nga shtete perëndimore të Evropës, do të na vijnë edhe mërgimtarët tanë, luftëtarët e lirisë: Sali (Jakup) Basha, Zaim (Smajl) Muqa, i cili po vepronte që kohë më parë në Podrimje, Shpejtim (Isë) Basha, Mujë (Xhemajl) Llugaxhiu, Feriz (Imer) Llugaxhiu si dhe Afrim Basha "ABI" dhe Agron (Osman) Basha të cilët kishin vepruar në Rekë të Keqe e në Smolicë e ndonjë tjetër; Ndërsa që Reshat (Mejdi) Muqa, që moti, kishte lënë studimet në Universitetin e Kosovës në Prishtinë dhe në radhët e UÇK ishte rreshtuar e po vepronte: në Drenicë, në anë të Malishevës e në anë të Podrimjes, në Rahovec e në rrethina të Rahovecit si dhe kudo tjetër në zona të luftës.

Dëshmori i Kombit: Reshat (Mejdi) Muqa (1975- 25.03.1999)

Dëshmori i Kombit: Zaim (Smajl) Muqa (1969- 05.04.1999)

Kishte lënë studimet e kishte ngjeshë radhët e UÇK edhe Bashkim (Shaban) Luzha i cili po vepronte në Dobërdelan, kurse këtu në Vraniq po rreshtoheshin edhe luftëtarë nga fshatra përreth e nga anë të ndryshme të Kosovës. Edhe Zaimi, edhe Reshati, deri më tani, ishin sprovuar dhe kishin lënë pas një varg të tërë betejash të përgjakshme të luftës për liri e bashkim kombëtarë. Ndërsa që Reshatit veçmas po i përmendej, me shumë respekt, lufta e madhe që kishte zhvilluar në Zaqisht të Rahovecit; Zaimi edhe më tej po radhiste pjesëmarrjen, në të gjitha betejat që po ndodhnin, kudo që po dëgjonte se do të zhvilloheshin luftime. E veçanta e Zaimit do të jetë se e kishim shumë fish më trim se që ishte nevoja për trimëri e se që e donte puna. Rënien për liri, që do ta bëj më pas, e bën tamam si Jakup Ferri, ndoshta rast i vetëm i përsëritur në histori.

Angazhimet në Batalionin II

Takimin e parë me Sadikun e kisha në odën e Sadri (Azem) Kokollarit, në Budakovë. Odën tashmë baca Sadri e kishte dhënë që të vendosej komanda, ndërsa kishte dhënë edhe djalin e tij Kadriun për luftëtarë dhe vajzën e tij "Shota" për luftëtare të lirisë. Ky burrë kreshnik, me ti përmendur, do të falë edhe gjakun e djalit të tij të vrarë kohë më parë, ndërsa edhe vet do të rrokë pushkën dhe do ta mbajë fortë në duar, gjithmonë përkrah nesh. Kadriu, vritet në betejën e parë me forcat armike, te Dardhishta e Poshtme, duke u bërë dëshmori i parë i Batalionit II e i kësaj ane, ndërsa "Shota" do ta bëj luftën përkrah vëllezërve të sajë deri në fitoren definitive mbi pushtuesin.

Foto nga takimi i parë në fillimet e luftës, Skender Basha dhe Sadik Halitjaha

Hava Bytyqi, Komandant Sadik Halitjaha, Meritë Vata, Tahir Veselaj, Sadri Kokollari dhe Skender Basha.

Komandant Sadik Halitjaha, Sadri Kokollari dhe Skender Basha

Me komandant Sadik Halitjaha së fundmi ishim parë, në ndarje, në Gjykatën e Qarkut në Prizren, me të përfunduar procesi gjyqësorë ndaj nesh; Ndërsa që unë po mendohesha e krejt kjo po më dukej si të ishte një film i

mirë, komandanti po më përmendte porosinë që në ndarje i kisha lënë: “Të vepronte pareshtur për liri”.

Dalja publike e Njësitit të UÇK në Vraniq

Rrethanat e krijuara nga sulmi i parë i forcave armike, kundër pozicioneve të UÇK, në Budakovë, përkatësisht kundër ushtarëve të parë të Batalionit II, i cili ishte në formim, më 03. korrik 1998, bënë që njësiti i Vraniqit ti bëj publike ekzistimin dhe veprimet e veta, ndërsa që vet dalja publike do të jetë befasi e këndshme për njeriun e këtij vendi, e veçmas mënyra aq korrekte dhe krejt ushtarake e sjelljes së këtyre burrave, të gjithë në moshë pjekurie të plotë, që tashmë po bëheshin djem Kosove e luftëtarë lirie.

Për të përforcuar shokët, në Budakovë, në betejën që po zhvillohej te fshati Dardhishtë e Poshtme e në fshatin Muhlan, shkojnë: Azem Kolgeci, Enver Basha dhe Rrahman Muqa, ndërsa ushtarët tjerë nën komandën dhe urdhrat e mi; të ndarë në dy skuadra e me të cilat komandonin: Bislim Muqa e Milazim Kolgeci, kanë vënë pengesa dhe kanë zënë pusi në të dy rrugët që vijnë në Vraniq.

Në rrugën që vjen nga Suhareka, në fund të fshatit Vraniq e në dalje të fshatrave Bukosh dhe Savrovë, kishin prerë e rrëzuar lisa bungu të trashë, ndërsa në rrugën që vjen nga Popolani kishin vendosur lesa të kthyera mbrapsht e rimorkio traktorësh. Kështu kishim evituar mundësinë që Budakova të sulmohej edhe nga këndej.

Këtë ditë për të na përforcuar ne, në Vraniq, kishte ardhur Safet Kica i cili fillimisht ishte rreshtuar këtu, në njësitin tonë e në skuadrën e komandantit Bislim Muqa, ndërkaq që siç më kishte thënë, më pas, Bislimi, gjatë këtyre veprimeve, duke e parë gjallërinë e Safetit dhe se po dallohej për trimëri në veprim; Bislimi, i kishte ofruar mundësinë e komandimit të skuadrës, e meqenëse Safeti se kishte marrë komandën e në shenjë respekti të ndërsjellë, në këtë aksion luftarak, e kishin komanduar e udhëhequr bashkë njësinë.

Ushtarët e këtij formacioni, së bashku me komandantët e tyre, në këtë periudhë kohore, dy herë i kanë shkuar në përforcime Kompanisë IV që vepronte ne Maqitevë e me të cilën komandonte Selim Haziraj, gjersa po zhvilloheshin luftime te "Guri i Kuq", e në "Qafë të Rokopeqit", kurse më pas po ndihmonin në mbajtjen e "Pikës" në lagjen Buzhalë të Budakovës dhe po përforconin njësit tona, të tjera, në luftimet e pareshtura, gati të përditshme, në Griqec dhe te "Zalli i Verdhë".

Si përgjigje kërkesave të shumta për armë dhe për municione, kishim provuar dy herë, pa sukses, të dërgonim njerëz tanë në Shqipëri, dhe që të dy herët do të na kthehen nga Reshtani prej nga duhej të niseshin në mënyrë të organizuar. Këtu duket të ishim me shumë fat ngase iu ishim shmangur shumë vuajtjeve, mundimeve por edhe rreziqeve që provonin luftëtarët tanë, por do të përpiqemi, e në të shumtën e herave do ia dalim të bëjmë më të mirën.

Përkrahja financiare nga Shoqata "Vraniqi" në Zvicër

Në këtë hov të zhvillimeve këtu, kurbetçinjtë tanë në Zvicër, të organizuar në shoqatën e tyre "Vraniqi", nën udhëheqjen e Hamit (Miftar) Kolgeci, Sylë (Tahir) Llugagjiu e Mustafë (Mulë) Basha, me qëllim të përkrahnin luftën tonë, krejt në bazë vullnetare, kishin grumbulluar nëntëdhjetëmijë (90.000) marka gjermane. Këto mjete na i dërgojnë pa humbur kohë, ndërsa unë isha i përzgjedhuri i tyre për ti menaxhuar ato. Për të realizuar mirë këtë, kishim krijuar një grup, komision, prej shtatë vetash, nga njerëz që kishin autoritet dhe që gëzonin respekt në fshat: Skender Basha, Jakup (Azem) Llugaxhiu, Vesel (Tahir) Llugaxhiu, Sali Llugaxhiu, Bislim Muqa, Azem Kilgeci. Në këtë grup, do të jetë edhe një që përfaqësonte kryesinë e LDK në fshat përkatësisht Tahir (Vesel) Kolgeci, të cilin, me kërkesën tonë që të na dërgohej përfaqësuesi i tyre, na e kishte dërguar kryesia e fshatit e i cili shumë shpejt do të largohet nga këtu, ndërsa kurrë s'do të mësojmë arsyen e këtij largimi. Mjetet i ishin lënë ti mbajë e ruaj Jakup (Azem) Llugaxhiut, ndërsa nën kryesimin tim, këto mjete do të shfrytëzohen në tërësi për nevoja të shumta, të ndryshme, të luftës; Kryesisht për armë e municione për ushtarët e fshatit ngase me këto mjete ne po armatosnim e veshë- mbathnim secilin nga fshati Vraniq që po rreshtohej kudo në radhët e UÇK, por edhe për uniforma, ushqime e veshmbathje për ushtarët e Batalionit II dhe ata të njësisë së komandant "Guri", ndërsa që po bënim edhe ndonjë ndihmesë të vogël bamirësie civilëve në fshat siç ishte rasti kur i kishim blerë një dhi një familje nevojtare.

Pas një periudhe të shkurtër kohore, në vizitë të rregullt familjes së tij këtu, në Kosovë, do të vjen Mustafa. Praninë e tij këtu e kishim shfrytëzuar ta njoftonim, në detaje, me zhvillimet këtu; me mënyrën se si po i menaxhonim këto mjete, ndërsa për të pas një pasqyrë më të plotë mbi gjendjen reale e kishim dërguar në vizitë në ndonjë njësit të UÇK këtu dhe në njësitin e komandant "Guri". E kishim bërë këtë, që Mustafa të mund të bënte një kallëzim, sa më të plotë, të kësaj gjendje bashkëvendësve tanë në Zvicër.

Në lidhje me krejt këtë, kreut të Shoqatës "Vraniqi", me të përfunduar lufta i kishim bërë raport shtatë faqesh me shkrim, kurse bashkëngjitur këtij raporti iu kishim dërguar të gjitha faturat, të nënshkruara nga shfrytëzuesit e këtyre mjeteve.

Edhe kurbetçinjtë tanë në Gjermani kishin provuar të vepronin njësoj. Por duke mos qenë të organizuar si duhet, sado që kishin grumbulluar, siç na kanë thënë, dyzetmijë marka gjermane. Shumë shpejt, meqë s'po mund ti qonin çështjet përpara, fillimisht kishin menduar t'ia kthejnë këto mjete donatorëve, kurse shumë kohë më pas ia kishin dërguar qendrës së Shoqatës "Vraniqi", në Zvicër, ndërsa nga kjo ndërmarrje do të dalin krejt të thyer e të përçarë dhe këtu përfundon tërë aktiviteti i tyre. Këto mjete, kjo shoqatë, i kishte ruajtur deri në përfundim të luftës, kurse më pas do të bëj ndonjë meremetim në shkollën e fshatit tashmë të riparuar nga ndërkombëtarët dhe do të përkrahë ngritjen e lapidarit për dëshmorët.

Përkrahja materiale nga fshati

Vraniq e përkrahës të tjerë

Kur flasim për përkrahjen materiale që i ishte bërë luftës e kam të vështirë të përmendë gjithë këtë përkrahje, ndërsa duhet veçuar ndihmesën dhënë në forma e mënyra të ndryshme të Ali (Mulë) Bashës dhe Bislim (Rrustem) Muqës. Sofi (Muharrem) Muqa na kishte dhënë 100 marka gjermane për nevoja tona dhe një shtek cigare për ushtarin Mahmut (Sadik) Muqa i cili ishte rreshtuar në Kompaninë IV në Maqitevë, kurse pasi të jemi riorganizuar, më ka rënë të dëgjojë se Hasan (Ramadan) Kolgeci i kishte dhënë 250 marka gjermane komandës sonë, por që unë se di përmes kujt dhe kurë e ka bërë këtë. I ngjashëm ishte rasti edhe me Regjë (Regjë) Matoshi kur i kishte dhënë 500 marka gjermane.

E madhe ishte edhe ndihmesa që bënte Ramiz Haziraj, Elmi Haziraj dhe Ahmet Asllanaj nga fshati Gjinoc, kryesisht me karburante për makina, por edhe me perime për nevoja të ushtrisë e të popullatës, si dhe Xhavit Sadikaj, Shpëtim Sadikaj e Sadri Gashi nga fshati Sopijë, dhe Riza Vata e Milazim Vata nga fshati Sallagrazhdë me veshmbathje dhe gjëra ushqimore të cilat i kishim dërguar, që të gjitha, në njësitë tona: në Budakovë, në Maqitevë, por edhe në njësinë e Komandant "Guri" në Griqec.

Mund të thuhet se na ishin dhënë krejt pasuritë e njerëzve, veçmas automjetet e tyre, ndërsa thënë e vërteta ne kishim marrë, vullnetshëm, nga Zeqir (Shefki) Berisha një agregat për spitalin ushtarak në Buzhalë ku po merrnin ndihmën mjekësore dhe po gjenin shërim edhe të gjithë civilët në nevojë; Dhe sa për tu shërbyer dhe me kthim, një

kombi (tip xhipi) të Ali (Mulë) Bashës, këtë në rrethana tepër të rënda lufte, gjersa po zhvillonim luftime të ashpra me armikun dhe për të bartur të plagosur të shumtë mes të cilëve dhe në përpjekje për ti shpëtuar jetën Komandant Gjemajl Regjajt nga fshati Papaz, i cili kishte marrë plagë të rënda mes të tjerash edhe në gjoks, ndërsa që pjesë granate të minahedhësit i kishin depërtuar thellë në mushkëri e të cilat plagë po ia zinin frymën. Por që këtë kombi, Ali Basha s'kishte pranuar t'ia kthenim më, ndërsa ne, që atë ditë, ia kishim lënë në shërbim ambulancës ushtarake në Budakovë dhe njerëzve që po merreshin me tërheqjen dhe me bartjen e të plagosurve, të shumtë, nga vijat e fronteve të luftës. E meqë përmenda komandant Gjemajl Regjaj të them se ishte veprimtarë i hershëm, i devotshëm i çështjes kombëtare shqiptare dhe i çështjeve shoqërore në Kosovë, ndërsa që kishte vuajtur vite të rënda burgu, në Ish Jugosllavi, mu për këto çështje, kurse megjithëse e kishim dërguar me kohë në spitalin ushtarak në Breshanc, atje, pas dy dite, do të ndërroi jetë në mungesë dhe në pritje të kirurgut.

Përkrahja materiale nga LDK

LDK, në çdo nivel të organizimit të sajë, kishte krijuar siç i quanin ata Komisione për Mbrojtje. Në lidhje me këtë e për të plotësuar nevoja, nga popullata kishin kërkuar para të gatshme me të cilat kishin krijuar fond. Me sa më kujtohet, Nëndega në Vraniq, kishte grumbulluar rreth njëzetmijë marka Gjermane. Falë Bislim Muqës të cilin e kishim aty, mund të kishim qasje e njohuri për

zhvillimet dhe lëvizjet që bëheshin atje. Në fillim po vizitonin zona që po digjeshin nga zjarret e luftës dhe kishin ide ti ndihmonin ata në përballimin e gjendjes dhe në tejkalimin e vështirësive. Më pas duke e parë se këto zjarre lufte po zgjeroheshin, kishin vendosur ti ruanin ato, për kudo që paraqitej nevoja në zona më të afërta. Pasi kishin dëgjuar që kurbetçinjtë tanë në Zvicër kishin grumbulluar para e deri sa kishin kuptuar se ato para po me dërgoheshin mua, thjeshtë për ta bërë luftën; Ishin të mendimit, që me këto para, të meremetonin xhaminë dhe shkollën e fshatit. Krejt në fund, pasi që këtu vërtetë po vlonte, kishin vlerësuar se me këto mjete duhej të blinin barna dhe material tjetër, të nevojshëm, sanitarë, ndërsa që s'ishim në dijeni se ku po e mbanin e ruanin dhe se sa e ku e kishin shfrytëzuar.

Angazhimi dhe kontributi i punëtorëve shëndetësorë

Në këtë kohë, e edhe më pas deri në përfundimin e luftës, ishin të paktë mjekët që po tregonin se kishin ndërgjegje kombëtare e ndjesi humane në mbështetje dhe konform Betimit të Hipokratit që ata japin me tu bërë mjek; Dhe të përmendë këtu, me shumë respekt, punën e madhe dhe kontributin e veçantë, me shumë mund e sakrificë që ka dhënë që nga ditët e para të fillimit të luftës këtu e deri në përfundimin e kësaj lufte të madhe, tepër heroike: Doktori i mjekësisë, Ibish Ahmeti dhe gruaja e tij teknike e mjekësisë, Valdete Ahmeti si dhe Doktoresha e mjekësisë Dritë Sallauka dhe teknikët e mjekësisë Zymer LLugaxhiu e Arben Veselaj. Që të gjithë këta i gjeje pranë

e në shërbim të popullit, si dhe në ambulancë dhe në spitalin ushtarak, ndërsa që i kishim sa herë paraqitej nevoja, kudo, në të gjitha vijat e frontit të luftës edhe kur luftohej fyt a fyt me armikun. Kjo ishte vërtetë madhështi. S'mund të mos përmendë se Zymerin e kishim tepër aktiv edhe në detyra, të tjera të shumta të luftës, dhe rastin kur më kishin sjellë siç thuhet "në raport", Arbenin, se s'po rrinte në ambulantë, ndërkaq që këtë po e bënte, me këmbëngulje, ti lejonim të ishte në vija të frontit, atje ku shokët po merrnin plagët e ku po luftohej për liri ja vdekje. Me gjithë respektin flas edhe për angazhimin e veçantë e me tërë përkushtimin njerëzorë të Doktor Sejdi Elshani dhe Sali Asllanaj, i cili sapo kishte përjetuar ofensivën serbe në jug- perëndim të Suharekës, pa humbur kohë, kishte kaluar në përkrahje tonë dhe ishte me ne gjatë gjithë sprovës në përjetim të ofensivës serbe kundër nesh tani e më pas deri në përfundim të luftës së UÇK; Ndërsa që mjekë e teknik të tjerë të mjekësisë, do të marrin mundin e gjejnë angazhim vetëm në prag të përfundimit të luftës, në kohën kur armiku kishte kryer masakër në masë, në Suharekë dhe në fshatin Terrnje e në Sopijë; Që i bie se kishin ardhur të strehoheshin kur, personalisht, ishin rrezikuar seriozisht dhe kur ishte vënë në pikëpyetje jeta e tyre.

Edhe më tej ndajë mendimin se ky segment kishte dështuar edhe më parë, në periudhën e paraluftës, kur kishin hapë ordinanca private e kur i ishin rrekur pasurimit, ndërsa që populli ishte në vuajtje e mjerim.

Mjetet e mobilizuara për luftë

Më pas, shumë vonë, gati në përfundim të luftës e pasi të kishim në fuqi: Ligjin e Luftës për Mobilizim të Përgjithshëm të tërë potencialit ekzistues, njerëzorë e material, të nevojshëm për nevoja të luftës, më konkretisht, për të bartë ushtarët tanë të shumtë që po na plagoseshin e që po na vriteshin në të gjitha vijat e frontit të luftës, ngase po zhvilloheshin luftime tepër të ashpra, çdo ditë, në të gjitha vijat e frontit; E me kërkesë të Komandantit të Batalionit II, Fehmi Berisha, në Vraniq, kishim kërkuar dy automjete, të cilat do të na i japin me shumë dëshirë, Tahir (Vesel) Kolgeci dhe Zekë (Ramadan) Llugaxhiu. E dimë që, në këto rrethana tepër të rënda për ne, edhe Izet (Hamdi) Kolgeci, i kishte dhënë Batalionit II, automjetin e tij, për nevoja lufte dhe se ky automjet ishte mirëfilli në shërbim të këtyre nevojave, por që s'dimë kujt ia kishte dhënë, ngase kjo ishte bërë jashtë njohurive të mia për këtë zhvillim. Çfarëdo tjetër, që të ketë ndodhur, gjatë gjithë kohës së luftës, në kuptim të marrjes a mobilizimit s'ka të bëj me Batalionin II as me ushtarët e këtij batalioni, ngase ne vërtetë kishim krijuar, në batalion: rend, rregull dhe disiplinë, ndërsa ushtarët tanë kishin vet- disiplinë dhe karakter e moral të fortë luftarak krejt të pakontestueshëm, e nëse ka pasur ndonjë veprim të tillë, s'ishte në dijeninë time e të Komandës së Batalionit II, nuk na janë raportuar veprime të kësaj natyre, dhe se nuk kishim as edhe një vërejtje nga kushdo.

Disiplinën dhe rendin e rregullin si parakushte për suksese në jetën tonë prej luftëtarësh veç i kishim arritur.

Veprime kompromettuese dhe të dëmshme të individëve

Me të vërtetë është bërë luftë madhështore. Mbi të gjitha çmoj, se nuk më ka rënë të dëgjoj që dikush i ka shitur dikujt miell. Por, kjo s'do të thotë se s'kishte njerëz që përfitonin nga rrethana të rënda, të krijuara, të gjendjes së luftës. Ndonjëri prej tyre ishte lëshuar në fitim enorm nga telefona mobil që mbanin e të cilët njerëzit nevojtarë, meqenëse ishte me rrezik për ta të lëviznin e shkonin kudo më larg, i përdornin për komunikim, me pagesë, me njerëzit e tyre kudo e gjithkund jashtë Kosovës. Kishte të tillë që në përpjekje për të përfituar nga tregtia me mallra që bënin, do të bien në duar të armikut dhe do të pësojnë në mënyra të ndryshme madje edhe do të robërohen e vuajnë burgjeve te Serbisë, ndërsa ndonjëri prej tyre edhe do të humbë jetën në këto burgje. Ishte i ndjeshëm rasti kur kishim dërguar për lindje, gruan e një ushtari që po mbante vijën e frontit në Qafë të Duhlës për muaj të tërë, duke e ngrënë bukën me molla të papjekura, ndërsa është dashtë që Zymer Llugaxhiu, nga gjepi i tij, të paguaj njëqind marka gjermane, që ajo të lindë fëmijën nën përkujdesje të duhur profesionale- mjekësore edhe pse në kushte jo ambulante.

Tregtohej e fitohej edhe kur zhvilloheshin luftime, madje edhe gjatë ofensivave të ashpra serbe kundër nesh dhe në kohën kur po digjej çdo gjë, të thuash edhe dheu i Kosovës, e kur po derdhej mund, djersë e gjak i shumtë lirie. Dhe të jem i sinqertë, ishin të paktë, por ja që kishte të tillë. Kishte edhe të tillë, që ishte tepër denigruese, që kishin marrë madje me shumicë dhe në sy të njerëzve mallra nga më të ndryshme përfshirë edhe pajisje plastike

e pajisje tjera të nevojshme kuzhine prej dyqaneve në fshat që ishin thyer nga serbët që po merrnin pjesë në operacione të luftës e dhunës kundër të gjithë neve dhe çdo gjëje që ishte jona, ndërsa që këta s'po përmbaheshin dhe këtë po e bënin në prani dhe para syve të këtyre të huajve.

Rasti kur sa s'kishte plasë sherri

Ishin shqyrtuar gjithanshëm të gjitha mundësit tona, që të shtriheshim mirëfilli në Vraniq, deri nën fshatin Vraniq; edhe në Jug edhe në Perëndim. Por ja që mundësitë për të rritë zonën e veprimit, siç ishim mësuar ne ta quanim "Zonën e Lirë", mungonin. Në lidhje me këtë edhe filozofia dhe mënyra jonë e veprimit politik se thoshte e se lejonte këtë. Mbi të gjitha për të mos e ngushtuar hapësirën e njeriut të thjeshtë serb këtu dhe për të mos e provokuar me asgjë atë.

Paksa ngutshëm, nga operativa e Batalionit II, ishte marrë qëndrim të vendoseshin vija fronti luftimesh, në vendin para se të dilej nga Vraniqi në drejtim të lagjes Buzhala. Në rrethanat e kohës, ende s'ishte paraqitur nevoja që për veprime të drejtpërdrejta luftarake, të futeshim në oborret e njerëzve. Këtu sa s'kishte plasë sherri. Të parët kishin reaguar, arsyeshëm, ata që po iu futeshim në oborret e tyre, për ti bërë ato arena lufte. Më pas edhe kryesia e fshatit, fillimisht po ziente e më pas përfliste, por s'po thoshte gjë zëshëm e zyrtarisht. Si reagim, e si duket për ti provokuar paksa, struktura ushtarake nga Budakova kishin kërkuar, mu nga kryesia e fshatit Vraniq, të siguronin e gjenin një bager për të hapë

istikame në këtë vijë fronti dhe kjo ishte hera e parë që ishte kërkuar diçka nga ata. Meqenëse ishin strukur e futur thellë në gëzhojën e tyre të ngushtë, le që s'ishin në gjendje të reagonin, por s'ishin në gjendje as të gjenin një bager, sado që kishte të tillë në fshat e kudo më gjerë.

Sado që s'kishim as fërkimin më të vogël, përkundrazi donim të ishin pranë nesh e në shërbim të vendit e të luftës, këtë kohë, po rrija anash dhe sinqerisht po mendohesha si ta zgjidhë këtë e të tejkalojmë gjendjen e krijuar. Ngjarjet po zhvilloheshin shpejt. Ndokujt që po më pyeste në lidhje me këtë, i thosha prerazi se ishte çështje e operativës dhe e ushtrisë në përgjithësi dhe se ne s'mund t'iu përziheshim e aq ma pak ti pengonim në punët dhe në veprimet e tyre. Këtë e bëja bashkë me shpjegimin se: Në luftë pushon politika, se pushteti është ushtarak, se ka staf ushtarak përgjegjës për veprime, se gjërat bëhen me urdhër dhe se çdo urdhër duhet zbatuar ngase veprohet me Ligje të Luftës të cilat duhet respektuar madje duke iu nënshtruar tërësisht atyre, dhe se këto ligje janë të ashpra varësisht nga rrethanat. Ndërkohë, te unë vijnë kryetari i fshatit Bajram (Musli) Kolgeci dhe disa anëtarë të kryesisë së fshatit. Në bisedë të shkurtë me ta, mora porosinë dhe u obligova t'iu dilja në ndihmë. S'më kujtohet përmes kujt, i bëra të ditur këtë nevojë Vesel (Tahir) Llugaxhiut, i cili pas pak minutash, me bager, do të jetë atje, ndërsa brenda një pasdite kishte përfunduar këtë. Shumë shpejt, në bisedë me komandant Sadikun e pasi që kisha dhënë arsye të shumta, këto pozicione lufte do të lehën e mbyllen duke i zhvendosë ato, mbi lagjen Buzhalë. Kështu i kishim ikë çfarëdo shqetësimi të kujtdo qoftë këtu, që mund të kishte

efekte negative morale- politike; Dhe mund ta konsideronim si një bashkëpunim për tu përafruar me kryesinë e fshatit në ndonjë veprim të përbashkët në të ardhmen. Për fat të mirë të te gjithë neve, kështu do të ndodhë me rastin e strehimit të popullatës së shumtë që na i kishte mësy më pas për strehim, të thuash nga të gjitha vendbanimet e komunës sonë.

Pajtimi i kundërshtive

Si përgjigje kërkesës së Shefki Muqa dhe Halil Krasniqi e meqë ishte shqetësuese paraqitja, po në të njëjtin teren, e dy njësiteve: "Lisi" dhe "Çeliku 50"; i shoqëruar nga: Bislimi, Azemi dhe Enveri, kisha ndihmuar në pajtimin e kundërshtive dhe tejkalimin e mosmarrëveshjeve në mes të tyre, ndërsa që këtë e kisha bërë në bisedë me Feim Bala dhe Ukë Bytyqi.

"Ikja" nga shtëpia dhe qëndrimi në popull

Meqenëse shtëpia ime që moti dihej, si bazë që ishte, këtu bëheshin lëvizje tepër të mëdha të njerëzve, të ushtarëve, të mallit e të armatimit, jo vetëm për këtë zonë por edhe për më larg, për zonën e Neredimës e për atë të Karadakut. Në këto rrethana aty do të hyjë e dal kushdo që kalonte këndej pari, me punë e pa punë. Dera qëndronte hapur natë e ditë, ndërsa çdonjëri shërbehej me çka kishte nevoje e mundësi. Kishte rast që brenda njëzetekatër orësh ishte kthyer shtatëmbëdhjetë herë sofra. Pos këtyre, në shërbim të luftës kishim lënë edhe oborrin, automjetin dhe

traktorin që kishim. Këto mjete merreshin e ktheheshin pa pyetur kënd, nga kushdo qoftë që i duheshin dhe për kudo që i duheshin. Ishin të shpeshta rastet që merrej traktori nga dikush që shkonte ta zëmë në Maqitevë dhe lehej kudo atje. Të tjerët, kur ju duhej e merrnin nga Maqiteva për të shkuar në Budakovë, ndërsa kalonin pranë nesh e shtëpisë sonë, duke mos ditur se ishte i yni ose duke e ditur se ishte i dhuruar dhe në shërbim të tyre. Kishte një rast kur dikush nga ushtarët do të na qojë, po me këtë traktor në Maqitevë, mua dhe komandant Sadikun, ndërsa me të hyrë brenda e merr dikush tjetër për ndonjë punë tjetër. Fakti që kur dolëm s'e gjetëm traktorin aty, e bëri tepër nervoz komandantin, kurse unë qesha aq shumë sa që e bëra në moment edhe më tepër nervoz dhe të dyshojë se unë ia kisha lejuar dikujt tjetër traktorin.

Në rrethanat dhe kushtet e krijuara me sa u tha për lëvizjet që po bëheshin në shtëpinë time dhe rreth sajë, mua me të vërtetë s'më kishin mbetur as hapësirë e as kushte pune këtu, prandaj kisha vendosur të jam kudo pranë, por jo aty, jo në shtëpi. Dhe meqenëse të gjithë më donin e respektonin; Do të jam, një ditë a një natë te dikush e ditën a natën tjetër te dikush tjetër, në shumë familje në fshat. Kështu e kisha shumë më mirë edhe për faktin se duke qenë me njerëzit kisha arritur tua bëj të ditur tërë filozofinë e veprimit tim politik e ushtarak në ato rrethana lufte. Aty ku isha, me mua ishin gjithmonë Shefki Muqa dhe njerëz të tjerë me autoritet e që gëzonin respekt, e si të ftuar, edhe këshilltarët e mi. Për këtë, se ku gjendesha, e dinin vetëm shokët e mi: Bislimi, Azemi dhe Enveri, për kontakte pune, për të marrë detyra apo për të

raportuar për detyrat e kryera. Për vendin ku ndodhesha ishte e informuar gjithmonë edhe roja në Pikën e Buzhalës dhe kishte për detyrë t'ia bënte me dije këtë komandantit të batalionit, Sadik Halitjaha, sa herë që ai kalonte këtë Pikë, në mënyrë që ai të më gjente e kontaktonte me lehtësi. Në këto kushte do të jem shumë më efikas dhe po bëja punë të shumta duke qenë kështu edhe më i frytshëm në angazhime.

Marrja me elementin destruktiv

Për të realizuar objektivat dhe qëllimin që kishte parashtruar vetës dhe detyrat që i ishin ngarkuar; komandanti i batalionit, Sadik Halitjaha, shihej qartë se po mbështetej fort në mua, në Halil Krasniqin, në Mehmet Mustafën, në Milaim Elshanin, në Hetem Sopën e në shokët tjerë, të vjetër. Në një rast, sapo kishte ardhur, më pat përmendur se pos të tjerash i ishte dhënë detyrë që fillimisht të merrej me elementin destruktiv e bashkëpunues me armikun dhe ta pastronte terrenin nga ta. Përmendi edhe regjistra të gjatë, madje me nga disa dhjetëra emra, të këtij elementi për çdo vendbanim ku duhej të shtrinim ndikimin dhe veprimin tonë politiko-ushtarak e atë të luftës.

Falë vendosmërisë e këmbëngulësisë sime, gjatë gjithë se kaluarës, sado e rendë e me rreziqe më ishte ajo, kisha qëndruar gjithmonë këtu në Kosovë. Prandaj e dija me saktësi se ky element i kishte shkaktuar të këqija e shqetësim të madh popullatës madje edhe vuajtje të mëdha, sidomos disave prej nesh. Por i vetëdijshëm se po

futeshim në veprime të rënda të një projekti tepër të madh, e dija se duhej vepruar mençur, me gjakftohtësi dhe me tepër maturi. Në fund të fundit ne kishim bërë një pajtim të përgjithshëm kombëtarë dhe kishim arritur aq sa kishim mundur të unifikoheshim. Do të marr guximin, që nga komandanti, të kërkoj me lutje, të mi falë të gjithë, kudo e ngado që ishin dhe sado që ishin, në të gjithë fshatrat dhe në territorin që synonim të mbulonim me veprimet tona, që unë të merresha me ta. Dhe sapo mora këtë falje, që ishte edhe përgjegjësi; Pa humbur kohë, pa hezitim dhe pa më të voglën keqardhje, përkundrazi me shumë vullnet, të gjithë atyre që i njihja do t'ju thosha kudo që i takoja ose do t'ju qoja të fala përmes të tjerëve, se: Në emër të gjakut të shumtë që po derdhej për Liri, ishin të amnistuar për veprime të tyre të dëmshme për popullin në të kaluarën. Në të njëjtën kohë, e kisha bërë krejt publik dhe shumë të ditur qëndrimin tonë se në kohën e luftës veprohet me ligjet e ashpra të luftës; Prandaj duhej të hiqnin dorë nga çfarëdo veprimi, tradhtarë e të dëmshëm për kombin, në të kundërtën ishte me rrezik madje me rrezikun më të lartë për ta.

Shumica dërmuese e tyre ishin në ankth dhe kjo kishte ndikuar që shumica e tyre në masë të madhe të vetëdijesoheshin, ndërsa që kjo do t'iu vjen si diçka më e mira që mund t'iu ndodhte. Disa, nga të këtij soji, që më parë, kishin llogaritur në burrërinë time dhe më kishin lutur, tashmë, t'iu jepja rast të përmirësoheshin; Ndërsa, njëri prej tyre më kishte dërguar një fqinjë të tij, të më luste: T'ia merrja armët që kishte, ta merrnim atë, ta gjykonim; qoftë edhe ta vrisnim, vetëm e vetëm, të lirohej

nga ankthi që e kishte kapluar, kurse ne e kishim "mobilizuar", e kishim rreshtuar mirëfilli në radhët tona; Dhe ky njeri gjatë gjithë kohës së luftës e deri në përfundim të sajë, i armatosur me armët e tij, do të bëjë roje tepër të vlefshme vëzhgimi e do të bëj veprime e kryej detyra të rëndësishme me vlerë për luftën tonë. Shumica prej tyre, më pas, deri në përfundim të luftës e edhe pas përfundimit të sajë do ta përkrahin luftën dhe krahun e sajë politik, në mënyra të ndryshme. Kishte të tillë, që vazhduan me të keqen dhe normalisht do të pësojnë në mënyra të ndryshme. Kishte, madje, edhe të tillë që do të pësojnë nga ata që ju kishin shërbyer deri atëherë.

Isa (Halil) Shehu ishte marrë dhe likuiduar shumë kohë më parë, ndërsa si përgjigje interesimit dhe hallit të familjarëve të tij dhe kryesisë së fshatit se si duhej të veprohej më tej në këtë situatë; në takimin e tyre të mbajtur në shkollë të fshatit e ku isha i ftuar enkas për mendimin e qëndrimin tim, iu kisha thënë: Të organizonin varrim të zakonshëm, si në çdo rast tjetër vdekjeje dhe të hapnin të pamën për ngushëllime, por që të mos i hidhëroheshin askujt nëse njerëzit s'marrin pjesë në varrim ose s`shkojnë për ngushëllim; Dhe të mos përfliste askush-askënd, nëse kishte marrë ose s'kishte marrë pjesë në tërë këtë ceremoni morti. Ishte qëndrim imi i prerë dhe kështu ishte vepruar.

Edhe tani vlerësoj se kishim vepruar drejt dhe se kjo mënyrë veprimi ka dhënë efekte të shumta pozitive, veçmas në plan politik karshi serbëve e në ruajtjen e pastërtisë së luftës.

Strehimi i të zhvendosurve dhe të evakuuarve

Në bashkëpunim me udhëheqjen e fshatit do të arrihet të sigurohet strehim për të gjithë të zhvendosurit. Këtu do te shkëlqej kryesia e fshatit dhe të gjithë njerëzit e Vraniqit, nga se kishin krijuar rregull ti prisnin të zhvendosurit, në rrugë, në hyrje të fshatit; Ndërsa edhe kishin identifikuar të gjitha familjet dhe objektet në fshat ku mund të vendosnin dhe sa mund të vendosnin. Madhështia e të gjithë neve këtu, qëndron në faktin se asgjë s'po ndodhte pa qenë më parë e planifikuar. Kjo, sa na përkiste neve dhe asaj që mund të bënim. Me veprimin tonë po ndikonim në ngjarjet, në rrjedhën dhe në dhënien kahe zhvillimit të këtyre ngjarjeve.

Kishte një rast kur një kurbetçi yni, me gjithë kërkesën e njërit prej nesh, nga biseda me të përmes telefoni që të na e hapte shtëpinë e tij të zbrazët, për të strehuar këta njerëz, s'na kishte dalë në takim. Këtu, unë do të jap qëndrim t'i thyhej dera dhe të strehoheshin njerëzit; Dhe kështu do të bëhej.

Edhe furnizimi i këtyre të zhvendosurve me gjëra të nevojshme ushqimore e me veshmbathje ishte i mirë dhe me kohë, ndërsa që këtë po e bënin, të gjithë mekanizmat në fshat bashkërisht dhe në harmoni e bashkëveprim të plotë. Sidoqoftë roli i individit, i secilit veç e veç, e edhe i bashkësive familjare këtu ishte i rëndësishëm, shumë domethënës dhe i pa kontestueshëm. Kishte raste si ai i Jakup Llugaxhiut e Sali Llugaxhiut që në familjet e tyre kishin nga më shumë se njëqind të strehuar, ndërsa që bashkë me këta të strehuar familjet e tyre po harxhonin mbi njëqind kilogram miell në ditë të cilat pasi ti kenë

harxhuar rezervat e tyre po i blinin, çdo ditë, për muaj të tërë. Dhe madhështia qëndron në faktin se askush askujt si ishte i tepërt, përkundrazi kultivohej dashuri, vëllazëri e ndjenjë njerëzore më shumë se kurrë.

Me ushtarët kishim ndihmuar në zhvendosjen përkatësisht në evakuimin e tyre nga zonat ku po kryheshin veprime luftarake. Veçmas kishim ndihmuar në evakuim banorët e Griqecit, të Llanishtit dhe të Papazit. Punët dhe angazhimet ditore që dilnin ishin të shumta, ndërsa falë vullnetit dhe përkushtimit e gatishmërisë së popullatës vendëse këtu, do të arrijmë që ti kryejmë, madje të gjitha, mirë e me përgjegjësi. Pa dallim, edhe më të riut, edhe fëmijës por edhe njeriut më të vjetër, kudo e takoje, mund t'i jepje detyra nga më të ndryshmet dhe që të gjitha do të kryheshin mirë e me kohë, me përgjegjësinë më të lartë. S'kishim as edhe një rast të vetëm, për çfarëdo qoftë, që të na ishte thënë Jo, ose që të ishim refuzuar. Në familjen tonë, në këtë kohë e në këto rrethana strehim kishin gjetur e po gjenin kohë pas kohe, veçmas, familje të shumta nga Maqiteva dhe Popolani.

Angazhim i madh i të gjithë neve: ushtarëve, strukturave në fshat dhe banorëve të fshatit deri në përfundimin të luftës në evakuimin, strehimin, furnizimin e mirë e me kohë, dhe në përkujdesjen me aq përkushtim për këta të strehuar të shumtë, nga të gjitha vendbanimet e Komunës së Suharekës e më gjer, kishte bërë që me të mbaruar lufta, Shtabi i Përgjithshëm i TMK- së, të vlerësojë këtë kontribut të dhënë dhe të mirë- njoh me mirënjohje të veçantë fshatin Vraniq dhe banorët e tij.

Ruajtja e rendit dhe qetësisë

Meqenëse fshati ishte mbingarkuar me popullatë, vlerësuam se duheshin forca që do të siguronin rendin dhe qetësinë dhe i krijuam ato pa humbur kohë. Kështu, për të bërë punën e policit, fillimisht kishim angazhuar Milazim (Bajram) Kolgecin dhe Sadik (Brahim) Kolgecin, kurse për të mbuluar terrenin njëzet e katër orë, shumë shpejt angazhuam edhe Azem (Miftar) Kolgecin dhe Enver (Ibrahim) Bashën. E deshi fati të mos kishin nevojë për asnjë ndërhyrje, kjo fale rregullit të krijuar dhe respektimit të këtij rregulli nga të gjithë këtu. Të përmendë se ushtarët tanë e kishin të ndaluar të përdornin çfarëdo pije alkoolike dhe të qëndronin në shitore, ndërsa meqë ishin të disiplinuar, në shitoret në fshat s'mund ti shihje as për furnizime. Këtë ndalesë, për përdorimin e pijeve alkoolike ua kishim bërë pas një rasti kur kishim dëgjuar se një ndërrim i rojave natën kishte përdorë alkool derisa po ruanin, në vendin e rojës.

Mbrojtja e Pyjeve

Duke e parë se s'po funksiononte mekanizëm që mbron pyjet shtetërore, njerëz të pandërgjegjshëm kishin filluar ti dëmtonin ato. Me kërkesën dhe me insistimin tim; komanda e Batalionit II, përkatësisht komandanti i batalionit, Sadik Halitjaha, shumë shpejtë, do të krijojë mekanizmin përgjegjës për të mbrojt pyjet, Njësinë e Mbrojtjes së Pyjeve, ndërsa policët tanë ushtarak i përkrahnin këto roja në detyrë dhe në angazhimet e tyre në

mbrojtjen e duhur të pyjeve. Kishim raste konfiskimi të druve, ndërsa i detyronim ti dërgonin në Budakovë dhe përdoreshin për nevoja të ushtrisë. Na është kërkuar nga ndonjë individ këtu, ta rreshtonim në këtë njësi, ndërsa s'e kishim bërë këtë me bindjen se do të shërbenin me më efekt njerëz nga vendbanime tjera. Kështu së bashku me komandantin e batalionit, në Njësinë e Mbrojtjes së Pyjeve, kishim angazhuar ushtarë tanë nga fshatrat: Budakovë, Papaz e Topillë; respektivisht nga një roje pylli prej secilit nga këto fshatra, përkatësisht: Hasan (Xhemajl) Buzhala, Vesel (Rahim) Maksutaj, dhe Faik (Shaqir) Muhadini.

Edhe kjo sikurse nismat dhe angazhimet tjera kishte ndikuar në krijimin e rregullit dhe disiplinës për më shumë edhe në krijimin e një vetëbesimi se mund të organizohemi e të veprojmë si një trup pavarësisht rrethanave që mund të na krijoheshin dhe sprovave me të cilat mund të ballafaqoheshim në këto rrethana të gjendjes në prag të shpërthimit të luftës këtu. Dukej se po mësoheshim të krijojmë e respektojmë mekanizmat tanë.

Hapja e rrugëve

Operativa e Batalionit II, kishte shtruar si nevojë, ngjashëm me kudo tjetër, që për nevoja të luftës, të hapej rrugë nga Vraniqi në Maqitevë. Për të realizuar këtë ishte dërguar këtu Avni (Rexhep) Jakupi me të gjithë djemtë e tij dhe një drenicas i cili manipulonte me makinën. Këta i kishim strehuar e vendosur në shtëpinë time, ndërsa gjatë zhvillimit të punimeve i siguronin ushtarët tanë. Trasenë e

rrugës së re ua kishim përcaktuar ne. Veçmas ishim kujdesur që të mos dukej e të mos binin në sy të armikut këto veprime. Kështu kishim arritur të mos jepnim shkas për të rënë ndonjë granatë kudo në fshat e të pësonim ndonjë dëm.

Kishte kërkesa individësh a grupe njerëzish entuziastë ose të tillë që donin të përfitonin nga situata dhe rrethanat në të cilat vepronim, për të hapë a për të zgjeruar rrugë të tjera në fshat ngaqë shihnin mundësi të tilla te fakti që s'po na dilte as edhe një pengesë në kryerje punimesh e realizim të detyrave. Që të gjithëve do t'iu themi: Jo; Për arsyet e thjeshta që të mos jepnim pretekst të binte ndonjë granatë e të pësonte ndokush, krejt pafajshëm, në fshat; Por edhe që të mos ndodhte as keqkuptimi më i vogël, te kushdo nga njerëzit tanë, se ne po keqpërdornim "fuqinë" që kishim, për të realizuar interesa të vogla, meskine, individësh a grupesh interesi, në këto kohë të pa kohë e tepër të rënda, krejt të liga, për të gjithë ne, pa dallim, si komb; Siç kishte ndodhë, ta zëmë, derisa po hapnin rrugë në fshatin Bukosh.

Marrëdhëniet me serbët lokal dhe përfaqësimi politik

Për të ruajtur karakterin çlirimtarë të luftës do të merremi vesh me serbët lokal të fshatit Popolan dhe Dvoran. Kjo deri në mobilizimin e përgjithshëm të tyre, të dhunshëm nga pushteti serb, kur u prish kjo marrëveshje. Këtë e kishim bërë përmes njerëzve tanë dhe përfaqësuesve të këtyre dy vendbanimeve, ndërsa kishim siguruar që popullata e përzier këtu të mos kishte as

shqetësimin më të vogël mes vete. Në ndonjë rast edhe do të furnizohemi nga ta me duhan, uniforma ushtarake, municion e armatim të lehtë. Kjo për përfitime personale të ndonjë individi prej tyre, por që njerëzit tanë paraprakisht na e kishin bërë me dije e kishin lejen tonë.

Ishte vera e vitit ’98, këtu zhvillimet kishin marrë hov. Kudo ndjehej erë lufte e gjendja po përkeqësohej çdo ditë e më shumë. Njeriu i ynë këtu dinte shumëçka, ishte i informuar dhe në rrjedhë të zhvillimeve; Megjithatë ne dhe ushtarët e njësitit tonë, që siç u përmend me parë po bënim roje vëzhgimi, ishim përkujdesur të mos dukemi shumë. Për të arritur këtë, lëvizjet edhe brenda fshatit Vraniq i bënim me automjete tona private ose lëviznim në shoqëri me ndonjërin nga shokët ushtarë dhe me automjetin e tij. Armët i mbanim në automjet, fare pran vetës, ndërsa veçanërisht përkujdeseshim që ato të mos dukeshin e të mos binin në sy. Secili prej nesh mbante edhe armë brezi e bomba dore të cilat s’na dukeshin gjithashtu në asnjë rrethanë.

Këtu po bëheshin lëvizje të mëdha njerëzish. Do të lëvizin këndej ushtarë tanë me uniforma e armatime nga Budakova, në drejtim të Kompanisë në Maqitevë dhe anasjelltas. Pushteti lokal, këtu, në nivel komune, ishte i përqendruar në duart e serbëve të këtushëm, ndërkaq që ne me filozofinë tonë të veprimit ushtarak e politik dhe me mënyrën se si po silleshim, aq njerëzishëm, me serbët, kishte bërë që njerëzit e fshatit tonë të lëviznin fare lirshëm dhe që pa asnjë pengesë të kryenin punët e tyre kudo te pushteti. Njeriu i këtushëm, s’kishte ndërprerë lëvizjet me qendrën komunale për të kryer punë e për të

plotësuar nevoja nga më të ndryshmet. Sado që i këshillonim e kishim dhënë qëndrim që këto lëvizje të reduktoheshin, mbi të gjitha për sigurinë e tyre, kishte lëvizje që bëheshin pa pasur shumë nevojë. Njerëzve të Vraniqit që shkonin në stacionin policorë në Suharekë, për të marrë ndonjë dokument a për të kryer ndonjë punë tjetër të tyre, po ju jepej laps, letër dhe po iu kërkonin të shkruanin nga pesë emra të pjesëtarëve të UÇK. Që të mos rrezikoheshin, këta, i kishim këshilluar të jepnin emrin e: Skënderit, Bislimit, Azemit, Enverit dhe të Sali Llugaxhiut; por shumë shpejtë këta emra, policisë serbe i ishin bërë të tepërt, prandaj do të kërkojnë pesë emra të tjerë dhe kështu gjërat po shkonin duke u vështirësuar.

Për fat të keq e për turpin e tyre kishte edhe të tillë që po shkonin për tu "rrëfyer", ndërsa edhe pse ia kishim thëne, madje disa herë, hapur njërit prej tyre, s'kishim arritur ta bindim e ta ndalnim, ndërsa e kishim duruar derisa e kishin vrarë punëdhënësit e tij. E kishim bërë këtë ngaqë ishte naiv dhe e "dinim" se s'mund të tregonte gjë tjetër pos emrave të neve që ishim me armë në dorë; Dhe kjo, neve, s'na prishte punë ngase kishim zgjedhë të vepronim haptazi, madje s'përdornim as nofka e as pseudonime siç po përdornin shokët tanë kudo në Kosovë, në zona të luftës. I tillë ishte edhe një tjetër, që vërtetë s'dinte të tregonte gjë, ndërsa kishte edhe të "mençur"; por që ne i kishim duruar, thjeshtë, që të mos bënim asnjë të keqe, madje as kundër atyre që po bënin keq.

Pos një fronti të gjerë masash popullore, këtu dukej qartë se kishim krijuar edhe një front politik që përfaqësonte grupet e interesuara të merrnin pjesë në

zhvillime dhe të jepnin kontributin e tyre gjithanshëm në këto zhvillime, ndërsa mënyra si veprohet më tej po bënte të ditur se ne kishim zgjidhur edhe çështjen e përfaqësimit politik, në raport me këdo, dhe se kjo çështje më ishte lënë mua.

Autobus, të shtetit, qarkullonin normalisht edhe për në fshatin tonë. Në të dy autobusët, konduktorët e tyre ishin banorë të këtushëm: Zenel (Kamer) Kolgeci dhe Ramadan (Musli) Luzha, ndërsa në njërin prej tyre vozitësi ishte serb, nga fshati Dvoran. Ishte përhapur gënjeshtër se struktura të caktuara të UÇK kishin bërë urdhëresë, ndërsa ushtarët tanë po donin të kapnin e merrnin këtë vozitës serb të autobusit. Kishte një shqetësim në popullatë në lidhje me këtë, i shqetësuar ishte ndjerë edhe Zenel Kolgeci, i cili e kishte kolegë në punë; do të na kontaktoi shumë shpejtë dhe do ta bisedojmë shtruar. I kishim thënë se s'kishte asgjë zyrtare, prandaj e tëra ishte gënjeshtër. Për më shumë, ishim obliguar që këtë ta bisedonim me komandantin e batalionit, ndërsa e kishim porositur të kishin shqetësim vetëm nëse ky vozitës serb do të vepronte çfarëdo kundër interesit të njeriut të këtushëm dhe kundër luftës sonë për çlirim.

Meqenëse nga biseda me komandantin kishim kuptuar se ky serb s'po ndiqej dhe se s'ishte i kërkuar e biseduam edhe faktin që ai ishte i pranishëm çdo ditë në fshatin tonë, meqë po voziste autobus publik. Patëm vendosur të mos i bëheshim pengesë ngase ai ishte thjeshtë një qytetarë që po bënte punën e vet dhe po i shërbente popullit, deri në ndonjë vendim tjetër, varësisht rrethanave. Shumë shpejtë, bashkë me këtë njoftim, Zenelit do ti

bëjmë të ditur tërë filozofinë e veprimit tonë. Mes të tjerash e mbi të gjitha do ta sigurojmë se asnjë qytetarë të thjeshtë s'do ta gjejë gjë e ligë pa marrë parasysh kush ishte ai, nëse s'bëhet pengesë në rrugën tonë për çlirim. Kjo do ti pëlqej tej mase Zhikës, siç e quanin, dhe do të obligohet të veproj në këtë frymë edhe ai deri në fund. I kishim bërë të fala njëri tjetrit, ndërsa përshëndeteshim, së largu, sa herë që takoheshim në rrugë, edhe me vonë kur ne mbanim uniformën ushtarake dhe armët hapur.

Në këtë gjendje të shtendosur të raporteve me fqinjët tanë serb, banorët serb të fshatit Popolan, përmes fqinjit tim Nezir (Shahin) Basha, patën kërkuar nga ne të mos ua merrnim të drejtën që kishin në ujin për ujitje, nga uji i lumit të fshatit tonë, nga e diela në mbrëmje deri të hënën në mbrëmje, për 24 orë në javë, e drejtë e tyre e kamotshme. Përgjigja e jonë në këtë ishte pozitive, ndërsa për ti ikur çfarëdo fërkimi të tyre me ne rreth ujit, çështjen do t'ua rregullojmë ashtu që Neziri do t'ua lëshojë e ruaj ujin si punëtorë i tyre me mëditje.

Ndërkohë, pas pak ditësh, përmes Zenel (Hajrush) Kolgecit do të marrim të fala nga Zorani, një shok imi i shkollës së mesme, por që ishte krye serb aty, në Popolan, i cili edhe na kishte mirënjohur e falënderuar për qëndrimin tonë të drejtë e burrërorë. Pa humbur kohë, këtij, i kishim thënë se më shumë se çdo gjë na duhej qetësia dhe rehatia në mes nesh të thjeshtëve dhe se kështu do të dilnim të fituar të dyja palët. I kishim thënë se po përpiqeshim që luftën ta bartim maleve dhe që atë ta bënin forcat ushtarake, në konflikt, në mes veti, ndërsa popullatën ta kursenim nga çfarëdo veprimi luftarak. E

kishim “siguruar” se lufta do të ishte e shkurtë dhe shumë e kontrolluar nga faktori ndërkombëtarë me ndikim, e ndoshta që edhe mund të zgjaste, por që fitorja ishte gjithsesi e jona ngase ishim të vendosur ta fitonim lirinë, dhe se siç dukej e kishim përkrahjen e duhur nga faktori ndërkombëtarë me ndikim. Patëm kërkuar të kemi marrëveshje në këtë kuptim dhe ti qëndronim kësaj marrëveshje në mënyrë që ti iknim çfarëdo nga ajo që kishte ngjarë më parë në luftën, në Kroaci dhe në luftën në Bosnjë e Hercegovinë, dhe që të mos na përsëriteshin skena ku fqinji po konfrontohej me fqinjin e parë të tij, krejt pakuptimshëm. Morëm përgjigje pozitive, të vlefshme deri në mobilizimin e përgjithshëm, të dhunshëm, të tyre nga pushteti ushtarak e policorë, në pranvere ’99, kur na dërgojnë fjalë se ishin të pafuqishëm dhe se marrëveshja po binte.

Se po respektohej kjo marrëveshje, ne kishim dhënë një varg provash, ndërsa që kishim siguruar lëvizje të lirë të njerëzve tanë kah do e edhe nëpër fshatin Popolan e Dvoran në drejtim të Mushtishtit dhe anasjelltas dukej sheshit. Shihej, gjithashtu, që njerëzit e fshatit tonë po lëviznin më lirshëm se, ta zëmë, ata të fshatrave tjerë, veçmas atyre të fshatrave Budakovë e Mqitevë, dhe se kudo po haseshin, madje edhe në Suharekë e kudo tjetër po kalonin më lehtë dhe me më pak shqetësime se të tjerët. Thënë të vërtetën, ne kishim folur në emër të fshatit dhe në emër të luftëtarëve të UÇK në këto anë, por ja që kishim arritur vetëm kaq; Ndërsa që në një rast kisha guximin, që me uniformë e nën armët që mbaja, të jem në Popolan, mysafir në familjen e Jahir (Zymer) Kolgeci e kisha

provuar vet, madje derisa po kaloja nëpër qendër e pran shitores së fshatit Popolan, nga automjeti i Bexhet Kolgecit me të cilin po vozitesha, i kisha përshëndetur, me të ngritur dore, të gjithë të pranishmit e rastit, shqiptarë e serb që ishin aty.

Më pas kishte edhe raste të tjera të shumta që thoshin e dëshmonin se marrëveshja po qëndronte dhe po respektohej nga të dyja anët, ndërsa do të përmendja shkurt dy raste: I pari kishte ndodhë sapo kishim bërë këtë marrëveshje, kurse i dyti, krejt në fund, në kohën pasi të jem njoftuar se marrëveshja po binte, në pamundësi të serbëve lokal ta ruanin e respektonin edhe më tej, ndërsa që më pas do të kuptoni se në rrethana të caktuara, familja ime dhe familje nga fshati Papaz ishin strehuar, te miq të tyre familjarë ose kudo, në familje shqiptare, në Dvoran e që edhe kjo flet shumë. Të strehuar të tillë nga fshatra të tjerë kishte edhe në familjet shqiptare në Popolan; Dhe ky do të ishte pasqyrimi më i mirë dhe më i plotë i raporteve mes njerëzve të thjeshtë, të entiteteve të ndryshme serbe e shqiptare në këto rrethana të rënda e të gjendjes së luftës këtu.

Në rastin e parë, sipas dëshmisë së prindit tim, Ibrahim (Vesel) Basha: Polic të rregullt serb ndalin autobusin që po vinte për në fshatin Vraniq dhe pas një kontrolli të shkurtër nxjerrin nga autobusi vetëm atë, me arsyen se po mbante në dorë gazetën "Zëri", në ballinën e së cilës kishte foto dhe shkrime që po flisnin për UÇK. Ç'është e vërteta, Ibrahimi, fillimisht kishte menduar se po e njihnin se ishte prindi im, ndërsa që unë isha tepër i kërkuar e që më pas, pas ofensivës serbe të shtatorit '98,

në kërkim timin, secili prej tyre, do të mbante edhe fotografin time dhe do të pyeste se ku gjendej terroristi, Skender Basha, por ja që në këtë kohë dhe në këtë rast nuk ishte kështu. Sapo e kishin nxjerrë nga autobusi e deri sa po e pyetnin për gazetën dhe shkrimet e pamjet fotografike në të, pa humbur kohë kishte reaguar madje ashpër vozitësi i autobusit, Zhika, duke i qortuar zëshëm pse po merreshin me këtë njeri të vjetër, aq më tepër që po e dinin se ai këtë gazetë e kishte blerë, në trafikë, diku në qendër të Suharekës, e që në këtë rast policët serb nuk ishin zgjatur më shumë dhe e kishin lëshuar këtë burrë.

Ndërkaq që në rastin tjetër, sipas dëshmisë së dajës tim, Hetem (Zeqir) Aliaj, nga fshati Dvoran, tani i ndjerë, viktimë e terrorit serb të luftës, i vrarë së ekzekutuari me datë 03.05.1999, nga banda kriminale paramilitarësh serb, në oborrin e shkollës fillore në fshatin Bukosh së bashku me 24 burra të tjerë të kësaj ane, e derisa aty kah fundi i luftës, Hetemi, po shkonte krejt i vetëm, nga lumi i lagjes Buzhala, ku ishte strehuar nga zjarret e luftës bashkë me familjen e tij e shumë njerëz e familje të tjera, në shtëpinë e tij në fshatin Dvoran për të parë çka mundë të shihte nga pasuri e tij e mbetur e meqë këtë po e bënte për të tretën herë radhazi; Komandanti i Pikës serbe, që serbët tani më të mobilizuar dhunshëm nga pushteti i tyre e bashkë me serb të ardhur, kishin vendosur në hyrje të fshatit të tyre, në Dvoran, nga ana e fshatit Vraniq; I kishte thënë për të tretën herë radhazi të vetëdijesohej e të mblidhte mend dhe të mos vinte më kështu sepse kështu po rrezikonte të humbte jetën e tij, ngase siç i kishte thënë: Më askush s'po i pyeste gjë serbët vendorë, e meqë po e dinte se Hetemi

ishte daja im, e kishte pyetur nëse e dija Unë, që daja po bënte këto lëvizje me rrezik për jetën e tij.

Në mbështetje të kësaj fryme politike e në bazë të këtyre veprimeve politike, edhe Kompania e jonë në Maqitevë, përkatësisht stafi komandues i sajë: Iu kishte lejuar banorëve serb e shqiptarë të fshatit Dvoran, që nën vëzhgim dhe në përcjellje të vazhdueshme të ushtarëve të kësaj kompanie të shkonin të riparonin rrjetin e ujësjellësit të fshatit të tyre, thellë në zonën e luftës, në afërsi të fshatit Maqitevë. Kjo dhe të gjitha që u përmendën, kishin bërë që zona ku po ruhej qetësia të shtrihej edhe në Mushtisht e ndoshta edhe në Dolloc.

Kjo qetësi ndër- fqinjësore mes etnive këtu do të ruhet edhe kurë aksidentalisht, nga një ushtarë yni, në fshatin Mushtishtë, ishin vrarë, siç na është thënë, dy djem të Vlladës, të cilin e njihnim për njërin nga çetnikët serb meqë ishte nipi i Spirrë Dollocit, i njohur për krimin që kishte bërë mbi shqiptarët e Kabashit, në të kaluarën jo shumë të largët historike, kur kishte prerë njëqind krerë shqiptarësh brenda një nate.

Marrëveshja do të bie e "paqja" do të thyhet kurë mekanizma shtetërorë serb, në pranverë '99, e pasi të kenë filluar bombardimet e NATO-s mbi caqet ushtarake e policore serbe, po iu thoshin serbëve lokal, të vetëdijesoheshin, se këtu mund të mbetnin vetëm ata ose vetëm shqiptarët dhe se jetë të tyre, të përbashkët, s'mund dhe s'do të ketë më. Ndërkaq që, atëherë, nga burime të shumta, nga serb lokal, njëkohësisht, ishim njoftuar se marrëveshja po binte dhe atë me arsyetimin: Se s'po i pyeste kush më, për asgjë. Dhe s'kishte kaluar shumë

kohë, ndërsa që ata, të udhëhequr nga paramilitarë e të tjerë po mësynin, ne ishim detyruar ti zmbrapsnim disa herë radhazi: te Ura, në Lagjen e Agushve, në Branesha e në pyjet në lindje të Vraniqit, dhe po vriteshim me ta kush kënd mundte më shumë, deri në fund të luftës.

Emërimi i Adem Kolgecit, Komandant i Togës në Vraniq

Në gjysmën e dytë të muajit korrik, në një nga takimet tona të radhës me komandant Sadikun, me propozimin tim, do të merremi vesh që të bisedonim me Adem (Brahim) Kolgecin mundësinë e emërimit të tij të komandant të togës në Vraniq dhe kështu u bë. Për të realizuar këtë, fillimisht, kisha biseduar, unë, me Ademin, ndërsa që e kishim vendosur më pas në një takim të përbashkët me komandant Sadikun, kurse për ta bërë zyrtarë dhe të ditur për ushtarët e Vraniqit e për popullatën si dhe për ta prezantuar para tyre, në odën e Ramush (Adem) Matoshit, kishim mbajt takim të përbashkët me të gjithë ushtarët e njësitit në Vraniq. Te jem i sinqertë, mezi po prisja që dikush, gjithsesi, të më zëvendësonte e të mos merresha me vijat e frontit, ndërsa kjo vërtetë me lehtësoi në punë dhe në angazhimin tim.

Emërimi im zv. Kom. në Kompaninë III, anulimi i këtij vendimi

Sado që komandant Sadiku më mbante e më konsideronte për krahun e tij të djathtë, e synonte të më lente të veproja lirshëm, për arsye që si di, pak ditë më vonë, më kishte emëruar zëvendës komandant në Kompaninë III, e cila po vepronte me Togat e sajë: në Bukosh, në Buzhalë e në Vraniq. Sapo kisha marrë këtë vendim, të tij, në formë të shkruar, i kisha thënë se po filloja të veproja dhe se do të bëja përpjekjet maksimale të jap efekte pune të dobishme, por edhe e pata lutur që të mos me ngarkonte me përgjegjësi dhënie urdhrash e me vija të fronteve të luftës, qoftë edhe nga pozita e zv. komandantit. Derisa kisha kontaktuar stafet e njësive të kësaj kompanie dhe kisha vizituar një për një ushtarët në vijat që mbante kjo kompani, komandant Sadiku, do të vërejë izolimin tim, meqenëse nuk më kishte parë dy ditë të tëra, ndërsa do të reagojë duke e tërheqë këtë vendim dhe më pas do të më lë ” në punët e mia“.

Këtu e këtej, do të jam fare pranë komandant Sadikut, i pajisur me leje të veçantë që siguronte të drejtë lëvizje, papengueshëm, në të gjitha zonat e luftës, në tërë Kosovën; Jo zyrtarisht njëri nga këshilltarët e tij, i përkushtuar realizimit të detyrave të shumta në gjithë hapësirën që pretendonte të zhvillonte aktivitetin e tij luftarak Batalioni II, kurse për sigurinë time e në shenjë përkujdesje për mua, ma kishte ndaluar çdo lëvizje në zona me rrezik për jetën time, jashtë zonave të luftës. Të përmendë se, Komandant Sadiku, po këshillohej me burrin

e këtij vendi, Haxhi Zyba, dhe që zyrtarisht e kishte këshilltarë të tij, por që se di se a po takohej shpesh herë me të, ngase Haxhiun s'po e lejonte shëndeti i lig të lëvizte mjaftueshëm.

Në këto rrethana e në kushtet që më ishin krijuar, veçanërisht do ti jem afër Vraniqit për shkak të specifikave, ngase përkufizonte zonat ku zhvilloheshin veprime ushtarake dhe zonën me popullatë të përzier.

Oferta të largonim familjet tona nga këtu

Shqetësimi i madh e krejt i arsyeshëm që kishin vëllezërit tanë për ne e veçanërisht për anëtarët e familjeve tona këtu, përkatësisht shqetësimi i vëllezërve të Bislimit, Azemit dhe Mustafës me vëllezërit e tij; kishte bërë që ata të tregojnë interesim dhe gatishmëri të kalonin të gjithë anëtarët e familjeve tona në Perëndim, në Zvicër, dhe të përkujdeseshin për ta deri në përfundim të luftës, duke heqë gjithë harxhimet e kalimit, shkuarjes dhe mbajtjes së tyre atje.

Në lidhje me këtë njoftimin ma kishte bërë Azemi, ndërkaq që, unë, isha i prerë dhe do të shprehem: "Se i përkulesha humanizmit të tyre dhe gatishmërisë për të ndihmuar; Por që ideja ishte e sëmurë dhe se po ta bëja këtë; sapo ta bëja, do të shkoja të mbytesha në lumin Drini, madje as këpucët s'do i leja buzë Drinit që ndokush të mund të përmend emrin tim kur përmendë se të kujt ishin këpucët që kishte gjetur e që mbanë", ndërsa që isha shpjeguar: "Po si mund të bëj luftën dhe rezistencën, unë, me familjet e të tjerëve"; Kurse isha shprehur: "Se ndoshta

nuk do të ishte keq që ai- Azemi, dhe Bislimi tua "postonin" familjet e tyre, vëllezërve të tyre, meqë i kishin gratë e reja dhe fëmijët e vegjël, krejt të pa përkujdesje, ngase këta kishin angazhime vërtetë të shumta dhe s'po mund të merreshin fare me ta"; Ndërkaq që më kishin thënë se, që më parë, edhe ata ishin të mendimit dhe qëndrimit që po shprehja e që po mbaja unë. Dhe kështu kishim vepruar së mbajturi në zjarre të luftës edhe familjet tona, bile duke qenë me më pak përkujdesje se të gjitha familjet tjera ngase ne po merreshim kryekëput me luftën dhe vetëm me luftën, ndërsa që edhe po i shihnim tepër rrallë. Më pas, kah fundi i luftës, kisha një rast kur, Unë, s'do të kthehem në shtëpi plotë dy muaj, kurse Bislimi s'do të shohë familjen e tij, në lumi i Buzhalës, për dy javë ditë edhe pse po mbante vijën e frontit, fare pranë tyre, në Bukosh, te "Mulliri i Kadollëve".

Veçmas, gjatë gjithë kohës sa do të zgjas lufta e deri në përfundimin e sajë, kisha bartë drojën: Nëse serbët do të ma veçonin e merrnin familjen për ta trajtuar posaçërisht atë; Dhe ndoshta për të më thirrur publikisht t'iu dorëzohem në ndërrim me ta, raste të shpeshta të veprimit të tyre në të kaluarën, gjatë historisë, ndërsa që e kisha edhe më të rëndë kur mendoja se kjo mund ti ndodhte edhe ndonjërit nga shokët e mi, meqë njihja tërë pabesinë serbe; Por edhe se si do të mund të komentohej në popull, më pas, ky dorëzim a mos dorëzim imi forcave serbe, gjersa familjarë të mi të ishin në duar kriminelësh serb. Ndoshta, ishte rëndesa e vetme që po bartja e që s'ua kisha thënë asnjëherë shokëve.

Zhvillimet në prag të ofensivës së shtatorit
Potenciali ushtarak që po angazhohej

Mësymja ishte tepër e madhe. Kishim informata të bollshme se po na përgatitej sulmi, ndërsa shihej edhe arsenali ushtarak e policor që planifikonin të angazhonin, dhe vërtetë ky potencial luftarak ishte i madh.

Një ditë para se të fillonte kjo ofensivë, do të shohim autokolonë nga makineri, e ndryshme, ushtarake që "koka" i kishte mbërri në Shirokë, kurse "bishti" ende si dukej në Qafë të Duhlës, ndërsa kjo s'ishte e tëra, ngase ngjashëm po ndodhte edhe me autokolonën tjetër që po vinte nga Prizreni në drejtim të Suharekës e që depërtonte e përqendrohej duke u pozicionuar nëpër fshatrat e anës sonë ku ne s'kishim arritur të shtriheshim ende. Kishte në teren, edhe forca e mjete të tjera të mekanizuara luftarake, që ishin vendosur që moti, por edhe të tilla që ishin dislokuar ditë më parë. Krejt kjo kundër Batalionit II, i cili as numerikisht s'kishte arritur të mbante këtë emër, kurse për potencial luftarak e kapacitete të tij çfarëdo që pretendohet të flitet është e tepërt. Kjo ngase kishim të bënim me kundërshtarë mijëra herë më të fortë, të përgatitur e që kishte strategji të përpunuara mirë, ndërkaq që ne kishim vetëm vullnetin e çeliktë, por edhe gatishmërinë të vdisnim ose të jetonim të lirë, ndërsa që këtë se them për të gjithë ne, e më së paku për emra nga stafi komandues në batalion, të cilët kishin marrë pozita e që s'ishin të vetëdijshëm për përgjegjësitë e marra.

Përgatitja morale dhe ajo psiko-fizike e ushtarëve tanë, "konflikti" në mes meje dhe Besim Baraliut

Me ushtarët e me stafin komandues, në nivel batalioni, as që ishte marrë mundi të punohej në planin moral e politik, kurse ushtarët e këtij batalioni as që e dinin se kënd kishin ndihmës komandant batalioni për këto çështje, ngase i emëruari këtu, Besim Baraliu, po merrej me hapje rrugësh madje, me shumë, të tilla që i duheshin lagjes së tij duke shfrytëzuar kështu rastin që i ishte dhënë dhe "fuqinë" që kishte në këto kohë të liga për të gjithë ne, duke mos dashur ta dijë se kështu po shkaktonte shqetësime, telashe e mosmarrëveshje dhe situata konflikti mes lagjes së tij e njerëzve në fshatin e tij e me këtë po thyente moralin e njerëzve për luftën dhe po dëmtonte rëndë unitetin e krijuar me pajtimin e arritur gjithëkombëtarë, në prag të luftës, në nivel vendi; Dhe po menaxhonte e harxhonte mjete të gatshme në para, dhuratë nga djersë e popullit ose potencial tjetër në mjete pune që ishte lënë në shërbim të luftës sonë për liri e jo të hidhej në angazhime për të kënaqë apetite e plotësuar interesa meskine grupesh interesi nga më të ndryshme.

Në batalion, ishte krijuar gjendje skajshmërish liberale të mos them krejt kaotike dhe kjo më së miri do të shihet më pas kur komandanti i batalionit po vente gjoksin në çdo betejë, në të gjitha vijat e fronteve të luftës, ndërsa që mësuesit, gati të gjithë, po lenin radhët e po i ktheheshin punës së tyre në shkolla, ku pagat nuk iu ishin shkëputur, kurse vendet e punës iu ishin ruajtur. Për të qenë ironia edhe më e madhe, me këta dezertor s'po merrej

kush, e vet ata po bëheshin sikur vërtetë s'kishte ndodhë gjë, bile s'po njihnin rrezikun dhe po silleshin lirshëm ngado nëpër zona të kontrolluara nga serbët ku ndonjëri prej tyre edhe do të pësoj duke u bërë rob lufte. Gjëra krejt të pazakonta për rrethanat e luftës dhe gjendjen në ekstrem të rëndë kur duhej shumë sy- çelësi. Nuk thuhet mëkot se trimat vetëm një herë e shijojnë vdekjen, kurse këta dezertor frikacak po vdisnin çdo ditë nga pak. Kur jam këtu s'mund të mos përmendë se e gjith kjo ishte rezultat i ndikimit politik të LDK- së e cila edhe më pas gjatë gjithë kohës së luftës për njerëzit e saj në UÇK po ndante paga të rregullta mujore.

Që të mos iu kthehem sërish gjërave, të përmend se: Unë, s'kisha pasur as fërkimin më të vogël me te, ndërsa që po më kërcënonte, në bisedë me shokët e tij, "prapa shpine", se herën tjetër do të më përzinte nga objekti i Komandës së Batalionit II, në Budakovë, ngase siç po thoshte, unë, i isha bërë i tepërt aty meqë po shkoja shpesh herë, kurse s'po i jepja para, ndërkaq që, unë, krejt këtë e kisha të lehtë meqenëse fati e kishte dashur që ai s'po kërkonte nga unë, drejtpërsëdrejti, asgjë, ndërsa që unë s'po e ktheja vëmendjen tek ai as edhe njëherë, pavarësisht krejt asaj që ai po thoshte ose mund të thoshte, dhe se isha përkushtuar me tërë mundësit dhe potencialin si dhe po merresha kryekëput dhe vetëm me punët, obligimet dhe detyrat që po më shtronin nevojat ditore e të kohës, të luftës.

Kështu, deri në ditën e tretë të ofensivës së parë serbe kundër nesh, në atë të shtatorit '98. Këtë ditë, sapo kishte përfunduar e tëra e kësaj ofensive e kur ishim ulur të

pushonim e të hanim mishin e fërguar sjellë "dhuratë" nga fshati Vraniq, të cilit ende si ishin shuar flakët, ndërsa që po të mbyste tymi dhe kundërmimi i shkrumbit nga krejt çka ishte djegur në të gjatë tri ditëve të shkuara, e meqë s'po mund t'ia duroja llafet krejt shkapërderdhur; Si përgjigje në njërën nga gjithë ato që po thoshte e në lidhje me "luftën e madhe" që, sipas tij, e kishim bërë, isha shprehur se: Deri më tani vetëm e kemi ndezë zjarrin e luftës e dhashë Zoti që luftën ta bëjmë pas këtej, ndërsa që këtë, gjatë gjithë kohës së luftës më pas, do ta komentojë së shtrembëruari sikur, unë, paskësha thënë se ne jemi ata që i vumë zjarr e që e dogjëm Kosovën, kurse me këtë ishte përpjekur të shërbehej edhe në angazhimin e tij, madje haptas, por gjithë herë prapa shpinës sime, të më bëhej pengesë në emërimin tim Nihmës komandant i Komandant Tahir Sinani në Zonën Operative të Pashtrikut.

Por e keqja, vërtetë, s'ka fund askund e as në rastin që përshkruaj këtu e të cilit po përpiqem ti bëj shpjegim. Jo vetëm ky, Besimi, por edhe të gjithë të tjerët nga stafi i Komandës së Batalionit II, më pas ishin ngjitur, më lartë, në hierarkinë ushtarake në strukturat udhëheqëse e komanduese të UÇK, saqë më ishte mbushur mendja se këta po mund të vetë- emëroheshin ose po emëronin njëri-tjetrin dhe kështu po merrnin e mbanin pozita të larta në hierarki ushtarake, derisa, atë kohë, s'kishte një mekanizëm të shihte e të vlerësonte "punën", "veprën" dhe "kontributin" e tyre në të kaluarën aq të afërt, ndërsa që ende besoj se kështu disi të ketë qenë.

Këta, më pas, pos Komandant Sadikut, Hava Bytyqit dhe profesorit të nderuar, Komandant Selim

Hazirajt, që po na vizitonin fare shpesh dhe që vërtetë ishin tepër të mirëpritur, të tjerët, asnjëri prej tyre, nuk do të kthehen kurrë më në batalionin e "tyre", madje as edhe për një vizitë të shkurtër e të shihnin ushtarët e tyre, që tashmë ishin bërë luaj të vërtetë dhe që po rrinin gjithë herë në arena lufte e që gjithë herë po dilnin fitimtarë, ngase tanimë i ishin shtrirë luftës mirëfilli, e kishin mësuar mirë artin e të bërit luftë dhe i kishin çelikosë zemrat e s'po dinin të thyheshin.

Për hir të gjithë së vërtetës, që të mos harroj asgjë dhe që të mos mbetem borxh asgjë, këta kishin ardhur më vonë, shumë më vonë, në Budakovë, në truallin e Shqiponjave, por që kishin ardhur të strehoheshin, në kohën që batalioni ynë po strehonte gjithë stafin komandues të te gjitha niveleve komanduese të UÇK, në tërë vijën komanduese të hierarkisë së sajë, përfshirë këtu edhe komandat e disa njësive elite, në kohën kur vetëm Batalioni II po rezistonte duke bërë luftë burrash dhe po mbronte zonën e tij të lirë, të vetmen zonë të lirë, në atë kohë, në gjithë Zonën Operative të Pashtrikut e më gjerë. E nëse më besohet, meqë po "shihja" fundin e luftës, po "shihja" edhe pas luftën, e në te, në pas luftë, që atëherë, po shihja edhe "të parët e luftës" dhe "heronjtë e luftës" e normalisht që ata do të na udhëheqin e prijnë edhe në paqe, pas luftës, madje ashtu "drejt e mirë", si në luftë, ndërsa që nuk më kishte shkuar ndërmend se pas lufte mund të na kryesonin e udhëhiqnin edhe këta që po na shanin e na ishin pengesë e madhe në luftë.

Edhe në planin e përgatitjeve psiko- fizike të ushtarëve të Batalionit II, për luftën e madhe që pritej

s'ishte bërë gjë, dhe as që mund të gjenden gjurmë të ndonjë angazhimi në këtë plan, pos në njësinë në fshatin Vraniq, falë "ABI-t" dhe sa isha unë komandant njësie. Kjo ngase s'ishin vizituar ushtarët në vendqëndrimet e tyre dhe se s'ishin mbajtur takime e këshillime me ta, ndërsa që ushtarët po na plagoseshin e vriteshin mes vete nga mos disiplina dhe nga pakujdesia e tyre e tepruar si dhe nga përdorimi i gabuar i armëve meqë pjesa dërmuese ishin të rinj dhe s'kishin ndonjë përvojë ose s'kishin bërë shërbim ushtarak, kurse që këta të plagosur dhe të plagosur të tjerë meqë s'po trajtoheshin në vende të sigurta për jetën e tyre detyroheshin që me gjithë rrezikun të gjejnë mundësi shërimi në Prishtinë e kudo tjetër dhe këtë po e bënin me përpjekje krejt individuale duke qenë të harruar tërësisht nga shokët dhe strukturat e tyre përgjegjëse. Si pasojë, kishte nga këta që ishin thyer moralisht dhe s'ishin kthyer ma në vendin e tyre në radhët tona dhe po bënin jetën së përplasuri me forcat serbe kudo në Kosovë, kurse që neve po na dërgonin të fala nga vijat e fronteve të luftës në Smolicë, Gllogjan e kudo tjetër.

Thjeshtë, s'ishte bërë as edhe minimumi i mundshëm i gjërave që duheshin bërë, ndërsa që vërtetë kishim kaluar e po kalonim gjëra që shqetësonin dhe ishin të dhimbshme, kafshatë që s'kapërdihen siç do të thoshte, Migjeni, poeti i mjerimit. Por ti kthehemi pasqyrimit dhe shpjegimit të gjendjes ekzistuese dhe zhvillimit kronologjik të ngjarjeve ashtu siç po rridhnin me gjithë peripecitë që sillnin, përfshirë mundësitë reale dhe shfrytëzimin e potencialit që kishim.

Mundësitë dhe potenciali ushtarak i Batalionit II

Vërtetë ishim në fillim të gjërave, ndërsa mungonin përvoja dhe të gjitha pas sajë, ndërkaq që s'na kishin lënë të ngriheshim e të merrnim vetën as mësymjet, luftërat dhe betejat e shumta që kishim zhvilluar që nga themelimi, gati çdo ditë me forcat serbe: në Dardhishtë të poshtme, te "Zalli i verdhë", dhe në Qafë të Duhlës ku po përforconim në vazhdimësi njësinë e komandant "Guri" e të komandant "Kumanova" në luftimet e tyre të rregullta, gati të përditshme; Si dhe te "Guri i Kuq", në "Qafa e Rokopeqit" dhe te "Guri i Dollocit" ku po luftohej herë pas here, por që luftimet ishin të shpeshta.

Me sa e di kishim diç më shumë se 430 ushtarë, të armatosur lehtë e me fare pak municione, rreshtuar e sistemuar dobët dhe me radhë krejt të pa shtrënguara e me nivel krejt labil komandues. S'mund të thuhet se mungonte disiplina e rendi, por edhe të thuhet se i kishim vendosur e krijuar ato, nuk qëndron.

Paksa u zgjata këtu, thjeshtë, për ti bërë respektin vullnetit të çeliktë të ushtarit tonë, pjesëtarit të UÇK-së, që nga numër i konsiderueshëm i komandantëve të te gjitha niveleve të komandimit e udhëheqjes së vijave të frontit në këtë kohë e deri te ushtari i fundit i sapo rreshtuar në radhët tona; Por, ja që ishte vështirë të bëje ushtrinë, vështirë ishte të bëje edhe luftën, kurse s'kishte gjë më të vështirë se sa ti bëje të dyja këto njëkohësisht madje në kushte dhe rrethana lufte të ashpër kur po i thoshe ushtarit: Ja, merr pushkën dhe njëkohësisht po i tregoje se ku e

kishte armikun, ndërsa që popullin kishim "si zorrët" nëpër këmbë.

Kishte munguar edhe përkushtimi në punë e në angazhime, ndërsa që sado që të jetë punuar, këtu kishim të bënim me raport krejt të pabarabartë e të shpërqendruar forcash në këtë përballje dhe duke qenë kështu ishim të predisponuar, por edhe të dënuar të humbnim. Dhe ky ishte fati ynë i përcaktuar këtë herë.

Gjendja në terren e në fushëbetejë

Na ishte krijuar rreth i ngushtë, i çeliktë dhe nga forca tepër të mëdha; ishim krejt të pabarabartë në teren andaj shihej se nuk do të kishte ndonjë përballje të mirëfilltë forcash në konflikt, madje çfarëdo që mund të provoje do të thoshte të thyesh kokën për muri dhe të bësh forcat tua mish për top.

Shumë shpejt do të shohim se po përdorej krejt çka posedonte armiku, të gjitha llojet e armëve dhe do të villet municion vërtetë i shumtë, i ndryshëm, ndërkaq do të mësyhemi nga të gjitha anët dhe do të granatohemi nga armë kalibrash e potenciali të madh, që vepronte nga distancë dhe largësi e madhe, madje edhe nga Prizreni, Landovica, Novaka, Shtimja, Ferizaji e Shtërpca.

Më pas do të mësojmë, ngase kjo ishte bërë krejt publike, se kishim qenë të sulmuar nga hiq më pak se njëzeteshtatëmijë (27.000) trupa ushtarake, policore e paraushtarake dhe se ishim granatuar nga tridhjetegjashtë pika të pa lëvizshme dhe nga shumë pika granatimesh që ishin mobile dhe të lëvizshme nga vendi në vend. Në lidhje

me këtë, paksa me shaka, do te them se: “Po t’ia mësynin edhe kufirin gjerman do ta thyenin“.

Vetëm dy ditë më parë, në një betejë me forcat serbe, na ishin plagosur komandanti i batalionit Sadik Halitjaha dhe ushtari Zaim Muqa. Kjo na kishte gjymtuar paksa nga se sigurisht do të ishte më ndryshe me ata. Kur jemi këtu duhet thënë se ishte në vullnetin e komandant Sadikut të kishte komandën dhe të vazhdonte përpjekjet. Mirëpo shumica nesh s’shihnim këtë mundësi. Veçanërisht unë, do ta këshillojë të kaloj komandën te dikush tjetër dhe sinqerisht do ti them, duke ia uruar plagët, se këto plagë së paku kësaj here do ti shërbejnë për të mos humbur asgjë në karakter, ngase çdo gjë veçse dihej ende pa filluar, e edhe epilogu i kësaj përballje forcash.

Dy batalionet tjera të brigadës sonë, Batalioni I dhe Batalioni III sapo kishin provuar këtë që po ndodhte me ne dhe të thuash ishin zhbërë andaj s’mund të llogarisje në ndonjë përkrahje, as në kuptim të ndonjë sulmi pas shpine. Kur jam këtu të përmendë se Batalioni IV, në brigadën tonë asnjëherë dhe gjatë gjithë kohës së luftës s’është krijuar, ndërkaq që ishte caktuar staf i cili kishte marrë detyrë dhe përgjegjësi ta krijonte atë, njëkohësisht me batalionin II, e ndonëse që ky staf po sillej në teren poshtë lart dhe e kishte bërë publike ekzistencën e tyre si stafi komandues i Batalionit IV, asnjëherë, edhe sot se kam të ditur pse s’ishin bërë as përpjekjet më të vogla që të krijohej ky batalion e të mobilizohej e futej në veprim edhe potencial tjetër i shumtë që kishim në teren, tepër i nevojshëm për luftën tonë.

Edhe komanda e brigadës 123 s'ishte gjëkundi, ndërsa komandanti i saj Blerim Kuqi, me kohë, shumë mençur do të na lë mundësi e hapë rrugë, që edhe mos të përballemi fare me forcat serbe, me këshillën të shmangemi tërësisht nga vijat e frontit deri në kalim të tyre, me qëllimin e vetëm të ruanim forcat tona. Këtë madje ia kishte propozuar me shkrim komandant Sadikut e të cilën porosi me shkrim e kisha lexuar edhe unë personalisht. Në këto rrethana komanda do ti kalohet Sadri Emërllahut, i cili deri atëherë ishte shef i operativës në Batalionin II, meqenëse ishte kuadër për çështje sigurie dhe kështu "ishim futur ne luftë".

Në Vraniq, duke e parë qartë se s'po mund të arrihej ndonjë organizim a përgatitje e duhur, ditë me parë, kisha përmendur se këtë vendbanim dhe njerëzit këtu s'do ti gjente gjë e ligë. Vërtete këtu, në këtë plan isha tepër i fuqishëm ngase në fund të fundit këtu isha në "zanatin tim", në atë të agjitacionit e propagandës. Më kishte bërë të besueshëm edhe sinqeriteti im me njerëzit gjatë gjithë të kaluarës sime jetësore, prandaj çfarëdo që thosha besohej thellësisht dhe merrej si e vërtetë. Këtë e bëra të ruaja qetësi deri në momentet e fundit para se të përballemi, të mos na ndodhte neve ajo që po i ndodhte gati çdo ditë Bukoshit, që për një gënjeshtër nga më të voglat ose për një granatë të rënë kudo, madje edhe jashtë fshatit të tyre, të lëviznin gjithë njerëzit pa asnjë rregull a kriter, në ikje për vende më të sigurta. Edhe sot me vjen të qeshë që vinin te ne këtu në Vraniq, madje për siguri tepër të madhe e veçanërisht kur shpreheshin: "Se, po shkonin në Kralevë". Çka të thuhet: Se ku në të vërtetë ishim ne?

Padyshim, siç thuhet "në thumb të parë", ngase ishte bërë e ditur përkatësia jonë zonës së luftës duke qenë se po vepronim hapur në përgatitje për luftë, dhe se kufizoheshim me vendbanim serb.

Një natë para se të përballemi, siç e kisha menduar, kërkova të lehej fshati. Popullata e këtushme dhe ajo e strehuar këtu, isha i mendimit të lëviznin në drejtim dhe jo me afër se në Grikoc. Kjo për shumë arsye, mbi të gjitha për sigurinë e tyre. Për të mos u zgjatur me arsye tjera, në mes të cilave kishte edhe ndonjë shpresë, do të them, thjeshtë, se në fund të fundit s'na duhej gjë popullata këtu. Por që ky do të jetë dhe do të mbetet vetëm mendim i imi dhe jo qëndrim i imi i prerë nga se s'isha në pozitë të jepja urdhra. Kjo, po bisedohej "jo zyrtarisht" ngase ishim thjeshtë mysafir në një odë fshati, më konkretisht në shtëpinë e Zekë (Ramadan) Llugaxhiut, ndërsa isha kujdesur të ftoja e të kisha pranë këshilltarët e mi, e njerëz të tjerë, mendimi i të cilëve ishte i rëndësishëm.

Të bëj një kallëzim të shkurtër të gjendjes: Gjërat këtu, në Vraniq, kishin mbetur në rrugë, kishin stagnuar. S'kishte një bazë komande ku mund dhe ku duhet të takohej stafi komandues i njësisë. S'kishte as një kuzhinë të përbashkët ku do të duhej të ushqeheshin së bashku ushtarët e kësaj njësie, gjë e cila do të përafronte e do të lidhte më shumë emocionalisht mes vete këta ushtarë. Komandanti i kësaj njësie s'ishte takuar as edhe një herë me komandantin e tij të Kompanisë, ku ishte i rreshtuar, me gjithë insistimin e vazhdueshëm të këtij të fundit për tu takuar e koordinuar veprimet, ndërsa që tepër rrallë po takohej me komandën e batalionit dhe fare rrallë herë

kishte paraqitur gjendjen e kishte raportuar në komandë, për gjendjen në njësi. Komandantin e njësisë e gjeje gjithherë në shtëpinë e tij, ndërsa me komandantët e skuadrave e me ushtarët e njësitit komunikohej vetëm përmes korrierit. Ushtarët tanë, s'kishin provuar, kënaqësinë, të rreshtoheshin me shokët e të shtrëngonin radhët, kurse gjumin e bënin me gratë në shtëpitë e tyre.

S'ishte punuar strategji veprimi, madje mungonin edhe kontaktet e komandantit këtu me komandantin e kompanisë së tij e me lartë me komandën e batalionit me qëllim të koordinimit të veprimeve e as marrjes së urdhrave edhe tani kur po pritej dhe ishim krejt në prag të përballjes me forcat serbe. Për më shumë, derisa ne po bisedonim këtu, po më vinin informata se komandanti i Pikës në Buzhalë, po shqyrtonte mundësinë që qe atë natë, bashkë me ushtarët e tij të lente këtë pozicion, kurse unë s'po guxoja të përmendë gjëra të tilla këtu nga frika mos po futja defetizëm e shqetësim, ndërsa që të nesërmen kuptuam se kjo kishte qenë e vërtetë.

Sidoqoftë, kishim shqetësim të veçantë dhe ishte mirë që po bisedohej. Pati edhe mendime të tjera. Dikush përmendi mundësinë e lëvizjes së popullatës deri në fushën e fshatit, në Toqilla, me çka u pajtova. Një a më shumë të tjerë ishin të mendimit që popullata të dilte, në Lumi i Madh, mbi fshat, dhe kështu mbeti.

Ishte shtruar pyetja: si të vepronin njerëzit tanë me vendbanim në Popolan? Popullata shqiptare atje, deri më tani kishte bërë jetë të qetë. Këtu isha i prerë dhe konkret: Ata janë njerëz tanë dhe duhet të jenë, kudo që të jetë popullata që ishte në fshatin Vraniq. Përmenda se po

përballeshim me forca serbe e jo me fqinjët tanë serb. Lamë mundësi të vendosnin ata vet.

U bisedua edhe si të vepronte forca jonë. “ABI“ ishte i mendimit që armiqtë të mos priteshin në fshat; por që atyre t’ju zihej pritë, te vreshtat, nën fshatin Savrovë. Të këtij mendimi s’ishin të tjerët, ndërsa unë do të shprehem se kjo është çështje, krejt, ushtarake dhe se për çfarëdo, do të duhej këshilluar ose marrë instruksione nga stafi i hierarkisë së tyre komanduese ose zbatuar urdhrat, përndryshe isha shprehur se personalisht s’isha për asnjë zënie prite dhe kështu, në një farë mënyre, kisha treguar tërë luhatjen tonë. Të përmendë se këtu, në këtë takim, ishte komandanti i Togës në Vraniq Adem Kolgeci dhe se kryesisht është pajtuar me mendimet që shpreha unë, ndërsa që në këtë takim s’ishte askush nga kryesia e fshatit, gjë krejt joserioze dhe që rriste shqetësimin, por edhe mllefin e shumicës së civilëve të pranishëm aty.

Përpjekja e fundit

Atë natë, më duhej qetësi më shumë se asnjëherë tjetër, prandaj kisha zgjedhur të jam te Fadil Llugaxhiu dhe kjo për shumë arsye. Së pari më duheshin shakatë e tij të shumta e shumë të qëlluara, ngase e dija që ndoshta s’do të flija fare. Te Llugaxhinjtë, në të vërtetë e kisha bazën dhe sado që përkrahesha e gëzoja respekt te të gjithë në fshat, këtu, në këtë lagje, isha tepër i mirëpritur. Fadili më kishte qëndruar fare afër dhe se bashku me Regjë Kolgecin më kishin ofruar shërbime dhe mundësi veprimi duke lëne në shërbim të luftës dhe timin madje katër automjete

njëherazi, që të gjitha të kushtueshme, të cilat s'i kisha pranuar ngase atëherë shërbime me automjet me ofronin Bislim Muqa, Azem Kolgeci e Sali Llugaxhiu, ndërsa kisha edhe automjetin tim; Dhe mbi të gjitha ngase Fadili kishte telefon mobil i cili më duhej që në orët e para të mëngjesit të kontaktoja Degën e KMDLNJ në Suharekë, me qëllim të sensibilizimit të situatës kundrejt faktorit ndërkombëtarë këtu në Kosovë, që të kishin ndikimin dhe të gjenin formë të siguronin popullatën civile prej rreth njëzetmijë (20.000) njerëz sa kishim këtu, në mënyrë që ajo të mos dëmtohej. Në atë kohë në Kosovë vepronte Misioni Verifikues Ndërkombëtarë. Kontaktin e kisha realizuar rreth orës katër (4), herët në mëngjes; Në bisedë kisha Kryetarin e këtij Këshilli Destan Berisha. Në interesimin tim se a do të jetë e mundur të ndikohej disi tek ky Mision për intervenim dhe marrje nën mbrojtje dhe përkujdesje të popullatës civile, sepse i kanosej një sulm i paparë nga forcat serbe të cilat tashmë ishin pozicionuar, kurse më ishte thënë se në këtë fazë është krejt i pamundshëm intervenimi, ngase veprimi i verifikuesve ndërkombëtarë fillonte të vinte në shprehje tek pasi që agresori e kryente sulmin e parë . Ndërkaq nga ana e Këshillit, tanimë ishin bërë përpjekje, duke njoftuar mediat më të fuqishme botërore si: Zërin e Amerikës, BBC etj. për lëvizjet e forcave të mëdha serbe në pjesën lindore të Suharekës që kishin filluar që nga pasditja e që vazhdonin deri vonë pas mesnate. Duke e ditur që çfarëdo thosha, bëhej krejt publike, isha deklaruar se mund të shpresonim në të mirë.

Fillimi i veprimeve luftarake

Më 27. shtator, që në mëngjes ndihej erë baroti ngase kishin filluar veprime luftarake. Se do të veprohej dhunshëm, si kudo tjetër, u pa nga djegiet që filluan në fund të fshatit Savrovë, me të filluar këto veprime. Normalisht që kisha zgjedhur të jam në Vraniq. Krejt në mëngjes, me të filluar këto veprime, Sedat (Xhemajl) Muqa ishte i pari që kishte ardhur te unë dhe po më pyeste nëse bënte që me kamerën e tij të incizonte ç'po ndodhte, ndërsa që unë e kisha falënderuar dhe i isha shprehë mirënjohës për idenë por edhe për punën kaq të madhe që do të bënte; kurse isha shprehë se ndoshta do të jetë puna më e mirë që do të mund të bënim. Për fat të keq, për arsye të shumta që mund ti supozojë, meqë Sedati ishte zënë e marrë rob lufte, s'kishte mundë të bëjë punën e tij, ose që do ti dëmtohet materiali. Fati e kishte dashur që këtu të ketë gazetarë e reporter të shumtë të agjencive e mediave të huaja të lajmeve, madje nga ato më të njohura botërore dhe se i ishte prezantuar deri diku opinionit ajo që pat ndodhur këtu.

Granatimet kishin filluar. Granata minahedhësish, topash, tankesh, e predha të ndryshme nga tërë llojet e armëve që kishte makineria armike binin në mënyrë përzgjedhëse në fshat, ndërsa veçanërisht granatohej Quka. Në Qukë, gjuhej pandërprerë edhe me kundërajrorë të tipit "Praga". Shihej qartë që e dinin se Vraniqi ishte i ngarkuar me popullatë civile dhe mënyra se si gjuanin më pas caqet tregonte qëllimin e tyre që këtë masë të shumtë njerëzish ta shtynin në grykë të lumenjve, mbi fshat.

Evakuimi i popullatës

Në këtë tmerr që kishte filluar, është me rëndësi të veçantë të thuhet, për habi, së paku timen, njerëzit evakuoheshin me tepër maturi, ngadalë dhe mençur. Ishin tepër solidarë me njëri tjetrin, ndihmoheshin dhe përkraheshin mes vete. Bashkë dhe njëkohësisht me popullatën e këtushme po tërhiqeshin edhe banorët shqiptarë të Popolanit. Ishte befasi e këndshme kur te ta nuk vërehej shqetësim i tepruar. Tamam reagim njerëzish krejt të përgatitur. Pata menduar e isha shprehë: "E dhanë provimin sërish"; Dhe vlerësova se po ndodhte mrekullia.

Prej fillimit të organizimit tonë ushtarak e deri më tani në sprovën e parë serioze, i kishim "testuar" disa herë. Kishim kërkuar nga çdo familje sapun për ushtarët tanë- na kishte dhënë çdo familje në fshat; Ngjashëm kishin vepruar në mase njëqind për qind kur kishim kërkuar pasta e brusha dhëmbësh, herën tjetër peshqir e edhe kur kishim kërkuar batanije. S'mbajmë mend të na është thënë: Jo, madje as njëherë, as kur kemi kërkuar të meremetojmë e mobilojmë spitalin ushtarak në Buzhalë dhe as kur kemi kërkuar, madje shpesh herë, me disa dhjetëra burra e të rinj, fuqi punëtore, për të hapë istikame në vijat e frontit që po vendoste Batalioni II, kudo.

Kisha vendosur të përcillja vëmendshëm çdo lëvizje të popullatës gjersa po evakuohej, përkrahjen dhe ndihmesën që po i jepnin në këto momente asaj ushtarët pasi që kishte kohë deri në ndonjë përpjekje për të rezistuar si dhe lëvizjen e mënyrën e sjelljes së tyre në përgjithësi, prandaj isha në rrugë, te dyert e mia, ngase nga

aty shihja, si në pëllëmbë dore, të dyja rrugët dhe ndodhesha në mes fshati ku mund të jepja këshilla të nevojshme, si popullatës ashtu edhe ushtarëve.

Ushtarët i porositja të dëgjonin urdhrat dhe të ishin tepër të vëmendshëm, ndërsa popullatës të lëvizte pak me më shpejtësi në atë pjesë të rrugës, kurse askujt si thosha se do të bënim këtë apo atë veprim. E dija, vetëm, se do ta kishim vështirë, madje tepër vështirë, që të gjithë, pa dallim ushtarë e civil, kurse që veçmas po mendoja në pleqtë, nënat e reja me fëmijë dhe në fëmijët, sidhe në ditët e flakëve të luftës e në dhunën qe po na përfshinte e që do ta përjetonim për gati një javë të tërë, siç më ishte përmendur e thënë nga ata të KMLDNJ- së. Mbështetje kishim forcën morale dhe ndoshta Zotin, të cilin të jem i sinqertë s'po e lusja për asgjë, ndërsa që i isha hidhëruar për fuqinë që po i lente në dorë barbarëve këtu, por edhe të dhunshmëve kudo në botë e që s'po ua thyente qafën.

Tërheqja e ushtarëve dhe kontakti i parë me kryesinë e fshatit

Popullata ishte larguar nga fshati tashmë; kur vërejta edhe lëvizje të ushtarëve që po tërhiqeshin larg vijës se frontit. Dhe gjersa po i këshilloja që në asnjë rrethanë të mos lenin armët dhe të mos shkonin te popullata, por të shkonin në grykën e Lumit të Vogël, ku do të takoheshim pas pak; te unë vijnë anëtarë të kryesisë së fshatit, të cilët s'po merrnin mundin të më pyesnin gjë, por më lutën të mos shtija më, nga oborri im me: top pa dridhje, minahedhës e armatim tjetër të rëndë. Sapo i sigurova se

unë s'po shtija nga asnjë lloj arme dhe se si kisha ato, më pyetën nëse: Shefki Muqa po shtinte nga Quka me "kallash"? Kjo, për ta fajësuar atë, më pas, për "incidentin"; Mund të merret me mend, në kohën kur sapo kishin filluar granatimet, ndërsa forca serbe s'shihnim gjëkundi, këta po përmendnin të shtëna me "kallash", e nga ku? Nga "Quka" që po digjej nga breshri municioni e predhash të shumta që s'po lenin gurë mbi gurë. Ashtu krejt qetë, i luta të ishin më serioz e që veprimin e tyre t'ia përshtatnin rrethanave, dhe u ndamë.

Evakuimi i familjes sime

Ishte pasdite e vonë kur iu kisha thënë anëtarëve të familjes sime që edhe ata të lenin shtëpinë e të largoheshin; tani më s'po shihja kënd duke u tërhequr pos Asllan (Hajrush) Kolgecit, i cili më këshilloi: Të mos e vonoja familjen ngase "Shkiet" ishin në livadhin pranë shtëpisë së tij. Meqenëse kishim shumë fëmijë (nëntë) dhe ishin tepër të vegjël (më i madhi prej tyre ishte Vlora tetë vjeçe); Asllani na kishte ndihmuar edhe ti lëviznim ata deri në oborrin e Hajrulla (Musli) Matoshit. Deri sa po ndahesha prej tyre, për t'iu bashkuar shokëve në Lumi i Vogël; pashë që njerëzit e shtëpisë së Hajrulla Matoshi, i morën ata dhe i futën në bodrumin e shtëpisë së tyre. Si mund të jepet shpjegim e përfytyrim më i mirë se ky, për mundësitë reale që kishim, për lodhjen që na kishte shkaktuar robëria e gjatë e pushtuesve të tjerë të shumtë gjatë gjithë së kaluarës sonë historike dhe e këtij pushtuesi kaq të dhunshëm dhe për gatishmërinë tonë për tu flijuar.

Takimi në “Lumi i Vogël”, riemërimi im komandant

Me të kaluar në Lumi i Vogël, takova numër të vogël shokësh të cilët u shprehen se po me pritnin. Si përgjigje interesimit tim: “Se ku ishin të tjerët”? Do të më thonë: “Se kishte edhe ndonjë me lart, por që janë pak”; Dhe vërtetë ishin pak, ndërsa që më than: “Se për komandantin e tyre s’dinin gjë”. U shpreha se na duhej komandant dhe se atë duhej emëruar menjëherë, ndërsa i kisha lutur të mos jam unë i përzgjedhuri i tyre me shpjegimin se duke qenë pranë komandantit do të mund të ndihmoja më shumë me këshilla se si të vepronim . Të këtij mendimi s’ishin të tjerët. Kjo do të më jetë sfida më e rëndë në përvojën time jetësore, në të cilën isha me fat që, me gjithë vështirësitë, nuk më është vrarë kush.

Emërimi i Reshat Muqës zv. Komandant

Sapo isha zgjedhur komandant, këta ushtarë do ti ndajë në dy njësi, fillimisht të vogla, të cilat më pas do të rritën tejmase, ndërsa për komandant të tyre caktova Bislim Muqa dhe Azem Kolgeci. Meqë kisha dëgjuar se Reshat Muqa ishte aty diku, kisha vendosë që Reshati të ishte zëvendës imi. Për hire të realitetit të përmendë se ishte njësia e vetme që këto ditë do të ruaj organizimin dhe që “po vepronte”. Për më shumë, ishte njësi që u krijua pikërisht në rrethana kur nga forca goditëse e armikut po shkatërrohej e zhbëhej çdo gjë.

Më tej, kishim rend dhe rregull; Kjo edhe sa i përket mos largimit nga njësia dhe sistemimit në njësi.

Vëzhgimi i zhvillimeve në fshat

Kisha vendosur të jem personalisht në vëzhgim të zhvillimeve në fshat, ndërsa po më duhej një shoqërues. Azemi më kishte lutur ta merrja atë dhe kështu u bë, kurse të tjerët i kishim sugjeruar të pushonin dhe të ruanin energjitë. Në insistimin e tyre të na bashkoheshin, ju kisha thënë se ishte thjeshtë një vëzhgim dhe se s'mund të rrezikonim.

Duke qëndruar mbi lagjen Shehu, deri para mbrëmjes, kishim parë shumë çka nga tërë ai mllef që po zbrazej në krejt të mirat në fshat. Digjeshin radhazi të gjitha shtëpitë dhe objektet përcjellëse; S'lehej kotec pulash pa djegur. Ishte e rëndë, sidomos, ulërima e qenve dhe pallja e lopëve që po digjeshin.

Para se të bie terri u kthyem në njësi, ndërkaq vërejta se njësia ishte rritur në numër, por që këtu s'ishin shumica e ushtarëve të fshatit. U ndjeva mirë që këtu kishte qetësi dhe disiplinë të lartë, ndërsa shpreha njëkohësisht habi dhe shqetësim për ushtarët tanë që s'i kishim aty. Veçmas isha shqetësuar dhe po shtrydhja mendjen për komandantin e njësitit, ndërsa që për këtë po pyesja secilin nga ushtarët veç e veç.

Takimi me Kryesinë e Fshatit në "Lumi i Madh"

Më duhej të takohesha me kryesinë e fshatit, sa për t'ju bërë të ditur se kisha zgjedhur të mos provokoja asgjë me veprime tona në mënyrë që së paku për këtë, ata të ishin të qetë; Gjithashtu doja të shohë cila ishte gjendja

shpirtërore dhe gjendja në përgjithësi e popullatës dhe të leja porosinë që ushtarët tanë të lenin popullatën dhe ti bashkoheshin njësisë, ngase kështu ata po rrezikonin vetën dhe ishin shqetësim për popullatën. Prandaj për të mbuluar mirë dhe shpejt këto veprime, pa u zgjatur shumë te popullata, së bashku me Bislimin, Azemin dhe Enverin kishim shkuar atje me detyra të ndara kush- kënd të takonte dhe çka të bisedonte me ta.

Unë kisha biseduar fare shkurt me pothuaj tërë kryesinë e fshatit. Ua pata shpalosë projektin tim të cilin ata e pranuan në tërësi; Edhe pjesën kur iu thash se kështu do të veproj derisa s'ngushtohem të hedhë armët e të dorëzohem.

Meqenëse familja ime ishte vendosur ndër të fundit ose më saktësisht e fundit aty, i pashë shkurt, ndërsa në pyetjen e tyre: Se a ishin mirë aty ku ishin?, iu thash: Po, mirë jeni, tamam siç ka thënë i ndjeri, Qazim Munishi: "Çka e ka ndërmend të më gjejë nesër më gjetët sot". Qesha me ta dhe ju thash ta kalonin natën si të mundnin, ngase: "Të nesërmen që në mëngjes do ti largonin, serbët, në ndonjë vend më të sigurt, e më pas do të përpiqeshin të na largonin ne nga këto zona". Ju përmenda se jam me shumë shokë dhe se kam shokë të mirë, prandaj edhe ne do t'ju shmangeshim disi. Me kryesinë e fshatit e me familjen, u ndamë duke uruar njëri- tjetrin që ta kemi sa më lehtë. Ishin rrethana që më kot lodhem ti përshkruaj e paraqes, por ja që askush prej nesh në njëfarë mënyre s'po dorëzohej; Ose i ishim dorëzuar fatit të gjithë. Fundi i kësaj ofensive do të tregoj se në këtë rast fati do të jetë në anën e të guximshmëve.

Improvizimi i Pikës

Ora ishte rreth 22, dhe derisa po ktheheshim, na kishte shkuar ndërmend mundësia që forcat paramilitare serbe të futeshin në popullatë, natën. Për këtë, vendosëm të improvizojmë një Pikë roje vëzhgimi në "Kodra", mbi fshat, ndërsa që kishim zënë pozicion fare pranë rrugës, kurse unë personalisht po rrija në rrugë dhe po legjitimoja çdo njeri, grup njerëzish apo automjet që lëvizte nga fshati në drejtim të popullatës, e meqë kjo ishte krejt e rrezikshme për mua, ngase asnjëherë s'dija kënd po e ndalja nga terri i rëndë në atë natë tepër të errët ose nga dritat e automjeteve që më binin direkt në sy derisa po i ndalja, kisha urdhëruar paraprakisht shokët, të vepronin me zjarr në çdo situatë të re, të konfliktit, të krijuar duke mos më kursyer as mua në të tilla raste. Më pas, rreth orës 24, të sigurt se forca serbe s'po hynin natën te popullata, kishim vendosur të hiqeshim nga rruga, ndërsa po qëndronim në "Pikën" që improvizuam. Ushqime, shtrojë e mbulojë të shumtë do të na japin familjarë të Haxhi (Hysen) Matoshi. Derisa ne po flinim, deri në mëngjes, do të na ruajnë neve dhe do të vëzhgojnë: Halil (Sinan) Basha, Zekri (Sinan) Basha dhe Florim (Osman) Basha. Fati e deshi, s'pati lëvizje, kaluam një natë të mirë dhe u zgjuam të lumtur, kurse shiu që kishte filluar që nga orët e para të pasmesnatës do të na shoqëroi gjatë gjithë këtyre ditëve të ofensivës deri në përfundim të saj.

Organizimi i jetës në njësi dhe zhvillime tjera

Me tu kthyer, pamë se njësia, së cilës i kishte qëndruar në krye Reshati, ishte rritur numerikisht dhe se tani bëhej fjalë për një Kompani të fuqishme. Për të pasur gjërat plotësisht nën kontroll, qëllimisht, s'e kisha ndarë më tej njësinë dhe s'e kisha rritur stafin komandues. Nga që s'po e njihja terrenin dhe kisha vështirësi orientimi në hapësirë, caktova udhërrëfyes e këshilltarë për këtë çështje Rrahman Shehun, me porosinë që gjithherë, në çdo moment, e në çdo rrethanë të më qëndronte pranë.

Derisa unë po mbështetesha fort në Reshatin, i cili po shkëlqente gjithanshëm në veprime, në një moment, e kisha lutur të mos më zëvendësonte, por të ishte komandant i imi, kurse ai ma pat kthyer: "Baca Skënder, me të vërtetë je i mirë"; Dhe me kaq ishim kuptuar të vepronim siç ishim. Të përmendë këtu se s'do të kem fatin të njoh më njeri, mik e dashamirës për mikun e ujk për armikun, siç ishte Reshati, ndërsa s'do të më hiqet mendjes bukuria e tij. Siç e njoha, Reshati, bukurinë e shpirtit e kishte edhe më të madhe se bukurinë fizike që i kishte dhuruar natyra. Te ai, gjithë të mirat rrinin në një vend.

Ata që po bashkoheshin me ne, i sistemonim në njësi, ndërsa civilët e shumtë po i strehonim dhe po tregonim gjithë respektin e përkushtimin për ta. Dhe derisa s'po bënim gjë tjetër, fakti që kishim strehuar dhe po mbronim këta civil na kishte zgjuar ndjenjën e lumturisë dhe ishte një ngushëllim i mirë për ne, sepse po bënim atë që mund të bënim.

Me civilët, na kishin ardhur edhe informatat për të vrarët e parë civil dhe kështu do të vazhdoje për tri ditë me radhë. Ndërsa, derisa i ishin bashkuar njësisë, në lëvizjet e tyre, ndonjëri nga njerëzit tanë, ishin ballafaquar me forcat serbe dhe kishin vrarë ose plagosur ndonjë prej tyre. Kështu kishte ndodhur me Reshat Muqën. Në kohën që unë e kisha emëruar zëvendës timin, ai s'po gjendej aty. Anëtare të familjes së tij të strehuar në Lumi i Vogël, më kishin thënë se ishte kthyer në shtëpi, e meqenëse po më duhej, kisha shkuar pas tij dhe ishim takuar tamam në kohën kur ai po vriste serb të cilët po digjnin shtëpinë e Sadik (Mahmut) Muqës. Këtë, më vonë, do ta dëshmojë, në një deklaratë të sajë, Rrushe (Muharrem) Muqa kur kishte thënë se kishte parë forca serbe të cilat po bartnin të vrarë të tyre, të cilët i kishin mbështjellë në batanije. Edhe Zaim Muqa, ashtu i plagosur, në një përballje, kishte shti në ta dhe kishte arritur të shpëtojë prej tyre një grup civilësh. Kishte, ndoshta edhe ndonjë rast tjetër të izoluar.

Të përmende këtu se, në Lumi i Vogël, për dallim prej krejt asaj popullate që kishte fshati, ishin strehuar: familja e Veli (Xhemë) Muqa (familja e Reshatit) dhe familja e Mehmet (Muharrem) Basha, të cilat ishin ndihmesë e madhe për ne të kemi bukë dhe se krahas teknikut të mjekësisë, Zymer Llugaxhiu, nënë e bijë: Halime (Muharrem) Basha dhe Minire (Muharrem) Basha, janë përkujdesur për ndonjë të plagosur që po vinte.

Ishte dita e dytë, më e gjata dhe që mbyste psikikisht. Njësia ishte rritur tej mase. Ishte rritur edhe numri i civilëve të strehuar aty. Bukën që mund të na gatuanin këto dy familje, në ato rrethana të rënda, sipas

rregullit po ua jepnim civilëve; Atyre po i jepnim edhe shumicën e mollëve të papjekura që vinin nga "furnizuesit" tanë. Kishim filluar të ndjenim uri, ndërsa shiu që po binte pa ndërpre që nga mëngjesi, bashkë me granatat e shumta, nga të gjitha anët, kudo rreth nesh dhe vringëllimi i armëve gjithandej, kishin bërë të lodhemi.

Që nga mëngjesi i kësaj dite, më kishte rënë në sy një i strehuar civil dhe po më pengonte me dukjen e tij prej zotërie ngase ishte i veshur mirë e me shije, vetën po e mbante të pispillosur e të pastër, ndërsa me vete po e mbante një kamerë. Fillimisht kisha menduar të jetë gazetarë a reporter dhe po prisja të identifikohej me prezantim. Më pas, ngaqë shihja se po më bëhej rëndesë; në një takim me zëvendësin tim dhe dy komandantët e nën njësive, aty pranë por ndaras nga ushtarët dhe civilët, e bisedova këtë çështje me ta e më pas e thirra edhe këtë "zotëri". Isha i drejtpërdrejt. I thash se po dyshoja në të: se mos ishte spiun serb ose edhe më keq dhe se për këtë duhej të shmangej nga masa e njerëzve aty; të shkonte më tej në pyll ku do ta kontrollonin në gjithë trupin dhe rrobat që mbante veshë, Bislimi dhe Azemi e më pastaj të merrej në pyetje nga Reshati. Sipas qëndrimit tim duhej të lente kamerën këtu, të ishte i sinqertë dhe i drejtpërdrejtë me njerëzit që po merreshin me të dhe i shkurtë në përgjigjet që do të jepte. Pas tërë kësaj, ia kisha kthyer kamerën, ndërsa e kisha urdhëruar që gjatë gjithë kohës të kujdesej të më qëndronte afër por në pozitë që ti përcillja me lehtësi lëvizjet e tij. Në fund të krejt asaj që ndodhi për tri ditë, këtij burri, i pata kërkuar falje duke i thënë: "Besoj që më keni kuptuar", ndërsa më ishte përgjigjur me: "Dëgjofsha

mirë për Ty e për Ju, jeni shpëtimtarët tanë“. Ngjashëm me këtë, se ishim shpëtimtarët e tyre, na ishin shprehur edhe të gjithë të strehuarit tjerë në njësinë tonë. Kështu, si edhe në veprimet e mija më parë, po ia qoja në vend të dy amanetet që më kishte lënë i ati im, Ibrahimi: “Që të punoja veç mbarë e mirë dhe të mos ia bëja keq askujt, duke mos u marrë me Shqiptarët“; Dhe “Të ruaja vetën nga armiqtë kudo, e të mos bija në duar të tyre madje duke ruajtur për vete dy fishekët e fundit“.

Njësinë po e mbanim në pushim, e meqë ishim në rreth tepër të ngushtë (ngado që silleshim, shihnim dhe mundë të vrisnim serb), kishim vendosur roja të dyfishta. Kur na dukej se forca serbe po lëviznin në drejtim tonë, pozicionoheshim dhe përgatiteshim të rezistojmë, kurse gëzoheshim shumë sa herë që s’kishte nevojë për këtë. Po bëhej vërtetë një “luftë” e fortë, që shkatërronte, nervash.

Rendi, rregulli dhe disiplina në njësi

Ushtarët e njësisë dhe civilët të cilët ishin strehuar këtu në njësinë tonë, e kishin të ditur qëndrimin tim se s’lejoja largim të tyre nga njësia. Kisha vetëm një rast largimi pa leje, të ushtarëve dhe civilëve edhe pse isha pyetur, por që normalisht s’ju kisha dhënë leje largimi; Dhe këta, sapo ishin larguar nga njësia, kishin rënë në pritë të forcave serbe dhe ishin vrarë dy prej tyre, ndërsa një tjetër ishte plagosur. Në lidhje me këtë, ishim mobilizuar në grup: Unë, Reshati, Bislimi, Azemi, Enveri, Imeri dhe Nevzati, i kishim tërheqë trupat e tyre, ngarkuar në kalë samari, ndërsa Imeri dhe Nevzati i kishin sjellë në oborrin

e Xhamisë së fshatit. Të vrarët ishin: Hafir Elshani e Milaim Bugari ndërsa i plagosuri, njeri nga pak civilët që ishin me ta. Meqë këta civil ishin kthyer në njësi, kishim zhvilluar një "hetim" të shpejtë, ndërsa flitej për rezistencë, të suksesshme, të këtyre djemve për të mbrojtur këta civil, por jo edhe për të mbrojtur vetën. Kjo, ndoshta ngaqë kishin zhvilluar luftime të gjata. Për të plagosurin, sipas rregullit, më pas ishim kujdesur maksimalisht, ndërsa unë s'isha më fare miqësorë me ta, kurse isha bërë më i ashpër edhe me të tjerët dhe po kërkoja maksimumin e disiplinës.

Edhe tani kur serbët na kishin zënë frymën, mendja po më rrinte te "Quka", si pikë strategjike që ishte e të cilën mendja ma thoshte se do ta mbajnë serbët për më gjatë, meqë do të krijonin siguri për lëvizjet e tyre dhe për serbët lokal, ndërsa që kjo neve do të na zhvendoste nga të gjitha këto terrene luftimesh që nga Maqiteva e këndej.

Heqja e barrës, nxjerrja e shokëve nga rrethimi

Para mbrëmjes, na ishte bashkuar edhe pjesë e "komandës së batalioni II", në mesin e tyre edhe "komandanti i batalionit", Sadri Emërllahu. Edhe këta i kishim sistemuar si gjithë të tjerët, dhe meqë s'po bënim gjë kishim vendosur ti nxirrnim të gjithë nga aty me të rënë terri. Këtë e bëmë tepër suksesshëm, duke i përcjellë në grupe të vogla.

Së pari i ndanim, në grupe të vogla, varësisht nga cilat vendbanime ishin, i rreshtonim, ju emëronim një komandant i cili me kërkesën tonë i numëronte disa herë

radhazi dhe na raportonte edhe pse ne ishim të pranishëm mu aty. Këtë e bënim për të ditur komandanti i tyre, por edhe secili prej tyre si dhe që t'iu fiksohej në mendje sa vetë ishin në grup dhe kush ishin anëtarët e grupit. Pastaj, në rresht për një e me distancën e duhur mes tyre, ushtarët tanë, i udhëhiqnin përgjatë rrjedhës së Lumi i Vogël deri në fshat e më pas përgjatë rrjedhës së Lumi i Madh deri në dalje nga fshati. Kur të dilnin nga fshati, në fushë të hapur, këta përcjellës, i kisha urdhëruar ti nxirrnin nga lumi, në një arë, në fushë dhe ti orientonin mirë në hapësirë madje edhe duke ju treguar ku ishte vendbanimi i tyre, në bazë të dritave. Këtu, me punën dhe angazhimin e tyre do të shkëlqejnë ushtarët: Imer (Sherif) Shehu, Nevzat (Jonuz) Shehu, Safet (Nazim) Muqa, Mehmet (Muharrem) Basha, dhe Enver (Ibrahim) Basha e ndonjë tjetër që ishte në shoqëri me ta, dhe këtë e kishin bërë në kohen kurë i tërë fshati po vlonte nga forca, nga më të ndryshmet, të shumta armike serbe, të cilat edhe më tej po e digjnin fshatin, por duke pas lejen dhe urdhrin tim, që në rast se hetoheshin, të rezistonin fuqishëm deri në fund.

Tani, meqë iu kishim bërë këtë ndihmesë e edhe nderë këtyre që përcollëm, ndjenim se kishim bërë një punë, ndjeheshim edhe më të lehtësuar për faktin se ishte më lehtë të mbaje barrën e mbetur, shumë më të vogël nga barra e rëndë që kishim deri atëherë duke pasur atë numër të madh njerëzish, dhe gjithë përkujdesjen për ta.

Vëzhgimi në “Lumi i Madh”

Ishte mesi i natës, kur siç thuhet kisha marrë frymë tri herë radhazi, dhe sado që kisha informata të bollshme për gjithë të vrarët e të plagosurit, por edhe për zhvillimet me popullatën në ato rrethana, veçmas të rënda për ta, ngaqë s’po mund të rehatohesha, vendosa të bëj një vëzhgim mbi fshat dhe në afërsi të Lumi i Madh ku kishte qëndruar popullata, për të parë cila ishte gjendja atje, ndërsa po shoqërohesha nga Azemi, Enveri, Florimi, Halili e ndonjë tjetër që s’më kujtohet. Në fshat po vazhdonte me djegie, kurse në Lumi i Madh ende po dilte tym e flakë nga ato që iu kishte futur zjarri më parë, ndërsa që s’kishte njeri. Derisa po ktheheshim, fillimisht mbi koka tona hodhën raketa ndriçuese e më pas, nga Maqiteva, na gjuajtën rrufeshëm me kundërajrorë të tipit “Praga“, e më shumë, me pushkë- mitraloz të rëndë nga Quka dhe nga Rrafshi nën Maqitevë. Shpëtuam sado që vërtetë “e dogjën atë sipërfaqe“. Këtu do ti them Enverit: Të kujdeset, të mos jetë kurrë më në afërsi me mua, që të mos ndodhte të vriteshim njëherazi që të dy.

Shqetësimet për familjet dhe për popullatën

Ngjashëm me një natë më parë edhe këtë natë moti ishte i lagësht, shi po binte gati pa reshtur, ndërsa e patëm kaluar më lehtë, para së gjithash, meqë i ishim përshtatur kushteve dhe rrethanave e edhe për faktin që vërtetë kishim mbetur shumë më pak krahasuar me dy netët më parë. Edhe buka tashmë “na mjaftonte”, ndoshta ngase

s'po na hahej nga lodhja, pagjumësia dhe ngarkesa psikike.

S'na lente të qetë dhe po mendonim vetëm për fatin e familjeve tona dhe gjithë asaj popullate civile, jeta a vdekja e të cilëve kishte mbetur në duart e përgjakura e në mëshirën e kriminelëve serb të atij fundshekulli, por që s'dallonin gjë nga bandat çetnike të kohëve të liga më parë, dhe për këtë e kishim tepër vështirë.

Ishin të paktë ata që po flinin duke u ndërruar në vazhdimësi në dy apo tre dyshek krejt të lagur nga shiu që kishim, kurse të tjerët pos atyre që po bënin rojën dhe sigurinë e trefishtë të shokëve e të civilëve, po komentonim informatat që kishim mbi gjendjen e popullatës dhe po prisnim informatat e së nesërmes. Çdo gjë po vlonte në zemrat e në mendjet tona, ndërsa që "luftën" më të madhe po e bënim me ndjenjën për hakmarrje. Sidoqoftë ne së paku deri atëherë e kishim ruajtur qenien tonë si njësi e organizuar, dhe kishim krijuar një përvojë e cila padyshim do të na shërbente mirë të mësoheshim me jetën e luftëtarit që duhej të bënim në të ardhmen, por edhe kishim mësuar faktin se nuk do të na ngushtonin sa të na detyronin të rezistonim.

Fundi i ofensivës, kontrollimi i terrenit, numërimi i të vrarëve

Në ditën e tretë të kësaj katrahure, derisa ne po vëzhgonim gati çdo lëvizje të tyre, që herët paradite kishim vërejtur se po tërhiqeshin nga tereni, madje këtë tërheqje e bënin krejt shkujdesur. Mundësitë për t'ju dhënë

“mësim”, duke u hakmarrë në ta, i kishim më shumë se të mëdha, por ja që s’po bënte të merrnim hak; Dhe, edhe për këtë e kishim vështirë.

Meqë, forcat serbe, u bartën nga tereni shumë shpejt dhe në tërësi, atje kishim mbetur vetëm ne; E derisa po pushonim në heshtje varri e ndjeheshim si zogj qyqeje, na vije mish i pjekur “nga fshati”, të cilin na e kishte përgatitur e dërguar Bahrije (Osman) Basha dhe bukë e nxehtë nga familjet “furrtare” që kishim aty. Në gjendjen që ishim, veçmas ky mish i pjekur që kishte ardhur “nga fshati” do të na ushqejë e edhe do të na shërojë shpirtërisht. Kjo përkujdesje kaq e shpejtë për ne, ishte shenji i parë dhe dëshmia më e mirë dhe më e fuqishme se njeriu i thjeshtë, i vendit, ishte i lidhur fort me ne dhe se kishte kuptuar mundësit tona e po njihte vullnetin dhe gatishmërinë tonë të çeliktë, që me luftën dhe përpjekjet tona të këpusim prangat e robërisë qoftë edhe duke bërë sakrificën më sublime po qe nevoja.

Krejt të rehabilituar, gjithanshëm, kishim vendosur të lenim këtë pushim, ndërsa ishte qëndrim imi të kontrollonim gjithë terrenin në kërkim të ndonjë të mbeturi a të ndonjë të plagosuri ose të vrari në teren, dhe këtë e kishim bërë gjatë gjithë ditës, në gjithë terrenin ku mund të kenë lëvizur njerëzit gjatë këtyre tri ditëve të fundit. Për fat të te gjithë neve, s’kishim gjetur të vrarë e të plagosur të tjerë, ndërsa që atë ditë kishim mësuar edhe detajet për krejt çka kishte ndodhë me fshatin e me fatin e pothuaj secilit njeri veç e veç.

Pos dhimbjes për të vrarët kishim dhimbje e shqetësim të madh edhe për vuajtjet dhe për fatin e shumë

njerëzve që ishin marrë si robër lufte, ndërsa po dëgjonim se ndaj tyre ishte ushtruar e po ushtrohej dhunë e egër serbe, ndërkaq që numri i tyre ishte i madh dhe shkonte në qindra të tillë, moshash të ndryshmet, por që kryesisht ishin të rinj që ende se kishin shijuar jetën. Disa prej tyre do të lirohen brenda pak ditësh, kurse disa prej tyre tek në pasluftë madje duke i dhënë pushtetit serb shuma të mëdha parash, ndërsa që secili prej tyre ishte pyetur për "terroristin" Skender Basha, veçanërisht ishin pyetur se çka ka bërë Skenderi me dorën e tij. Të shumtë ishin edhe të tillë nga vendbanime të tjera që ishin zënë rob në Vraniq. Këtu do të përmendë vetëm ata nga fshati Vraniq:

1. Adnan (Sali) Shehu;
2. Arben (Hajrush) Kolgeci;
3. Arben (Vesel) Llugaxhiu;
4. Arben (Xhevdet) Basha;
5. Arif (Sinan) Basha;
6. Asllan (Hajriz) Matoshi;
7. Avdulla (Sherif) Kolgeci;
8. Avni (Rrahman) Kolgeci;
9. Bajram (Bajram) Muqa;
10. Baki (Arif) Llugaxhiu;
11. Besnik (Avdyl) Basha;
12. Destan (Hafez) Kolgeci;
13. Emri (Halit) Loshi;
14. Emrush (Musli) Matoshi;
15. Emrush (Sadik) Muqa;
16. Faton (Avdulla) Kolgeci;
17. Fatmir (Shefki) Berisha;
18. Feim (Isë) Shehu;

19.Gazmend (Jahir) Kolgeci;
20.Gëzim (Ahmet) Loshi;
21.Hajrulla (Musli) Matoshi;
22.Hasan (Sherif) Muqa;
23.Hysen (Sokol) Berisha;
24.Ilir (Halil) Luzha;
25.Jakup (Azem) Llugaxhiu;
26.Lumni (Gani) Matoshi;
27.Milaim (Xhemajl) Matoshi;
28.Milazim (Bajram) Kolgeci;
29.Muhamet (Shaban) Basha;
30.Mustafë (Adem) Kolgeci;
31.Nezir (Rrustem) Loshi;
32.Osman (Bafti) Llugaxhiu;
33.Ramiz (Hazir) Loshi;
34.Rexhep (Hasan) Luzha;
35.Rizah (Shaban) Kolgeci;
36.Rrahim (Idriz) Kolgeci;
37.Rrahman (Hamdi) Basha;
38.Sadik (Brahim) Kolgeci;
39.Sadik (Muharrem) Rraqi;
40.Sali (Azem) Loshi;
41.Sedat (Qamil) Kolgeci;
42.Shaban (Azem) Kolgeci;
43.Tahir (Vesel) Kolgeci;
44.Ukë (Imer) Kolgeci;
45.Vesel (Tahir) Llugaxhiu;
46.Xhavit (Sali) Kolgeci;
47.Xhavit (Azem) Loshi;
48.Xhavit (Jetulla) Basha.

Grup robërish të luftës nga fshati Vraniq, në burgun e Prokupjes.

Në tërë këtë dhe nga tërë dhuna serbe që ishte përdorë këtu, në zonën që ishte përfshirë nga ky operacion i forcave serbe (nga fshati Griqec e deri në fshatin Maqitevë) mbetën disa dhjetëra civil të vrarë dhe numër i vogël i të plagosurish. Që të gjithë këta, ishin vrarë nga armë të lehta këmbësorie që do të thotë se ishin vrarë nga afërsia ose se ishin ekzekutuar së pushkatuari, ndërsa disa prej tyre më pas ishin masakruar ose ishin djegë në objektet që po digjeshin nga flakët e zjarreve që po i viheshin shtëpive dhe çdo objekti përcjellës të këtyre shtëpive në gjithë fshatrat e kësaj ane. Ndër të vrarët, sikurse edhe ndër të plagosurit, pos të rriturve, kishte edhe fëmijë, gra e pleq. Ishte e dhimbshme vrasja, në Vraniq, e Rasim (Kadri) Kolgecit nga fshati Vraniq, Burim Elshanit nga Suhareka, Hazir Bajraktarit nga fshati Budakovë, Zelfije Palushit nga fshati Budakovë, Imri Palushit nga

fshati Budakovë dhe Sherif Qatanit i cili ishte gjetur i vrarë disa ditë më vonë si dhe e të gjithë të vrarëve të tjerë kudo.

Nga radhët tona, në këtë konflikt, pos Milaimit dhe Hafirit që kishin rënë në përpjekje e në ballafaqim me forcat armike; ishte vrarë edhe Burim Elshani nga Suhareka, i cili ishte plagosur nga granatat e para të rëna në fshatin Vraniq, derisa po ndihmonte popullatën të evakuohej nga fshati, e të cilin më pas popullata po përpiqej ta mjekonte dhe e kishte strehuar në gjirin e sajë; Ndërsa edhe pse i plagosur dhe pa armë në dorë, forcat serbe e kishin ekzekutuar në mënyrë klasike dhe tepër dhunshëm bashkë me të tjerë që ishin civil, po ashtu të plagosur ditë ma parë nga granata që kishin rënë kudo në këto fshatra në mënyrë krejt joselektive, ngase armiku, kur granatonte, s'po zgjidhte caqe ose qëllimisht granatonte vendbanimet, për të shkaktuar dëme tek civilët.

Nga radhët e forcave armike serbe "ne dinim" se kishin pesë të vrarë e tetë të plagosur, ndërkaq që pas këtij operacioni ata kishin pranuar se kishin tre të vrarë e pesë të plagosur, që të gjithë nga veprimet në fshatin Vraniq dhe ndoshta do të mund të krenoheshim me këtë efekt veprimi kundrejt këtyre barbarëve sikur të kishim të drejtën të vepronim së rezistuari mirëfilli mbi ta, aq më tepër që ne kishim vepruar mbi armiq të uniformuar dhe në troje tona, kurse ata në veprime të veta s'kishin kursyer gjë dhe ishin marrë me krejt çka po hasnin.

Meqenëse në veprime luftarake në këtë aksion po merrnin pjesë forca të mëdha e njësi të shumta ushtarake, policore e paramilitare serbe, asnjëherë s'kemi mësuar se

kush i kishte komanduar këto forca e as njësitë e tyre veç e veç, por e dinim se ishin të udhëhequra nga krye-kriminelët serb: Mishkoviqi, që ishte Shef i Njësisë së Shërbimit të Sigurimit Shtetërorë në Suharekë, dhe Milan Shipka që ishte Komandant në Stacionin Policorë në Suharekë, që të dy të njohur për dhunën sistematike që kishin ushtruar edhe më parë mbi popullatën shqiptare duke qenë se ishin bartës të pushtetit serb këtu për vite e dekada me radhë.

Shqiptarë të vrarë e të masakruar në ofensivën serbe, në Vraniq - shtator 1998.

Kthimi në fshat

Para mbrëmjes së ditës së tretë ishim kthyer në fshat, në shtëpitë tona, me marrëveshjen ti qëndronim afër njëri tjetrit dhe se do të shihnim si do të vepronim më pas. Shtëpia, sado që i ishte vënë zjarri, nuk ishte djegur, ndërsa aty gjeta gjithë anëtarët e familjes sime. Në shoqëri me mua dhe vëllanë tim, ishin Azem Kolgeci dhe Bislim Muqa. Në interesimin tonë se ku mund të ishin familjet e tyre, nga anëtarë të familjes sime kuptuam se s'dinin gjë të keqe për ta, kurse meqenëse këtyre iu ishin djegur shtëpitë, mund të ishin në fshatin Korishë ku kishin familje me të cilat ishin në miqësi të përhershme.

Ishte normale të kishim ndjenja të përziera. Azemi e Bislimi ishte e kuptueshme që kishin nevojë të kontaktonin familjet e tyre, kjo edhe për t'ju bërë me dije atyre që këta s'ishin vrarë, ngase ishte spekuluar e përhapë gënjeshtër se ishin vrarë së bashku me mua dhe Enverin. Unë dhe Enveri, meqë ishim mishëruar me ta, s'po mund ti lenim të shkonin vetëm, sepse e konsideronim me rrezik për ta këtë shkuarje. E këta të familjes sime mendonin se ishte punë me sherr dhe e menduar mirë nga serbët, mos djegia e shtëpisë sonë, për të na zënë të gjithëve në të e për të na zhdukur siç kishin atakuar e ishin përpjekë të zhduknin deri më tani familje të njohura në Drenicë e gjetkë.

Thjeshtë mendonin se na kishin lënë, qëllimshëm, për një trajtim të veçantë në të ardhmen, ngase ishim tepër në sy të tyre, pasi që në të kaluarën e para kësaj lufte, familja jonë ishte bastisur shtatë herë, ndërsa unë isha

marrë në polici shtatë herë, paraburgosur tri herë e dënuar dy herë dhe isha dënuar më shumë se pesë vite burg të cilat siç thuhet i kisha mbajt e vuajt "birë më birë", këtu në Kosovë e në Bosnjë - Hercegovinë, kurse s'isha penduar asnjëherë dhe s'kisha heqë dorë për asnjë moment nga qëllimet e mia e as s'kisha pushuar aktivitetin tim me shokët për tu çliruar nga robëria serbe e për ta bashkuar kombin. Babai im, Ibrahimi, ishte marrë e torturuar dy herë në stacionet policore në Mushtishtë e në Suharekë, kurse Enveri ishte paraburgosë e dënuar, si i mitur, një herë dhe kishte vuajtur një vit burg të rëndë. Kështu, sipas tyre, pushteti na kishte halë në sy, prandaj për sigurinë tonë, ne duhet të largoheshim nga shtëpia dhe gjithherë të ishim ku janë shokët. Vendosëm të shkonim bashkë, në Korishë, dhe kështu u bë.

"Pushimi" në fshatin Korishë

Në Korishë, ishim te dhëndri i Azemit, Bislim (Jahir) Regjaj, i cili në marrëveshje me ne e për siguri të fshatit Korishë, na pat strehuar në shtëpinë e vëllait të tij, Milaimit, e cila gjendej, krejt në periferi, në krye të fshatit, dhe që ishte e meremetuar mirëfilli, por që deri më atëherë ishte e pa banuar, ndërsa që Bislimi dhe familja e tij ishin përkujdesur tej mase, madje duke na ofruar tërë përkujdesjen dhe të thuash gjithë të mirat, që ne ta kemi sa më mirë.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë që kishim për armikun dhe se për kapjen tonë mund të ndizeshin zjarre të reja lufte dhe se mund të pësonte para së gjithash

familja e Bislimit që na kishte mirëpritur e ndoshta edhe fshati Korishë përgjithësisht. Ishim tepër të disiplinuar dhe s'kishim bërë as lëvizjen më të vogël, sado që ishim krejt në periferi të fshatit, buzë malit e bjeshkëve të paskajshme të Korishit, të Kabashit e më gjerë.

Këtu qëndruam pesë ditë e net derisa në mendjet tona na u bë "ferr", ngase s'po pajtoheshim të mos ishim në Vraniq e te shokët tanë, kurse vërtetë pamë se na ishte mase i nevojshëm ky pushim sepse kishim qenë tepër të lodhur. Meqë s'po mund të bëheshim rehat u kthyem në shtëpinë time. Këtu s'gjetëm kënd.

Largimi i familjes nga shtëpia, strehimi në fshatin Dvoran

Daja im, Rrustem (Zeqir) Aliaj, që atë natë kur ne kishim shkuar në Korishë, e kishte vizituar familjen tonë për të kuptuar nëse i kishim shpëtuar "tmerrit", ndërsa që ishte i shqetësuar për ne ngase i kishte rënë të dëgjojë gënjeshtra kinse ishim vrarë: Unë, Enveri por edhe Bislimi e Azemi të cilët i njihte mirë; e meqenëse kishte menduar ngjashëm me këta të familjes sime, i kishte marrë për ti strehuar në shtëpinë e tij në fshatin Dvoran. Në fund të fundit, kishte thënë daja "Rrustë" dua t'iu shoh çka po ndodhë në Ju, ndërsa më pas gjatë gjithë kohës së luftës do të jetë pranë dhe në mbështetje të familjes tonë. Kështu kishte vepruar edhe gjatë gjithë së kaluarës sonë kur ne po vuanim burgjeve e kazamateve të ish Jugosllavisë dhe kjo është arsyeja që ne, familjarisht, e kemi njeriun më të dashur nga të gjithë të dashurit tanë.

Daja i Skenderit: Rrustem (Zeqir) Aliaj (1954- 2011)

Kthimi nga fshati Korishë, vizitat bazave tona

Që atë natë që ishim kthyer nga fshati Korishë, kishim shkuar ta vizitojmë familjen e Halime (Muharrem) Basha, ngase këtu kishim bazën tonë të dytë e veçmas "hallën" Halime që po na përkrahte, gjithanshëm, në përpjekjet tona e të cilën e kishim nga shokët tanë të luftës. Ishim edhe për ta falënderuar e për ta mirënjohur në njëfarë mënyre për tërë atë përkushtim për luftën dhe për ne që po e bënim këtë luftë, por edhe për kontributin e sajë të çmuar e të veçantë që po e jepte në këto rrethana lufte, ndërsa që nga e nesërmja ishim tubuar me shokët në shtëpinë time dhe kishim filluar jetën ushtarake siç e

kishim më parë. Pos nesh, këtu ishin rregullisht: Reshati, Zaimi, Shpejtimi, Azemi, Bislimi, Rahmani e shumë shokë të tjerë, ndërkaq që kishim edhe bazën tjetër në shtëpinë e vëllezërve: Hamdi, Florim, Agron e Shpejtim (Osman) Basha ku po qëndronte një grup tjetër ushtarësh tanë dhe ate në shtëpinë e Sherif (Imer) Shehut ku gjithashtu po qëndronin ushtarë tanë, por që thjeshtë po pushonim që të gjithë, kurse po bënim një vëzhgim sa për të mos u kapur nga forca serbe që kishin guximin të kalonin jo vetëm nëpër fshatin tonë në drejtim të fshatrave Popolan, Dvoran e Mushtishtë, por edhe nëpër fshatin Budakovë. S'do të kemi rehati meqë po ndjenim rrezikun e ecjes në anë të kundërt me tehun e shpatës dhe kjo e dinim se do të thoshte vdekje për së gjalli për të gjithë ne, ndërsa që ishim betuar dhe po i qëndronim fort vullnetit të mos lejonim të vdisnim dy herë; Dhe këtu ishim të prerë, të vdisnim ja të jetonim të lirë.

Pamje nga vendi ku kishte qëndruar popullate, në "Lumi i Madh"; marrë nga "Koha Ditore".



Pamje nga vendi ku kishte qëndruar popullate, në "Lumi i Madh"; marrë nga "Koha Ditore".

**Pamje (të Human Rights Watch) nga gjendja
në fshatin Vraniq, shtator 1998.**

Kërkimi i një të zhdukuri

Kuptuam që njerëz nga fshati Duhël kishin ardhur këtu dhe po interesoheshin për një, burrë, njeri të tyre meqë po konsiderohej se ishte zhdukur. Në lidhje me këtë ishim mobilizuar dhe kishim kontrolluar, dy ditë me radhë, të thuash gjithë terrenin, deri në afërsi të objektit të Antenës në Maja e Ahishtës, por që s'kishim gjetur as gjurmë të tij. Shumë shpejt, në shtëpi kthehen edhe anëtarët tjerë të familjes sonë. Në një far mënyre çdo gjë po fillonte sërishmi.

Qëndrimi politik i njerëzve dhe ai ndaj nesh, gjendja në fshat

Njerëzit në fshat, sërish ishin tepër miqësorë me ne, të thuash se asgjë s'kishte ndryshuar. Të "gjithë" i ishin

gëzuar shpëtimit tonë. Ishin të shumtë ata që po na përqafonin me mall e dhembshuri e shumë prej tyre derdhnin lot gëzimi kur na takonin e shihnin. Veçmas ishte i përzemërt dhe emocionues takimi im, Azemit dhe Enverit me Dalip (Osman) Kolgecin dhe me gruan e tij Nazifen, krejt rastësisht, në rrugë, në lagjen e Ogushve.

Në fshat ishte ringjallur jeta në çdo aspekt. Ishte riparuar e aftësuar në tërësi rrjeti elektrik. Ishin hapur, furnizuar mirë dhe po punonin të gjitha shitoret. Ngjashëm me më parë njerëzit po rrinin, deri në orët e vona, e po pinin me shumicë në to. Për dallim nga më parë, tani po na përflisnin më shumë dhe po na shanin nga pak, ndërsa që ishin të njëjtit ata që na kishin përfolur e sharë edhe më parë, me ndonjë përjashtim të vogël. Ne normalisht "i kuptonim" njerëzit, aq më tepër që tani edhe iu kishin djegur shtëpitë e iu ishin dëmtuar pasuritë, ndërsa që ne po tregonim durimin e "myslimanit të mirë".

LDK, në përgjithësi në Kosovë e edhe udhëheqësit e sajë lokal këtu, ishin të mendimit dhe po na sugjeronin në të folmet e tyre kuluareve të lenim armët dhe të pushonim aktivitetin tonë luftarak meqë sipas tyre s'kishte nevojë ma të veprohej kështu, ngase Serbia po pranonte të bisedonte me ne, kurse zgjidhja e ofruar ishte që dikush nga ne që kishim armët në dorë të angazhohej në një polici të përbashkët lokale, që do të krijohej.

Kishte të tillë që po na "lavdëronin" se ne e "kishim bërë tonën" dhe se këtë e kishim "quar në fund", ndërsa s'po ju prishte gjë punë që policia serbe në shenjë triumfi e fitoreje mbi ne po parakalonte me makineri luftarake, ushtarake e policore, çdo ditë nëpër fshatin tonë në

rrugëtimin e tyre nga Suhareka në Mushtishtë dhe anasjelltas madje ndonjëherë edhe nga dy herë në ditë, kurse s'po e dinin që neve atë kohë, Serbia, po na ofronte si zgjidhje ndarjen e Kosovës me kufi në "Qafa e Duhlës". Dukej se "s'po e dinin" që ne luftën po e bënim për liri e për jetë a vdekje, se luftës i ishim përkushtuar me tërë mundësitë tona dhe se ishim të vendosur ta qonim deri në fund e ta kurorëzonim me liri, ose thjeshtë të vdisnim por që të mos ishim rob serbi më. Po mendonin që ne kishim rrokur armët krejt të ekzaltuar e pa menduar mirë, dhe se ato do ti lenim e mund ti lenim kurdo e për "dëshirë, rehati e selam" të kujtdo dhe pa dëme për ne, për popullin e për vendin, ndërsa që kishte edhe të tillë, nga struktura udhëheqëse lokale këtu, të cilët po deklaroheshin hapur kundër nesh dhe luftës sonë madje duke u shprehur se: "Më mirë do t'ju vinte të shihnin polic serb të parakalonin nëpër fshat se sa që po na shihnin ne me uniforma të ushtrisë sonë e me armë në dorë". Por këtu s'ishte fundi i marrëzisë.

Këto ditë, okupatori kishte kërkuar ti dorëzoheshin armët, ndërkaq që ato, sipas serbëve, mund të dorëzoheshin e liheshin kudo, madje edhe kudo në rrugë, ngase aq i bënte okupatorit për armët tona të tilla çfarë i kishim e sa i kishim, ndërsa që këta, udhëheqësit tanë në fshat, kishin grumbulluar e dorëzuar një sasi të tyre në një depo bujqësore në Gjinoc, madje pa qenë të pritur nga askush atje, dhe pa pasur as presionin më të vogël e pa qenë të shtrënguar nga askush, duke harruar krejt se asgjë s'kishte përfunduar këtu dhe se për të sjellë ato armë, nga

Shqipëria, kishin rënë e po binin edhe më tej shumë nga djemtë e burrat më të mirë të kombit.

Kishin harruar edhe se mund t'iu delte shqetësim meqë kështu kishin bërë tradhti dhe se mund të mbanin përgjegjësi morale e ligjore për këtë, në dëm të moralit e jetës së tyre dhe të familjeve të tyre.

Vërtetë s'po mësoheshin se këtu veprohej me ligjet e ashpra të luftës, ndërsa do ta kenë gjithherë mirë falë nesh dhe mirësisë e durimit tonë duke i pasur e bartur vazhdimisht barrë të rëndë mbi supet tona të rënduara tej mase në këto kohë e rrethana tepër të rënda për ne.

S'ishin të pakta rastet kur na është dashur të shfrytëzojmë autoritetin dhe ndikimin tonë te njerëz e mekanizma tanë të ndryshëm për ti shpëtuar ndoshta edhe nga më e keqja, këta tipa, vetëm e vetëm që e keqja që na kishte kapluar, të gjithë neve, të ishte më e vogël e që gjithë këtë ta kalonim me sa më pak gjak e dhimbje.
Kishim vendosur ti binim "shkaut" me sa mundnim e të mos përgjaknim duart nga gjaku i ynë, i kujtdo çoftë ai, edhe pse se kishim të lehtë dhe se po na kushtonin e hakmerreshin gjërat e po humbnim pakuptimshëm energjitë tona që s'i kishim gjithaq të mëdha.

Edhe më parë ma kishin thënë, madje disa herë radhazi, se si e kishim pranuar në radhët tona këtë apo atë njeri, ndërkaq që gjithherë ua kisha shpjeguar me shumë durim se: Neve, lufta na ishte imponuar nga Serbia, por edhe nga ndërkombëtarët meqë dhe pasi kishim provuar për kohë të gjatë të gjitha format e veprimit të rezistencës pasive e jo të dhunshme krejt pa ndonjë rezultat a efekt pozitiv; Njerëzit kishin treguar vullnet e gatishmëri ti

dilnin zot pragut të tyre dhe se këtë s'kishte të drejt dhe s'mund tua mohonte askush, ndërsa ju thosha të na bashkëngjiten që të bëheshim më shumë të mirë se sa të tillë "të këqij", në të cilët kishin vërejtje ata. Dhe çka ndodhte? Këtu përfundonte "muhabeti".

Kishin guximin të më akuzonin publikisht se e kisha djegur fshatin. Me naivitetin e tyre po harronin qëllimshëm se isha po ai Skenderi lindë e rritë në këtë fshat që për 39 vjet më parë s'i kisha shkaktuar kujt as shqetësimin më të vogël, ndërsa që isha më i përvuajturi i regjimit të huaj gjatë gjithë së kaluarës dhe i përzgjedhuri i tyre për ti udhëheqë vite të tëra dhe se gjatë gjithë së kaluarës sime isha përpjekur siç thuhet "me mish e me shpirt" që popullit tim ti qëndrojë te këmbët e te kryet dhe se këtë e kisha bërë në vazhdimësi të thuash gjatë gjithë jetës sime, dhe se ishte krejt e ditur se për ta bërë këtë pos të tjerash është dashur edhe shumë mund dhe edhe më shumë sakrificë, gati sublime e që ngjashëm po veproja edhe tani në këtë katrahurë të vërtetë, të këtyre kohëve krejt të pa kohë e të mundësive tepër të vogla, e që edhe më tej s'po kursehesha dhe po jepja të tëra që kisha, siç shprehem shpeshherë: "Hallall ma bëftë familja ime", kurse që gjeja prehje kur më binte ndërmend se kështu ishin keqkuptuar edhe burra dheu të trungut tonë që nga Hasan Prishtina e këtej. Në fund të fundit vet jeta na ishte luftë, të gjithë neve dhe gjatë gjithë kohës.

Grup luftëtarësh që kishin ruajtur organizimin; Në këmbë: Meritë Vata, Tahir Veselaj, Betim Halitjaha, Reshat Halitjaha, Xhylferije Kokollari "Shota" Fadil Halitjaha, Ilir Bytyqi; Ulur: Enver Halitjaha, Zenun Krasniqi dhe Skender Basha.

Kulmi i hipokrizisë

Hipokrizia e ndokujt këtu kishte arritur kulmin kur po mendonin dhe kur po organizoheshin, që në shenjë "hakmarrje" të ma digjnin shtëpinë, ndërsa që unë me të kuptuar këtë, përmes ndërmjetësit, i kisha lutur të kishin durim deri në ofensivën tjetër serbe kur do të më digjej shtëpia vetëm e vetëm që të mos bëheshim "turpi i botës". Dhe normalisht që i kisha falënderuar dhe i falënderoj edhe sot për mirëkuptimin. E nëse do të pyetesha se a i kam falur, them se po, madje pa kërkim- falje; Kështu pa kërkim- falje, i kisha falur edhe të gjithë shqiptarët tjerë që në të kaluarën më kishin paraburgosur, më kishin rrahur mizorisht e më kishin dënuar se po kërkoja e po

përpiqesha për lirinë time e të tyre. Ne tanimë, që moti kishim një pajtim kombëtarë, dhe kishim drejtuar e adresuar ku të harxhonim mundin, djersën, energjitë, e ku të derdhnim gjakun.

Ishte e dhimbshme që njerëzit ende s'po kuptonin se pragu na ishte shkelur qëmoti, se tani ky prag edhe na ishte dhunuar, dhe se shkelësit e dhunuesit tanë ishin barbarët serb qe më shumë se një shekull qëndrimi në trojet tona. S'po kuptonin dot se politika serbe, gjatë gjithë së kaluarës ishte gjenocidale e shfarosëse ndaj nesh si popull siç ishte edhe kjo luftë që në fillimet e sajë. Për ta s'po thoshte gjë forma dhe mënyra e veprimit të organizuar e në harmoni të te gjithë mekanizmave shoqërorë, politik, ushtarak, policorë, paramilitarë, publicistik, mediatik, akademik e kishtarë serb kundër të gjithë neve si Shqiptarë, dhe çdo gjëje që ishte shqiptare këtu, ndërsa që po gaboheshin rëndë se me mos pjesëmarrje e mos përfshirje në luftë s'mund ti iknin asnjë të keqeje, ngase serbi po atakonte çdo gjë shqiptare, madje edhe fëmijën në djep, e edhe atë ende të pa lindur, në barkun e nënës. Ndërkaq që assesi s'po mund të merrnin me mend se barbarët serb në të ardhmen do të na e dhunojnë edhe sedrën meqë do të na e dhunojnë edhe nënën, gruan e motrën; Jo për të shfryrë epshin, por si strategji lufte për të na dëmtuar moralisht e për të na e thyer kurrizin e shpirtin për më gjatë, për të na e humbë tërësisht ardhmërinë. Thjeshtë s'po e kuptonin se kur ishte dhunuar pragu- ishte dhunuar burri.

I vendosur se s'do të merrem më me të tilla gjëra, të përmendë shkurtimisht se pyetesha atëherë e edhe sot pyes veten: Ku ishte "udhëheqësi ynë shpirtërorë", Imami i

fshatit?, e të gjithë udhëheqësit tjerë fetarë këtu e kudo në këto troje në këto kohë kaq të rënda për ne që jemi njerëzit e tij e të tyre, ndërsa që më kishte rënë të dëgjojë se, imami ynë, s'po merrte pjesë as në varrimet e të vrarëve tanë gjatë luftës, të cilët po i varrosnim shkapërderdhur gjithandej, ku ishin vrarë; Dhe se s'kishte ndërmarrë, as edhe një aktivitet, as s'kishte derdhë trohë mundi e as një pikë djerse për komb, fe e atdhe, kurse përkrah nesh po bënin luftën e po derdhnin gjakun edhe vullnetarë të shumtë të huaj, nga shtete të Lindjes e të Perëndimit. Vërtetë pyetem, madje shpeshherë edhe sot: "Cili është shpjegimi logjik, nëse mund ta bëjnë këtë, i këtyre njerëzve për gjithë të kaluarën tonë historike në përgjithësi e për këto rrethana të përjetuara vet në veçanti, ose çka mund të predikojnë te të tjerët, te nipat e mbesat?

Takimi me Komandant Sadikun

Kishin kaluar të thuash dhjetë ditë qe kur e kishim parë komandant Sadikun, ndërsa që kishim marrë vesh se ishte në Maqitevë, se po ndjehej mirë nga plagët që kishte marrë dhe se i kishte shpëtuar një prite në luftë gati fyt a fyt me serbët.

Komandanti po barte nëntë plagë, dy prej të cilave në ballë e të cilat, Unë, ia quaja të gërvishtura granate, kurse shtatë të tjerat, që të gjitha i kishte në gjoks. Përkujdesjen e duhur për te po e tregonte kompania jonë atje që nga Komandanti, Selim Haziraj, e Zëvendës Komandanti, Halil Krasniqi.

Kishim shkuar te ai, e meqë e kishim gjetur mirë e në kushte të mira dhe ngase ishim lutur nga Komandant Sadiku, nga Komandanti i Kompanisë, Selim Haziraj, nga Halil Krasniqi e shokë të tjerë; Ishim ndalë për ditë të tëra atje, e kishim kaluar tepër mirë dhe ishim rehabilituar tërësisht. Mirëpritja që na ishte bërë dhe përkujdesja që treguan për ne do të mbesin të pashlyera në kujtesën tonë.

Me Komandant Sadikun dhe me stafin tjetër atje, i kishim biseduar shterueshëm të gjitha mundësitë dhe mënyrat e mundshme për rimëkëmbje, si dhe metodat dhe rrugët që do të ndiqnim tani e këtej në riorganizim dhe në veprimin tonë luftarak. Si përgjigje kërkesës dhe interesimeve të komandantit ishim obliguar të vizitonim Komandant Guri- n dhe njësitin e tij, por edhe të rinisnim angazhimet tona për ta përkrahur me gjithë çka mundnim njësinë e tij të kalonte vështirësitë me të cilat mund të përballej në këto kohë të vështira për të gjithë ne.

Luftëtaret tona të lirisë; Betimi im i sërishëm

Në Batalionin II ishin rreshtuar: Hava Bytyqi dhe Meritë Vata e Gjylferie Kokollari "Shota", motra të veprimtarëve të devotshëm për çlirim e bashkim kombëtarë: Murat Bytyqi, Fadil Vata e Shyqeri Kokollari, por edhe Feride Zenelaj e cila prej kohësh s'po rreshte veprimet për jetë të lirë, ndërsa që kishte provuar dhunën e burgjet serbe. Ishin rreshtuar edhe Selvie Kica e Florie Bajrami "Flora" nga Shtimja; Dhe derisa, Unë, ngjashëm me të tjerët po përkujdesesha veçmas për to; Ato tanimë ishin bërë heroina të vërteta. Të gjitha këto luftëtare më

pas do të shkojnë në njësi elite e në nivele të ndryshme komandimi, kurse te ne do të rreshtohet Magbule Mustafa nga Komogllava e Ferizajt, krenaria jonë.

S'kishte kaluar një javë e plotë nga ofensiva serbe, kur krejt rastësisht, në afërsi të shtëpisë sime kisha takuar "Shotën", heroinën e anëve tona. Është e pamundshme të përshkruhet gjithë ai pezëm, i Shotës, ndaj nesh, por edhe ajo dhimbje aq e madhe për ne "që kishim tradhtuar së dezertuari", e më pas tërë ai mall e gëzim në fytyrën e në sytë e sajë plot shkëlqim e dritë, dhe gjithë ajo lumturi që po shprehej së përqafuari vëllanë e sajë, shokun e idealit, që po shihte. Plot drojë do të më pyes për Komandantin, e kur po i thosha se është mirë s'po mjaftohej me kaq. Sapo i them se komandanti është këtu, në çast pashë njeriun më të lumtur në botë, e unë do të heshtë para kësaj mrekullie dhe ashtu heshtur do të betohem sërishmi: Se eshtrat mund të më mbesin vetëm këtu, në Kosovën që po mbante erë shkrumbi, por që s'po e humbte krenarinë.

Vizita njësisë dhe Komandantit "Guri"; Shqetësimet, kërkesa që më kishte drejtuar

Me porosinë e komandant Sadikut e me shumë dëshirë kishim shkuar në njësinë e komandant "Guri", për të parë si ishin dhe si po ia kalonin me furnizimet. Shkuam: Unë, Bislimi, Azemi dhe Enveri, kurse Sali Llugagjiun, e kishim të rreshtuar atje që nga koha kur unë e kisha lënë komandën në njësitin tonë ushtarak në Vraniq dhe që kur kishte parë se këtu s'po mund të krijohej rend dhe rregull i mirëfilltë ushtarak, ndërsa që këto i kishte gjetur në njësitin e komandant "Guri", ku pos rendit dhe

rregullit të nevojshëm, kishte edhe disiplinë të mirëfilltë ushtarake. I gjetëm mirë, në shtëpinë e Faik (Shaqir) Muhadini në fshatin Topillë, ndërsa po iu mungonin furnizime nga ato më themelore.

"Guri" ishte i shqetësuar me mungesën e riorganizimit dhe me riorganizimin e rimëkëmbjen e ngadalshme të njësive tjera të UÇK, në këtë Zonë, por edhe gjetiu kudo në Zonat tjera, ngase kjo po i paraqiste problem edhe këtij, ndërkaq që ky ishte detyruar të merrte me policinë e tij ushtarake ata pak ushtarë që kishte nga fshati Dragaqinë, ndërsa që kishte edhe të tjerë, në njësi, të cilët po mendonin se po mungonte vullnet ose edhe kushte të vazhdohej lufta, dhe të tillë që po ndikoheshin nga politika qyqare e kohës e që po mendonin se gjërat edhe mund të zgjidheshin me bisedime me Serbinë.

Në këto rrethana, komandant "Guri" më kishte lutë t'ju flisja, ndërsa që unë ju mbajta një ligjëratë dhe bëra një bashkëbisedim të gjatë, rreth tri orë, me ta.

Meqë ndjeva shqetësimin e komandant "Guri" e duke e vlerësuar seriozitetin e momentit, këtyre ushtarëve ju kisha folur edhe për gjëra që thënë sinqerisht si besoja as vet derisa po i thosha, por që ata i besuan në tërësi dhe kështu kisha arrit të heqë çdo dilemë te këta ushtarë dhe kisha krijuar atmosferë të vazhdohej me veprime si më parë e edhe me më shumë vullnet.

Në bisedë me ta kisha shtjelluar, gjithanshëm, gjendjen politike dhe at tjetër, e të luftës në vend; Ndikimin e sajë te faktori politiko- ushtarak te qendrat dhe faktorët me fuqi vendosjeje në Botë, si dhe interesat gjeopolitike e gjeostrategjike të tyre këtu. Ju kisha folur

për të arriturat e mëdha në ndërkombëtarizimin e çështjes sonë kombëtare si të pazgjidhur dhe në sensibilizimin e faktorit ndërkombëtarë ta shtrojë për zgjidhje si më të rëndësishmen për paqen dhe sigurinë rajonale e më gjerë.

Ju kisha përmendë se pas këtej do të kishim edhe më shumë kushte për jetë e veprim ushtarak dhe se do ta institucionalizonim këtë jetë, andaj do të kishim më shumë rend, rregull e disiplinë; Që do të vendoseshim në objekte publike, në shkolla e në objekte të tjera dhe të ngritnim e ulnim flamurin tonë kombëtarë gjithherë me nderim duke qenë të rreshtuar çdo mëngjes e mbrëmje, ndërsa që s'do të na mungonte as përkujdesa shëndetësore e asgjë tjetër. Ju kisha thënë se do ti krijonim bazë ligjore çdo veprimi tonë dhe se fillimisht, shumë shpejtë, do të kemi ligjin për mobilizim të përgjithshëm të te gjithë potencialit. Do t'iu përmendë përkrahjen e madhe morale e politike që gëzonim nga bota e qytetëruar dhe atë politiko- ushtarake që do të marrim së shpejti.

"Profecia" ime bëhet realitet

Për fat timin, për kënaqësinë time e për befasinë time më të këndshme e meqë më kishin kuptuar edhe si udhërrëfyes; Të gjitha këto në njësinë e komandant "Guri", më pas, janë arrit e janë bërë realitet brenda pak ditësh duke u vendosë në shkollën e fshatit në Llanishtë, duke vënë në jetë e duke praktikuar gjatë gjithë së ardhmes, deri në përfundim të luftës, të gjitha ato që kisha përmendë në premtimin tim në bisedë me këta luftëtarë trima. Do të marrin gjithë shërbimin shëndetësorë përfshirë këtu edhe

vaksinimin e rregullt dhe ndihmën e madhe të aleatëve tanë Perëndimorë të luftës, ndërkaq që ne si edhe më parë që nga fillimi i luftës kishim vazhduar ti mbështesnim me krejt që mundnim e kishim që nga ushqimi, veshmbathjet e gjëra tjera të nevojshme për punë e jetë e deri te armatimi e municionet për luftë. Këtë e kishim arritur e po e bënim në vazhdimësi falë përkrahjes së të gjithë njerëzve në Vraniq dhe vullnetit të madh të tyre, por edhe falë autoritetit tonë të pakontestueshëm që gëzonim në masat e gjëra të popullit këtu në Vraniq dhe kudo në të gjitha vendbanimet përreth.

Përkrahjen tonë të pakursyeshme, këta luftëtarë trima po e shpërblenin me luftën e tyre të madhe heroike dhe me gjakun e shumtë që do të derdhin gjithandej në mbrojtje të popullatës, për çlirimin e vendit, por edhe në aksionet e tyre të njëpasnjëshme kundër forcave të shumta, të ndryshme serbe, nga pritat e shpeshta në "Gryka e Carralevës".

Festimi i Ditës së Flamurit, dasma e luftëtarëve të lirisë. Një kërkesë tjetër e komandant "Guri"

Atje ishim edhe për të festuar 28. nëntorin, Ditën e Pavarësimit të Shqipërisë, meqë rast i kishim organizuar dasmë dhe e kishim martuar luftëtarin Isak (Selim) Selimi nga fshati Rancë i Komunës së Shtimjes me një mësuese nga Ferizaji, pasi që këtij luftëtari në një rast, gjatë evakuimit të familjes së tij nga zona luftimesh të ashpra, me traktor, i ishte dëmtuar e tërë familja, ngaqë gjatë lëvizjes së tyre, një predhë minahedhësi serb ju kishte rënë

në rimorkio duke zhbërë, njëkohësisht, të gjithë njëmbëdhjetë anëtarët e kësaj familje që gjendeshin aty përfshirë nënën, gruan dhe të gjithë shtat fëmijët që kishin si dhe gruan e vëllait dhe një fëmijë të sajë. Ishte emocionuese, pos të tjerash, edhe kurë nuses si dhuratë për martesë i kishim dhënë një "kallash". Çdo gjë po më dukej si në ëndërr dhe vështirë po besoja se po përjetoja këtë madhështi luftëtarësh trima shqiptarë, që gati te secili prej tyre shihja Mihail Gramenon e Çerçiz Topullin.

Në këtë kohë më ishte bërë kërkesë, me lutje, nga komandant "Guri", zëvendësi dhe bashkëluftëtarët e tij të rreshtohesha në njësitin e tij dhe të merrja barrën dhe detyrat e ndihmësit të tij për çështje moralo- politike, kurse, unë, iu isha përgjigjur sinqerisht, se në ato rrethana më shumë mund ti duhesha Batalionit II, meqë këtu ende s'ishim organizuar dhe se duhej punë e madhe për tu arritur kjo. Më pas kjo ofertë më është përsëritur disa herë, e unë po përsërisja gjithherë arsyetimin tim të njëjtë ngase ne po vonoheshim së tepërmi në riorganizim.

Përpjekjet për riorganizim e rimëkëmbje

Serbi po na sfidonte e provokonte rëndë çdo ditë, veçmas me parakalimin e forcave të tyre të shumta, gati çdo ditë, në rrugën nga Suhareka që shpie në fshatrat serbe: Popolan, Dvoran e Mushtishtë, por edhe më keq kur parakalonte në drejtimin Budakovë, Muhlan e që ne me të drejtë po e konsideronim si shkelje pragu.

Si kudo tjetër në Kosovë, edhe këtu te ne po bëheshin përpjekjet e duhura për riorganizim e rimëkëmbje

dhe ishin të shumtë ata që po punonin për tu riorganizuar, ndërkaq që shumica e ushtarëve tanë po na bënin presionin e duhur që sa më parë të arrihej kjo.

Këtu, pos të tjerëve, tepër aktiv ishin: Komandant Sadik Halitjaha, Halil Krasniqi, Selim Haziraj, Haqif Kadriaj, Haxhi Sallauka, Agim Zyba, Muhamet Buzhala dhe unë Skender Basha, ndërsa që na kishte kontaktuar e na kishte përkrahë edhe Kurtish Fandaj, kurse me ecejaket tona, shpesh herë edhe duke ndërmjetësuar e pajtuar kundërshtitë, kishim ndihmuar shumë: Unë, Bislim Muqa, Azem Kolgeci dhe Enver Basha. Për të arritur këtë si kishim reshtur përpjekjet tona as edhe për një moment, dhe se nuk jemi kursyer për asgjë. Këtë po e bënim me vullnetin dhe me përkushtimin më të madh e me angazhimin tonë më të sinqertë.

Në kohën kurë, ne këtu, kishim arritur të organizoheshim sërish, ishte riorganizuar edhe Komanda e Brigadës 123, kështu që do të kemi rirreshtim të mirëfilltë ushtarak dhe kishim filluar së vepruari në mënyrë dhe me rregulla e norma krejt ushtarake.

Pse s'mund të isha komandant batalioni?

Krejt në prag të riorganizimit më ishte përmendë mundësia e emërimit tim komandant në Batalionin II, dhe kërkesat për këtë nga ushtarë e civil ishin të shumta. Në lidhje me këtë do të kem edhe presione të shumta pozitive e kishte edhe të tillë që po ma shihnin për të madhe që s'po merrja këtë komandë. Isha shprehë se s'do të pranoja në asnjë rrethanë, dhe kisha arsyet e mia. Mbi të gjitha

s'mund të merrja barrën e komandimit të vijave të frontit të luftës meqë këtu s'isha profesionist, mandej s'doja të zëvendësoja Komandant Sadikun dhe së fundmi, për të pas qetësinë dhe rehatinë e duhur, që të mund të arriheshin efekte e rezultate duhej të kishim kuadër profesionist, ngase kjo tanimë ishte kërkesë e ushtarëve tanë por edhe dëshirë e popullatës së këtushme; Por ndoshta edhe s'do të isha i pranueshëm për të gjithë, ngase këtu gjërat ishin politizuar tej mase dhe siç themi "kishin marrë erë". Sidoqoftë, s'do të isha komandant, ose edhe po të isha: "S'do të isha komandant i mirë", kurse që isha jetësisht i interesuar të tejkalonim situatën e krijuar dhe të mos kemi as shqetësimin më të vogël në të ardhmen.

Më pas, edhe mua do të më jepen detyra me rëndësi e peshë, për të cilat sinqerisht mendoj se isha i përgatitur, së paku moralisht, dhe të cilat mendoj se ia kam dal ti kryej me sukses, gjithsesi. E për të realizuar këto vërtetë duhej punë me përkushtim, devotshmëri e skajshme dhe qëndrueshmëri e lartë në sfidat e shumta me të cilat të ballafaqonin rrethanat e kohës së luftës.

Aksionet, e shokëve, që na kishin ruajt nderin

Menjëherë pas ofensivës serbe të shtatorit kundër nesh e meqë ishim përfshirë të fundit në te, duke qenë se Serbia mbështetur në llogaritë e sajë krejt të gabuara po konsideronte se kishte përfunduar me sukses për të çdo gjë në raport me ne; Në një takim me diplomatin amerikan Holbruk, i cili ishte në përpjekje ndërkombëtare të gjente një zgjidhje politike për të përfunduar luftën këtu, Kryetari

i Jugosllavisë, kryekrimineli serb Millosheviq, ishte shprehur të mos i përmendej më emri i UÇK- së, ngase siç ishte shprehur e kishte shuar e çrrënjosë, dhe se ajo nuk ekziston më. Këtë duket ta ketë thënë krejt i ekzaltuar me sukseset që kishin korrur forcat serbe në teren, ngase me ofensivën e tyre në shkallë të gjerë e duke mbjellë vdekje kudo, kishin arritur që pos të tjerash edhe të bënin të mundur lëvizjen e forcave të tyre përmes Grykës së Llapushnikut dhe përgjatë Grykës së Carralevës, të cilat për kohë të gjatë luftëtarët tanë trima kishin mundur ti mbajnë të mbyllura dhe krejt të pakalueshme për forcat armike. Me të dëgjuar këtë, shokët tanë trima e të devotshëm çështjes së çlirimit, kudo në gjithë Kosovën ishin koordinuar dhe në të njëjtën kohë kishin sulmuar dyzetegjashtë vend- përqendrime të forcave serbe, tri nga këto realizuar nga shokë tanë, luftëtarë të Brigadës 123, të udhëhequr e të komanduar nga Komandanti i kësaj brigade Kurtish Fandaj, ndërsa që kështu na kishin ruajt nderin para faktorit të vendosjes dhe opinionit ndërkombëtarë e atij vendorë. Në këtë periudhë kohore, rregullisht po kontaktohesha nga Misioni Monitorues Ndërkombëtarë.

Emërimi i stafit komandues në Batalionin II

Për komandant batalioni, nga ana e komandës së brigadës, na ishte emëruar Bekim Arifi, nga një fshat në komunën e Gjilanit, një luftëtarë që sapo kishte ardhur nga jashtë, nga Zvicra, i cili siç na është thënë kishte të kryer shkollën e mesme në Akademinë Ushtarake në Zagreb, ndërsa për zëvendës të tij kishte marrë Fehmi Berishën nga

Gurbardhi i Malishevës, kurse kishte ardhur i shoqëruar nga Xhemajli Kastrati "Xhema", Latif Krasniqi "Lata", nga Fadil Qitaku nga Skenderaj i Drenicës dhe nga Shemsedin Bajrami "Shema" nga Ferizaji.

Për kohë të gjatë s'po mund t'iu binim në fije se cili ishte komandanti ynë, meqë këta po na ndërroheshin shpesh njëri me tjetrin, Bekimi dhe Fehmiu, ndërkaq që Xhemën e kishim Shef të Operativës. Të përmendë se neve po na dukeshin të gjithë të mirë, se s'kishim asnjë vërejtje në asnjërin prej tyre dhe se i kishim mirëpritur që të gjithë, në grup, siç kishin ardhur, pa dallim. Dukej që në fillim se puna do t'iu jepte sukses ngase shihej se s'po nguteshin me emërimet, dhe se për këtë po këshilloheshin dhe po merrnin mendimin e të gjithë mekanizmave në terren, por edhe po vëzhgonin me tepër kujdes dhe po i bënin analizë dhe vlerësim çdo reagimi a zhvillimi nga kushdo qoftë; Sjellje që për kohën dhe rrethanat atëherë, Unë, do ta vlerësoi lartë, si më të qëlluarën. Gjërat po rridhnin ngadalë, por sigurt. Ishte shenji më i mirë se mund të shpresonim në rimëkëmbje të qëndrueshme dhe në riorganizimin që aq shumë i duhej luftës.

Emërimi im Komisarë Politik në Batalionin II

Siç më është thënë, më pas edhe nga komandanti Fehmi Berisha, fillimisht, njerëz të afërm me komandën e brigadës sonë i kishin sugjeruar të më kishte në ekip dhe në stafin e komandës, ndërsa që pasi kishin ardhur në batalion, në Budakovë e gjetiu kishin kërkuar propozime dhe gati secili ju kishte thënë të më kishin mua në ekip

meqë isha veprimtarë i hershëm për çështje kombëtare e shoqërore dhe shumë herë i përndjekur e i dënuar politik, andaj pos që isha më i merituari kisha edhe një përgatitje dhe një përvojë të mirë në organizim dhe në udhëheqje, ndërkaq që edhe tani në luftë kisha dhënë kontribut të çmueshëm deri më atëherë duke bërë punë të mëdha dhe se kisha krijuar autoritet të pakontestueshëm në popull kudo në këto fshatra e më gjerë.

Pata kuptuar se ndër të shumtët që më kishin propozuar ishin edhe komandant Sadiku dhe komandant "Guri", i cili i kishte shpjeguar edhe përpjekjet që ka bërë ai dhe ofertat që më ka bërë, që të më kishte në njësitin e tij dhe në komandë përkrah tij. Për kandidat tjetër të mundshëm i kishin propozuar Nebih (Ramadan) Kokollarin dhe ndoshta ndonjë tjetër.

Kur Komandant Fehmiu kishte vendosë të bisedonte me ne, me qëllim njohje dhe intervistimi, fillimisht kishte thirre në bisedë, Nebihun, i cili që në fillim të bisedës, i kishte thënë komandantit se i kishte rënë të dëgjojë që kundër kandidat e kishte Skender Bashën; Se ishte interesuar për të, meqë nuk e kishte njohur personalisht, por që të gjithë i kishin thënë se, Skenderi, është më i qëlluari dhe se për te kishte dëgjuar shumë fjalë të mira, prandaj meqë edhe ky ishte për Skënderin kishte vendosur të tërhiqej nga kjo mundësi emërimi për të. Kështu, komandanti, Fehmi Berisha, më kishte emëruar Ndihmës Komandant për Çështje Moralo- Politike, për Informim dhe për Marrëdhënie me Civil përkatësisht Komisarë Politik në Batalionin II, ndërsa që unë e kisha vlerësuar lartë dhe vërtetë madhështore këtë mënyrë sjellje e veprimi

të këtij burri, në kohën kur njerëz të shumtë po shtyheshin bërrylash të bëheshin komandant e çka tjetër e po lakmonin të ishin në vende udhëheqëse, kurse po i mbanin ato edhe atëherë kurë vërtetë s'ishin të denjë ti realizonin detyrat që ju shtronte koha e rrethanat e luftës, dhe që s'ishin të vetëdijshëm se këto s'ishin poste që sillnin benifite, por vende, udhëheqëse, me përgjegjësi të lartë, ku merreshin vendime, detyra e veprime të rënda për realizimin e të cilave duhej të rrezikosh jetën tënde dhe jetën e shokëve tu më të mirë. Ndërkaq që ne të gjithë, më pas, Nebihut, i kishim falë shumë respekt, e kishim vazhdimisht në komandë, dhe gati secili prej nesh e mbanim për ndihmës tonin në realizim të detyrave tona të shumta, kurse unë gjithherë jam përpjekë dhe kam arrite ta mbajë afër meje. Ngjashëm ishte vepruar edhe në rastet e të gjitha emërimeve tjera në nivel komande në batalion gjatë emërimit të ndihmësve të tjerë të komandantit, kurse kështu do të veprohet edhe më pas gjithherë kur po emëronim, në çdo nivel komandimi veçse tani komandanti po këshillohej dhe po kërkonte që ne, ndihmësit e tij, të bënim edhe propozimet.

Vërja e rendit, rregullit dhe disiplinës në batalion

Sidoqoftë komandant kishim Bekim Arifin, i cili pa humbur kohë, që në fillim të angazhimit e punës së tij këtu, në batalionin II, kishte vendosë rend, rregull e disiplinë të çeliktë, ndërsa që po përkrahej fort e pa rezervë nga të gjithë ne e që më vonë, në të ardhmen, me komandant Fehmiun, këtë rend, rregull e disiplinë e kishim

ruajtur e ngritur lartë e më lartë deri në përfundimin me sukses të luftës tonë çlirimtare, në Qershor '99 . Zëvendës komandant ishte emëruar Fehmi Berisha, ndërsa ndihmës të tyre kishin emëruar:

- Ramadan (Ahmet) Haxhiaj, nga fshati Gjinoc: Ndihmës komandant për çështje Personeli, në Batalionin II, "S-1";
- Agim (Avdyl) Zyba, nga fshati Bukosh dhe Muhamet (Vesel) Buzhala, nga fshati Budakovë: Ndihmës komandant për Zbulim-Kundërzbulim, në Batalionin II, "S-2";
- Xhemajli Kastrati nga fshati Drenoc i komunës së Rahovecit: Shef i Operativës, në Batalionin II, "S-3";
- Haxhi (Kadri) Sallauka, nga fshati Budakovë: Ndihmës komandan për Logjistikë, në Batalionin II, "S-4"; dhe
- Skender (Ibrahim) Basha, nga fshati Vraniq: Ndihmës komandant për çështje Moralo-Politike, për Informim dhe për Marrëdhënie me Civil, përkatësisht Komisarë Politik, në Batalionin II, "S-5".

Puna ekipore, forma e veprimit

Secili nga ne gjatë gjithë kohës së veprimit e punës sonë deri në fund të luftës do të jemi në nivel të detyrave e përgjegjësive që kishim marrë. Këtë e them në mbështetje të vlerësimit që në vazhdimësi po i bënte punës dhe angazhimit por edhe efekteve dhe rezultateve të punës sonë madje edhe duke na notuar kreu i komandës së

Batalionit II. Ndërsa që secili prej nesh po bënim ekskluzivisht punën tonë, ne në vazhdimësi po ndihmoheshim e po përkraheshim nga njëri tjetri sa herë që për këtë kishim nevojë por që këtë duhej ta kërkonim paraprakisht nga shokët dhe ky ishte rregulli i vendosur e mbi të cilin rregull po funksiononim, përndryshe me asnjë veprim tonin nuk implikoheshim në punët dhe përgjegjësitë e tjetrit. Kjo na bënte shumë përgjegjës por edhe të efektshëm në realizim të punëve e detyrave tona gjatë veprimit, ndërsa që për punë tona të shumta po këshilloheshim mes vete dhe po merrnim mendimin e njëri tjetrit. Kështu ta zëmë ishte e kotë të pyesje cilindo nga stafi i komandës, por edhe komandantin tonë për çfarëdo që kishte të bënte me politikën madje në çfarëdo niveli të sajë. Ai gjithë herë do të përgjigjej': Të pyesni Skenderin për këtë; E edhe kur s'isha prezent do t'iu thoshte: Të më pyesnin kur më takojnë. Kjo ishte mënyra e veprimit të te gjithë neve, ndërsa që po tregoheshim tejet korrekt dhe krejt të fortë në punët tona ku ishim përgjegjës. Për të realizuar mirë e me kohë detyrat tona po merrnim edhe ndihmës. Kështu, unë, shumë shpejt i kisha lënë në përgjegjësi çështjen e informimit Halit (Ajet) Buqajn, një gazetarë që po afirmohej, kurse Halil (Sokol) Ahmetin, për shkak të largësisë e meqë s'po mund ta vizitoja sa duhet këtë kompani, e kisha Ndihmës për Moral në Kompaninë III, në Maqitevë. Këtu në të vërtetë, Halili, ishte ndihmës i dyfishtë duke qenë njëkohësisht edhe ndihmës i imi edhe ndihmës i Komandantit të Kompanisë, Halil Krasniqit.

Fillimi i mbarë, gjendja në njësi dhe te ushtarët

Kishin përfunduar me emërimet dhe kishin plotësuar stafin komandues, ndërkaq që edhe më tej kishte gjëra që s'po kuptonim. Neve na kishte emëruar Fehmi Berisha, ndërsa që tani në këtë kohë komandant kishim Bekim Arifin. Sidoqoftë neve s'po na prishte gjë punë meqë kishim marrë detyrat dhe përgjegjësitë, ndërsa ishim jetësisht të interesuar e tepër të përkushtuar ti hynim punës, të tubonim shokët e të rimëkëmbeshim, ngase siç na kishin mbetur, të thuash si "zogj qyqeje", ushtarët tanë, ishin të mërzitur dhe po rrezikoheshin që në lëvizjet e tyre, kudo, të kapeshin nga forcat serbe e të pësonin. Kishte edhe të tillë që kishin humbur durimin nga pritja e gjatë dhe që po na shanin që po vonoheshim me riorganizimin, por edhe të tillë që po hezitonin të na bashkoheshin sërish e madje edhe të tillë që me hezitimin e tyre kishin vazhduar deri krejt në fund, në kohën kur ndjeheshin më të sigurt të radhiteshin me ne, se sa të qëndronin duar bosh e ti priste serbi në fyt, kurse që neve tanimë na kishin sfiduar, mbi të gjitha për t'iu siguruar armë, gjersa po i rreshtonim ngutshëm, të papërgatitur.

Detyrat

Më ishin të shumta. Para së gjithash më duhej të ngritja moralin ushtarak dhe atë të luftës, përfshirë këtu edhe rendin dhe rregullin si dhe raportet e duhura shoqërore mes tyre, te ushtarët. Duhej krijuar vullnet e moral lufte edhe te masat e gjëra dhe duhej ruajtur këtë vullnet e këtë moral te të gjithë këta gjatë gjithë kohës e

edhe në rrethanat më të rënda që krijonte gjendja e luftës. Duhej siguruar edhe njësitë simotra dhe ato me të cilat përkufizoheshin në veprim se ishim në nivel detyrash dhe partner të denjë në bashkëpunimin mase të nevojshëm për veprime konkrete të përbashkëta luftarake dhe të mos kishin drojën andej kah ishim ne.

Ishte kapitull më vete, por që ishte detyrë imja të krijoja e të ruaja së kultivuari në vazhdimësi raporte vëllazërore, mbështetje të ndërsjellë e bashkëpunimi në mes të Batalionit II dhe njësive tjera simotra që po vepronin në teren dhe me njësi ushtarake të Zonave tjera por që po përkufizoheshin dhe na duhej të përkraheshim e të vepronim bashkë.

Duhej krijuar, ruajtur e kultivuar në vazhdimësi raporte marrëdhëniesh, ti quaj miqësore, të shëndosha me civilët duke siguruar përkrahjen e tyre gjithanshëm për të siguruar gjithë ç'na duhej meqë kryekëput po mbështeteshim në ta, aq më tepër që lufta jonë ishte çlirimtare dhe se po përpiqeshim me tërë çka kishim për lirinë e tyre e të popullit.

Meqë z. Halit Buqa i kisha lënë detyrë dhe përgjegjësi vetëm çështjen e zëdhënies dhe informimit në raport dhe përmes mediave; Më duhej ti mbaja të informuar drejt dhe ti informoja mirë e me kohë ushtarët tanë, por edhe civilët këtu me të gjitha zhvillimet politike këtu e kudo në botë, kur këto zhvillime kishin të bënin me ne dhe me luftën tonë si dhe me detajet e ndonjë ndryshimi që bënim ne këtu, ndërsa që po informonim gjithherë edhe njësitë simotra dhe ato me të cilat përkufizoheshin, me

gjendjen që kishim në teren dhe në vijat e frontit në raport me forcat armike.

Isha i ngarkuar të njoftoja së raportuari komandën e batalionit fillimisht e edhe komandën e brigadës sonë me gjendjen në teren sa i përket moralit, informimit të drejtë dhe me kohë por edhe marrëdhënieve mes ushtarëve tanë dhe gjendjes në këtë plan te popullata dhe te njësit simotra e te njësitë me të cilat përkufizoheshin, si dhe të ngritja e ruaja moralin e stafit komandues, të informoja këtë staf komande me çdo zhvillim kudo e veçmas në teren, por edhe të këshilloja, mbikëqyrja dhe kontrolloja komandën përfshirë këtu edhe komandantin e batalionit duke ruajt të drejtën të qoja secilin prej tyre në përgjegjësi për çfarëdo veprimi të mundshëm shmangie nga rregulloret dhe normat me të cilat vepronim.

Më pas do të marr detyrë dhe do të krijoj ku po e ku jo, në njëzetetre vendbanimet ku kishim shtrirë aktivitetin, Shtabet Civile të Mbrojtjes, do të emërojë komandantët dhe struktura të tjera të këtyre shtabeve, do ti koordinojë veprimet dhe bashkëveprimin e tyre, dhe do ti udhëheqë e komandojë në realizimin e detyrave të tyre për përkujdesje të duhur ndaj popullatës.

Puna me përkushtim, rimëkëmbja e shpejtë

I ishim dhënë punës me gjithë përkushtimin e s'po dinim të lodheshim. Kështu vepronte secili prej nesh, ndërsa shpejt kishim kuptuar se këtu s'kishte ndodhë ndonjë avari dhe se gjërat si kishim rrëmujë. Kishin ndihmuar edhe ecejaket dhe angazhimi konkret i shumicës

prej nesh por edhe vullneti i ushtarëve tanë e ndoshta edhe nevoja e tyre të qëndronin pranë njëri tjetrit duke ruajtur kështu bërthama të shumta të organizimit ushtarak. Për tu bashkuar sërish na kishte mjaftuar qëndrimi dhe njoftimi se po bashkoheshim dhe ja ku ishim, së paku sa për ti mjaftuar njëri tjetrit fillimisht e më pas shumë shpejtë edhe për të realizuar projekte detyrash të mëdha me rëndësi për ta bërë luftën.

Edhe në Budakovë, si kudo tjetër, do të dëgjohet ndonjë zë ndaras e krejt i vetmuar se s'donin të na kishin e të na strehonin por ja që ne s'po i dëgjonim e s'po merreshim me ta, ndërsa që, këta zëra, i kishim pushuar me punën e zellshme që po bënim dhe me sjelljet tona krejt njerëzore në raport me këdo e kudo që takonim gjatë veprimit tonë, kurse shumë shpejtë do të fitojmë simpatinë e tyre dhe do të marrim përkrahjen e shumicës prej tyre në çdo aktivitet tonin. Komandën e batalionit e kishim vendosë në odën e Hysen (Tahir) Kokollarit, nga odat më të mira në Budakovë, kurse ushtarët tanë kudo ku na duhej në gjithë Budakovën e kudo në këto fshatra, ndërsa që krahas punës së madhe e më pas luftës së madhe e krejt heroike do të mishrohemi me këta njerëz, dhe kur po vriteshim po e bënim vdekjen si me le.

Angazhimet

Më ishin të shumta siç më ishin të shumta edhe detyrat dhe përgjegjësitë që kisha. Fillimisht unë po kontaktoja vullnetarët e shumtë që vinin dhe ata që po na bashkoheshin sërish e më pas po i drejtoja te S- 1- shi, të

futeshin në regjistra dhe në radhët tona. Kisha praktikuar të ndalesha në bisedë të gjatë me secilin prej tyre. Doja ti njihja sa më mirë dhe gjithanshëm. Më interesonte gjendja e tyre emocionale e shpirtërore dhe cili ishte motivi i tyre dhe sa ishin të motivuar e të përkushtuar luftës e lirisë. Nga pyetjet ishte edhe ajo se ku ishin në ofensivën e parë, cili ishte pozicioni i tyre dhe si e kishin përjetuar atë.

Ishin të shumtë vullnetarët që po paraqiteshin për herë të parë e përjetimet e mia me ta nga më të ndryshmet. Shumë prej tyre meqë po zgjatesha në bisedë me ta dhe po bisedoja gjithanshëm edhe detajet këtë po e merrnin si provokim. Kishte të tillë që po më luteshin ti pranoja e të mos i ktheja, ndërsa që armët i kishin blerë nga të luhatshëm ose i kishin gjetur por edhe të tillë që s'kishin armë të tyre e që ishin të interesuar të kyçeshin. Do të veçoja rastin e Xhavit (Azem) Loshi, tepër i ri në moshë, i cili kishte provuar të jetë rob lufte në duart e serbëve, kur po më thoshte se serbët më mund ti priste vetëm me armë në dorë dhe në istikame; Dhe atë të Labinot (Muharrem) Llugagjiu, fare i mitur, i cili po më luste të mos e ktheja, ndërsa që unë po përpiqesha ta bindë se nuk kishim të drejtën e angazhimit të tij për shkak të moshës që kishte, kurse ai më tha porosinë që atij dhe babës së tij i kishte dhënë gjyshi i tij Murseli: "Të mos e turpëronin më, por të shkonin e të rreshtoheshin me shokët". Të dyja këto raste më ishin emocionuese. Xhavitin e kisha rreshtuar meqë kishte tetëmbëdhjetë vjet, kurse Labinotin e kisha futë në regjistra, e kisha sistemuar në Togun e Vëzhguesve te Komandant Sevdi Kadriaj, ndërsa që më pas do ta kemi nga vëzhguesit më të mirë në teren i cili punën dhe

aktivitetin e tij po e mbulonte me raportet më të mira, gati të përditshme, me shkrim dërguar komandantit ë tij. Isha në vështirësi të mëdha dhe e kisha hall të madh si të veproja me djemtë që ishin të vetëm në familje. E kisha biseduar me shokët në komandë por ja që s'kishim mund të merrnim një qëndrim ti pranonim e ti strehonim në batalion apo ti lenim ti dorëzoheshin fatit të tyre. E di vetëm se jemi përkujdesur të jenë të strehuar, por që nuk i kishim të radhitur. Kështu kisha vepruar personalisht gjatë gjithë kohës, në ofensivën e shtatorit '98, së mbajturi "nën sqetull" djalin e Rahim (Ramadan) Kolgeci, i cili kishte tërë familjen në Zvicër, ndërsa që atë e kishin zënë rrethanat e rënda të luftës këtu.

Ata që për çfarëdo arsye kishin lënë armët qoftë edhe për një moment, i këshilloja të mos i merrnin më ato, por që të ndihmonin luftën në forma të tjera me gjithë shpjegimin se lufta pas këtej do të ishte edhe më e ashpër. Ata që kishin humbë armën e që kishin marrë guximin të vinin iu thosha ti falënderohen Zotit që s'kishim kohë e mundësi të merreshim me ta dhe ju leja porosinë të bënin të pamundurën ta gjenin atë, ndërsa që obligohesha se edhe ne do ti përkrahnim me gjithë mundësitë e mekanizmat që kishim përfshirë edhe policinë ushtarake në gjetjen e tyre nëse ata ishin të interesuar dhe kishin ose dinin gjurmë ku mund të ishte arma e tyre. Të tillët po i obligoja të bëjnë një deklaratë me shkrim të ditur për policinë ushtarake, kurse po i bëja me dije se të humbësh armën është përgjegjësi që sanksionohet, dhe se mund të kishin pasoja.

Vizitoja në vazhdimësi të gjitha njësitë tona kudo në gjithë fshatrat ku po shërbenin dhe pos ligjëratave të shumta të gjata që iu mbaja gjithherë ndalesha në biseda shteruese me ta. Bisedonim gjithë ç'ju interesonte dhe ua thosha ato që më duhej tua thosha. Shihja kushtet e tyre të jetës ushtarake, merrja dhe gati gjithherë ua kemi plotësuar kërkesat e tyre, ndërsa që po i sqaroja në detaje për çdo gjë që ishe në interesim të tyre. I këshilloja deri në pambarim e deri në pafundësi për të gjitha gjërat me rëndësi për ta, për ne, për misionin e detyrat që i kishim dhënë vetes dhe për luftën tonë të madhe. Gjithherë po ndahesha i kënaqur me ta e edhe më shumë isha kënaqur me betejat e shumta e me luftën e fituar dhe trimërinë e heroizmin që patën treguar.

Mbaja kontakte të rregullta me njësitë simotra dhe me njësitë që kufizoheshim në teren e së fundmi edhe me njësitë e komandat e shumta nivelesh të ndryshme që kishim strehuar ose që po na përforconin në luftimet e përditshme ag e terr që po zgjatnin me muaj të tërë, që s'po dinin së ndaluri e që dukej se s'kishin përfundim.
Vizitoja të gjitha vijat e fronteve ku luftohej e derdhej gjak i shumtë Shqiptari për liri, ua rrihja shpatullat e ju jepja edhe më zemër e guxim këtyre trimave që e kishin mbytë frikën në tërësi, që i ishin bërë argat luftës e që po rrinin si luaj në arena të kësaj lufte.

Mbaja të informuar drejt e me kohë popullatën, kudo që ishte, për çdo zhvillim në teren, ndërsa për të gjitha këto e të tjera po i raportoja komandës së batalionit: Çdo pas mbrëmje, me gojë, së lexuari ditarin e punës, ndërsa që ia dorëzoja edhe Raportin në formë të shkruar;

Çdo të tretën ditë në formë të shkruar, si Raport treditorë i punës; Dhe çdo dhjetë ditë në formë të shkruar e të shtypur me makinë klasike shkrimi si Raport Dhjetëditorë i Punës, kopje të te cilit i dërgoja edhe S- 5-shit në Brigadë, z. Ukë Bytyqi.



Skenderi gjatë kohës së punës, në lokale të komandës së Batalionit II, në Budakovë.

Emërimi i Reshat Muqajt Komandant në Kompaninë Vëzhguese Diversante në Batalionin II

Kishim vendosur të krijonim Kompaninë Vëzhguese Diversante. Komandanti i Batalionit, Fehmi Berisha, kishte dalë me kërkesë ti propozonim emra për komandant të kësaj kompanie dhe këtë po e kërkonte nga secili prej nesh në komandë. Na ishte sugjeruar të ishim të kujdesshëm dhe të përkushtuar kur propozojmë këta emra ngase po bëhej fjalë për komandant, njësia e të cilit do të bartte barrën kryesore në zhvillimet e ardhshme dhe

ndoshta fatin tonë në këto zhvillime, por edhe na ishte thënë se emërimin do ta bënte komandanti pasi të ketë biseduar me secilin nga këta të propozuar, veç e veç. Si përgjigje i kisha propozuar emrin e ushtarit Reshat Muqa të cilin tashmë po e njihja mirë dhe për së afërmi.

Kështu kishim përzgjedhë Reshatin për komandant të kësaj kompanie, kurse që në lidhje me këtë propozim, Komandanti, Fehmi Berisha, gjithherë do të më jetë mirënjohës dhe falënderues, ndërsa Reshati këtu do të shkëlqej më shumë se gjithherë më parë duke na krijuar vërtetë një njësi elite e cila tamam siç e kishim menduar do të jetë bartëse kryesore e barrës në vija të frontit e të cilën do ta kemi kudo që paraqitej nevoja. Më pas me kërkesë të tij e në shenjë respekti, Komandant Reshatit, i kishim mundësuar të transferohej zv. Komandant në Njësinë e Policisë në Brigadën 123, kurse në vend të tij kishim emëruar Komandant Latif Krasniqi "Lata", nga fshati Drenoc i Komunës së Rahovecit, i cili gjithashtu do të shkëlqej në veprim deri në përfundimin e luftës.

Krijimi i Shtabeve Civile të Mbrojtjes

Në përballje dhe në vorbullën e sfidave të kohës e rrethanave nga më të ndryshme që sillte lufta; Na kishte dalë detyrë të krijonim shtabet civile të mbrojtjes kudo, në të gjitha vendbanimet ku Batalioni II kishte shtrirë aktivitetin e edhe atje ku s'kishte mundur të shtrihej, por që kishte përgjegjësinë të përkujdesej e të mbronte popullatën nga hordhi serbe qe po suleshin kudo dhe gati çdo ditë e që po ushtronin dhunë e terror.

Bashkë me detyrën të formonim këto Shtabe Civile të Mbrojtjes, nga Ukë Bytyqi, kishim marrë edhe udhëzime se si ta bënim këtë, ndërsa që kjo pos të tjerash do të jetë detyrë dhe përgjegjësi e imja. I ishim përveshë punës dhe ku po, ku jo i kishim krijuar me shpejtësi marramendëse, ndërsa që do të kenë rol të rëndësishëm dhe do të bëjnë punë të madhe e me shumë vlerë në të ardhmen shumë të rëndë për ne e për popullatën.

Pasi ti kemi krijuar në shumicën dërmuese nga njëzetetre vendbanimet e anës jug- lindore të Suharekës, përfshirë këtu edhe Lagjen Sopa të fshatit Duhël; Do ti komandoj dhe do ti koordinoj veprimet e tyre si dhe do të jap në vazhdimësi detyra dhe udhëzime të duhura të realizonin me sukses këto detyra, ndërsa që gjithherë ishim fare pranë njëri tjetrit dhe se po më raportonin rregullisht për sfidat dhe të arriturat e tyre në terren. Kjo kishte bërë të ishim ushtri- popull, dhe në përkrahje të vazhdueshme njëri- tjetrit. Edhe këtu do të ketë sfida dhe ndoshta mosveprim të ndokujt që ishte i papërgjegjshëm.

Edhe unë po kërkoja luftë, vendimi demokratik, marrja e popullatës në mbrojtje

Ishim rirreshtuar si është më së miri, kishim shtrënguar radhët dhe kishim krijuar maksimumin e mundshëm, të nevojshëm, të rendit, rregullit dhe disiplinës në njësitë tona në të gjitha nivelet e organizimit ushtarak e të komandës, madje deri në atë masë sa që për dy orë vikendi nga fshati Budakovë në fshatin Vraniq ushtarin po e lëshonim me dijeninë dhe me lejen e komandantit të batalionit dhe me leje të posaçme në formë të shkruar, të

nënshkruar nga komandanti i tij dhe komandanti i batalionit, kurse që kërkesat për çdo leje vikendi po na vinin së paku dy ditë më parë përmes komandantit të tij të njësisë, ndërsa që ne më pas, shumë shpejt, po i shqyrtonim dhe po vendosnim në lidhje me to, kurse në vonesën e tyre, vetëm për pak minuta, për kthim po reagonim me policinë ushtarake; të thuash po merrnim frymë njësoj dhe njëkohësisht e me të njëjtin ritëm që të gjithë që nga komandanti i batalionit e deri te i rreshtuari së fundmi në njësit tona.

Gjendja dhe rrethanat në teren po na mbanin për ditë të tëra dhe për kohë të gjatë në gjendje mobile dhe të gatishmërisë së plotë për veprim. Do ndodhë të vritet një zyrtarë komunal serb, i fshatit Sopijë, në Suharekë e në shenjë hakmarrje dhe për të shfryrë mllefin forca të shumta serbe, nga më të ndryshme, kishin filluar fushatë terrori mbi popullatën shqiptare. Fillimisht krejt të tërbuar kishin bërë masakër në familje të Berishve në Suharekë ku gati ose kishin zhdukur familje të tëra duke mos kursyer gjithë ç'po gjenin edhe të moshuar, gra e fëmijë, kurse në rrethana tepër rrëqethëse do të kenë fatin të shpëtojnë dy gra të reja. Shumë shpejt, gati njësoj kishin vepruar edhe në fshatin Terrnje e më pas edhe në fshatin Sopijë. Ndërsa që neve s'po na sulmonte dhe të thuash serbi s'po merrej me ne, ishim stresuar dhe ishim mbushur plot mllef.

Do të shqyrtojmë mundësi e mënyra të shumta veprimi por ja që s'ishte e lehtë, mbi të gjitha ngaqë serbi s'po na e mësynte, ndërsa çfarëdo lënie e pozicioneve tona dhe veprimi ynë kudo me aksione ose frontalisht duke hyrë në vendbanime do t thoshte luftë fyt a fyt me serbin, por që

popullin do kishim nëpër këmbë, andaj s'ishte e lehtë që kësaj ti gjykoje e ti shihje fundin aq më pak të llogarisje në ndonjë sukses të mundshëm. Në këto rrethana, vërtetë tepër të rënda, kur s'po mund ti jepja një përgjigje situatës, dhe kur për herë të parë në jetën time kisha filluar ti përtoj e madje edhe ti shmangesha kontakteve dhe takimeve me civilët, popullatën por edhe me ushtarët; Unë që po e bëja luftën por edhe qe po e urreja, njëkohësisht, shumë atë; Iu kisha drejtuar komandantit dhe komandës në batalion se doja luftë dhe atë menjëherë, ndërsa për të shmangur këtë iu kisha propozuar marrjen e të gjithë popullatës në mbrojtje duke e vendosur mbrapa krahësh tanë, në prapavijën tonë. Meqë isha i prerë dhe tepër këmbëngulës në këtë, nuk ishim zgjatur shumë dhe kjo ishte çështja e parë që e kishim vendosur në mënyrë demokratike, me votim, në nivel komande; E meqë të gjithë ishin për, dhe të këtij mendimi, kështu do të vendosej dhe vërtetë u bë mirë, ngase para së gjithash ne u shëruam dhe mund të vepronim më tej me urti e maturi të plotë.

Vendimi që morëm ishte i vështirë dhe bartte përgjegjësi të mëdha e ndoshta edhe konsekuenca, aq më tepër që me sa më kujtohet ishim të parët në gjithë zonat e luftës kudo në Kosovë që po vepronim kështu. Mu për këtë, gjersa unë isha zgjuar më herët se zakonisht, e kisha bërë publik qëndrimin tonë dhe tërë ditën po dërgoja porosinë, popullatës, përmes njerëzve tanë në teren, ose po shkoja personalisht, kudo, në të gjitha vendbanimet; komandanti i batalionit kishte pyet në ndërkohë strukturat tona, të UÇK- së më lart dhe kishte marrë lejen të vepronim kështu, kurse i gëzuar tej-mase, këtë qëndrim me

shkrim, përmes korrierit, ma kishte dërguar mua kudo që isha në teren, ndërsa që më kishte gjetur, në orët e vona të mbrëmjes, në fshatin Sallagrazhdë, kur po kanalizoja tërë atë autokolonë e atë masë njerëzish të vinin në zona prapa nesh. Këta po i siguronim se do ti mbronim deri në fishekun e fundit dhe me mundësitë e jetët tona dhe kështu kishim vepruar përfundimisht.

Pjesë të kësejë popullate, numër i konsiderueshëm i tyre, nga të gjitha vendbanimet e veçmas ata nga fshati Vraniq, nga granatime të shumta të përditshme dhe nga luftime të ashpra gati të përditshme kudo e këtu tani më kishin lënë shtëpitë dhe ishin strehuar në grykën e Lumi i Vogël mbi fshatin Vraniq dhe në grykën e lumit të lagjes Buzhala. Këtu do të qëndrojnë për javë të tëra nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e luftëtarëve tanë. Luftimet po zgjatnin edhe më, ndërsa që të krijohej përshtypja se s'kishin të ndalur. Ishte dita e dyzetegjashtë e luftimeve të pandërprera kur nga radio "Dojçe Vele" do të mësojmë se sipas burimeve serbe ne të Batalionit II po përballeshim me tetëmbëdhjetëmijë forca serbe, ndërsa që për të përfunduar me ne, serbët, këtu po hidhnin edhe gjashtëmijë paramilitarë serb nga rajoni i Dukagjinit ku po bënin veprime nga më kriminalet e më të tmerrshmet. Këtë e kishte paralajmëruar edhe krye- çetniku serb Voisllav Sheshel, madje për herë të dytë në këta muaj të fundit, në parlamentin e Serbisë ditë më parë kur po thoshte se: Në Budakovë është bastioni i UÇK-së, prandaj Budakova duhet lënë e fundit, se duhet mësyrë e fundit dhe me forca tepër të mëdha dhe se duhet çrrënjosë nga aty UÇK- në sipas parimit serb të "Tokës së Djegur".

Në rrethanat e reja edhe më të rënda të krijuara, kur po sulmoheshim edhe më me ngulm dhe nga të gjitha anët, me gjithë arsenalin që posedonte armiku, por edhe me raketa të shumta kalibrash të ndryshëm, e që për dallim më parë tani po na granatonin pareshtur edhe natën, ndërsa që çdo ditë po përballeshim me këmbësori të shumtë e cila kishte mobilizuar tërë potencialin që kishte përfshirë edhe njësi të tëra pajisur me kuaj samari për depërtim në teren, kurse që kjo po na ndodhte në të gjitha vijat e fronteve të luftës; Pas analizave të duhura në nivel komande, në batalion, kishim vendosur që popullata e strehuar në Lumi i Vogël mbi fshatin Vraniq dhe ajo në lumin e lagjes Buzhala të kalonte edhe më në thellësi në prapavijë, në Lumi i Llanishtit. Tani po mendonim se ndihmesa që po na jepte çdo ditë e më shumë NATO me angazhimin e sajë nga ajri edhe pse, të jem i sinqertë, nuk po na ndihmonte gjithaq ngase kishim vërejtur se sado që çdo natë ne po i jepnim të dhëna mbi vendndodhjen dhe ku po pozicionoheshin forcat serbe, ata po goditnin serbët vetëm pasi këta po na mundnin ne.

Sidoqoftë ne po llogaritnim në lodhjen dhe ndoshta në dorëzimin e Serbisë e të forcave të sajë para tërë këtij presioni, besonim shumë edhe në forcën dhe vullnetin e gatishmërinë tonë për rezistencë edhe më, dhe mbi të gjitha kishim vlerësuar se ne ishim përgjakur tej- mase me forcat serbe këtu madje e dinim se gjak të shumtë kishim derdhur të dyja palët dhe se të gjithë, edhe ne edhe ata, ishim lodhë e mërzitë nga ajo që po bënim. Prandaj kishim vendosë të fusnim këtë popullatë më në thellësi të prapavijës sonë. Vendimin ua kisha bërë me dije unë me

gjithë ftesën të vepronin siç po kërkonim dhe me gjithë shpjegimin që përmenda, ndërsa që kjo popullatë, me gjithë rrezikun, kishte vendosë të nisej në rrugëtim për në Shqipëri, të joshur nga ç'po dëgjonin se numër i madh kosovarësh, të dëbuar, kishin gjete strehim e shpëtim atje. Iu kisha përmendë më- kot edhe të gjitha rreziqet të cilave mund t'iu ekspozoheshin, por ja që kështu e kishin ndarë mendjen dhe kështu do të veprojnë shumica e tyre. Numër i vogël i tyre që na kishin dëgjuar e të cilët kishin kaluar në lumi i Llanishtit, me gjithë vuajtjet që po ju zgjatnin do të kalojnë më mirë dhe do të shpëtojnë të pa dëmtuar, kjo para së gjithash ngase kishin rënë në duar serbësh, në Shtime, të cilët nuk ishin lodhur, nuk ishin përgjakur andaj s'kishin marrë plagë lufte dhe s'ishin vrarë, prandaj ishin më të arsyeshëm dhe më të butë karshi popullatës shqiptare; Kurse shumë nga këta që iu dorëzuan serbit, nga lumi i Buzhalës, provojnë situata vërtetë të rënda e njëzetepesë prej tyre, në mesin e të cilëve edhe: Xhavit J. Basha, Jemin Q. Muqa, Ragip H. Muqa, Haki K. Muqa, Azem J. Llugagjiu, Arben R. Kolgeci dhe Arben S. Muqa pushkatohen barbarisht në oborrin e shkollës fillore të fshatit Bukosh. Pak më lehtë do ta kenë këta në Lumi i Vogël, ndërsa që këtu ishte vrarë, së ekzekutuari nga afërsia, Mehmet R. Kolgeci.

Ndërgjegjja më thërret të jem i sinqertë. Ishin krijuar rrethana të tilla të rënda të luftës kur ishte prishë gjaku, kurse dhembja të përziente ndjenjat. Po na vriteshin gati çdo ditë, shokë tanë, dhe të thuash po shkëputeshin hallka të zinxhirit nga radhët tona, e sado që s'po lenim të copëzohej ky zinxhirë atij po i humbte fortësia. Të

humbësh një shok do të thoshte gjithherë se ke humbur shumëçka nga vetvetja, ndërsa që po ndjeje qartë se nuk je më ai që ishe. Në luftën e madhe ndjeje se të është tharë krahu, dhe se tani je më larg fundit të luftës dhe më larg fitores, prandaj dhimbja ishte shumëfish më e madhe se kur humbje ndoshta një të afërm tënd, aq më tepër që me shokët mund të mbroje atë që ishte e jona.

Sidoqoftë, në asnjë rrethanë të kësaj lufte të madhe nuk patëm një unifikim të faktorit politik e ushtarak në nivel vendi e as në nivele tjera më të ulëta të organizimit, e për pasojë as një bashkërendim të veprimeve dhe shfrytëzim të mundësive dhe potencialit që kishim për të realizuar këtë luftë. Kjo nevrikoste, kurse që unë do të shajë dy herë radhazi "Qeverinë" dhe kreun e sajë atëherë, ndërsa që këtë e kisha bërë zemërplasur që po na mungonin kushte, veçmas municioni i nevojshëm për veprime tona të përditshme.

Peripecitë me Vraniqin, emërimi i Zaim Muqës Komandant i Togës II në Vraniq

Që nga pas- ofensiva e shtatorit, këtu në Vraniq, po sfidoheshim nga lëvizje të shumta të forcave po ashtu të shumta, të ndryshme, serbe, të cilat po parakalonin të thuash çdo ditë në rrugëtimin e tyre nga Suhareka në drejtim të vendbanime me popullatë të përzier: Popolan, Dvoran e Mushtishtë dhe anasjelltas; Por edhe në drejtim të fshatit Budakovë e Muhlan. Kishte raste kur këto lëvizje po i bënin edhe më shumë se një herë brenda ditës, ndërsa që po qarkullonin me makineri të rëndë lufte dhe tepër

guximshëm. Po na paraqiteshin situata kur edhe po ndaleshin për furnizime, ose edhe për një pije, ashtu kalimthi në ndonjërën nga shitoret në fshat. Ishte irituese dhe indinjonte fakti që sikur po mësoheshim me këto lëvizje dhe me këtë prani të tyre këtu, madje ndokush nga ne që deri dje mbante armën dhe rrihte gjoks, tani po iu shiste mall, po i shërbente me pije, dhe ndoshta paksa po zgjatej në bisedë me ta. Kur i shtohet kësaj edhe ajo që është thënë më parë mbi dorëzimin e një numri të konsiderueshëm armësh, del se këtu vërtetë ishin krijuar parakushte për rrethana tepër të volitshme për çfarëdo hakmarrje, kurdo që këtyre iu paraqitej nevoja për hakmarrje mbi popullatën e këtushme për ndonjë veprim tonë kudo. Kjo, thjeshtë po na tmerronte, ndërsa që ishim krejt të pafuqishëm në ndryshimin e shpejtë të kësaj gjendje. Ç' është e vërteta kishim ruajt efektiva dhe organizim që këto lëvizje ti ndalnim duke i dëmtuar rëndë nga prita e edhe të përballeshim me to, por pamundësia që më pas të mbronim popullatën na ishte pengesë në këtë dhe pashmangshëm do të ishte vetëvrasje për ne.

Do të jetë çështja më shqetësuese për veprimtarët e këtushëm, e edhe për komandën e re të Batalionit II, mu për këtë edhe çështja me të cilën në vazhdimësi, për muaj të tërë, do të merremi me të. Kishim diskutuar shterueshëm dhe po merrnim mendimin e secilit prej nesh, dhe gati të secilit akter relevant në fshat. Mendimet dhe idetë nga më të ndryshme ishin analizuar thellë, kurse që fshatin asnjëherë se kishim lënë pa roje vëzhgimi ose pa një njësi sado të vogël që do të jepte alarmin, ose që do të bënte rezistencën e parë, duke i siguruar gjithherë se nga

Komanda e Batalionit II do të intervenohej shpejtë, me të marrë lajmin për çfarëdo zhvillimi të ri në Vraniq. Komandant të njësitit të parë të krijuar në këto rrethana këtu kishim emëruar një nga ushtarët tanë të guximshëm, Imer (Sherif) Shehu, të cilit i kishim dhënë dy korrier, dhe porosinë të qëndronte në lidhje të vazhdueshme me Pikën tonë në lagjen Buzhala, ndërsa që po e kontaktonim shpesh, po i jepnim gjithë instruksionet e duhura dhe po qëndronim në lidhje të vazhdueshme me te, madje duke e vizituar gati çdo ditë, veçmas mbrëmjeve.

Pas përpjekjeve të mëdha, tepër të mundimshme, do të arrijmë të rikrijojmë njësinë në nivel toge, së cilës për arsyen e thjeshtë se po e donin ushtarët, sërish i kishim vënë në krye Komandant, Adem Kolgeci, të cilit i kishim dhënë për zëvendës Komandantin e Skuadrës së I- rë, Imer Shehu; Por që këtë togë nuk do të arrijmë ta bëjmë efektiv dhe funksional edhe për kohë të gjatë, dhe kjo për arsye të shumta nga më të ndryshme, deri kur ushtarët e këtushëm (ata që treguan vullnet të rreshtohen mirëfilli) i kishim marrë një për një ose në grupe në radhët tona pranë komandës së batalionit, i kishim trajnuar, i kishim stërvitur, dhe përgatitur fizikisht e moralisht për angazhime të reja. Dhe jo vetëm kaq; Meqë rrethanat dhe gjendja e re e krijuar kishte shtruar nevojë, do të arrijmë të kemi numër të konsiderueshëm ushtarësh edhe për Togën e II- të, të cilën e krijuam shumë shpejtë më pas e së cilës i kishim vu në krye Komandant, Zaim Muqa, padyshim luftëtarin e paepur e më trim që kishim. Këtë e kishim arritur bashkë me Komandantin e Batalionit, Fehmi Berisha, në kohën kur më kishte dhënë lejen dhe

kompetencat e përgjegjësinë të bëja çka mundja e çka dija, veç të bëja zgjidhjen e duhur për Vraniqin.

Njëri nga luftëtarët tanë - Sadri (Ramadan) Muqa (në këmbë- i dyti nga e djathta), në kohën derisa po stërvitej në njësitin elitë të Komandant Latif Krasniqi "Lata".

Rrethanat përditë e më të rënda po rritnin edhe kërkesat për t'iu bërë ballë sfidave që sillnin mësymjet e pareshtura të forcave serbe dhe luftimet gati të përditshme të te tria ofensivave të më pasme serbe kundër nesh, kurse ne po përpiqeshim të bënim më të mirën për Vraniqin, ndërsa që çdo gjë po jepnim prej vetes dhe nga brumi që kishim. Kështu do ti japim më të mirët edhe luftës së madhe për çlirim që po bënte Ushtria Çlirimtare e Kosovës, trimat: Reshat Muqa dhe Zaim Muqa, të cilët i vumë granit në themele të lirisë së vendit.

Rënia e Zaimit në altarin e lirisë do të jetë e shpejtë, sapo kishim vu rend rregull e disiplinë e sapo i kishim vu gjërat në binarë, ndërsa që ne në krye të Togës së II- të në

Vraniq e kishim emëruar luftëtarin Shpejtim (Isë) Basha-zëvendës i Zaimit deri atëherë.

Për Zaimin kam siguri të plotë të them se detyrimisht dhe pashmangshëm do ti ketë ngjarë gjyshit të tij, Osman (Mehmet) Muqa, të cilit i përmendet lufta, pip në këmbë, kundër forcave malazeze në luftimet në Qakorr dhe në Malësi të Madhe; Por edhe se i kishte "plasë zemra" në një rast kur nuk kishte mundur ti ofronte ndihmë një shqiptari, të cilin në Lipjan po e therte me bajonetë një serb i uniformuar, ndërsa që Osmani po kalonte rastësisht andej pari, dhe ishte krejt duarthatë. Them se edhe Zaimit do ti ketë plasë zemra kur serbët na e vranë Reshatin; Dhe medoemos duhet të ketë qenë kështu, ngase në këtë kohë, Trimi, po udhëhiqej fuqishëm nga ndjeja e hakmarrjes. Sidoqoftë humbja e këtyre Dy Yjeve do të jetë mobilizuese për gjithë ne dhe kishte bërë që edhe më ti qasemi e ti përkushtohemi luftës së madhe.

Reshat (Mejdi) Muqa

Dëshmori: Zaim (Smajl) Muqa

Zhvillimet kishin marrë hov, ngjarjet po rridhnin në mënyrë më të përshpejtuar, ndërsa ne s'kishim reshtur përpjekjet të jemi përballë sfidave. Në këtë kohë zhvillimesh dramatike, së bashku me eprorin Ramadan Haxhiaj, po e përforcoja në komandim e urdhër- dhënie Komandant, Shaban Gashi, kurse po i qëndroja fare pranë komandantëve të njësive tona në Vraniq.

Tani më kishim qartësuar vijat e fronteve të luftës që fillimisht kishin të bënin me anën perëndimore dhe atë jugore të fshatit Vraniq, andej kah përkufizoheshin me fushën e fshatit dhe me vendbanimet serbe: Popolan,

Dvoran dhe Mushtishtë, kurse më pas pasi të ketë rënë Maqiteva edhe në anën lindore të fshatit, përgjatë bjeshkës deri te Maja e Ahishtës në vendin e quajtur Antena; Kishim rreshtuar mirëfilli ushtarët tanë, dhe kishim rritur njësitë numerikisht sa të ishim një kompani e fortë. I kishim sistemuar mirëfilli dhe ju kishim siguruar qëndrim dhe ushqim nga furrë buke dhe kuzhinë e përbashkët. Bukën po na e gatuanin e piqnin familjarë të Ajet (Sylë) Shehu, kurse kuzhinierët ishin luftëtarë tanë. Luftëtarët tanë këtu po vinin nga të gjitha vendbanimet e Komunës së Suharekës dhe nga të gjitha anët e Kosovës. Veprohej harmonishëm dhe në bazë të urdhrave të dhënë. Ishte kohë kur po rezistonim fuqishëm, veçmas do të zhvillohen luftime të ashpra, të gjata, gati të përditshme, te Ura dhe në anën e fushës së fshatit, kurse beteja më e madhe do të zhvillohet në lagjen e Ogushve, ku po rezistonte Komandant Sadri (Ramadan) Muqa me luftëtarët: Azem (Miftar) Kolgeci, Enver (Ibrahim) Basha, Ali (Fazli) Kolgeci, Shaban (Mërtez) Kolgeci, Zenel (Hajrush) Kolgeci e shokë të tjerë të cilët i kishin thyer keqas forcat serbe.

Pas kësaj, të nesërmen e kësaj dite, në shenjë hakmarrje, forcat serbe do ta granatojnë e raketojnë fshatin me artileri e raketahedhës kalibrash nga më të mëdhenj, veçmas vendqëndrimet e ushtarëve tanë dhe objektin e kuzhinës sa do ti zhbëjnë nga faqja e dheut ato, kurse kjo kishte bërë të bie rezistenca e jonë e mëtejme. Këtu kishte ndikuar edhe rënia e vijave tona të fronteve të luftës në Maqitevë e për pasojë shtrirja e jonë përgjatë bjeshkës deri te Maja e Ahishtës, duke krijuar gjendje që nuk

përballohej meqë s'kishim ushtarë të mjaftueshëm për të mbuluar gjithë këto vija, kurse në secilën prej tyre po zhvilloheshin luftime.

Më datë 03. prill, në kohën kur ishte krijuar gjendje krejt e padurueshme, ndërsa popullata e këtushme kishte vendosur të lëvizte për në Shqipëri, nga granata të rëna në fshat vdes Zenel (Bajram) Aliaj nga fshati Maqitevë me vendbanim në Savrovë dhe Ganimete Sopa nga fshati Bukosh, e plagosen disa anëtarë të familjes Sopa, kurse bie dëshmorë luftëtari Besnik Muqaj nga fshati Korishë.

Në vlug të kësaj rezistence të gjatë e skajshmërish heroike, më 05. prill kishte rënë Komandant, Zaim Muqa; E në përpjekjen për të na përforcuar, gati njëkohësisht, në të njëjtën ditë, më datë 03. maj, bien edhe luftëtarët: Emrush Buzhala, në fushë të fshatit Vraniq, dhe Emin (Murat) Musliu në Maje të Ahishtës.

Pas kësaj forcat serbe që kishin depërtuar në territorin tonë, më datë 03. maj, në pyje të Vraniqit, vrasin e masakrojnë: Hamdi Palushin nga fshati Budakovë, Ramadan (Musli) Luzhën, Rifat (Durak) Kolgecin, Shpend (Hamza) Kolgecin dhe Sherif (Imer) Shehun nga fshati Vraniq, si dhe Murat (Rasim) Aliajn nga fshati Maqtevë me vendbanim në fshatin Dvoran, kurse plagosin Sabri (Nazim) Kolgecin dhe Arben (Nuhi) Kolgecin, ndërsa në mbrëmjen e një dite më parë, më 02. maj, mbi fshatin Savrovë, nga armë zjarri ishte plagosur Zyrafete (Asllan) Matoshi. Dhe së fundmi, një muaj më vonë, me 02. Qershor '99, në mësymjen e fundit serbe, vriten: Osman (Rrahman) Kolgeci, Vesel (Tahir) Kolgeci, dhe Rexhep

(Sylë) Shehu nga fshati Vraniq, si dhe Xhevdet Gashi nga Suhareka.

Në këmbë: Bexhet Kolgeci, Azem Kolgeci, Enver Basha dhe Astrit Kolgeci; Ulur: Komandant Zaim Muq dhe Komandant Shpejtim Basha.

Nipat dhe mbesa (në prapavijë, motra dhe familja) e Skenderit, të strehuar në lumin e Buzhalës.

Jahir (Zymer) Kolgeci dhe Bexhet (Nebih) Kolgeci, në prapavijë popullata e strehuar në lumin e Buzhalës.

Traktori i familjes së Skenderit në lëvizje për në Shqipëri, (në plan të parë refugjatë nga fshati Savrovë që po udhëtonin bashkë me ata)

Zhvillime e ngjarje të shumta, sfidë për mua

Ashpërsisë së rrethanave e luftimeve të pareshtura duhej kundërvu me ashpërsinë më të egër ndaj barbarizmit që po shfaqnin veprimet gjakatare serbe, e në të njëjtën kohë duhej të shfaqeshim vigjilent e esëll, dhe me butësinë e ndjeshmërinë më të madhe në veprim kur kishe të bëje me njeriun tonë kushdo qoftë ai e veçmas me luftëtarin nga i cili varej kryekëput fati i zhvillimeve të luftës dhe

ardhmërisë së popullit e vendit, por edhe me popullatën krejt të pafajshme që po bënte sakrificën nga më të ndryshme. Dhe kjo s'ishte e lehtë.

Do të jem në vija të frontit çdo ditë, dhe gati çdo ditë në vija të tjera të këtyre fronteve të shumta të luftës, për t'iu dhënë përkrahjen e duhur morale këtyre luftëtarëve trima dhe për të amortizuar ose evituar ndonjë situatë të pakëndshme e të dëmshme që mund të paraqitej, dhe në kontakt të vazhdueshëm (me qëllim informimi) me popullatën, në vendqëndrimin e tyre si të strehuar në gryka të lumenjve, çdo pas mbrëmje.

Po bëja punën e ndërlidhësit mes Komandantit të Togës së Vëzhguesve, Sevdai Kadriaj, dhe eprorëve tanë të lartë (Komandant "Drini" e Bislim Zyrapi) por edhe të mekanizmave ndërkombëtarë të pranishëm për të dekonspiruar e denoncuar vendqëndrimet e forcave e të makinerisë serbe te qendrat e NATO- s në mënyrë që ata ti goditnin me efektivitet dhe sipas prioriteteve tona.

Do të sprovohem të ndihmoj në dhënien e urdhrave ushtarake për veprime luftarake, kur kishim vendosur që të shpërndanim komandën e batalionit për t'iu qenë më afër dhe në përkrahje direkt njësive tona, ndërsa që mua më ishte lënë detyrë të përforcoja komandën e Kompanisë së Komandant, Shaban Gashi, me qendër në lagjen Buzhala, e cila po vepronte me togjet e sajë në: Buzhalë, Bukosh, dhe në Vraniq.

Do të mbajë përgjegjësinë kryesore për sigurinë e të plagosurve tanë dhe për të plagosurit e shumtë të njësisë së Komandantit "Guri" pasi të kemi humbur territoret e lira që po mbanim e kur ishim detyruar që këta të plagosur ti

vendosnim në stacionar ose në spitale ushtarake në Zonën Operative të Neredimës, ndërsa që nga komandanti i batalionit isha obliguar ta vizitoja kudo që ishte dhe ti raportoja gojarisht dy herë në javë për gjendjen dhe për rrethanat në të cilat po mbaheshin e po kuroheshin këta luftëtarë të plagosur.

Meqë familja ime do të jetë nga familjet që të fundit kishin lëshuar Kosovën (me 02. Qershor '99), ndërsa që kishin mbetur pa kujdestarin e tyre ngase forcat serbe, për një kohë, e kishin ndaluar babanë, Ibrahimin, me burra të tjerë në fshatin Bukosh e për pasojë, për ditë të tëra, i kishte humbur lidhjet me familjen; Më duhej që herë pas here ti vizitoja edhe ata, kurse që kjo kërkonte mund e më merrte kohë.

Po e përjetoja tepër rëndë kur përfundimisht po ndaheshin prej nesh shokët luftëtarë, dhe kur po asistoja në ndërhyrjet mjekësore meqë rast shokët kishin humbur ose po iu hiqeshin gjymtyrë të trupit.

Ishte shqetësuese dhe e dhimbshme çdo situatë kur njeriut të vendit s'mund ti ofroje çka i duhej, veçmas kur s'mund ti ofronim sigurinë për jetë. E tëra ishte sfidë.

Përgatitjet për pasluftën

Angazhimet dhe detyrat e shumta të secilit prej nesh për të mbajte organizimin ushtarak, për ta bërë me sukses luftën dhe gjithë puna e rëndë me gjithë përkushtimin, aktiviteti i gjithanshëm, tepër i mundimshëm, përfshirë mbajtjen e vijave të frontit të asaj lufte tepër të madhe, skajshmërish heroike; Kishin bërë të ndjeheshim të lodhur

madje tej- mase sa të ndjeheshim edhe të rraskapitur. Ishte koha kur për javë të tëra luftëtarëve, që vërtetë ishin të paepur, po iu dërgonim ushqimet në pozicione, veçmas mëngjesin dhe drekën e ndonjëherë edhe darkën, ndërsa që vërtetë po pushonim e flinim në orar tepër të shkurtuar (dy orë brenda natës). Dhe sado që fitoren e kishim të sigurt, të përkrahur nga e gjithë bota e qytetëruar e demokratike dhe forca goditëse e sajë NATO, ende s'kishim komoditetin të mendonim pasluftën e as detyrat po aq të rëndësishme sa ato të luftës që na prisnin për të organizuar jetën përfshirë edhe atë politike. E mira qëndron në faktin që, të thuash, secili po bënte një punë, ose po e lodhte mendjen për diçka të nevojshme e të mirë.

Në lokale të komandës së batalionit kishte ardhur z.Halim Haziraj, një burrë nga fshati Gjinoc, por që fare s'po e njihja, ndërsa që kishte kërkuar të takohej personalisht me mua. Sapo të jem përshëndetur e të ishim prezantuar, në takim krejt të ndarë, fillimisht më bëri të ditur se po më njihte përmes Ramiz Hazirajt, një burrë krejt i përkushtuar luftës, që po shkëlqente në veprim konkret të nduar- nduarshëm varësisht nevojave dhe detyrave që shtroheshin dhe kjo do të më gëzojë. Me kërkesë të tij, biseduam pas luftën dhe gjithë çka ishte e nevojshme të bëhej që, paslufta, të na gjente të përgatitur. Si përgjigje i kisha thënë, shkurt, se ishte ide e mirë dhe se po bënte punë të mirë, ndërsa me kërkesë të tij, ashtu paksa ngutshëm i kisha përmendë emra të shumtë njerëzish nga të njëzetetre vendbanimet ku po zhvillonim aktivitetin dhe ku kishim përgjegjësinë dhe ndikimin, përkatësisht nga gjithë ana (e Nën Malit) Jug-Lindore e

komunës së Suharekës. Duke qenë se kisha pasqyrë të plotë të gjendjes kudo dhe se po njihja nga afër dhe mirë veprimtarët madje edhe të kaluarën e tyre dhe veprimin konkret të atëhershëm, në mënyrë gati telegrafike i kisha dhënë emrat e: Jetulla Regjaj nga fshati Papaz, Haxhi Sallauka e Destan Palushi nga fshati Budakovë, Arben Veselaj nga fshati Reqan, Isë Morina nga fshati Stravuqinë, Fatmir Kodra nga fshati Qadrak, Shefki Kolgeci dhe Bislim Muqa nga fshati Vraniq, Halil Krasniqi dhe Halil Ahmeti nga fshati Maqitevë, Bajram Zyba nga fshati Bukosh, Xhemajl Zenelaj nga fshati Savrovë, Milaim Elshani e Xhavit Sadikaj nga fshati Sopijë, Rrustem Aliaj dhe Ibish Ahmeti nga fshati Dvoran, Halit Demiri dhe Rexhep Shala nga fshati Mushtishtë, Agim Gashi nga fshati Dubravë, Riza Vata nga fshati Sallagrazhdë, Ramiz Haziraj, Ramadan Haxhiaj e Sali Asllanaj nga fshati Gjinoc dhe Shefqet Beqiraj nga fshati Grikoc, duke përzgjedhë kështu njerëz të përkushtuar çështjeve shoqërore dhe asaj kombëtare, por që s'ishin ngjyrosur shumë politikisht, të cilët, siç po mendoja unë, do të ruanin mesin duke ofruar rehati, shumë të nevojshme, deri në zgjedhjet e para kur krerë dhe aktivist të subjekteve politike, në garë për votën e popullit do të përzgjidheshin të na përfaqësonin e udhëhiqnin. Derisa, unë, po i përmendja z.Haziraj të kontaktonte këta burra dhe ti përgatitnin bazë pushtetit popullor të pasluftës, më kishte përmend të mos pranoja të bisedoja me këdo tjetër në lidhje me këtë. Ngase në interesimin tim se a mund të më vinte kushdo tjetër në lidhje me këtë dhe se a kishte këtu çfarëdo dualizmi, më ishte përgjigjur me: "Po"; Do ti

them fare shkurt të lente gjithë këtë dhe të harronte bisedën me mua ngase thjeshtë s'dua të jem unë e as idetë e mësimet e mija kudo ku ka dualizma. Në ndarje e kisha lutë të më kuptonte drejtë.

Së fundmi

Me shokët e komandës e të veprimit ushtarak e politik do të jem si gjithë herë gjatë gjithë së kaluarës sime jetësore tërësisht i sinqertë, ndërsa që ushtarëve dhe veçmas popullatës ia thosha gjërat varësisht nevojave të luftës a rrethanave të momentit; por gjithë herë për të mirën dhe rehatinë e tyre, për të mirën e luftës dhe për të mirën e përgjithshme; ndërkaq që iu isha përkushtuar çështjeve me mish e me shpirte të rezultonin me sukses aq më tepër për të mbuluar dëmin që po na shkaktohej nga të pa ndërgjegjshëm këtu e më lartë, por edhe për t'ua çelikosë moralin e fortë luftëtarëve tanë dhe të gjithë atyre që po na përkrahnin pa kursim, në forma të ndryshme, në këtë luftë të madhe tepër heroike që bënin bijtë e shqipes në këtë cep të Kosovës.

Kohëve të fundit, në rrethana tmerrësisht të rënda e skajshmërish të mundimshme për të gjithë ne, kur do të jemi vërtetë të lodhur, madje tepër të zënë nga angazhime të shumta në detyra tona e në vija të frontit gjithandej përgjatë gjithë zonës sonë të veprimit politiko- ushtarak nga luftime të ashpra, të pareshtura, të përditshme, që po zgjatnin me muaj të tërë, e që s'po u dihej fundi; kur po mendonim se e kishim gjithë përkrahjen e të gjithë popullatës meqë atë e kishim marrë në mbrojtje dhe e

kishim vendosë prapa krahësh, në prapavijën tonë, ndërsa që po plagoseshim e vriteshim tepër vullnetshëm në mbështetje të sigurisë dhe mbrojtjes së sajë ashtu siç ishim obliguar moralisht me detyrimin dhe përgjegjësinë më të lartë morale e kur s'po bënim të thuash një sy gjumë e s'po dinim për pushimin e trupit e të shpirtit e që ngado që silleshim po merrnim bekimin e popullatës bashkë me lutjen e tyre të na ndihmoj Zoti; Do të na ndodhë të mos mund të fusim në sistem tërë potencialin njerëzorë nën armë e as të gjitha armët që posedonte popullata civile, andaj le që s'do të jemi ata që duhej dhe mund të ishim në vija fronti, por fakti që armë dhe njerëz nën armë po rrinin te popullata e strehuar, do të jetë denigrues për ne dhe do të na ulë moralin para popullatës, së shumtë, që në këto rrethana kishte jo më pak se disa mijëra njerëz për të cilët përkujdeseshim gjithanshëm duke përfshi edhe përkujdesjen për shëndetin e tyre dhe furnizimet me ushqime e veshmbathje për ta, ndërsa që me luftën dhe rezistencën tonë po mbronim dhe po i krijonim siguri nga këto anë edhe disa dhjetëra mijëra njerëzve, popullatë e Komunës së Shtimjes dhe të fshatit Jezercë. Pas shumë përpjekjesh, me gjithë mundin, së vepruari pandashëm politikisht, por edhe me masa shtrënguese policore, diku kah fundi kishim arritur të fusim në sistem këto armë dhe të krijonim rregullin e duhur edhe në këtë plan.

Pos rezervave të pakta në furnizime që kishte popullata, të gjitha që ju duheshin i kishin nga Njësia e Logjistikës së Batalionit II, të cilën po e udhëhiqte tepër suksesshëm Ndihmës Komandanti Haxhi Sallauka, i cili për të realizuar këtë kishte themeluar njësinë e transportit

të cilën po e udhëhiqte suksesshëm ushtari Bekim (Sahit) Krasniqi nga fshati Savrovë, e të cilin transport po e bënte, çdo natë, nga vendbanime të ndryshme deri në fshatin Grikoc, me kuaj samari të cilët i kishte mobilizuar për këtë qëllim, ndërsa që shpërndarjen e këtyre të mirave, kryesisht miell, po e bënin me shumë rregull e urti ushtarët tanë dhe aktivist nga shtabet civile të mbrojtjes të fshatit Budakovë dhe Krushicë e Epërme. Kështu deri në shterje të te gjithë rezervave në batalion dhe në teren dhe deri kur në mungesë e në pamundësi furnizimi të mëtejmë me municione kishim vendosur të lëmë pozicionet dhe të lëmë vijat e frontit të luftës ballë për ballë për të kaluar në forma të veprimit ushtarak të tipit gueril.

Gjithherë isha për formën guerile të veprimit. Lufta frontale, me vija të përcaktuara e statike të frontit, na ishte imponuar nga rreziku i mosnjohjes së kësaj lufte si luftë çlirimtare nga faktori i jashtëm, dhe nga hezitimi i faktorit të brendshëm, përndryshe do ta kishim më lehtë sesa të krijonim e mbanim tërë atë strukturë ushtarake.

Njohja dhe takimet me komandant e eprorë të UÇK

Do të kem fatin e papërsëritshëm të jem afër, të njoh në veprim, por edhe të bashkëpunoi në realizim të detyrave me shumë shokë të mijë të mëhershëm e edhe me shumë të tjerë që u njohëm në vorbull të zhvillimit të luftës.

Nga këta që nuk përmendë në këtë publikim e që i njoha nga afër në veprim, flas me shumë respekt edhe për:

- Komandant: Ismet Jashari “Kumanova”;
- Epror: Safet Syla;

- Komandant: Tahir Sinani;
- Komandant: Ekrem Rexha “Drini”;
- Komandant: Bislim Zyrapi;
- Komandant: Gëzim Hazrolli;
- Komandant: Remzi Mehmeti;
- Epror: Enver Rrustemi;
- Komandant: Izet Buzhala;
- Komandant: Afrim Basha “Abi”;
- Zv. Komandant: Xhafer Kabashi;
- Zv. Komandant: Mufail Elshani;
- Epror: Vesel Maliqaj;
- Epror: Beqir Kabashi;
- Komandant: Aqif Kadriaj;
- Komandant: Sevdi Kadriaj;
- Komandant: Regjë Buzhala;

Ndërsa që përbetohem në burrërinë e Komandant: Ahmet Kaqiku. Për fat të keq, kishte edhe komandant e eprorë të tillë që s’po i dinin anët e botës.

* * *

Në vend të përfundimit

Pjesëmarrja, përkrahja dhënë luftës, përgjithësisht në Kosovë

Në përgjithësi, në Kosovë, kishte një pjesëmarrje të vogël në luftë. Meqë s’kishim një regjistrim të popullatës në përgjithësi e as regjistra të potencialit njerëzorë të aftë për angazhim të drejtpërdrejtë në luftë por as edhe regjistra

të besueshëm, në kuptim të shifrave, të pjesëmarrësve aktiv dhe atyre që e kishin ndihmuar luftën në forma të ndryshme; është vështirë të jepen vlerësime të bazuara. Sidoqoftë, mund të thuhet diçka më pak se një për qind dhe vërtetë kjo është pak, aq më tepër që lufta po bëhej për çlirim. Për të vlerësuar drejt, detyrimisht, duhet ik të dhënave me të cilat spekulohet tani pavarësisht cili është mekanizmi a faktori në shoqëri që ofron ose jep këto shifra e të dhëna.

Janë mbingarkuar dhe fryrë tej- mase të gjithë regjistrat pa dallim e edhe ai i dëshmorëve për fat të keq. Kjo për shkak mungese kriteresh të përcaktuara mirë dhe unike që do të vlenin në të gjithë Kosovën, si dhe për mungesë komisionesh e grupesh punuese që do të njihnin mirë jetën dhe veprën e të rënëve dhe të vrarëve e që tek më pas të vlerësonin jetën dhe veprën e këtyre të vrarëve e të rënëve në luftë e jo siç është vepruar ngutshëm duke vepruar së nxituari dhe me komisione të krijuara ngutshëm dhe ç'është më e keqja të krijuara ad'hok dhe me mandat të shkurtë veprimi.

Jo vetëm për të ardhur keq, është fatkeqësi fryrja e regjistrave të këtyre që mund të thonë meqë mund të flasin. Janë të fryrë edhe regjistrat e invalidëve të luftës edhe ai i ushtarëve edhe ai i civilëve, ndërsa që jemi bërë të gjithë luftëtarë; bilës, të gjithë veteran të luftës. Pyes, pse s'kemi kategori të tjera? Si mund të bartet epiteti i veteranit nga të gjithë? Ose si mund të barazohemi me ata të radhëve të para, të mos them ngase se kam të lehtë, me burrat shokë të Adem Jasharit?

Ku janë gjithë ata përkrahës, të shumtë, të luftës dhe ata që e kishin ndihmuar atë duke dhënë kontribut të çmueshëm madje edhe në mënyrë të organizuar në kuadër të shtabeve civile të mbrojtjes të cilat ishin krijuar nën direktivë dhe nën përkrahje e mbikëqyrje të ushtrisë sonë, ndërsa që i kishim krah të djathtë në angazhimin tonë për përkujdesje për popullatën.

Po të pyetesha për përkrahjen, luftës, në nivel Kosove, përgjithësisht, në çdo plan; Përgjigjja e parë që do të më vinte në mendje do të ishte se në Kosovë s'ka pasur luftë. Kjo ngase zjarret e luftës s'patën përfshirë pjesë të tëra të saj. Edhe sot po i pyete të sinqertët, në shumë pjesë të Kosovës, do të përgjigjen se i mbajnë mend bombardimet e NATO-s, dhe se dikush iu kishte thënë ose se kishin dëgjuar se po thoshin të largoheshin andaj ishin larguar dhe kishin shkuar në Shqipëri, në Maqedoni ose më pas diku më larg, ndërsa që s'kanë dëgjuar krismat e armëve dhe s'kanë parë tmerret e luftës, kurse ushtrinë e tyre e kanë parë në televizor.

Imagjino gjendjen kur një pjesë e Kosovës po digjej, vritej e pritej në luftë për lirinë e vendit e të kombit, kurse i pari i vendit le që s'po njihte as luftën as ushtrinë që po bënte këtë luftë për çlirim, por që këtë ushtri po e quante dorë e zgjatur e Serbisë dhe po ndërronte perdet në pallatin e tij gati mbretërorë ndërtuar nga mundi e djersa e po këtij populli që po bënte sakrificën sublime në luftë heroike. E ç'të thuhet për situatën kur po digjej Tususi, ndërsa që Prizreni po pinte "Makiato" buzë Lumbardhi ose kur po digjej Dardhishta e Poshtme e po vdisej për të, kurse në

Vraniq rrihej e pihej të thuash se lufta po zhvillohej në Lindje të Largët.

Këto rrethana kanë krijuar edhe absurdin që sot kemi garnitura të tëra udhëheqësish ushtarak të ushtrisë sonë që se kanë parë luftën ngase ajo s'ka ndodhë fare atje në zonat dhe në rrethet e tyre edhe pse ishin organizuar dhe emëruar për këtë, ndërsa që më pas mbajnë gradat e luftës dhe i kemi në vende udhëheqëse kudo deri në kreun e shtetit e të shoqërisë meqë kanë krijuar autoritet, ndërsa që s'duam të dimë se atje ku se kemi bërë luftën sot i kemi problemet, e duke qenë të pakrijuar vet duket se do të krijojmë shumë shtete.

Kudo në botë dhe gjatë gjithë historisë së njerëzimit, individ, familje, shtete ose shoqëri njerëzore; Kur lufta është në prag bëjnë mobilizim të ngutshëm, madje edhe duke orientuar gjithë potencialin njerëzorë e atë prodhues në drejtim të përfundimit të luftës shpejt dhe me sukses. Te ne s'po ndodhte kështu. Ndoshta po ndodhte e kundërta nëse në retrospektivë shikohet në veprimet e "Qeverisë" në ekzil, por edhe të kontribuuesve individual të cilët në pamundësi ardhje- vajtje dhe bërje investimesh me qëllim rritje të standardit të tyre jetësorë po bënin kursime të cilat do ti fusin më pas në përdorim dhe do të përfitojnë majshëm nga kategoria që kishte bartë barrën e luftës gjithanshëm. Më pas, nga asnjë qeveri në pushtet le që s'është bërë as përpjekja më e vogël, por as që është menduar një sistem ekuilibrues mes të dëmtuarve që realisht janë edhe bartësit e luftës dhe të merituarit për lirinë e të gjithëve, dhe atyre që si ka prekë lufta e që kanë përfituar gjithanshëm nga lufta. Do të kemi dobësi edhe

ne. Pse të mos përmendë se duket të jem i vetmi nga 64 eprorët në brigadë që s'kisha pranuar të marr lokal ose banesë si kompensim për kontributin tim në të kaluarën.

Përfituesit më të mëdhenj janë individ, të shumtë, të pandërgjegjshëm, nga kreu i ynë politik e ushtarak, që po menaxhonin mjete nga djersë e popullit për luftën, ndërsa që këto mjete po i shpërdoronin edhe para se ta kemi lirinë e shtetin por edhe më pas për të blerë aktivist për partin e tyre e për interes të tyre si dhe për të shtuar pasuri të shumtë, ndërsa që këtë po e bënin pa fije turpi dhe pa asnjë rrezik nga kushdo madje edhe duke i privatizuar këto fonde, në sy të te gjithë neve.

S'mund t'iu falet kurrë atyre që ishin më të vjetër se ushtari ynë, fare iri në moshë, që s'ishin përfshirë në luftë dhe këtë për shumë arsye. Do të ishin luftëtarë më të mirë meqë ishin më të pjekur dhe më të përgatitur ngase gati secili prej tyre kishte një shërbim ushtarak; Si rezultat do ti kursente lufta më shumë dhe do të kishim më pak të rënë, por edhe më pak viktima, ndërsa edhe po të binin vërtetë do të humbnin jetë, por që dëmi për shoqërinë do të ishte shumë më i vogël krahasuar me gjendjen që kemi me gratë e reja të veja dhe me fëmijët e shumtë jetim.

Në Suharekë

Kishte një angazhim të hershëm, them të mirë dhe me kohë. Sfidat e mëdha që sjellin rrethanat e luftës na kishin luhatë herë- herë, nga pak, si kudo tjetër. Ndërrimet e shpeshta në stafin komandues të Brigadës 123 përfshirë gjithherë edhe ndërrimin e komandantit të saj lenin gjurmë

që kërkonin kohë dhe mund për ti riparuar, ndërsa që këtu njeriu i këtij vendi se kishte ndikimin meqë tamam sipas rregullit këta po na emëroheshin nga lart. Do të ishte mirë të mos kishte fërkime e as tendencë dualizmash në teren, ndërsa jemi tepër të merituar që kishim tejkaluar këto dhe s'kishim lejuar zhvillime që mund të qonin në vëllavrasje e në gjakderdhje me çka do të krijoheshin rrethana të rënda për luftën e situata të paripareueshme që do të na lëndonin e thyenin shpirtin, dhe që do të lenin vragë e plagë të pashlyeshme e të pa shërueshme. Ishte i veçantë dhe për kënaqësinë e të gjithë neve angazhimi i hershëm, në organizim ushtarak, në UÇK, i udhëheqësve tanë të deri atëhershëm, Ukë Bytyqi e Blerim Kuqi, por edhe i neve të tjerëve që po vepronim në teren gjatë gjithë paraluftës. Kishim arritur të organizoheshim mirëfilli, padyshim më mirë se kudo tjetër në gjithë zonat e luftës, duke vënë rend, rregull e disiplinë që kanë vetëm ushtritë e rregullta e të organizuara me standarde të larta.

Dallohemi nga të gjithë të tjerët, kudo në Kosovë, se djemtë tanë kanë vrarë kryepolicin serb në komunë dhe jo vetëm atë, kryetarin serb të komunës, dhe se jemi të vetmit që jemi çliruar ende pa hy KFOR- i në Kosovë.

Në Vraniq

Janë bërë përpjekje për të cilat s'mund të thuhet se ishin të tilla që plotësonin nevoja e që do të mund të bëheshin me një angazhim më të madh të te gjithëve.

Fshati Vraniq kishte specifika të cilat e bënin të vështirë veprimin politik e veçmas, veprimin ushtarak-

luftarak mbi të gjitha për shkak të përkufizimit me serbët lokal, të pozitës gjeo- politike dhe gjeo- strategjike të tij, pozitës gjeografike dhe konfiguracionit të terrenit që ka; dhe kjo do të jetë arsyeja pse gjatë gjithë kohës ishim sjellë ndryshe. Në fillim të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Vraniqi kishte 280 familje me po aq shtëpi, me rreth 2.500 banorë. Përjetoi katër ofensiva serbe: Me 27. shtator 1998, me 03. mars 1999, me 03. maj 1999, dhe me 02. qershor të cilat kishin zgjatur varësisht mundësive tona për të rezistuar e për t'iu bërë ballë, kurse që është djegur në masë 98 %, ose 272 shtëpi me të gjitha objektet përcjellëse. Është djegur edhe shkolla e fshatit dhe xhamia.

Si pasojë e luftës, Vraniqi ka 21 të vrarë, dy prej tyre dëshmorë kombi: Reshat (Mejdi) Muqa dhe Zaim (Smajl) Muqa, ndërsa të tjerët viktima civile të luftës, kurse në Vraniq kanë ra në altarin e lirisë edhe katër dëshmorë të tjerë: Hafir Elshani, Milaim Bugari, Besnik Muqaj dhe Emrush Buzhala, sidhe shumë viktima civile të luftës, banor të vendbanimeve të tjera.

Mirënjohja nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së dhënë fshatit Vraniq, me të përfunduar lufta, ka vlerësuar dhe çmuar lartë angazhimin tonë.

Përfundimisht

Si të gjithë të tjerët, meqë nuk më mori lufta sado që s'isha kursyer asnjëherë, madje në gjithë angazhimin tim derisa po veproja, asnjëherë nuk më kishte shkuar ndërmend t'iu ruhesha plumbave qorr dhe granatave, por ja që lufta nuk më mori; Edhe unë kisha ëndrrat e mia dhe

kisha varë shpresat te shumë të mira në pasluftë. Këtë e kisha mbështetë veçmas në lutjet që po dëgjoja nga goja e popullit derisa po kthehej, në mënyrë aq madhështore, prej nga ku ishte strehuar, kur thoshte: "O ishalla drejtohemi", por ja që nuk ndodhi kështu. Fillimisht gaboi rëndë populli, kur i dha votën atyre që ishin kundër luftës e me këtë pavetëdijshëm ishin kundër lirisë, rast i dytë në histori të njerëzimit pas atij në Çeçeni; E më pas gabuam ne, me sjelljet tona, mësuar nga të huaj e vendorë që na patën udhëhequr, duke kaluar çdo normë morale e ligjore, deri në ditët e sotme. Dhe nëmi veten: "Mos më rafte të shkruaj, vazhdimin, pasluftën", ndërsa që s'do të mund ti jepja shpjegim faktit që: Serbi nuk është këtu, kurse populli i ynë edhe më tej është krejt i pakënaqur, me shumë arsye; Përndryshe do të shkruaja se në lirinë pas dymijë vjet robërie, në këtë varfëri të skajshme, nga dallkauk e kopuk ngrihen "minare të gurta" e njeriut tonë po i kthehen arnat. E dhimbshme. Që s'falet.

Nga lexime të shumta, që në fëmijëri, do ta kem njohur Hivzi Sylejmanin, të cilin edhe më e mbajë për idhull timin. Shumëçka do të mësojë edhe nga Haxhi Zyba. Duket se është përzgjedhje imja, ose fat imi, që edhe unë ta bëj dhe ta përfundoj jetën mu si këta.

Regjistër i pjesëtarëve të UÇK nga fshati Vraniq

1. Adem (Ahmet) Kolgeci;
2. Adem (Brahim) Kolgeci- veteran, Komandant i Togës së I- rë në Vraniq;
3. Afrim (Ramadan) Matoshi;

4. Afrim (Rrahman) Basha- veteran, Komandant i Njësisë së Shpejtë pranë SHP të UÇK, invalid i luftës;
5. Agim (Musli) Kolgeci- komandant skuadre;
6. Agron (Osman) Basha- veteran, invalid i luftës;
7. Ali (Fazli) Kolgeci;
8. Ali (Haki) Kolgeci;
9. Ajet (Ahmet) Kolgeci;
10. Astrit (Mustafë) Kolgeci;
11. Azem (Miftar) Kolgeci-veteran, komandant skuadre, polic ushtarak në ruajtjen e rendit, invalid i luftës;
12. Bajrush (Fazli) Kolgeci;
13. Bashkim (Ramush) Matoshi-veteran;
14. Bashkim (Shaban) Luzha- veteran, polic ushtarak në sigurimin e personelit;
15. Beqir (Izlam) Kolgeci- komandant skuadre;
16. Bekim (Haxhi) Kolgeci;
17. Besim (Sherif) Muqa- invalid i luftës;
18. Bexhet (Nebih) Kolgeci;
19. Blerim (Haxhi) Rraqi- veteran;
20. Blerim (Shefki) Kolgeci;
21. Bislim (Rrustem) Muqa-veteran, komandant skuadre;
22. Brahim (Hysen) Muqa;
23. Bujar (Rrahman) Basha;
24. Burim (Rrahman) Basha;
25. Burim (Hetem) Kolgeci- teknik i mjekësisë;
26. Brahim (Ahmet) Basha- veteran, komandant skuadre;
27. Destan (Ramadan) Llugaxhiu- veteran;

28. Elez (Isuf) Kolgeci;
29. Enver (Ibrahim) Basha- veteran, polic ushtarak në ruajtjen e rendit, vëzhgues në Kompaninë III në Maqitevë, invalid i luftës;
30. Erzen (Adem) Muqa;
31. Florim (Osman) Basha- veteran, invalid i luftës;
32. Haki (Hazir) Llugaxhiu;
33. Haki (Kadri) Muqa- veteran, civil i vrarë;
34. Halit (Sylë) Kolgeci;
35. Halit (Zenel) Kolgeci- veteran;
36. Hamdi (Osman) Basha- veteran;
37. Haxhi (Hysen) Kolgeci;
38. Haxhi (Muharrem) Muqa;
39. Hazir (Sali) Kolgeci- veteran, invalid i luftës;
40. Hetem (Hajrush) Kolgeci- kuzhinier;
41. Imer (Halil) Luzha;
42. Imer (Sherif) Shehu- veteran, komandant skuadre;
43. Jonuz (Isuf) Kolgeci;
44. Jonuz (Osman) Kolgeci;
45. Labinot (Muharrem) Llugaxhiu- vëzhgues;
46. Liman (Maxhun) Rraqi;
47. Lulzim (Vesel) Llugaxhiu;
48. Mahmut (Sadik) Muqa;
49. Mehmet (Muharrem) Basha- veteran, vëzhgues në Kompaninë III në Maqitevë;
50. Milazim (Ferat) Llugaxhiu;
51. Milazim (Jemin) Muqa;
52. Muhamet (Imer) Shehu;
53. Muhamet (Murtez) Kolgeci;
54. Muhamet (Shefket) Basha;

55. Mujë (Xhemajl) Llugaxhiu- veteran;
56. Musë (Tahir) Loshi- komandant skuadre, invalid i luftës;
57. Musli (Hasan) Muqa- invalid i luftës;
58. Musli (Muhamet) Llugaxhiu;
59. Naim (Selim) Basha- veteran, korrier i komandantit të togës;
60. Nevzat (Jonuz) Shehu- veteran;
61. Nuhi (Selim) Loshi;
62. Nysret (Osman) Shehu;
63. Osman (Ismail) Muqa;
64. Qerim (Osman) Kolgeci- veteran;
65. Ragip (Sali) Kolgeci- veteran;
66. Ramadan (Miftar) Kolgeci;
67. Refki (Vesel) Kolgeci;
68. Reshat (Mejdi) Muqa- veteran, zv. komandant i komandant Skender Basha në njësitin në Vraniq, Komandant i Kompanisë Vëzhguese Diversante dhe për Veprime të Shpejta në Batalionin II në Budakovë, zv. komandant i komandant Enver Cikaqi në Njësinë Policore të Brigadës 123, dëshmorë i kombit;
69. Regjë (Hajrullah) Kolgeci- veteran;
70. Ruzhdi (Veli) Muqa- veteran;
71. Rrahman (Ismail) Muqa- veteran;
72. Sadri (Ramadan) Muqa- komandant skuadre;
73. Safet (Nazif) Muqa- veteran;
74. Sahit (Jakup) Llugaxhiu;
75. Sali (Adem) Llugaxhiu- veteran;
76. Sali (Gani) Matoshi;

77. Sali (Hazir) Kolgeci;
78. Sali (Jakup) Basha- veteran;
79. Sami (Zenel) Muqa;
80. Sinan (Qerim) Llugaxhiu- veteran;
81. Skender (Halit) Loshi;
82. Sedat (Nazif) Muqa;
83. Sedat (Xhemajl) Muqa- veteran;
84. Sejdi (Mehmet) Oruqi- për shkaqe shëndetësore e me lejen tonë, në kërkim të shërimit- le radhët.
85. Skender (Hajrush) Kolgeci- veteran;
86. Skender (Ibrahim) Basha- veteran, komandant i Njësitit të parë të UÇK- së ("Çeliku 50") në Vraniq dhe në pjesën Jug- lindore të Komunës së Suharekës; zv. komandant i Kompanisë III që vepronte në Bukosh, Vraniq dhe në Buzhalë; Ndihmës- komandant për Moral, për Politikë, për Marrëdhënie me civil dhe subjekte të tjerë, si dhe për Informim të ushtarëve dhe të popullatës i Komandantit të Batalionit II Fehmi Berisha (dhe Komandantit Bekim Arifi) në Budakovë;
87. Sokol (Mehmet) Llugaxhiu;
88. Shaban (Murtez) Kolgeci- veteran;
89. Sherif (Imer) Shehu- veteran, i vrarë;
90. Shpejtim (Isë) Basha- veteran, zv. komandant i Togës II në Vraniq, komandant i Togës II në Vraniq;
91. Shpejtim (Osman) Basha;
92. Shefket (Eqerem) Kolgeci;
93. Xhavit (Azem) Loshi;
94. Xhemë (Mehmet) Rraqi- kuzhinier;

95. Xhemë (Veli) Muqa;
96. Xhevat (Tahir) Rraqi;
97. Xhevdet (Bafti) Basha;
98. Zaim (Ismail) Muqa- veteran, i plagosur, Komandant i Togës II në Vraniq, dëshmorë i kombit;
99. Zekri (Sinan) Basha;
100. Zenel (Hajrush) Kolgeci- komandant skuadre;
101. Zymer (Adem) Llugaxhiu- veteran, furnizues i njësisë së Komandant "Guri', teknik i mjekësisë;

Regjistër i rojave (nën armë) të fshatit Vraniq (nga korriku e deri më 27.09.1998)

1. Adem (Shaip) Kolgeci- anëtarë i SHCM;
2. Ahmet (Nazif) Muqa;
3. Arben (Azem) Muqa;
4. Arif (Sinan) Basha- rob lufte;

5. Arsim (Halit) Berisha;
6. Asllan (Hajriz) Matoshi- rob lufte;
7. Avdulla (Regjë) Berisha;
8. Avdulla (Tahir) Muqa;
9. Avni (Rrahman) Kolgeci- rob lufte;
10. Bajram (Imer) Llugaxhiu;
11. Bajram (Isuf) Rraqi;
12. Bajram (Halil) Luzha;
13. Baki (Arif) Llugaxhiu- ushtrues fizik i ushtarëve,rob lufte;
14. Baki (Hysen) Shehu;
15. Bashkim (Sherif) Rraqi;
16. Beqir (Hasan) Luzha;
17. Besnik (Avdyl) Basha- përgjegjës i rojave, rob lufte;
18. Dashnim (Isë) Basha;
19. Dibran (Sokol) Muqa;
20. Emrush (Musli) Matoshi- rob lufte;
21. Emrush (Sadik) Muqa- rob lufte;
22. Enver (Baki) Shehu;
23. Fadil (Sahit) Llugaxhiu;
24. Fadil (Vesel) Kolgeci;
25. Fatmir (Izlam) Muqa;
26. Faton (Avdulla) Kolgeci;
27. Feriz (Imer) Llugaxhiu;
28. Gazmend (Azem) Muqa;
29. Hajrulla (Musli) Matoshi- rob lufte;
30. Halil (Sinan) Basha;
31. Hamza (Hamez) Kolgeci;
32. Hasan (Fazli) Kolgeci;
33. Hasan (Ramadan) Kolgeci;

34. Haxhi (Halit) Basha;
35. Haxhi (Selim) Llugaxhiu;
36. Ibrahim (Islam) Rraqi- antarë i SHCM;
37. Ilir (Halil) Luzha- teknik medicinal, rob lufte, i vrarë në burgun e Dubravës;
38. Ilir (Imer) Kolgeci);
39. Ilmi (Dalip) Kolgeci;
40. Imri (Zenel) Kolgeci;
41. Ismajl (Ramadan) Shehu;
42. Jemin (Sherif) Kolgeci;
43. Liman (Azem) Kolgeci;
44. Milazim (Bajram) Kolgeci- mbikëqyrës i rojave, rob lufte;
45. Muhamet (Isuf) Llugaxhiu;
46. Muharrem (Azem) Basha;
47. Muharrem (Qazim) Kolgeci;
48. Mursel (Vesel) Kolgeci;
49. Mustafë (Smajl) Kolgeci;
50. Nezir (Rrustem) Loshi- rob lufte;
51. Nysret (Murat) Kolgeci;
52. Ramë (Hasan) Kolgeci;
53. Ramiz (Hazir) Loshi- rob lufte;
54. Ramiz (Sokol) Kolgeci- ushtrues fizik i ushtarëve;
55. Ramush (Adem) Matoshi- zv. Kom. i SHCM;
56. Ragip (Halil) Muqa- anëtarë i SHCM, civil i vrarë;
57. Remzi (Ali) Loshi- anëtarë i SHCM;
58. Rexhep (Hasan) Luzha- rob lufte;
59. Rexhep (Zeqir) Kolgeci;
60. Rexhep (Regjë) Matoshi- anëtarë i SHCM;
61. Rifat (Durak) Kolgeci- i vrarë;

62. Ruzhdi (Halil) Shehu;
63. Rrahman (Beqir) Shehu- Komandant i SHCM;
64. Sadik (Brahim) Kolgeci- polic ushtarak në ruajtjen e rendit, rob lufte;
65. Sahit (Qazim) Kolgeci;
66. Sali (Azem) Loshi- rob lufte;
67. Sejdi (Miftar) Muqa- anetare i SHCM;
68. Selim (Imer) Shehu;
69. Skender (Azem) Rraqi;
70. Sokol (Hysen) Kolgeci- anëtarë i SHCM;
71. Sylë (Hasan) Basha;
72. Sylejman (Izet) Kolgeci;
73. Shaban (Hasan) Llugaxhiu;
74. Shefket (Nazim) Muqa;
75. Shefki (Hamëz) Kolgeci- anetare i SHCM;
76. Shukri (Kamer) Kolgeci;
77. Xhavit (Sali) Kolgeci- rob lufte;
78. Xhemajl (Ahmet) Kolgeci;
79. Zeqir (Shefki) Berisha.

* * *

DITAR I LUFTËS

01.01.1999

Bashkë me komandantin dhe me zv. komandantin isha në Komp. E Kom. Gurit. Ishim për të uruar festën e Vitit të Ri ndërkaq unë shfrytëzova rastin të njoftoj kom.Gurin me rrjedhat pozitive në bat. tonë me hapin e shpejt me të cilin jemi duke ecur dhe me rezultatet që jemi duke arritur në vënien e gjërave në binarë dhe këmbë të shëndosha; duke e

lut kom. Gurin të na rrijë afër dhe të kemi bashkëpunim të ngushtë. Krejt kjo për t'ia ruajt moralin dhe për ta siguruar se përpiqemi dhe do të arrijmë të jemi në nivel të detyrave. U mirëprita, ishim të qartë dhe u ndamë si miq me zotime nga të dy anët se bashkë do të jemi deri në fitore.

02.01.1999
Mbrëmë me lejen e kom. të bat. kam shkuar në Vraniq. Me detyrë të sjellë listën e njerëzve në Vraniq që posedojnë armë. Listën e kamë sjellë në komandë. Në Vraniq jam takuar me ushtarë tanë dhe me një numër njerëzish që posedojnë armë. Ju kamë thënë se është qëndrim i komandës pran bat. që këta individ ose të vijnë në radhët e UÇK ose të dorëzojnë armët komandës së bat. Nëse nuk i përgjigjen kësaj ftese do të kenë punë PU me ta. Ata që i kanë humbë armët të lëshojnë deklaratë dhe ta sjellin në komandë. Kam biseduar me Z. Llugaxhiun dhe e kam caktuar të jetë njeriu i cili do të na bëj furnizimin nga Vraniqi dhe e kam vu në kontakt me përgjegjësin për logjistikë pran bat. tonë. Zymerin e kam vu në kontakt me Xh. Sadikajn nga fshati Sopi dhe R. Vatajn nga fshati Sallagrazhdë gjithashtu furnizues tanë të rregullt.
Kamë biseduar me njerëz të caktuar dhe jam marrë vesh me ta të jenë civil në shërbim të UÇK si vëzhgues. Të grumbullojnë dhe të shënojnë me saktësi çdo lëvizje të forcave të armikut nëpër fshatin Vraniq dhe ti bartin ato informata deri te vëzhguesi ynë në Buzhalë.
Kamë caktuar ushtarë tanë dhe ju kamë lënë detyrë konkrete të bisedojnë me ushtarë tanë në Vraniq. Ti thërrasin ata t'iu bashkohen radhëve dhe ti njoftojnë

bashkëfshatarët e mi të veprojnë sipas qëndrimit të komandës së këtij bat. sa i përket armatimit që e posedojnë. Kamë porosit të krijohet rrjeti i vëzhguesve civil në fshat.

03.01.1999
Isha në njësitin special. Shoqërohesha nga profesori Selim i cili gjithashtu ishte në detyrë të caktuar si dhe nga S. Emërllahu në shoqërim të profesorit. Biseduam shtruar-gjer e gjatë rreth kushteve në të cilat janë duke vepruar si dhe për problemet që paraqiten gjatë punës dhe në jetën tonë ushtarake. Konkretisht biseduam rreth të shtënave me armë zjarri nga një pjesë e njësitit të tyre në fshatin Vraniq natën e Vitit të Ri. Si dhe për një moment incidental mes ushtarëve të njësitit special dhe rojave tona. Fjala është për një mos ndalje dhe mos respekt rojave tona. U sqaruam për shumë çka duke iu falënderua mirëkuptimit që hasëm te zv. kom. Xhafa dhe te ushtarët e tyre. U morëm vesh të jemi më pranë njëri tjetrit dhe të jemi në kontakt të përhershëm.

04.01.1999
Në lokalet e komandës u takova me kryetarin e nëndegës së LDK për fshatin Budakovë zotin Eqerem Buzhala. Biseduam me të për aktivitetin e tyre politik, për nivelin e moralit në masa, për gjendjen humanitare pas luftërave të fundit në këtë anë si dhe për lidhjet ushtri- popull. U pajtuam plotësisht që këto lidhje të jenë të forta, të jemi afër njëri tjetrit dhe të ekzistoj bashkëpunim i ngushtë dhe i frytshëm.

U takova dhe e përgatita moralisht për takimin e parë me shokët vullnetarin tanimë ushtarin Driton S. Matoshi. Si dhe bisedova me ushtarët: Zaim Muqa, Kujtim Braha dhe Shpejtim Basha. Bëra një raport të punës sime të gjertanishme për kom. e batalionit dhe përshkrova në hollësi gjendjen morale dhe politike në mesin e ushtarëve në radhët tona.

05.01.1999
Me porosinë e shokëve në komandë u takova me ushtarët Azem Kolgeci dhe Bislim Muqa. Me ta bisedova për rrjedhën e grumbullimit të armatimit në Vraniq si dhe për moralin te masat e te ushtarët tanë në këtë fshat. Në ndihmesë logjistikës i porosita të na sjellin batanije dhe atë sipas porosisë sime menjëherë që sot. U zotuan që brenda dy ose tri orësh do të na sjellin batanijet në sasinë që i mbulon nevojat tona.
Pasdite bashkë me Agimin dhe Sevdiun e kemi shoqëruar kom. Bekimin në vëzhgim të terrenit me qëllim njohje dhe orientimi. Ia kemi thënë kom. Bekimit të gjithë emrat e lagjeve të fshatit Budakovë si dhe të gjithë emrat e fshatrave me rëndësi për orientim dhe veprim të suksesshëm duke i treguar edhe pozitat e tyre gjeografike e gjeostrategjike si dhe e kemi njoftuar me specifikat e tyre duke e njoftuar kështu në hollësi me të gjitha rrugët që nga këto fshatra qojnë në Budakovë dhe në Suharekë si qendër më e madhe banimi dhe vend kryesorë përqendrimi forcash të armikut.

E kemi njoftuar gjithashtu kom. Bekimin me të gjitha vend përqendrimet e forcave të armikut si dhe vendet prej nga armiku mund të vëzhgoj forcat tona.
Diku pa rënë muzgu i jemi ofruar pozicioneve tona të mëparshme (pikës një dhe dy) dhe kemi vëzhguar për së afërmi rrugën e asfaltuar që qon në Muhlan.
Jemi takuar me një fshatarë nga Krushica e Poshtme. Kemi kuptuar nga biseda me të se është vëzhgues i përhershëm dhe se për çdo lëvizje të forcave armike është i gatshëm të njoftojë njësitet tona. U kënaqa me moralin e lartë që kishte dhe me vullnetin e tij të na ndihmojë krejt çka nga ne kërkohet prej tij.

06.01.1999
Bashkë me shokët e komandës në përbërje të plotë kemi pritur dhe jemi takuar në komandë me kom. e zonës zotriun kom. Drini si dhe me kom. e brigadës sonë 123 zotin N. Kastrati.
Ju kam raportuar në hollësi për punën time si S-5 pran kësaj komande, për moralin në mesin e ushtarëve tanë si dhe për gjendjen morale dhe politike në mesin në të cilin veprojmë.
Në mbrëmjen e po kësaj dite saktësisht në ora 18.00 kemi shkuar në takimin që unë kam realizuar në Vraniq me 15 njerëzit më autoritativ të këtij fshati: unë, zv. kom. i batalionit Fehmi Berisha dhe shokët Agim Zyba e Shaban Gashi. Takimi ishte i realizuar mirë dhe i suksesshëm. Qëllimi ishte të forcohen lidhjet me masat dhe të njoftohen me qëndrimin e kësaj komande sa i përket armatimit që e posedojnë këta fshatarë.

07.01.1999
Sot jam kujdestarë. Ndihmës në kujdestari e kam Haqif Kadriajn kom. togu. Kujdestarinë e kam pranuar në gjendje të rregullt. Çdo gjë zhvillohet sipas planit ditorë. Ushtarët bashkë me kom. e tyre janë në kryerjen e detyrave të tyre të rregullta. Morali dhe disiplina e serioziteti në punë te ushtarët dhe kom. e tyre bëjnë të te rritet zemra.
Gjatë kohës së kujdestarisë ngaqë çdo gjë ishte në rregull dhe shkonte si është më së miri gjeta kohë të bisedoj me ushtarët:
*Zaim Beqa rreth dëshirës së tij të kthehet në batalion nga komp. E kom. Gurit.
*Bislim S. Gashi i cili ishte paksa i thyer ngase i është ndërruar arma nga kom. Aqifi me një armë më të vjetër si dhe me ushtarin e ri
*Bekim Gjemajli Ukaj lindur më 18.03.1982 në fshatin Korishë ku edhe banon. Nga prindët ka nënën kurse babai i ka vdekë shumë vite më parë. Deklaron se nënën e ka njoftuar një javë më parë kurse ditën që është paraqitë fillimisht në komandë thotë se nëna e ka pa por nuk është përshëndetë me te. Në deklarimin e tij të mëtejmë thotë se në UÇK e ka quar dëshira e tij e madhe dhe vullneti që t'ju bashkohet shokëve të cilët kanë rrokë armët për të luftuar pushtuesit. Thotë se nuk ka qenë i shtyrë nga askush pos që i ka pas lakmi vëllait më të madh se ky Naimit i cili ishte i angazhuar në njësitin e Korishit. Thotë se mbanë armë personale automatik me grykë të gjatë dhe shton se është armë pronë e familjes së tij. Thotë se është i

vetëdijshëm se baci i madh ndoshta do ta qortoj për këtë por siç thotë: Pisket, pisket e shef qe është e kotë dhe kthehet në shtëpi.

08.01.1999
Saktësisht në 10.30 në Biraq filluan luftime. Gjatë tërë ditës edhe gjatë natës ishim në gjendje gatishmërie të plotë. Pasdite isha në shoqërim të zv. kom. të batalionit në vëzhgim. Kontrolluam të gjitha vendrojat. Rojat ishin në nivelin e kërkuar të sy- qeltësisë.
Ishim gjithashtu te TVD pamë nivel të duhur gatishmërie. Në komandë ishin shokët nga SHP i UÇK do të dëshiroja të takohesha me ta por koha për veprim në gjendje mobile ishte shumë e shtrenjtë.
Vullnetarisht isha kujdestarë në lokalet e komandës. Konsideroja se isha më pak i rëndësishëm nga gjithë shokët tjerë edhe nëse ndjehesha i pa gjumë dhe i lodhur të nesërmen- ditën kur ndoshta do të zhvillonim luftime. Prita një mëngjes të qetë, çdo gjë është në pritje.

09.01.1999
Bashkë me kom. e batalionit ishim në vizitë njohjeje njësitit special. U takuam me kom. ABI dhe shokët e tij ushtarë. Biseda ishte konstruktive, shumë miqësore dhe me qëllim ofrimi për bashkëpunim.
Pas mbrëmjes me urdhër të komandantit shkova në fshatin Vraniq. Kisha për detyrë të kuptoj se ç'far po bëhet dhe deri ku është shkuarën punën me ushtarë tanë atje sa i përket radhitjes së tyre në radhët tona si dhe futjes së armatimit që e kemi atje në sistem.

10.01.1999

Në lokalet e komandës jam takuar me kryetarin dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së LDK të nëndegës së fshatit Grejkoc. Kemi biseduar dhe jemi marrë vesh për futjen e armatimit që posedojnë si fshat në sistem si dhe për bashkëpunim dhe qëndrim pranë njëri- tjetrit ushtria dhe populli.

Më pas jam takuar me Xhafën zv. kom i njësitit special njësit vëlla këtu pran nesh. Thjeshtë për koordinim punësh. Bisedova gjithashtu me Ruzhdi V. Muqën dhe Sadri R. Muqën rreth angazhimit të tyre në ushtrinë tonë ose të ofrojnë armët komandës së këtij batalioni. Janë të mendimit të formohet një tog në Vraniq dhe të jenë në shërbim aty pran familjeve të tyre.

Pas mbrëmjes kisha një takim me komandantin e togut në Vraniq zotriun Adem B. Kolgeci e elaboruam gjerë e gjatë punën që është bërë në teren, bisedat qe janë zhvilluar me ushtarë tanë atje si dhe me njoftimin e tyre me qëndrimin e komandës së batalionit tonë sa i përket këtij togu dhe armatimit që e posedojnë këta ushtarë. Mu tha nga kom. Ademi se mendim i të gjithëve është të jenë ushtarë në Vraniq dhe të qëndrojnë në mbrojtje të këtij fshati.

Pas mbrëmjes isha te kom. Guri për të parë nëse ka nevojë ta përforcojmë me ushtarë e armatim ngase ka lëvizje të mëdha forcash të armikut te lagjja e Lubovcëve. bashkë me Gurin e ushtarë të tij të zgjedhur ishim në Grykë Carralevë. Një aksion i suksesshëm nga prita.

11.01.1999

Me urdhër të zv. kom. të batalionit isha te kom. Guri. Më shoqëroi kom. togu Aqif Kadriaj. Ishim atje me detyrë për tu sqaruar rreth dy armëve njëra prej të cilave duhej të kalonte këndej e njëra andej si dhe të kërkojmë transferimin e një kuzhinieri në batalionin tonë. Kujtoj se kom. Guri nuk na ka dalë në takim, andaj gjeti disa arsye që të mos na e jep një kuzhinier.
Edhe çështjen e këtyre dy armëve e sqaruam dhe hasëm në mirëkuptim duke lënë kështu të dy armët në komp. e kom. Guri.
Isha në mesditë në mesin e ushtarëve tanë në togun e kom. Aqifit. Çdo gjë është në rregull përpos ushtarit Jeton Bajraktari, i cili i përton punëve dhe detyrave që i parashtrohen si dhe mungesave që i bën duke qëndruar më gjatë se sa i lejohet në familje. Bisedova me Kom. Aqifin dhe ushtarin Jeton Bajraktari për këtë problem. E porosita kom. Aqifin ti mundësohet transferim në mesin që e dëshiron Jetoni brenda bat. tonë dhe të provohet kështu një herë me te. Për çdo shprehje të pakënaqësisë ose për çfarëdo sjellje tjetër që si përkasin pjesëtarit të UÇK e që e bën ky ushtarë e njoftova atë drejtpërsëdrejti se do të pasoj transferim i tij për shërbim në viset më të largëta nga këtu.
Pasdite jam takuar me ushtarët tanë në Vraniq: E. Basha, Azem Kolgeci dhe Bislim Muqa. Më sjellën të dhëna që më bënë të kuptoj në saktësi dhe hollësi gjendjen në Vraniq sa i përket njerëzve tanë atje që posedojnë armë.
Për të gjitha këto i kam raportuar me kohë zv. kom. të batalionit.
Në mbrëmje vonë e kam biseduar me anëtarë të kësaj komande çështjen e zgjidhjes së mënyrës së furnizimit më

të mirë e më të drejtë të bat. tonë dhe komp. Së kom. Gurit. Duke i lutë shokët të jemi shumë të kujdesshëm në gjetjen e zgjidhjes më të mirë të mundshme në mënyrë që të mos dalin keqkuptime e keqinterpretime ose edhe ndonjë mosmarrëveshje sado e vogël me komp. e kom. Gurit në këtë plan. Ua shpjegova shokëve frikën e kom. Gurit se mos ne do t'ia ndalim furnizimet nga tereni i ynë. Shokët më than të gjithë se kjo frikë e kom. Gurit është e pa arsyeshme.

12.01.1999

U takuam me kom. e bat. veçmas. I raportova në hollësi për punën time gjatë ditëve të fundit dhe mora nga ai detyra konkrete dhe sugjerime se si duhet të veproj më tej.
Ishte plotësisht i kënaqur me atë që është bërë deri më tani.
Në mesditë jam takuar në lokalet e komandës me bashkëfshatarin Muhamet K. Kolgeci. Më njoftoi se armën e ka fshehur gjatë ofensivës dhe se nuk e ka gjetur më. Më tha se njeh gjurmë që qojnë deri te arma e tij. E sigurova se do ta ndihmoj në gjetjen e armës. Në pa mundësi të na bashkohet u mbarëm vesh të bëjmë përpjekje të gjejmë armën dhe ajo ti dorëzohet komandës së këtij batalioni.
Në mbrëmje në komandë erdhi kom. i kompanisë së tretë Halil Krasniqi me të bisedova për gjendjen në planin moral në këtë kompani.

13.01.1999

Bashkë me kom. e batalionit ishim në vëzhgim të pozicioneve tona në afërsi të fshatit Bukosh. Ishim gjithashtu edhe në mesin e ushtarëve atje. Na e thanë se

çdo gjë është në rregull me një kërkesë të vetme të punohet në aftësimin taktik e fizik të tyre.
Në fund, kom. të togut z. Nebih Zyba ia lash porosinë të më realizoi një takim me kryetarin, kryesinë dhe njerëzit më autoritativ të fshatit dhe që ai takim të jetë më 15.01.1999 në mesditë ngase po këtë ditë do të takohesha me strukturat e njëjta të fshatit Savrovë.
Pasdite me lejen e kom. të batalionit kamë shkuar në vizitë familjes sime si dhe të njihem me rrjedhat e organizimit të togut të Vraniqit. Në mbrëmje kam mbajte takim me Llugagjinjtë në odën e ushtarit Bislim Muqa.

14.01.1999
Në mëngjes jam kthyer në komandë. Me vete bashkë me ushtarët Azem Kolgeci, Enver Basha e Bislim Muqa kemi sjellë pajisje për kuzhinë, gota, lugë e gjygyma qaji si dhe ushqime për TVD. Gjatë ditës isha në komandë, kurse në mbrëmje bashkë me kom. Bekimin, prof. Selimin e dy shokë tjerë kemi shkuar në kompaninë e tretë në Maqitevë. Atje kemi mbërri diku rreth orës 23.00. Pashë seriozitet në punë dhe rregull e disiplinë të nivelit të duhur. Përgjegjësit në Maqitevë ia lash porosinë të bëj regjistrin e obliguesve ushtarak prej 18- 55 vjet si dhe regjistrin e teknikës dhe kafshëve tërheqëse për mobilizim. I thash gjithashtu se regjistrat duhet të sillen në komandë sa më parë që ishte e mundshme.

15.01.1999
Në mëngjes mbajta një takim me ushtarët e kompanisë së tretë. Më është përsëritë kërkesa për kuadro që përgatisin

këta ushtarë faktikisht. Vërejtje: as ankesa e kërkesa tjera nuk kanë. Në mesditë saktësisht ora 12.00 isha në Bukosh në odën e Taip Zybës. Aty u takova me kryetarin, me kryesinë dhe me njerëz autoritativ të këtij fshati. Njerëzit me të cilët u takova shprehen se e duan dhe e përkrahin UÇK. Janë të mendimit të bëhet mobilizim i përgjithshëm kurse unë i njoftova se është duke u punuar në atë plan dhe kërkova të bëhen regjistrat për mobilizim. Habiten përse komanda e bat. të II-të ende nuk mori masa ndaj atyre që organizuan ose dorëzuan armë.

16.01.1999
Jemi në gjendje gatishmërie të plotë. Pa ndërpre këshillohemi se si të veprojmë, në rast luftimesh të mundshme. Ndahemi në grupe dhe vizitojmë pozicionet dhe ushtarët tanë. Isha në Vraniq, në Bukosh dhe në krushicë. Kam vizituar ushtarët në pozicione një për një. Morali në nivel duket në çdo hap dhe te çdo ushtarë.

17.01.1999
Jam në kujdestari. E zëvendësova z. Xhemajli Kastrati ngase ishte shumë i lodhur nga pagjumësia. Dërguam ushtarë për të përforcuar shokët te "Guri" në Rancë e Reqak. Jemi në gjendje gatishmërie të plotë. Shokët na u kthyen mirë nga beteja.

18.01.1999
Jemi në gjendje gatishmërie të plotë. Sërish dërguam shokë për të përforcuar shokët që bëjnë luftë në Griqec, në Rancë e Reqak. Shokët na janë kthyer mirë. U takova me

z. S. Halitjaha këshilluam për formë veprimi dhe për punë të mëtejme. Së bashku vizituam ambulantën. Kemi mungesë teknikësh medicinal. Në mbrëmje vonë vizitova ushtarët tanë në Vraniq. Ishin mirë dhe në nivel gatishmërie të plotë. Nuk munda të ndalem në bisedë me ta ngase më duhej mua dhe shokëve të jemi së bashku.

19.01.1999
Zhvillohen luftime në Grejqec. Jemi në gjendje gatishmërie. Përgatitemi të dërgojmë ushtarë për të përforcuar shokët atje. Në mbrëmje shoqërova kom. e bat. në takimin me kryetarët e nëndegëve të LDK të caktuar në fshatin Bukosh ora 20.00. Të pranishëm ishin: kryetari i fshatit Gjinovc i shoqëruar nga dy shokë dhe kryetari i fshatit Savrovë.

20.01.1999
Gjatë tërë ditës ishim në gjendje gatishmërie të plotë. Me të tëra pajisjet në trup gjatë tërë ditës kam pritë numër të madh ushtarësh të rinj të cilët i kam përgatitë për takimin e parë me shokët ushtarë. Pas mbrëmjes isha në Vraniq të shoh gjendjen dhe nivelin e organizimit të shokëve tanë atje.
Rreth orës 24.00 kam dalë në kontroll rojës. Në Llugagji ishin krejt në rregull. Rojat tjera në fshat ishin të gjithë në gjumë. E kam zgjuar kom. e togut atje z. Adem Kolgeci e kemi vërtetuar gjendjen dhe i kam thënë se nuk bën kështu. Në shenjë revolte në ushtarët e tij më është arsyetuar përse nuk mundet të veproj përveçse në fshatin e tij dhe ma ka dorëzuar armën.

Armën e tij bashkë me municionet i kam sjellë në komandë mëngjesin e ditës së ardhme, kurse kom. Adem i kam lënë urdhëresën me gojë që nesër të paraqitet në raport në lokalet e komandës.

2101.1999
Në lokalet e komandës kam pritë dhe jam takuar me shumë ushtarë të rinj. Në mesditë; bashkë me zv. kom. e batalionit kemi biseduar gjerësisht me z. Adem Kolgeci dhe dy ushtarë të tij. E kemi sugjeruar deri në fund. E kemi bërë me dije se të gjithë njerëzit nën armë të fshatit Vraniq duhet të vijnë në komandën e këtij batalioni të mbahen në evidencën e ushtarëve të këtij batalioni dhe të vendosen e veprojnë sipas urdhrave të kësaj komande. Na është bërë i ditur mendimi i këtyre njerëzve se dëshirojnë të jenë në vëzhgim dhe vetëm në fshatin e tyre.
Jemi marrë vesh në mbrëmje të mbahet takim me këta njerëz në fshatin Vraniq. Takimi ishte realizuar. Në takim isha unë S-5. I kam njoftuar në hollësi me qëndrimin e komandës së bat. tonë. Kam pa te ata njerëz jo gatishmëri dhe jo seriozitet. I kam njoftuar se janë bërë rast me të cilin duhet të merret PU. Të gjitha i kanë të qarta.
Rreth orës 23.00 jam kthyer në komandë.

22.01.1999
Isha në Sallagrazhdë. U takova me kryetarin dhe një numër shokësh të kryesisë së LDK të këtij fshati. Nuk janë të gatshëm të marrin obligime dhe nuk kanë guxim të na kontaktojnë e të na rrinë afër si ushtri e tyre. Duan të ndihmojnë ushtrinë por janë në hall si ta bëjnë këtë pa u

diktuar nga askush. Krejt kjo nga frika e tepruar. Në Sallagrazhdë njerëzit nuk bëjnë gjumë të qetë, kanë shqetësim të veçantë sidomos pas vrasjes që ka ndodhë atje. Në çdo familje bëhet roje vëzhgimi ngase nuk mund të organizojnë roje të rregullt në nivel fshati. Janë shumë të ndarë e të përçarë. Kanë plot mosmarrëveshje dhe akuza të ndërsjella lagjja ndaj lagjes, ata të përkatësisë fetare myslimane ndaj atyre katolike dhe anasjelltas. Kryesia aty i ka humbë lidhjet me një pjesë të popullatës dhe nuk është autoritative dhe me ndikim.

23.01.1999
Jam në lokalet e kom. Me kërkesën e kom. të bat. i bëra atij raport me shkrim për punën time treditore për datën 20, 21, dhe 22.01.1999. U takova në lokale të komandës me z. H. Behlulin. U kuptuam tërësisht dhe u obliguam të bëjmë një lidhje të fortë dhe të rrimë pran njëri tjetrit ushtria dhe populli duke e ndihmuar dhe përkrahë njëri tjetrin ashtu siç duhet dhe e kërkojnë momentet. Ishte në nivel, duket se është i gatshëm të kryej të gjitha detyrat që shtron komanda dhe rrethanat.

24.01.1999
Në lokale të komandës bashkë me kom. e batalionit u takuam me kom. e togut në Vraniq z. Adem Kolgeci.
Ai paraqiti gjendjen atje shumë realisht. Njerëzit tanë nën armë nga ky fshat nuk janë të gatshëm të lëshojnë fshatin siç thonë, andaj nuk mund të vinë të bëhen ushtarë në komandën tonë në Budakovë.

Është mendim i këtyre njerëzve siç thotë Adem Kolgeci se është e rrezikshme të lehet fshati pa njerëz nën armë.
Kom. Ademi thotë se ka 25 ushtarë në togun e tij. Prej tyre 13 në skuadrën e Llugaxhive e 15 në atë në fshat.

25.01.1999
Saktësisht në orën 10.00 në lokale të komandës jemi takuar me z. Bajram Kolgeci kryetarë i kryesisë së nëndegës së LDK të fshatit Vraniq.
U bisedua gjatë për detyra e probleme të ndryshme.
Ju dha detyrë të bëj listat e mobilizimit të obliguesve ushtarak si dhe listat e mjeteve të transportit dhe të kafshëve tërheqëse atje.
Në takim konsultativ ishin edhe kom. i bat. dhe S-1. Në mbrëmje saktësisht ishim në takimin me kryetarin e LDK të fshatit Vraniq e ku ishin të pranishëm edhe kryesia e këtij fshati si dhe ushtarët tanë në këtë fshat. Takimi filloi në kohën e caktuar më parë. Të pranishëm janë 35 vetë. Është në takim edhe kom. i togut z. Adem Kolgeci. Nga ana a komandës përfaqësohemi nga kom. i batalionit dhe S-5.

26.01.1999
Gjatë tërë ditës isha në lokale të komandës. Kam përgatit për takimin e parë me shokët ushtarë disa vullnetarë që sot iu bashkuan radhëve tona si dhe 8 ushtarë tanë të cilët janë nga Reqani e që me vonesë janë kthyer në radhët tona. Kam mbajt takim me kryetarin e fshatit Dragaqinë z. Shefket Trolli. Kam përgatitë referimin për takimin në mbrëmje me shokët e komandës. Në referim shokëve të

komandës iu kam bërë me dije takimet me: 1. kryetarin dhe kryesin e Sallagrazhdës, 2. me kryetarin dhe kryesinë e Vraniqit e ku ishin të pranishëm edhe individët që posedojnë armë, 3. takimin me kryetarin e Fshatit Dragaqinë, punën time me ushtarët e sapo rreshtuar si dhe e kam paraqitur gjendjen tepër të rënduar në fshatin Sallagrazhdë e cila është përkeqësuar edhe më tej pas vrasjes që ka ndodhë në këtë fshat.

27.01.1999
Deri në mesditë isha në lokale të komandës. Këtu u takova me vullnetarë të rinj të cilët çdo ditë e më shumë po na i shtojnë radhët. Pas mesit të ditës isha në mesin e ushtarëve të komp. së II-të ku mbajta një takim trierësh me ta. Janë në nivel që dëshirohet. Më pyesin për uniformat që u janë premtuar. Me muzg nisem për nën- xhade siç themi ne. Shkoj atje për të marrë detyra nga S-5 në nivel Brigade.

28.01.1999
Mbërrita herët në mëngjes. E dija që shokët atje ende pushojnë andaj shkova te doktori të cilin e njoh prej vitesh. Isha në kujdestari pranë komandës së Brigadës. U takova me S-5 pran Brigadës u sqarova mirë me te dhe mora detyra e këshillime për punë të mëtejme.
Për të bërë gjumin isha te Skenderi.

29.01.1999

Me S-5 u takova sërish në lokalet e tyre të punës. Pashë shumë shokë me të cilët kam vepruar më parë. U ktheva sërish në kom. e Brigadës. Shokët ishin tepër të zënë me detyra dhe kishin shqetësim të veçantë për ato që ato ditë ndodhnin në zonën kufitare. Në mbrëmje jam kthyer në komandën e Bat. tonë.

30.01.1999
Tërë ditën isha në lokale të komandës. Përgatita shkresat dhe urdhrat për strukturat udhëheqëse të fshatrave që mbulon bat. i ynë për të formuar Shtabet Civile të mbrojtjes dhe për të organizuar mbrojtjen civile në këto fshatra. Përgatita për takimin e parë me shokët ushtarë numër të vogël vullnetarësh.
Në mbrëmje shkova në shtëpi me leje të zv. kom. të batalionit.

31.01.1999
Kisha leje nga shokët e komandës të pushoj tërë ditën. Megjithatë vjela të dhëna nga ato që ndodhin në fshat dhe tubova tri armë dhe municione të cilat i solla në mbrëmje në komandë.

01.02.1999
Jam në lokale të komandës. Përgatitem teknikisht dhe bëj shkresa e urdhra për formimin e Shtabeve Civile të Mbrojtjes. Pas mbrëmjes, vonë natën ishim në vizitë të gjitha rojave të objekteve dhe vend stacionimeve të ushtarëve tanë në tërë territorin që veprojmë. Në vizitë

ishim me zv. kom. e batalionit deri në orën 1 pas mesit të natës.

02.02.1999
Jam në lokale të komandës. Tërë ditën merrem me njerëz nga Vraniqi të cilët vijnë për të ofruar armët kësaj komande ose vijnë ushtarë. Përgatis ftesat zyrtare për kryetarët e nëndegëve të LDK të fshatrave që mbulon batalioni i II-të.

03.02.1999
Jam në lokale të komandës. Tërë ditën angazhohem në kryerjen e detyrave që dalin aty për aty. Takohem me vullnetarë shokë të rinj ushtarë. I përgatis ata për takimin e parë me shokët.
Në mbrëmje shkoj në shtëpi për të pushuar.

04.02.1999
Isha në KVD
Atmosfera është shumë shoqërore. Ende asnjë situatë mosmarrëveshjeje e as konflikti mes ushtarëve. Kom. i Komp. e thotë se nuk ka ngjyrime politike. Kom. i komp. dhe zv. i kom. të komp. ankohen në furnizimin me bukë. E thonë se ai nuk është i rregullt. Ankohen gjithashtu se armët që i kanë nuk janë të përshtatshme për veprimet për të cilat përgatiten. I përmendin uniformat. Kanë mungesë drush për nxehje. Ushtari i tyre del tri herë për një natë nga dy orë në roje. Mbi të gjitha ankohen se nuk kanë kushte për pastrim. Në mbrëmje shkoj në Vraniq për tu takuar me strukturat udhëheqëse atje.

05.02.1999
Që në mëngjes, në Vraniq takohem me kryetarin e nëndegës së LDK atje. E njoftoj me detyrat që i kanë dalë strukturave udhëheqëse. E këshillova se si duhet të punohet. I lash shkresën zyrtare: ftesën për takim në lokale të komandës, urdhrin për formimin e Shtabit të Mbrojtjes Civile si dhe shkresën Njoftim për qytetarët. E obligova që në afat prej 5 ditësh të më bëj informatë me shkrim deri ku është arrit në realizimin e detyrave.
Në mesditë në lokale të komandës takohem me z. Brahim kryetar i nëndegës së LDK të fshatit Reqan. I dhash shkresat dhe detyrat. E obligova të më bëj informatë me shkrim pas 5 ditësh me të arriturat në realizimin e detyrave të parashtruara. I bëra kom. të bat. raport treditorë të punës me shkrim dhe ia dhashë atë.
Zotëriut Ilaz Kadriaj ia dërgova përmes kom. Aqifit shkresat dhe ftesën për një takim me të në lokale të komandës, për tu sqaruar rreth mënyrës së realizimit të detyrave në Dardhishë të Epërme.
Në Vraniq isha vonuar andaj edhe pse paradite ishte në komandë z. Hasan Ramadani nga fshati Sopijë; Unë nuk munda të takohesha me te.

06.02.1999
E shoqërova dhe bashkë me z. Ukë Bytyqi e Hysen Gega fillimisht ishim në komp. e kom. Shabanit, përkatësisht në komp. e dytë në togun e parë. Fillimisht i prezantova shokët dhe ia dhashë fjalën z. Ukë Bytyqi.

Në vazhdim i lutëm ushtarët që pa hezituar, shumë lirshëm të shprehen për punën e eprorëve të këtij bat. si dhe për vërejtjet që kanë në punën dhe sjelljet e tyre me ushtarë.
*Regjë Buzhala përmendë uniformat dhe ka vërejtje të shumta në njësitin motër këtu, në njësiti special në sjelljet dhe veprimet e tyre duke përmendë kështu shumë raste konflikti mes ushtarëve të këtij njësiti dhe civilëve në këtë anë. Regja përmendë faktin se ushtarëve tanë të plagosur kohë më parë nuk iu është dalë në ndihmë sa duhet dhe se nuk është treguar kujdes i duhur ndaj tyre.
*Agim Kabashi thotë se ka ushqime të mjaftueshme por e përmendë se kuzhinierët nuk janë në nivel të detyrës andaj ushqimi i zier nuk është i shijshëm dhe kualitativ.
*Reshat Halitjaha kom. i togut të III-të; Përmendë faktin se objekti ku banon ky me ushtarët e tij është në lokalitetin që vrojtohet nga të gjitha anët. Gjithashtu përmendë se sa i përket fjetjes nuk kanë hapësirë të mjaftueshme.
*Regjë Buzhala përmendë se familja e Feriz Kabashit banon në Shirokë dhe paguan 50 DM në muaj te Zeqir Buzhala kurse kushtet nuk i ka as të vetë mbahet.
*Ishim në skuadrën e policisë ushtarake. Pamë një ambient të rregulluar mirë, ushtarakisht e me shije.
Djelmoshat kanë shëndet të mirë dhe duket nga pamja e tyre se nuk ju mungon as përgatitja e duhur fizike.
*Në togun e kom. Latifit ushtarët i gjetëm duke u çlodhur përveç atyre që ishin në kryerjen e detyrave ditore të tyre. Një ambient tamam ushtarak gjetëm edhe këtu. Gjetëm edhe një atmosferë të dëshirueshme shoqërore. I prezantova shokët, ndërsa shoqëroheshim nga kom. i

kompanisë z. Shaban Gashi si dhe nga S-4 z. Haxhi Sallauka.
Z. Ukë Bytyqi iu foli gjatë shokëve ushtarë për detyrat që na presin si dhe për përpjekjet që duhet bërë të jemi në nivel të këtyre detyrave që donë realizuar.
*Ushtari Negjmedin Kololli paraqet një sërë vërejtjesh në adresë të njësitit special. Thotë se flet si ushtarë por të njëjtat gjëra do ti thoshte edhe si qytetarë i fshatit Budakovë.
Përmendë probleme që ushtarët e këtij njësiti i sjellin rojave tona si dhe për sjellje që nuk janë në moralin e ushtarëve të ushtrisë sonë me civilët këtu.
*Ushtarët tjerë që deshën të marrin fjalën të gjithë e thonë se në njësitin e tyre është çdo gjë në rregull e mbi të gjitha përmendin raportet shumë vëllazërore mes ushtarëve si dhe në mes të ushtarëve dhe kom. të tyre z. Latif.
*Në mesditë ishim në KTV. Ushtarët i gjetëm të rreshtuar në oborrin e objektit ku ata janë vendosur dhe po mbanin orë mësimi nga mënyra e përdorimit të Mortajës së dorës si dhe njohja me këtë armë dhe efektin e sajë shkatërrues për forcat armike.
E thonë se nuk kanë vërejtje në sjelljet e shokëve, komandantëve të njësiteve të tyre si dhe në eprorët e kom. së bat. të II-të.
Para mbrëmjes jemi në togun e I-rë të kom. Fadil Qitakut në lagjen e Hogjve. Na thonë se furnizimi dhe ushqimi është i mirë. Ankohen në mungesë të rrobave.

07.02.1999

Bashkë me z. Ukë Bytyqi e Hysen Gegën jemi në komp. e parë te kom. Izet Buzhala në D. të Epërme. I prezantova zotërinjtë dhe fillimisht ia dhashë fjalën z. Ukë Bytyqi.
*Kom.Izeti përmendë mungesën e veshmbathjes e si pasojë e kësaj thotë se i është rrezikuar shëndeti ushtarëve. Përmendë gjithashtu se vendi ku qëndrojnë ushtarët është ambient me lagështi dhe kërkon të bëhen përpjekje të gjendet një objekt tjetër më i përshtatshëm.
Kom. Aqifi përmendë se ju duhet një bojler për pastrim.
Pasdite ishim të ftuar zyrtarisht me ftesë nga zv. kom. i njësitit special z. Xhafer Kabashi. Ftesës iu përgjigjëm. Shkuam bashkë me kom. e bat. z. Bekim Arifi me gazetarin dhe S-2 z. Muhamet Buzhala.
Në mbrëmje në lokale të komandës jam takuar me kryetarin dhe shokë të kryesisë së fshatit Grejkoc. E kam biseduar çështjen e formimit të Shtabit Civil të Mbrojtjes dhe iu kam dhënë detyrat dhe shkresat që udhëzojnë për punë. Gjithashtu jemi marrë vesh të bëjnë evakuimin e familjes së ushtarit tonë Feriz Kabashi prej Shirokës në fshatin e tyre Grejkoc.

08.02.1999
Isha në kujdestari. Shfrytëzova ardhjen e tre zotërinjve anëtarë të kryesisë së LDK të Sallagrazhdës u këshilluam për punët që na presin.

09.02.1999
Isha në komandën e zonës së Nerodimës përkatësisht në komandën e brigadës së komandantit tani të ndjerë Ahmet Kaqiku, në brigadën 161.

Ishim nisur me dëshirë të merrnim pjesë në varrimin e 40 kufomave të te vrarëve në masakrën e Reqakut. Ishte qëndrim i komandës së Zonës të uniformuarit të mos marrin pjesë në varrim. Të hjek uniformën nuk e kisha dhe aq problem por të ndahem nga arma thjeshtë nuk desha.
Në komandën e brigadës 161 u takuam me ushtarë të kësaj brigade. Këtu e lamë telegramin e ngushëllimit për Brigadën e zonës. Të gjithë shokët e komandës së zonës dhe brigadës 161 ishin të zënë në varrimin e këtyre kufomave. Shoqërohesha nga S-1, kom. i komp. së I-rë z. Shaban Gashi dhe ushtari Enver Hoxha.

10.02.1999
Bashkë me S-1 dhe me kom. e togut të vëzhguesve jemi në fshatin Dragaqinë për të kryer detyrat tona. Biseduam me nënkryetarin e kryesisë, me anëtarë të kryesisë dhe njerëz autoritativ të këtij fshati. Të pranishëm janë edhe shumë djem të rinj të interesuar të radhiten në radhët tona. Janë të pranishëm edhe ushtarë të UÇK-së më parë- ushtarë të kom. Gurit, të cilëve për vonesën që kanë bërë në kthimin në radhët e shokëve tanë iu ishte marrë arma si dënim.
Pasditen e kësaj date ishim në Vërshec. Përbërja e komandës ajo që ishte në Dragaqinë.

11.02.1999
Jam në komandë merrem me punë që dalin. Bëra vizitë ndeje njësisë speciale. Isha për drekë atje.

12.02.1999

Në lokale të komandës bashkë me zv. kom. e bat. jemi takuar me z. Eqerem Buzhala. Është biseduar në prezencën time çështja e shatorëve. I është thënë Eqeremit se janë duke na u dashtë për nevoja të ushtrisë. Eqeremi përmendë se ata janë dedikuar për popullatën dhe nuk është i pajtimit ti jepen ushtrisë. Megjithatë thotë se do ta bisedoj me shokët e kryesisë. U bisedua gjithashtu edhe puna e një agregati. Në lokale të komandës kam biseduar me shumë njerëz nga fshati Vraniq të cilëve iu është kërkuar arma për dorëzim. Një numër i vogël syresh kanë shprehë vullnet të jenë ushtarë. I kam përgatitë për takimin e parë me shokët.
Në mbrëmje kam shkuar në shtëpi me lejen e kom. të batalionit.

13.02.1999
Jam në shtëpi. Takimet me njerëz i shfrytëzojë për të kuptuar gjendjen atje përgjithësisht. Në veçanti përpiqem të kuptoj se çfarë ka ndodhur me ushtarët e ABIT e Gurit dhe individ që kanë arme në fshatin Vraniq si dhe me ata që kanë shator e që ju janë kërkuar nga ushtarët e përmendur më lartë. Kuptova se është shkaktuar pakënaqësi e madhe dhe se kanë një dozë frike si dhe kanë vërejtje të shumta në mënyrën se si janë sjellë këta ushtarë gjatë kryerjes së aksionit e në kontakt me këta njerëz.

14.02.1999
Mbajta një takim me kryetarin e fshatit Vraniq dhe me anëtarë tjerë të kryesisë atje.
E thonë se kanë vërejtje në mënyrën se si janë sjellë ushtarët e kom. Gurit në Vraniq si dhe ata të ABIT me të

cilët siç thonë më nuk habiten se janë mësuar ti shohin dhe ju janë të njohura edhe me parë sjelljet e tyre.
Më lusin edhe më tej të jem në rrjedha të çdo gjëje që ndodhë në këtë fshat e rreth këtij fshati. Ju them shumë sinqerisht se më shumë jam ushtarë se njeri i Vraniqit, megjithatë obligohem se krejt çka është në mundësitë e mia do të bëj që njerëzit të mos shqetësohen e aq më parë nga pjesëtarë të UÇK.

15.02.1999
Jemi në takim me kryetarin, kryesinë dhe me njerëz autoritativ të fshatit Budakovë. Takimi mbahet në lokalet e shkollës fillore në lagjen e Kokollarëve.
Takimin e shpalli të hapur kryetari i nëndegës së LDK të këtij fshati z. Eqerem Buzhala. Fillimisht u kërkua nga të pranishmit dhe u mbajt një minutë heshtje për të rënët për lirinë e atdheut. Në vazhdim z. Eqerem njoftoi shkurtimisht me historikun e UÇK dhe me gjendjen në Republikën e Kosovës si dhe me rrjedhat në planin ndërkombëtarë sa i përket çështjes së zgjidhjes së problemit ose çështjes së Kosovës. Në vazhdim u bisedua lirshëm me qytetarët e pranishëm në këtë takim. Të pranishmëve iu bë e ditur se është formuar Shtabi Civil i Mbrojtjes e ju tha edhe fakti se z. Hajrush Bajraktari është komandant i këtij Shtabi Civil të Mbrojtjes
Zv. komandanti e mori fjalën. Fillimisht i përshëndeti të pranishmit në emër të komandantit, komandës së batalionit tonë dhe në emrin e tij personal. Në vazhdim preku qëllimin dhe synimet e UÇK.

* Nga veterani i arsimit i kësaj ane na u bë vërejtje në raportet që kemi me njësitin special duke na u drejtuar konkretisht me atë se i duket që edhe raportet si kemi të mira si njësite.

16.02.1999
Jam kujdestarë. Në kujdestari takohem me njerëz nga fshati Sallagrazhdë konkretisht Ukë Marku. Përmendë rastin e shkuarjes së ushtarëve tanë në fshatin e tyre. Ushtarët janë deklaruar se janë nga Kleqka dhe janë nën komandën e Kleqkës. Kanë kërkuar një kerr karvan i tipit TOJOTA. Pronari thotë se mund ti dalin komplikime nga pushteti dhe policia serbe por edhe përmendë nevojat e shumta që ka kjo familje për këtë kerr. E lavdëruan Hysen Gegën dhe Shefqet Sopën. Në mesin e këtyre njerëzve është edhe prindi dhe vëllai i ushtarit tonë sot të pranuar Kolë Baftiaj. Ata thonë se kanë ardhur me e marrë Kolën përkundër vullnetit të tij e për hire të rrethanave të krijuara në fshatin e tyre. Kundër ardhjes së Kolës në UÇK është prindi i tij Ukë Marku. Por duket dhe del nga biseda e tij se është i ndikuar nga kreu i kishës katolike.

17.02.1999
Në lokale të komandës u takova me z. Ilaz Kadriaj kryetar i nëndegës së LDK të fshatit D. e Epërme. Në bisedë mu tha se qytetarët e këtij fshati janë të angazhuar shumica e tyre në UÇK andaj edhe i kanë dalë probleme për të gjetur njerëz për të formuar shtabin e mbrojtjes civile. Megjithatë është formuar shtabi i mbrojtjes civile dhe iu janë dhënë detyrat konkrete. Në përbërje janë njerëz nga kryesia dhe

qytetarë të tjerë, kurse komandant i këtij shtabi të mbrojtjes civile është zoti Sylejman (Bafti) Kadriaj. Më është dhënë raporti me shkrim për tërë ato që janë punuar në teren. Pasdite në lokale të komandës jam takuar me z. Shaqir Morina nga Stravuqina kom. i shtabit civil të mbrojtjes, shtab ky i sapo formuar. Jemi këshilluar për punë të më tejme dhe më është lënë raporti me shkrim.

18.02.1999
Në lokale të komandës jam takuar me komandantin e shtabit të mbrojtjes civile të D. së Epërme z. Sylejman (Bafti) Kadriaj. Zotëriu ka marrë detyrat konkrete me shkrim. Mes tjerash i është kërkuar lista e anëtarëve të shtabit civil të mbrojtjes si dhe listat e grupeve punuese profesionesh të ndryshme. Jemi marrë vesh të kthehet herë pas here në lokale të kësaj komande për detyra që dalin dhe këshilla plotësuese.

19.02.1999
Isha në Vraniq për të parë nga afër cila është gjendja atje. Te popullata është ashtu si më parë me një ndryshim të vogël keqësimi për shkak të një aksioni të ndërmarrë natën për të grumbulluar e marrë armë dhe shatorët në këtë fshat. Njerëzit e thonë me vërejtje, ka edhe të indinjuar pse e tërë kjo natën, pse njësiti i kom. Gurit. Tani më e dinë që Vraniqi i ka mbajt me bukë e veshmbathje e thonë se e mira iu kthye me të keq.

*E bisedova këtë me S. Llugaxhiun ushtarë dhe furnizues i komp. së kom. Gurit. Thot se është ushtarë dhe kishte urdhër për këtë. I vije keq. Lutë të mos bëhet e madhe.

20.02.1999
Në lokale të komandës takohem me anëtarë të kryesisë së fshatit Grejkoc. Më njoftojnë se kanë formuar shtabin civil të mbrojtjes. Në takim është edhe kom. i këtij shtabi civil. I bisedojmë gjërat, njoftohemi në detaje për detyrat që na presin si dhe mënyrën si duhet kryer ato.
Pasdite jam në Vraniq. Takohem me kryetarin z. Bajram Kolgeci dhe Tahir Kolgeci e Musli Muqa anëtarë të kryesisë atje. Ju përmendë me vërejtje vonesën që është bërë në formimin e shtabit civil të mbrojtjes. Shoh jo seriozitet dhe jo gatishmëri për të realizuar detyrat që shtrojnë rrethanat e luftës në të cilat jetohet. Bajrami është as në tokë as në qiell, ngjashëm qëndron edhe Tahiri.
Me tone të ngritura iu them se është detyrë që iu ka dalë këtyre strukturave dhe se ajo duhet kryer madje detyrimisht. Ishim shumë të qartë e Bajrami shtihej sikur nuk mund ti dalin atij dhe stafit të tij udhëheqës detyra të tilla. Ata janë politikanët, kom. e kanë Rugovën e duket se nuk e dinë që në Kosovë po bëhet Luftë, dhe se në rrethana Lufte para së gjithash janë obligues ushtarak dhe ushtarë.
Kërkova të realizohen detyrat dhe të më bëhet raport me shkrim për të realizuarat në teren.

21.02.1999
Sot bëjmë luftë me Shkiet. I zmbrapsim me sukses. Morali i lartë luftarak i ushtarëve tanë u pa në vepër.

Disiplina në nivel të duhur.
Para mbrëmjes kam zbrit në Vraniq. Sapo kam mbërri atje kam kuptuar se ka lëvizje forcash armike nga Mushtishti në drejtim të Vraniqit. Jam kthyer menjëherë te Eprori kujdestarë kam kërkuar të përforcohen vëzhguesit tanë në Vraniq dhe ushtarët tanë në Buzhalë me ushtarë tjerë dhe të lëvizen ata në drejtim të Vraniqit. Ashtu edhe u bë për 20 minuta në Vraniq kishim një tog të plotë.
Forcat armike të përcjella nga verifikator të OSBE-së po ktheheshin nga varrimi në Mushtisht. Nuk pati incident.

22.01.1999

Prapë luftë. Edhe një herë ua pamë shpinën shkive. Komandantët e thonë se kishte moral dhe disiplinë të duhur. Në luftime isha krah për krah me shokët. U bë luftë nga distanca. Nuk na ra të lodhemi gjithaq.

23.02.1999
Jemi në gjendje gatishmërie të plotë. Pasdite isha në mesin e ushtarëve pasi që isha eprori kujdestarë.

24.02.1999
Jemi në gjendje gatishmërie. Pasdite isha në mesin e ushtarëve tani në togun në Bukosh.
Jam ndalë pak edhe në Vraniq në një takim të shkurtë me vëzhguesit tanë atje.
Para mbrëmjes isha në njësinë e PU. Shokët janë mirë, më mirëpresin. Biseduam për shumë gjëra më tepër për punën e tyre dhe si të kryhet ajo zyrtarisht, mirë e me nderë.

25.02.1999
Ngaqë eprorët tjerë e edhe komandanti ishin në teren tërë ditën isha në lokale të komandës. Këtu pranova dhe përgatita për takimin e parë me shokët dy ushtarë të rinj. Për vizitë na ishin edhe kryetari dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së fshatit Grejkoc.
Në komandën tonë ishin edhe zv. kom. i komp. së kom. Gurit z. Mufail Elshani i shoqëruar nga tre polic. Z. kishin ardhur të kërkojnë në formë të shkruar qëndrimin tonë sa i përket ushtarëve tanë nga Dragaqina.
Vendosëm deri nesër në mbrëmje ta bëjmë këtë.
Vonë pas mbrëmjes isha në Vraniq për të hetuar në vend mënyrën e organizimit të rojave civile atje dhe të shoh kush është përgjegjësi i tyre atje. Nuk pashë rregull thjeshtë e as seriozitet. Para mesit të natës jam kthyer në komandë.

26.02.1999
Më është thënë se do të mbahet takim me anëtarësi në fshatin Vraniq, por njerëzit nuk e dinë se kush e ka thirr atë takim. Atje kryetari e as kryesia nuk janë në nivel të detyrave që parashtrojnë rrethanat. Unë kam shqetësim të veçantë. Atje është krijuar gjendje e pa kontroll të duhur përveç shqetësimit që ka komanda e bat. tonë askush se lodhë kokën për të keqen që mund të ndodhë atje. Sidomos pas vrasjes së dy civilëve në fshatin Mushtisht gjendja është shumë e tensionuar në komunën tonë. Kurse rrezikun për civilët e bën më të madh fakti se Vraniqi është ku është. Pranë ushtrisë sonë e edhe më pranë vendbanimit

me popullatë të përzier. Andej pari kalojnë edhe civil serb e ndoshta edhe polic e çka tjetër serb të pa uniformuar.
Vonë pas mbrëmjes jam sërish në Vraniq. Ka lëvizje të shumta civilësh. Kujtojnë se bëjnë diçka, thonë se bëjnë vëzhgim. Mbrëmë kanë bërë roje madje edhe kanë ndalë dhe legjitimuar persona, sonte nuk janë kurrkund. Më shumë se 15 njerëz janë në shtëpinë e Faik Muqës. Aty e kanë takëmin e çajit e kanë edhe 1.5 l alkool (sa pashë unë). Thonë se nuk janë roja e as të organizuar për këtë.
Nuk kanë përgjegjës. Deklarohen se sonte janë këtu vetëm për të luajtur letra. Përmendin me vërejtje lëvizjet e ushtarëve tanë nga Buzhala. I lus të ma lënë mua për zgjidhje këtë problem dhe obligohem ta zgjidhë me të vërtetë.
Ndalem gjatë në bisedë me ta. Dhe ua paraqes shqetësimin tim për Vraniqin në tërësi e për fatin e tyre në veçanti. Ngase kështu siç sillen ju them se janë duke paraqitë rrezik së pari për vete e mandej edhe për të tjerët.
Ju them se spiunin e kanë në fshat dhe se do të jenë të spiunuar për çdo veprim të tyre.
I këshillojë të jenë syçelë dhe të mos bëjnë gjumë të qetë në këto kohë të turbullta. Të bëjnë roje vëzhgimi por të mos duken. Pra të jenë por të mos duken as para syve të njerëzve të fshatit.
Askush nuk e tha por nga njerëz jashtë këtij rrethi (Nazmi Sh. Shehu dhe djali i Ymer Ukës) del se Hamdi Basha (i pranishëm këtu) është ai që ka organizuar këto roja. Vërejta se Hamdiu është aty shef.

27.02.1999

*Isha te ushtarët tanë bukëpjekës . Atmosferë pune. Thonë se nuk kanë probleme, se punojnë pa përtesë.
Njëri nga këta ushtarë më lutet ta armatosim ngase është i vetmi që nuk ka armë.
*Më pas shkova në togun e kom. Aqifit në D. të Epërme. U sqaruam për konfliktin mes kom. të skuadrës Sedat Kadriaj dhe ushtarit Sejdi Balaj kohë më parë por që unë e kuptova sot në takimin me ushtarin në lokale të komandës. Derisa bisedoja erdhën edhe S-2 dhe zv. kom. i bat.
Mbajtëm një takim ku edhe një herë u shqyrtua ky problem. Takimi u mbajt me kom. e skuadrave.
*Me urdhër të kom. të bat. u takova me Sylejman B. Kadriaj kom. i shtabit civil të mbrojtjes. Kërkova nga zotëriu punëtorë fizik civil nga ky fshat për të na ndihmuar në përfundimin e istikameve. U morëm vesh të mobilizojë sa më shumë njerëz dhe të vijnë pas mbrëmjes të kryejnë këtë punë bashkërisht ushtarë e civil.
*Më pas isha edhe te z. Hajrush Bajraktari kom. i shtabit civil të mbrojtjes për fshatin Budakovë. Edhe nga Hajrushi gjithashtu kërkova punëtorë fizik dhe u morëm vesh që në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë të qes punëtorë për të punuar istikame.
*Pas darke bashkë me zv. kom. e bat. ishim në Vraniq për të kontrolluar rojat tona në Buzhalë dhe ato civile në Vraniq.
*Kurse më vonë që nga ora 21.00 deri në 24.15 kemi mbikëqyrë gjithashtu rojat e punëtorëve dhe punën që kanë bërë këta punëtorë në hapjen e istikameve.

***Te kom. Aqifi sa ishim aty jam takuar krejt rastësisht me z. Sadik Halitjaha dhe Bacin Sadri të cilët kishin ardhur për të na vizituar këta ushtarë.
Për çudi të zotit, z. Sadik kishte qenë këtu 3 ditë e nuk gjeti kohë të vije në kom. tonë edhe pse është arsyetuar se ishte me detyrë në Zonën e Neredimes.
***Z. Hajrush Bajraktari nuk qiti asnjë punëtorë edhe pse për këtë ishim marrë vesh ma parë, kurse z. Sylejman Kadriaj ishte bashkë me 13 punëtorë të tjerë nga D. e Epërme.

28.02.1999
Jam në mesin e PU. Jam ftuar të takohem këtu me Jahir Kadri Buzhalën një fshatarë nga lagjja e Buzhalve.
Jahiri është në konflikt me Shaban (Ukë) Gashin nga Suhareka. Ndalem gjatë në bisedë me te rreth rastit dhe gjendjen e krijuar pas këtij rasti. Marr në hollësi shënimet që do të më duhen në punë në të ardhmen për të ofruar këto familje në konflikt.
*Në lokale të PU jam takuar me z. Xhemajl Zenelaj kryetarë i LDK në fshatin Savrovë. Më ka njoftuar se është formuar shtabi civil i mbrojtjes në këtë fshat. I kam kërkuar që nesër më së largu të më sillet raporti me shkrim.
*Në lokalet e PU jam takuar gjithashtu edhe me z. Agim Gashi. I kam bërë vërejtje për vonesën në formimin e shtabit civil të mbrojtjes. I kam kërkuar me urdhër ta bëj këtë sot dhe të më bëj raport me shkrim më së largu nesër.
*Përmes ushtarit tonë Daka (vëzhgues yni nga Vërsheci) me shkresë i kam ftuar kryetarin e LDK në Vërshec dhe

atë të LDK të Dragaqinës. Nga zotërinjtë kam kërkuar që menjëherë pa humbur kohë të më bëjnë me shkrim raport mbi formimin e shtabeve civile të mbrojtjes në këto dy fshatra.
*Në mesditë bashkë me dy S-2-shat dhe policin Naim Kadolli ishim në vizitë pune e bashkëpunimi në komp. e kom. Gurit. Atje jemi takuar me kom. Gurin, me zv. kom. e kësaj komp. z. Mufail Elshani, me zv. kom. për moral z. Beqir Kabashi si dhe me polic ushtarak e me ushtarë të kësaj kompanie.
Në mbrëmje me të rënë muzgu jam kthyer në komandë.
Rreth orës 22.00 na trandi një telefonatë nga vëzhguesi ynë në Dubravë. Atje ka ndodhë incident mes vëzhguesit tonë Valdet Gashi dhe ushtarëve të njësitit të kom. Abi. Gjendja është alarmante, tepër e tensionuar.
Lutem nga mësuesi atje të intervenojmë mençur dhe shpejtë. Zv. kom. Fehmiu më dërgon për ta qetësuar gjendjen atje. Isha, u kthyem ora 03.00 atje lam gjendje të rregullt. Një qetësi pas furtunës.
*Shqiptarëve iu ndihmoftë, zoti ata vetes nuk duan ti ndihmojnë.

01.03.1999
Paraditen e kalova në lokale të komandës. Jam shumë i lodhur nga pagjumësia. Këtu na vije dhe ndalemi në bisedë me z. Vesel Maliqaj G-1 në Zonën tonë.
Pasdite isha për tu takuar me përgjegjësit e rojave në Vraniq bashkë me zv. kom. e batalionit z. Fehmi Berisha.

Nuk pamë seriozitet në punë, ishin krijuar ndasi qysh në hapat e parë atje andaj iu tham këtyre përgjegjësve të vijnë në takim me ne në lokalet e kom. sonë të nesërmen.
Në kthyerje nga Vraniqi i kemi kontrolluar rojat ndërsa rojat tona në Buzhalë i kemi urdhëruar të ndalin çdo automjet dhe të shënojnë çdo civil që depërton brenda rojave tona.

02.03.1999
Isha në komandë gjatë tërë ditës. Para mbrëmjes përmes z. Nebih Kokollari kam kërkuar nga Z. Hajrush Bajraktari të më dërgoi 10 punëtorë fizik për të ndihmuar ushtarët tanë në hapjen e istikameve. Punë që u bë mirë dhe me kohë.
Zotërinjtë nga Vraniqi të ftuar për këshillim nuk erdhën. Rrahman Shehu përmes ushtarëve tanë Safet Muqës dhe Imer shehut më kishte njoftuar se kishin vendosur të pushojnë së dhëni roje. Me këtë e njoftova zv. kom. e bat. z. Fehmi Berisha.
Në lokale të komandës e bisedova veçmas me zv. kom. shqetësimin e veçantë për Vraniqin dhe së keqës që mund të na ndodhte atje duke i përkujtuar Reqakun. I thash që s'po mund të jem i qetë pa e definuar qartë statusin e Vraniqit në rrethanat e krijuara në teren. Vendosëm të merremi deri në fund me këtë çështje derisa ta zgjidhim siç është më së miri.

03.03.1999
Jam eprorë kujdestarë. Në lokale të kujdestarisë jam takuar me kryetarin dhe shokë të kryesisë së LDK të fshatit Grejkoc. Më kanë sjellë raportin plotësues me të cilin më

bëjnë të ditur se e kanë plotësuar shtabin e tyre civil të mbrojtjes plotësisht. Kam përgatitë për takimin e parë me shokët dy shokë të rinj. Shfrytëzova të qenët pranë për një bisedë të lirë me shokët ushtarë të togut të kom. Regjë Buzhala. Kam përshtypjen se kemi bërë një ndejë e bisedë sa dëfryese aq edhe të dobishme. Këta shokë shumë pak ose fare nuk merren me problemet e tyre e të familjeve të tyre. Më shumë ju interesojnë jeta në ushtri dhe çështja e kombit e rrjedhat në organizimin e ushtrisë tonë.

04.03.1999

Isha në skuadrën e policisë. Një vizitë pune. Në mesditë në lokale të komandës jam takuar me z. Ahmet Asllanaj, kryetar i LDK në fshatin Gjinoc. Më ka bërë të ditur tërë punën e shumtë që bën në fshatin e tij. Pak para orës 17.00 bashkë me kom. Bekimin, S-2 dhe ushtarin Behar Zyba jemi në togun në Bukosh, në mesin e këtyre ushtarëve tanë. Vizita është me karakter pune. U përpoqëm të bisedojmë të gjitha ato që na mungojnë e mundojnë. Biseduam dhe u sqaruam për punët dhe detyrat e shumta që na presin si dhe për format dhe mënyrat se si të realizohen ato.

*Ushtarët këtu përmendin se tani më janë vendosur në lokal më të përshtatshëm dhe se e kanë zgjidhë edhe problemin e të ushqyerit. Por përmendin se stërvitje ushtarake nuk bëjnë në mungesë të kuadrit përkatës profesionist.

*Mentori ka vërejtje të shumta por më bëhet se është fjalë shumë dhe konfliktuoz.

Emri Sopa është i mendimit se kom. i togut nuk është në nivel të detyrave dhe shprehet se ky kom. nuk i ka aftësitë dhe cilësitë e nevojshme e të duhura për kom. e togut.
*Saktësisht ora 19.00 jemi në takimin e ftuar nga kom. ABI, jemi në mesin e shumë ushtarëve nga fshati Vraniq, këtu në Vraniq.
Takimi është ftuar që edhe një herë të bisedohet çështja e armëve tek civilët në këtë fshat. Ne ishim për ta shoqëruar kom. ABI-n në këtë takim dhe për të dëshmuar se kom. ABI dhe njësiti i tij janë një njësit tjetër përndryshe të gjithë jemi ushtarë të UÇK-së dhe kemi një komandë të përbashkët.
*Shefki Kolgeci thotë se roja është mese e nevojshme në fshatin Vraniq sikurse edhe në çdo fshat tjetër ngase keqbërës sillen ditën e natën nëpër fshat.
Nuk u zgjatëm shumë. Të shënoj një ironi: Ramadan Kolgeci i drejtohet kom. tonë dhe të pranishmëve me deklarimin se nuk e din çka jam unë veçse e din që Skenderi është ushtarë. dhe them se nuk ka asgjë të keqe.
Dani moti ka rënë në provim.
Në shoqërim të Enverit dhe Azemit kthehem sërish në Bukosh për të vazhduar takimin me ushtarët tanë atje.
I shtrohemi rrafsh bisedës dhe jemi kuptuar deri në fund. Ora 23.35 kthehem në shtëpi me leje të kom. për të pushuar këtë natë.

05.03.1999
Isha në mesin e ushtarëve të kom. Regjë Buzhalës. Këtu është çdo gjë në rregull. Jam ndalë në bisedë të veçantë me ushtarin Shefqet Krasniqi- “Sotiri”.

Në lokale të komandës jam takuar me kryetarin dhe anëtarë të kryesisë të fshatit Grejkoc.
Kemi pranuar me S-1 dhe kemi përgatitë për takimin e parë me shokët dy shokë ushtarë të rinjë.
Para mbrëmjes isha në Papaz për të parë e vizituar dy skuadrat tona atje. Më shoqëroi kom. Aqifi. Rojat i gjetëm në rregull. Shokët thonë se te këta është çdo gjë në rregull. Përmendin uniformat si kërkesë të tyre të vetme.
Në stafin komandues nuk kanë vërejtje. Ushtarët janë kryesisht të këtij fshati, raportet janë vëllazërore.

06.03.1999
Isha në vizitë pune në togun e kom. Reshat Halitjahës. Jam zgjatë me bisedë të lirë, ishte kënaqësi e vërtetë të qëndrosh në mesin e këtyre shokëve.
Në lokale të komandës jam takuar me ushtarin Bajrush Hoxha. I kam biseduar me të gjerë e gjatë problemet që ky ushtarë i ka me shëndetin.
Në mbrëmje isha në Vraniq bashkë me kom. Fehmiun për të kontrolluar rojat tona në Buzhalë dhe ato civile në Lagjen e Llugaxhive.
*Le të jetë e shënuar për tu ditë gjithmonë: Me ndonjë përjashtim të vogël Llugaxhitë gjithë herë ishin në nivel që dëshirohej. Mua dhe veprimet e mia i kanë mbështetë fortë dhe aty kam gjetë bazë të fortë e të shëndoshë për veprim.

07.03.1999
Isha në mesin e ushtarëve të komp. së II-të në togun e kom. Regjë Buzhala. Një bisedë e lirë. U bisedua për nevojat, mungesat dhe problemet që kanë. Ushtarët këtu

më përmendin larjen e dobët të rrobave me vërejtje se rrobalarësi nuk është i përgatitur profesionalisht për këtë detyrë.
*Kanë mungesë këpucësh edhe më tej edhe pse dje kanë marrë 6 palë këpucë në togun e tyre e thonë se duhen edhe 6 palë tjera.
*Ka nevojë të madhe për një ujti elektrike.
***Bisedova në detaje me ushtarin Shefqet Krasniqi-"Sotiri", me problemin që e ka. E njoftova se ky ushtarë me kërkesën e tij si dhe me kërkesën e komandës së njësitit të tij dhe me leje të rregullt transferimi andaj ne konsiderojmë se çdo gjë është në rregull.

08.03.1999
Isha në mesin e ushtarëve tanë në togun e kom. Aqifit. Probleme nuk ka. Ushtari Halit (Zymer) Kadriaj më përmendë se ka këpucë të shkyera që moti si dhe përmendë dëshirën e tij të madhe të mbajë mortajën e dorës. Kom. Aqifi e thotë se sjelljet mes ushtarëve janë shoqërore.
Në lokale të komandës jam takuar me vëzhguesit tanë në Vraniq, ushtarët B. M; A. K dhe E. B.
Bashkë me S-2 dhe bashkë-punëtorin e tij M. Buzhala dhe policin N. Kadolli ishim në komp. e kom. Gurit. Vizita ishte e punës.
*Bislimi, Azemi e Enveri qofshin me fat. Janë duke ia larë tamam si duhet borxhin atdheut. Gjithmonë janë aty ku duhet e ku janë shokët.

09.03.1999

Jam në mesin e ushtarëve tanë në togun e kom. Fadil Qitaku. Derisa unë fola krijohej përshtypja se këtu është çdo gjë në rregull. Ndërkohë edhe pse kisha kërkuar të më thuhen pa ngurrim vërejtjet e tyre në sjelljet e shokëve si dhe në sjelljet dhe në punën e eprorëve dhe të komandantëve të tyre, kurse ushtarët u deklaruan se me çdo gjë janë të kënaqur dhe çdo gjë është në rregull; Në dhomë hyri kom. Izeti menjëherë përmendi çështjen e përdorimit të alkoolit nga ana e dy ushtarëve: Nazim Hamzajt dhe Bashkim Hamitit. U bë një polemikë mes këtyre dy ushtarëve dhe kom. Izetit. Dy ushtarët në fjalë i kam sjellë në komandë te zv. kom. i bat. z. Fehmi Berisha.

10.03.1999
Në mesin e ushtarëve të kom. Latës isha bashkë me S-3. Me S-3 ishim zgjuar herët në mëngjes para agut. Ishim në kontroll rojave tona poshtë te KVD-ja. Atje ishte çdo gjë në rregull. Ishim për të kontrolluar edhe vëzhguesin në D. të Poshtme. Atje vëzhguesi ishte prej herët në mëngjes dhe ishte çdo gjë në rregull. Në togun e kom. Latës më është dukur e tepërt ti këshillojë për çfarëdo ushtarët. Iu kam thënë të vazhdojnë kështu dhe të përpiqen ta ruajnë këtë atmosferë pune e shoqërore në mesin e tyre.
*Kom. Lata është një komandant që është duke shkëlqyer çdo ditë e më shumë.
*Xhema (S-3) gjithashtu një shok që nuk di për lodhje.

11.03.1999
Jam eprorë kujdestarë. Pas mbrëmjes i kam kontrolluar rojat. Çdo gjë është në rregull.

12.03.1999
Në lokale të komandës jam takuar me kryetarin e fshatit Dubravë dhe ate të fshatit Savrovë njëkohësisht. Kam përgatit për takimin e parë me shokët 3 ushtarë të rinj. Bashkë me kom. Fehmiun ishim në KVD, kurse vonë në mbrëmje edhe të gjitha rojave tona.
Në mbrëmje kemi lëshuar një skuadër ushtarësh në Vraniq dhe atje bashkë me kom. Fehmiun iu kemi dhënë atyre detyrat konkrete. Takimin me këta shokë e mbajtëm në odën e Sherif I. Shehut
* Baci Sherif prej ditëve të para i është përkushtuar luftës dhe ka dhënë prova të shumta deri më tani se është i paluhatshëm deri në fund. Në komandë u kthyem ora 23.20.

13.03.1999
Bashkë me kom. Fehmiun ishim në KVD për të vazhduar me ndriçimin e një problemi të vogël mes dy ushtarëve dhe kuzhinierit tonë atje. Në lokale të komandës jam takuar me ushtarin Emin Musliu rreth problemit që ka ngase familja e tij është në konflikt me një familje nga fshati Topillë. Bashkë me S-2 dhe dy ndihmësit e tijë isha në fshatin Topillë. Ishim në familjen e Ruzhdi Xhema. Atje ishim për të liruar ushtarin Emin Musliu dhe familjen e tij së paku deri në fund të luftës nga besë-marrja. Për ushtarin këtë e kemi arritë menjëherë dhe kemi marrë garancione që kurrë kjo familje nuk ka me ia rrezikuar jetën asnjë pjestari të familjes së këtij ushtari, ndërsa plaku Ruzhdi e tha se është madje tepër i interesuar që gjyqësia

në të ardhmen sërish të merret me këtë rast vrasjeje. Kurse sa i përket lirimit të pjesëtarëve tjerë të kësaj familjeje do të bisedojmë së bashku me axhën Ruzhdi, me telefon, këtë të dielë, me Muharremin djalin e madh të tij i cili tani gjendet në Slloveni. Në mbrëmje isha në shtëpi për të pushuar.

14.03.1999
Paraditen e kësaj dite në Vraniq jam takuar me Adem Kolgecin kom. skuadre atje dhe me ushtarë të kësaj skuadre. Duket që është dhe do të jetë çdo gjë në rregull.
I kam kështilluar gjerë e gjatë cilat duhet të jenë sjelljet dhe raportet me civil atje. Në mesditë e kam vizituar kujdestarinë. Më pas isha në lokale të komandës dhe jam përgatitë për referim. Bashkë me bacën Ruzhdi dhe S-2 ishim në telefon. Ne sosëm punë. Arritëm krejt çka kemi kërkuar. Tani edhe familja e ushtarit Emin Musliu është e lirë të punoj e jetoj pa iu nënshtruar marrjes së besës derisa jemi në luftë. Vonë në mbrëmje isha në Vraniq. Nga atje kam marrë ushtarë për të përforcuar KVD-në.

15.03.1999
Nuk jam mirë. Dua të pushoj në lokale të komandës. Në lokale të komandës takohem me dy civil dëmtues të pyllit. Përgatis dy shokë ushtarë të rinj për takimin e parë me shokët. Janë këta Xhavit A. Loshi dhe Qerim O. Kolgeci. Vonë në mbrëmje isha në Vraniq për të përcjellë një porosi me shkrim kom. të komp. së III-të në Maqitevë.
Vendosa dhe ashtu u bë. Shkova me gjysmë shpirti vet e i shoqëruar nga vëzhguesit e kësaj kompanie M. B. dhe E.

B. Në Maqitevë mbërritëm pasi kishin fjetë shokët. Rojat i gjeta në rregull. Çdo gjë ishte në rregull në këtë kompani. Kom. Halili për të më përcjellë rreshtoi të gjithë ushtarët. Mua mu duk një respekt dhe nderë i tepruar.
Megjithatë u kënaqa me rregullin dhe organizimin në ushtrinë tonë. U emocionova pak.

16.03.1999
Në lokale të komandës jam takuar me Ahmet Asllanajn kryetar i LDK në fshatin Gjinoc.
Prej mbrëmë në vizitë pune te ne janë z. N. Kastrati S-3 në zonën tonë dhe z.....kom. i brigadës sonë. Ju qëndrojmë pranë dhe përpiqemi ti informojmë për krejt çka është punuar, punohet e planifikohet të punohet.
Në lokale të komandës jam takuar me B. Muqën dhe Z. Muqën si dhe jam ndalë në bisedë të gjatë me ushtarin Imer Shehu rreth disa problemeve atje.
Imer Shehu ushtarë që shkëlqeu. Ma fali tërësisht besimin dhe u zotua se do të veproj vetëm ashtu siç do të vendosim bashkë dhe se deri në fund do të zbatoj urdhrat dhe këshillat e mia.

17.03.1999
Jam eprori kujdestarë.
Në lokale të kujdestarisë jam takuar me z. Destan Palushi dhe Elhami Kokollari veprimtarë të palodhshëm nën hije nga fshati Budakovë. Më informuan për punën e palodhshme që bëjnë dhe ndihmesën që i bëjnë S-4 pran këtij batalioni. Në oborrin e komandës jam takuar shkurt me z. Sylejman Kadriaj kom. i SHCM në D. të Epërme.

Më solli raport me shkrim mbi gjendjen në këtë shtab dhe në fshatin D. e Epërme. Më përmendi me vërejtje pa dëgjueshmërinë e disa individëve atje si dhe mosbesimin në ne për të na dhënë emrat e anëtarëve të SHCM të këtij fshati nga frika mos këta emra bien në dorë të organeve ndjekëse të pushtuesit. I sigurova këta zotërinj se diçka e tillë nuk guxon të ndodhë së paku për të gjallë timin jo. Në lokale të kujdestarisë jam takuar me kom. e skuadrës në Vraniq z. Adem Kolgeci dhe ushtarin Imer Shehu. Më njoftuan me gjendjen në këtë fshat. Atje nga raporti i tyre del se çdo gjë është në rregull sa i përket ushtarëve tanë atje. Lëvizje forcash armike në këtë fshat nuk ka.
I këshillova të vazhdohet të veprohet kështu.

18.03.1999
Kryesisht kam qëndruar në lokale të komandës ngaqë në vizitë pune na ishin shefi operativ i kom. së zonës sonë z. N. Kastrati dhe kom. i brigadës 123 z. Gëzim Hazrolli.
Kam përgatitë raportin dhjetëditorë të punës dhe kam kryer ndonjë punë a kam mbajt ndonjë takim me ushtarë tanë veçmas.
Ishim në gjendje gatishmërie të plotë luftarake.

19.03.1999
I kam vizituar shokët që na kanë ardhur nga Kabashi. I kam ngushëlluar për shokët e rënë si dhe jam përkujdesur për strehimin sa më të mirë të tyre duke e ndihmuar kështu S-4. Ishim në gjendje gatishmërie të plotë luftarake.

20.03.1999

Isha i caktuar në komisionin për varrim. Tërë ditën jam angazhuar që varrimi të jetë sa më madhështorë dhe të kalojë në rrethana sigurie të plotë për pjesëmarrësit.
Bashkëpunimi mes anëtarëve të komisionit për varrim nuk ishte i nivelit që e kërkonin detyrat, rrethanat dhe situata. Kujtoj që shokët tjerë ishin të mbingarkuar dhe tepër të lodhur dhe kjo duhet të jetë arsyeja. Përndryshe fitohej përshtypja se si batalion anashkaloheshim edhe pse ne jemi përgjegjës për terrenin në të cilin veprohet e ku jemi të përqendruar si dhe përkundër faktit që çem obliguar moralisht dhe realizuam me tepër sukses strehimin e këtyre shokëve që erdhën nga Kabashi.
Pas mbrëmjes me lejen e kom. të bat. isha në Vraniq për të kontrolluar ushtarët në vëzhgim atje dhe për të pushuar një natë në familjen time.
Bashkë me Zaim Muqën, Shpejtim Bashën e Enver Bashën nuk fjetëm tërë natën. Bisedat ishin të ndryshme. Më së tepërmi biseduam për organizimin ushtarak në brigadën tonë e në bat. e II-të. E biseduam gjatë edhe çështjen e sigurisë në fshatin tonë. I frikohemi ndonjë të keqeje të madhe- të madhe. Është mendim i gjithë neve se njerëzit në fshat nuk e kuptojnë seriozitetin e gjendjes dhe rrezikun që mund të sjellin rrethanat ndaj dhe nuk janë të gatshëm të mobilizojnë tërë forcën e tyre në mbrojtje të tyre, të familjes dhe pasurisë së tyre.

21.03.1999
Në Vraniq jam takuar me shumë ushtarë tanë atje dhe me kom. e skuadrës z. Adem Kolgeci. I kam këshilluar për veprim të më tejmë. Pasdite ishim në gjendje gatishmërie

të plotë për shkak të luftimeve në zonën e brigadës sonë, në terrenin që mbulojnë dy batalionet tjerë të brigadës sonë. Në mbrëmje referova për punën time.

22.03.1999
Ishim të alarmuar, ushtarët ishin në pozicione e unë u përkujdesa për civilët.
Pasdite jam takuar me kom. Lulin. E kam biseduar me vërejtje të na rrijë më pranë pasi që ushtarët i ka te ne nën komandën dhe urdhrat tanë.
Pas mbrëmjeje e kemi varrosur edhe ushtarin e tretë të vrarë në luftimet e zhvilluara në Kabash.
Vonë pas mesit të natës bashkë me kom. e bat. Dhe dajën Behar ishim në kontroll rojave në tërë shtrirjen tonë.
Pamë se çdo gjë funksionon siç duhet.
U kthyem të pushojmë ora 03.05. Unë edhe pak kohë qëndrova me rojën pranë lokaleve të komandës e më vonë shkova për të pushuar.

23.03.1999
Në lokale të komandës jam takuar me z. Xhemajl Hoxha anëtarë i SHCM. Jemi sqaruar në hollësi që të jemi sa më të përgatitur dhe sa më në nivel të detyrave që mund të na dalin. Përmes Xhemajlit i kam bërë përgjegjës të gjithë anëtarët e SHCM të fshatit Budakovë që sa herë që tensionohet gjendja ata të më ofrohen dhe të më rrinë pranë për të marrë urdhrat për veprim dhe instruksionet për punë me kohë. Saktësisht në ora 15.30 në komandë të bat. tonë kanë ardhur: kryetari i LDK të fshatit Budakovë z. Eqerem Buzhala si dhe anëtarë të kryesisë, kom. i SHCM

z. Hajrush Bajraktari me anëtarë të tjerë të këtij shtabi si dhe qytetarë të tjerë e bashkë me ta edhe ushtari Nebih Kokolllari dhe Enver Hoxha në cilësinë e përfaqësuesve të ushtarëve tanë nga fshati Budakovë. Thonë se kanë ardhur për të na njoftuar dhe për të na e tërheqë vërejtjen për herë të fundit në lidhje me mos disiplinën e komandantëve dhe ushtarëve të njësisë motër komp. së I-rë VD të kom. ABI-t. I pritëm: Unë- S-5, S-4, dhe kom. i bat. të II-të z. Fehmi Berisha.

24.03.1999
Kryesisht jam përkujdesur për civilët.

25.03.1999
Kam leje nga kom. i bat. të jam në Vraniq sa herë që konsiderojë të nevojshme deri në rregullimin e gjendjes plotësisht atje. Sot jam bashkë me kom. e bat. Në mbrëmje analizuam gjithanshëm dhe vendosëm të bëjmë ndryshime në nivel komandimi atje.

28.03.1999
Jam në Vraniq. Kam kompetencë të rregulloj çështjet si di më së miri.
I raportova kom. të bat. në detaje për punët që kam realizuar atje.

29.03.1999
Jam në Vraniq.
I raportova komandës për angazhimet e mia në Vraniq.

30.03.1999
Jam në Vraniq.
I raportova kom. të bat. për angazhimet dhe të arriturat atje.

31.03.1999
Jam në Vraniq...

01.04.1999
Pasdite jam në Vraniq...

02.04.1999
Pas mbrëmjes jam në Bukosh dhe në Vraniq. U ndala shkurt në Buzhalë.

03.04.1999
Pas dite jam në Vraniq...

04.04.1999
Tërë ditën jam në komandë. Jam i dërmuar nga lodhja dhe një ftohje.
Vizitova kujdestarinë.

05.04.1999
Pas dite jam në Vraniq. Atje kishte plasë kiameti.
E bëra natë me shokët ushtarë në shtëpinë e Reshatit.
Duket se do të rregullohen gjërat.

06.04.1999

Jam në Vraniq. Jemi të mobilizuar tërësisht ta bëjmë mirë ose do të ndryshojmë çdo gjë këtu.

07.04.1999
Jam në Vraniq në takim me ushtarët tanë atje. I pranishëm eprori Adem Kolgeci.
*Formacioni i ushtarëve dihet nga eprori, shënime nuk ka.
*Formacioni i armëve nuk dihet, shënime nuk ka.
*Adem Kolgeci thotë se në kohën kur është vra komandant Zaim Muqa vëzhgues ka pasë. Thotë se vëzhguesit ishin në odë të Nuhi Eqerem Kolgecit.
Z. Adem thotë se vëzhgimin në hyrje të fshatit Vraniq nga ana e Bukoshit me sa din (siç shprehet) ka qenë dashtë me ba njësiti i ABI-t.
Azem Kolgeci thotë se prej urës e lartë kah lagjja e Agushve përgjegjësinë e ka pasë njësiti i ABI-t.

15.04.1999
Jam në Vraniq. Është mbërri rregull dhe kontroll i plotë mbi lëvizjet e ushtarëve dhe civilëve të strehuar. Isha në mesin e të gjithë ushtarëve në të tri vendqëndrimet e tyre. Disiplina është në nivel. Duke rënë muzgu bashkë me shefin (komandantin) e policisë në bat. tonë z. Shefket Hoxha të shoqëruar nga ushtari Metë Basha kemi shkuar në vizitë pune në komp. e III-të te kom. Halil Krasniqi.
Rojat ishin në nivel në tri vendroja që vizituam, furnizime kanë, teknik medicinal kanë, furra dhe kuzhina në nivel të kënaqshëm. Sonte ushtarët ishin duke punuar istikame.
*Në Vraniq kam ftuar civilët dhe kam lënë përgjegjësit për të siguruar këta civil të hapin istikame.

Kam urdhëruar të punohet pas orës 20.30.

16.04.1999
Bashkë me z. Shefket Hoxha kom. i policisë ushtarake në bat. e II-të mbajtëm takim me kom. e kompanisë, kom. e togjeve dhe kom. e skuadrave në komp. e III-të.
*Kom. i komp. z. Halil Krasniqi përmendë mos disiplinën e ushtarëve. Përmendë se në vizitë pune kësaj komp. i jemi shkuar pak ose fare, si dhe se nuk kemi ndërmarrë sa duhet masa shtrëngimi ndaj të padisiplinuarve në këtë komp.
*Nd. I kom. të komp. së III-të z. Halil Ahmetaj përmendë se pajtohet me ato që iu than nga ana e jonë dhe është për denoncimin publik dhe për marrje masash adekuate shtrënguese ndaj atyre që nuk janë të disiplinuar dhe konstruktiv.
Z. Riza Kabashi nd. i kom. të kompanisë përmendë se është përdorë gjakftohtësia dhe toleranca e tepruar. Andaj kemi problemet që kemi. Përmendë se pozicionet nuk janë punuar sa e si duhet andaj edhe rezistenca forcave të armikut nuk mund t'iu bëhet e fortë ashtu çfarë duhet ngase siç përmendë ushtari në kokërr të lëndinës dëmtohet vetëm nga një predhë minahedhësi e mos të flasim tjetër. Andaj duhet pritur se morali i ushtarëve për rezistencë bie.
*Ishte ide imja, ia propozova kom. Shefketit dhe kom. Halilit, në komp. e III-të të ketë së paku 2 polic ushtarak. Kom. Halili pajtohet por e thotë policët të mos jenë ushtarë të kësaj kompanie.
*Në ora 13.30 jemi takuar (i kemi thirr në raport) ushtarët problematik e të padisiplinuar:
Imer Krasniqi

Muharrem Ndrecaj
Hagji Bajselmani
Florim Halitjaha
Xhemajl Ndrecaj
Hagji Muqa
Avdi Jakupi
Xhavit T. Ndrecaj
Medri Bajselmanaj

* Ushtarët e kom. Shaqir Krasniqi (4 prej tyre) të marrën në bisedë (si problematik) e thonë se kom. Shaqiri nuk është serioz me ushtarët dhe se i bënë gjërat me zhurmë.
*Ushtari Muharrem Ndrecaj ushtarë i kom. Shaqirit thotë se si ndihmës i shënjuesit me Mortajë nuk kemi vend (pozitë) të caktuar për Mortajë.
Në marrëveshje me kom. Halilin i kemi transferuar në Vraniq ushtarët:
Medri Bajselmanaj
Xhavit Ndrecaj
Hagji Muqa dhe
Bashkim Matoshi;
kurse ushtarin Fazli Ndreca kam vendosë vet ta mbajë këtu në Vraniq.

17.04.1999
Jam në Vraniq dhe sapo desha të nisesha për në komandë. Kur duhej të takohesha me kom. e PU të bat. tonë z. Shefket Hoxha, u dëgjuan të shtëna armësh nga drejtimi i Dubravës ose Sopisë. Një shqetësim dhe trazim i popullatës poshtë në Savrovë e Bukosh. Lëvizje e tyre në

drejtim Vraniqi. Pas më pak se 10-15 minutash mësuam se ishte një sulm i suksesshëm i ushtarëve tanë mbi forcat armike në dalje të Sopisë te ura. Kuptova se ushtari Fadil Shabani është i plagosur lehtë. Ushtarit Rrahman Hamzaj ia gjeta kerrin e Destan Llugagjiut dhe bashkë shkuan ta tërhjekin të plagosurin.
E pashë Fadilin ia bëra me fat plagët dhe e përcollëm për në ambulancën ushtarake. Gjërat dhe popullata u qetësuan shpejtë. E ne ishim në pozicione tërë ditën.

05.05.1999
Kemi dhimbje

11.05.1999
Gjatë tërë ditës janë zhvilluar luftime të ashpra mes forcave armike dhe njësive tona. Isha në përkujdesje të të plagosurve. Enverin dhe disa shokë që s'mund lëviznin i kemi dërguar në shpellë të Topillës herët në mëngjes dhe aty kanë qëndruar deri vonë në mbrëmje përkatësisht deri në ora 20.00 kur i kanë tërhjekë shokët e Z. N. Dhe i kanë dërguar në Rancë ku edhe jam takuar me ta të nesërmen e kësaj date. Popullata ishte në lum të Topillës deri ora 19.30 kur e shtrënguar nga krisma armësh në afërsi me vet- vendim ka lëvizur në drejtim të fshatit Petrovë e Shtimjes. Këtë natë e kanë kaluar në rrugë aty kanë qëndruar tërë natën në asfalt dhe me shqetësim të veçantë.

12.05.1999
Që me ag e deri në ora 08.30 e tërë popullata ka lëvizur në drejtim të Shtimjes dhe ka dalë në rrugën kryesore, kurse

në Petrovë, Reqak e as në Shtimje nuk kishte kurrfarë të shtënash nga kurrfarë armësh.. Ishte një qetësi absolute deri në ora 14.30 kur nëpër Petrovë nga ana e Llanishtit, Devetakut e Topillës kanë kaluar forca të shumta këmbësorësh serb të cilët me të shtëna nga armë të lehta kanë hyrë shtëpi më shtëpi, kanë demoluar e thyer por nuk kanë djegur as një shtëpi apo objekt përcjellës. Në lumin e Topillës janë gjetë 4 të vrarë civil të shtyrë në moshë.
Është deklaratë e ushtarit Zaim Beqa dëshmitarë okularë.

17.05.1999
Jamë në Petrovë. Vizitova të gjithë të plagosurit tanë dhe të kom. Gurit një për një. Janë duke u përmirësuar dukshëm. Janë të përkujdesur nga personeli mjekësorë, kanë ushqime dhe jan të vendosur në lokale të përshtatshme.
Isha edhe në Mollopolc dhe i vizitova shokët e plagosur në spitalin ushtarak atje. Enveri është më i disponuar dhe thot se mirë përkujdesen për te.
Me dr. Imerin ishim për të siguruar një karrige stomatologjike në Z. N.
Mora pjesë në varrimin e 4 shokëve të kësaj zone të vrarë ditët e fundit gjatë luftimeve. Ishin këta:
*ADIDASI (RAMADAN REGJEPI)...

Isha në vizitë te varri i kom. AHMET KAQIKU.

18.05.1999
Jam në Petrovë. I vizitova shokët e plagosur në të tri vend-përqendrimet. Të gjithë janë më mirë se dje dhe mund të

them se janë përmirësuar dukshëm përpos Enveit i cili edhe më tej sillet rreth fillimit të shërimit për shkak të pamundësisë ti kurohen plagët si duhet deri më tani në mungesë të kushteve gjer më tani ti kurohen plagët si duhet. Azem Kolgecin e qova te stomatologu dhe ia nxjerri dhëmbin që prej kohësh i dhimbte. Ushtarin Feriz Kabashi e nxjerra nga policia e Z. N. dhe ia bëra një leje qarkullimi në relacionin BUDAKOVË- PETROVË për të furnizuar shokët (17 ushtarë tanë) të bashkuar në lagjen e Lugut në Topillë. Në këtë leje shënova një lutje PU të kësaj zone të mos ndiqen ushtarët tanë me arsyetim se janë të shkëlqyeshëm dhe s'po mund të përkujdesemi për ta.

PA DATË
Përkujtim
Ishe fjalë pak e i sakrificave të mëdha. Me njerëz si ti, lehtë hapen dritaret e historisë kombëtare. Prandaj krenaria e mposhtë dhembjen. Do ti mbesim besnik veprës sate të madhe. I lehtë të qoftë dheu i Kosovës. Prehu në qetësi o Ahmet Kaqiku.

*Të lëshohen së paku fletëfalënderime ose të jepen edhe pse në rrethana lufte emblema kryefamiljarëve të familjeve të cilat dhanë krejt çka iu kërkue ose çka ishte e nevojshme e që kishin për UÇK.

SHCM Vraniq

Kom. Rrahman Beqir Shehu
Zv. Kom. Ramush Adem Matoshi

Nusret Shehu
Remzi Ali Loshi
Rexhep Regjë Matoshi
Hetem Hajrush Kolgeci
Sedat Xhemajl Muqa
Ibrahim Islam Rraqi
Liman Azem Kolgeci
Bexhet Nebih Kolgeci
Nuhi Selim Loshi
Ragip Halil Muqa
Adem Shaip Kolgeci
*Sa kam arritur të mësoj dhe sa kam parë e di Haxhi Sallauka gjithë herë ka qenë njeriu numër një në bat. tonë.
*Më të dalluarit për trimëri, punë e sakrificë në bat. tonë janë:
Haxhi Sallauka
Fehmi Berisha
Muhamet Buzhala
Enver Hoxha
Latif Krasniqi
Xhemajli Kastrati
Imer Shehu
Muhamet Kadriaj
Arben Veselaj
Makbule Mustafa
Aqif Kadriaj
*Muhamet Vesel Buzhala tepër në nivel të detyrave.
*Genc Zenel Daka një eprorë i shkëlqyeshëm, i afërt, i dashur, i nivelit të duhur.

*Temat që do të zhvillohen për çështje morale:

Qëllimi i UÇK-së- çlirimi i trojeve tona nga okupatori (3 orë).
Qëllimi i luftës së agresorit serb (2 orë).
Pozicioni ndërkombëtarë i UÇK- së dhe lufta e jonë (2 orë).
Bashkimi i gjithë popullit për liri dhe pavarësi ka për qëllim daljen nga robëria (3 orë).
Propaganda e armikut dhe lufta speciale. Detyrat tona kundrejt sajë (2 orë).
Burimet themelore të moralit luftarak gjinden në unitetin e popullit dhe mbrojtja e përgjithshme (3 orë).
Historiku i luftërave çlirimtare të popullit tonë (3 orë).
Njohuri mbi aktualitetin (10 orë).

Për kontributin dhe përkrahjen e dhënë meritojnë respekt:
*Sadri Azem Kokollari
*Idriz Sylë Palushi
*Baki Haki Palushi
*Adem Bajram Palushi
*Arif Ramë Kokollari
*Xhemajl Ahmet Hoxha
*Avdulla Brahim Buzhala
*Hysen Tahir Kokollari
*Haxhi Sallauka
*Sefer Kokollari
*Nebih Kokollari
*Elami Kokollari
*Destan Palushi

*Regjë Buzhala

*Hajriz Buqa- ka shitë duhan me çmim të lirë ose ka falë gjatë ofensivës së parë.
*Halil Trolli një trim.
*Sokol Hetem Sahiti ushtarë i Gurit nga fshati Topillë. Me vetiniciativë më datë 12.05.1999 në ditën më kritike dhe kur ishte më me rrezik ka bërë një vëzhgim të shkëlqyeshëm në fshatin Topillë, duke na lehtësuar kështu maksimalisht veprimin tonë. Ushtari të veçohet dhe të shpërblehet.
Për kontributin dhe përkrahjen e dhënë pos atyre që dhanë më të shtrenjtën, meritojnë respekt:
*Veli Xhemë Muqa
*Ibrahim Vesel Basha
*Sherif Imer Shehu
*Halime Muharrem Basha
*Sali Jakup Basha
*Sali Adem Llugagjiu
*Bislim Rrustem Muqa
*Azem Miftar Kolgeci
*Hamdi Osman Basha
*Rrahman Smajl Muqa
*Jakup Azem Llugagjiu
*Shpejtim Isë Basha
*Imer Sherif Shehu
*Safet Nazim Muqa
*Nevzat Januz Shehu
*Brahim Ahmet Basha
*Enver Ibrahim Basha

*Naim Selim Basha
*Sadri Ramë Muqa
*Rrahman Beqir Shehu
*Hysen Jashar Muqa
*Azem Mehmet Luzha
*Mustafë Mulë Basha
*Hamit Miftar Kolgeci
*Sylë Tahir Llugagjiu

* Flas me shumë respekt për ushtarët tanë, nga fshati Leshan: Emin (Bislim) Ramadani, Hashim (Imer) Ramadani, Shaban (Hazir) Ramadani, Muhamet (Hisen) Ramadani dhe Selmon (Ramiz) Ramadani, të cilët këtu në Vraniq me shumë urti e përkushtim bëjnë jetën e ushtarit dhe luftën, gati të përditshme, me serbët; Dhe për Nuhi (Idriz) Sopa e Veprim (Kadri) Sopa nga fshati Bukosh, të cilët bëjnë heroizma çdo ditë.

* Melihate Ramadan Zeqiri, Davidovc, një teknike shembull jo vetëm për teknikët medicinal e për mjekët por shembull si duhet të jetë ushtari, shqiptari, njeriu. E njoha në veprim më 09-13.05.1999 kur isha në luftime bashkë me kom. Gurin dhe shokët e tij.
Të veçohet, të shpërblehet, të mirënjohjet puna e sajë.

* Bajram Xhemë Tërshana nga Grejqevci me shumë vullnet e guxim ka bartë buk shokëve në vi të frontit. Të mirënjohjet, të shpërblehet, të mos harrohet nga shoqëria.
* Zymrije Brahim Shehu ka gatuar më së shumti deri në 60 bukë në ditë për ushtarët tanë në malin mbi Vraniq.

* Resmije Brahim Shehu pas ofensivës së majit ka gatuar buk për civil e ushtarë tanë në fshatin Vraniq.

* Xhavit Sahit Beqaj lindur më 29.11.1977, ka shërbyer pa përtesë e me vullnet të madh të plagosurit tanë. Veçmas në bartjen e me kalë e kerr nga stacionari në spital dhe anasjelltas për kontrolle të ndryshme.

* Ushtari më i zellshëm në bat. tonë është padyshim ushtari Murat Kadriaj. Është mrekulli si e kryen ky ushtarë punën e korrierit të komandantit Izet Buzhala.

Qëndrim:

*Të thirren në takim të gjithë njerëzit e fshatit- të gjithë.
*Të veshin uniforma të pastra.
*Të fshijnë armët dhe të kontrollohen armët nëse janë të pastra ose jo.
*Të merret formacioni i ushtarëve.
*Të merret formacioni i armëve dhe sasia e municionit si dhe bombave të dorës
*Të ndalohen menjëherë të shtënat.
*Deri në qëndrimin tjetër në fshat të mos ketë strukturë tjetër veç asaj ushtarake.
*Të bëhet regjistrimi i popullatës menjëherë.
*Të caktohet zëdhënësi për fshat.
*Të gjendet përkthyesi.
*Të caktohen punëtorët humanitarë (numri i tyre të caktohet sipas nevojës).

*Kom. e skuadrave të takohen me kom. e togut çdo mbrëmje dhe të dorëzojnë raport ditorë me shkrim.
*Të ruhen pasuritë e njerëzve.
*Ndalohet dëmtimi i fondit të bagëtive.
*Të vendoset bashkarisht të ruhet apo të mos ruhet edhe më tej fusha.
*Kom. i togut varësisht prej nevojave fton regrutët dhe formon strukturat që i duhen fshatit dhe njerëzve këtu.

DROMCA (humori) LUFTE

I thotë, baba i Halil Krasniqit, një fqinji të tij: "O filan, shiko bre se lopët e tua më kanë hy në speca". E ky ia kthen: "Ai Ajet, si s'ke fare durim, djali yt e kalli një katund e s'jemi kah të themi gjë, e ti, i përmendë lopët në speca".

***

Jo rastësisht, në Maqitevë, më së shumti granata binin në truallin e në shtëpinë e Halil Krasniqit. Kur ato binin në shtëpinë e Halilit, një fqinjë i tij thoshte: "Mirë është" e kur ato binin kudo tjetër në Maqitevë thoshte: "Eu Halil n'kry t'rafshin".

***

Në kohë luftë, popullata, shumë shpejt i përshtatej rrethanave të reja që krijoheshin; por, edhe mësonte shpejt shumëçka. Kështu, njerëzit nga Vraniqi, kur granatoheshim nga Duhla, matnin kohën deri në 17 sekonda e pastaj duartrokisnin me brohori: "Shkoi për Maqitevë".

Komandanti i Kompanisë në Maqitevë, Selim Haziraj, kishte bërë përpjekje që pos përgatitjeve të tjera për luftë, njerëzit atje të punonin edhe strehimore dhe bunker për vete e për familjet e tyre. Pa përtesë, kishte shkuar oborr më oborr për t'ju përzgjedhë e caktuar edhe vendin më të përshtatshëm për to. Por më kot. Pas pak ditësh fillojnë të bien granatat e para, kurse pothuajse tërë njerëzit e fshatit, thellësisht të shqetësuar, i kishin shkuar në komandë, Selimit, për ta pyetur si të vepronin tani dhe çka të bënin? Ky, pasi i lutë, disa herë, të uleshin; iu thotë: nesër e në të ardhmen na granatojnë edhe më shumë, andaj këtë të sotmen e harrojmë me lehtësi.

***

Ngjashëm me shumë të tjerë, edhe Shani Canaj shkon në Shqipëri për tu furnizuar me armë. Atje i bie të dëgjojë shumë fjalë e emra që si i kishte dëgjuar asnjëherë më parë. Kështu, pos të tjerash, dëgjon për: gulinov të madh, furgon e të tjera. Dhe, meqenëse ishte i interesuar të marr armë sa më të fortë dhe që e gjuan fishekun së me larg, pyet: "Sa e qet larg fishekun furgoni"?

***

Gjatë ofensivës së parë serbe kundër pozicioneve tona; nga krisma të shumta, të mëdha të armëve e të granatave, Bislim Muqës, i ishin dëmtuar ndjeshëm veshët. Më pas, kur binin granata, meqë s'po dëgjonte, s'ndjente shqetësimin që ndjenim ne. Mu për këtë ne kishim filluar ta quanim "Trimi"; kurse gruaja e tij ishte shprehur: "Uh mjera unë, kanë me e zënë shkit të gjallë".

Në një betejë, derisa po zhvillohej luftë e ashpër me forcat armike, numër i madh i ushtarëve tanë po thërrisnin të mbulohej me zjarr komandanti që ishte futë thellë në vijë të frontit, kurse një tjetër thërriste me sa mundte: "O mbulojeni kuzhinierin se komandantë kemi mjaft".

***

Pas ofensivës së parë të forcave armike kundër pozicioneve tona, meqenëse kishim humbur betejën, ishte luhatur ndjeshëm besimi i popullatës në mundësitë tona, ndërsa kishte të tillë, të cilët, në pikat tona, i kishim legjitimuar ndonjë herë, e që tani iu thoshin ushtarëve tanë: "Uh ta q… nënën. A po e do qetash letërnjoftimin?

***

Në një ndejë luftëtarësh, në Maqitevë, gjersa po pihej qaj e bëheshin biseda nga më të ndryshme, dikush e kaloi bisedën te planet e tij pas lufte. Komandant Selim Haziraj pasi dëgjoi tërë ato biseda e plane të shumta, tha: "Dëgjoni burra, të gjithë ju e keni më lehtë se unë", e në pyetjen e njërit prej tyre: "Pse"? Profesor Selimi tha: "Më ka lutë gruaja të mos dal në Maqitevë (të mos shkoj në luftë) e kur e pa që s'po e dëgjoj, më ka thënë: "Ani Selim dil, veç dije që nëse e shoh Rugovën sërish në televizor ti s'ke çka vjen në shtëpi - rri në Maqitevë". Ngase ju kishte bërë i tepërt me ato që i përsëriste çdo të premteje pas dite.

***

Njëri i Dardhishtës së Epërme, duke e parë se numër i madh burrash kishte shkuar në kurbet, kurse tani, shumë

djem të rinj po bëheshin ushtarë, ju thotë: “Unë po rri me gratë se mbetën vet ej”.

***

Komandant Sadik Halitjaha e kishte dëshirë të këshillonte shokët për gjëra të mira. Në një rast, i thotë Mehmet Mustafës dhe Skënder Bashës, që për shkak të angazhimit të tyre fizik në luftë dhe dëmit që shkakton duhani, ta lënë atë, kurse këta ia kthejnë: “O komandant, luftë është e s’na dihet. Por, nëse do me u përkujdes për ne, na e blejë ndonjë herë ndonjë paqetë duhan e mos të ndodhë të vdesim të përmallshëm për të”. Sadiku iu thotë jo, sërish me arsyetimin se është i dëmshëm dhe se duhet lënë duhanin, kurse Skënderi ia kthen: “O komandanti i ynë, më e keqja është, që me ndodhë me më lënë duhani, më as në vijë të frontit s’më rrihet”.

***

Pasi të jetë djegur e tërë Maqiteva e meqë ishin dëmtuar gjithë të mirat materiale, kurse popullata nga fshatrat përreth s’po na ndihmonte më ngase e kishim humbur betejën; ushtarëve tanë iu ishte dobësuar dukshëm ushqimi. Në ankesën e tyre se po hanin ushqim të dobët, Halil Krasniqi, iu kishte thënë: ”A ju thosha ngulni këmbët e rezistoni më shumë; Edhe, dine që s’mund ti harxhojmë krejt artikujt përnjëherë”.

Sa herë që pëlciste sherri e zhvilloheshin luftime; si përgjigje kërkesës së komandant Sadikut që të dilej me

ushtarët në vi fronti Shefi i Operativës, Sadri Emërllahu, i thoshte komandantit: "Të kam thënë se di vetëm me dhënë mësim", kurse komandant Adem Kolgeci në situata të tilla thoshte se: "Me vijën e frontit duhet komunikuar përmes korrierit nga distancë prej dy kilometrave".

***

Pak ditë pasi që kishim marrë popullatën në mbrojtje, duke e vendosur atë prapa shpine dhe pasi që ishim zotuar se vetëm pas rënies tonë mund të dëmtoheshin nga forcat armike. Një grup i vogël ushtarësh nga vija e frontit mbi Buzhalë, të dezinformuar se gjoja paskan rënë vijat e frontit të luftës në Jezercë, tërhiqen nga këto vija. Me të dëgjuar këtë, i kontakton Skënder Basha, i cili duke ditë seriozitetin e momentit dhe duke qenë i tej-ngarkuar, i shanë rëndë disa herë radhazi dhe i porositë ti ktheheshin pozicioneve të tyre. Dy ditë më vonë, njëri prej atyre ushtarëve, që ishte me të vërtetë ushtarë i mirë, i thotë: "Mirë baca Skënder, veç dije që na ke sharë pa faj tonë" ndërsa, ky ia kthen: "Ani bacën, më shani edhe Ju njëherë mua dhe kryhet". Por ushtari nuk e lë me kaq, i thotë: "Baca Skënder, ti na ke sharë disa herë neve", kurse Skënderi ia kthen serish: "Ani bacën, më shani edhe ju disa herë e le të përfundojë, se s'mund të zgjatemi me këtë".

Dy, nga bashkëfshatarët tanë në Zvicër, të cilët na kishin dërguar para për të bërë luftën; Pas ndërmarrjes së parë serbe kundër nesh, kur kishin dëgjuar se ishte djegur fshati e në këtë rast edhe shtëpitë e tyre: Na qojnë fjalë t'ua kthenim parat. I thash këtij zotëriut përmes të cilit

mora porosinë- ti pyeste: “Sa mjete kishin dhënë”? Në mënyrë që të dija sa t’iu kthenim. Kur më tha se: “Kishin dhënë, që të dy nga 500 Marka Gjermane”; E porosita t’iu tregonte se: “Do t’iu jepja që të dyve, së bashku, një kallash”.

***

Në një rast, një ushtarë i yni në Vraniq, shtie pa pasur asnjë arsye. Kjo ishte shqetësuese si për popullatën ashtu edhe për ne. Menjëherë pas kësaj grup njerëzish që po përpiqeshin t’ia vishnin fajin ushtarit Gëzim Caka meqë ishte nga Budakova, e kishin pyetur hallën Rushe: “Kush gjuajti”? Në këtë, halla Rrushe, shumë mençur, ua kthen: “O ja q... qeni nënën Haxhiut tim”.

***

Isha në komandë të njësisë, në Maqitevë. Komandanti dhe zëvendëskomandanti i kompanisë, Selim Haziraj e Halil Krasniqi, pos të tjerash, e pyesin: “Çka të re”? “Çka po thot Vraniqi”? E ky ua kthen: “Janë duke thënë që ju dy e dogjët Maqitevën”. “Ndonjë gjë tjetër, se kjo s’po na duket interesante” i thonë ata. Në pyetjen e Skënderit: “Pse”? Ia kthejnë: “Paj, ti i vetëm e dogje gjithë atë Vraniq e ne të dy këtë Maqitevë të vogël”.

Në njësinë e Komandant “Gurí”, gjersa po festonin Ditën e Flamurit e të Pavarësimit të Shqipërisë, një grup ushtarësh ekzaltohet dhe fillon të shtie në ajër nga armë të lehta. “Gurí”, duke e parë që askush s’po i dëgjonte thirrjet e tij që të ndërpritej me të shtëna, ia merr nga dora automatikun zëvendësit të tij, Mufailit, dhe fillon të shtie

me rafal. Pasi të ketë pushuar kjo, urdhëron rreshtimin e njësisë dhe nuhatë një për një çdo armë që kishte shtëne duke ndarë nga rreshti të gjithë ushtarët, armët e të cilëve mbanin erë baroti e bashkë më ta edhe zëvendësin e tij. Më pas këta i ndëshkon me stërvitje tërë ditën, në mot të lig me borë e në të ftohtë, kurse kurë i thuhet në mbrëmje se zëvendësi i tij s'ishte fajtor, ngase ky kishte shti me armën e tij, "Gurí" ua kthen se: "Me Mufailin i kanë bërë ushtrimet më mirë".

***

Kohë lufte, e shqetësimet ishin nga më të ndryshmet. Udhëheqësit e fshatit në Vraniq, kohë të gjatë kishin vuajtur, madje kishin bërë përpjekje të shumta të kuptonin pse s'kishim oficer e kuadro ushtarake? Pse e bënim luftën pa bekimin e kundër vullnetit të "Presidentit Rugova"? Etj; etj. Kurse në fund, a janë në të vërtetë me paga "oficerët" që na kishte përgatitë me urgjencë e që na kishte dërguar "Qeveria e Bujar Bukoshit". Në një rast, në lidhje me interesimin e tyre të fundit se a ishin këta "oficer" me paga, Skenderi, iu ishte përgjigjur fare shkurt: "Normalisht, ata janë oficer"; ngase si të tillë ua kishte prezantuar, për të ruajtur qetësinë aq të nevojshme te civilët e te ushtarët.

Meqenëse dajat e gjyshit tim, Veselit, i kisha nga Bukoshi, kurse dajat e mi nga Maqiteva; secilit nga komandantët e njësive, nga këto fshatra, që vinte në komandë i drejtohesha me "Dajë". Kjo e kishte bërë komandantin, Bekim Arifi, të dyshonte se këtu, në batalionin tonë, ka nepotizëm e familjarizëm prandaj në

një rast pasi të jetë shtangur më kishte pyetur: ”Çka është kjo”? E unë iu pata përgjigjur: ”E more komandanti jem; është interesantë kur ta bësh luftën, me dajat, si unë”, ndërsa që më pas e sqarova për këtë.

***

Ndodhte që komandant Sadikut ia mbuloja ndonjë faturë ose i jepja para të gatshme kudo që e takoja, ndërkaq që nga letra të bardha që mbaja në xhep, aty për aty, improvizoja faturë dhe e “detyroja” të nënshkruante. E meqë kështu po na ndodhte disa herë, në një rast, më tha: “ A, i keq je, “fare s’më beson”, kurse unë ia pata kthyer: “O komandanti jem, Unë, ty të besoj, por luftë është e s’i besoj “shkaut” që s’ta qëllon me ndonjë granatë krehës ende pa mbërri në komandë me leshu faturë.

***

Gjatë gjithë kohës së luftës dhe kudo kishte njerëz që po më pyesnin: “Ç’na duhej ky apo ai ushtarë”? Dhe gjithherë po më përmendnin ata që në të kaluarën e tyre jetësore kishin qenë problematik, ndërsa që unë sinqerisht ju thosha se: “ Mos ti kishim ata, as bam s’do t’ia bënim”.

Herën e fundit që vijnë tregtarët me bagëti, në Maqitevë, për të blerë ato pak lopë, viça e kuaj që i kishin shpëtuar zjarreve të luftës e të cilat i blinin me çmim sa për të thënë, ngase dimri po afrohej, ndërsa atje jo që s’kishte mbetur themel as kulm, por as edhe ushqim për bagëtinë; I thonë njëri-tjetrit: ”S’mbet gjë edhe këtu”. “Jo besa, veç dashtë Zoti e digjet së shpejti Grikoci”.

***

Një qytetar i yni, i ishte lutë Komandantit "Guri" që me luftëtarët e tij t'ia siguronte rrugën në Grykë të Carralevës, gjersa ky po kalonte andej pari me nusen e sapo marrë për djalin. Dhe derisa po e bënin këtë, kishte shpërthyer konflikti me serbët që në atë kohë po kalonin andej pari. I zoti i dasmës e kishte pyet komandantin: "Çka të bënte ai në ato rrethana"? Kurse "Guri" i kishte thënë: "Rezisto. A me ua dhënë nusen a"?

***

Ndodhë që, njëri i Vraniqit, për ta pasur veten dhe familjen me të sigurt, ndahet nga popullata që ishte strehuar në luginën e Lumit të Vogël mbi fshat. Në ndërkohë, forcat armike e zënë këtë popullatë dhe e përzënë për në Shqipëri. Këtij, shumë shpejtë, i bëhet i tepërt qëndrimi në pyll ashtu siç ishte "i vetmuar", ndërsa zgjidhjen e sheh në kërkesën me shkrim që Unë ta lëshojë popullatën prej rreth tridhjetëmijë vetash nga gryka e lumit të Llanishtit, të cilën e kishim në mbrojtje, në mënyrë që gjatë lëvizjes së kësaj popullate, ai të mund ti bashkohej asaj gjatë rrugës për në Shqipëri.

Në një ndejë me shokët ushtarë, Komandant Sadik Halitjaha, pos të tjerash e lavdëron Skënder Bashën se po i rrinte te thembrat gjithë herë e edhe në vijë të frontit, kurse Skënderi sqarohet se këtë po e bën me sherr, për tu fshehur pas gjoksit të madh të tij edhe pse e dinte që në front duhet qëndruar para ose përkrah komandantit.

***

Meqenëse kishim krijuar një batalion të shëndoshë e me shumë rregull e disiplinë, çdo e shtënë, kudo në Budakovë, paraqiste shqetësim për ne. Në raste të tilla ishim obliguar të lenim gjithë punët dhe detyrat, të dilnim në teren deri të kuptonim me se behej. Në një rast, i thash Komandantit të mos dilnim fare ngase e "dija" që njësia simotër i Komandant "Abi" e kishte gjuajtur helikopterin që sapo kaloi andej pari. E pasi që komandanti s'bëhej rehat, dola i porositur të shkoja në atë njësi dhe ti lusja të ndërprisnin veprimet e tilla. Derisa po ngjitesha një përpjete që të zinte frymën, pamë njëkohësisht njëri tjetrin, unë dhe Xhafa i Vogël, i cili filloi të qeshte me sa zë kishte. Sapo desha ti them: "Pse bre Xhafë që, sa herë …" ai më ndërpreu duke më thënë: "E di, e di, mu për këtë ne para se të shtimë, gjithë herë ju shajmë".

***

Shkojnë ushtarë tanë, në lumin e Buzhalës, ku ishte e strehuar popullata dhe kërkojnë nga të rinjtë fuqi punëtore për të hapë istikame në pozicione të reja. E këta ua kthejnë: "A ua hapem para tri ditësh ne Bukosh"? "Pse si mbajtët"?

Ngjashëm me shumë njerëz të tjerë, edhe një plak i Grikocit i kishte lidhë veprimet me qëndrimet e "Presidentit" Rugova. Kështu, plaku ua shihte për të madhe të rinjve qe po nguteshin me veprimet ushtarake e me luftën. Dhe këtë e përsëriste shpesh dhe kudo nëpër ndeja. Një ditë, në një rast, plaku provokohet nga një i ri i cili i thotë plakut se gjoja paska thënë Rugova që duhet ti

bashkohemi luftës të gjithë, kurse plaku ia kthen: “Ai bre, paska luajt mendsh edhe ai”.

***

Unë dhe shokët e mi nga bërthama e njësitit të parë të ushtrisë sonë në këto anë, edhe më tej çuditemi se si kishim mundur që, vetëm duke supozuar, ashtu me hamendje, t’ia qëllonim, me saktësi, se kush në të vërtetë kishte armë në fshatin Vraniq. Kishte kaluar kohë tepër e gjatë dhe njëri prej tyre, as s’po i bashkohej radhëve tona as s’po na e jepte armën. Sapo ishte bërë e ligjshme të mobilizoheshin armët, i thash Komandantit të policisë ushtarake, Shefket Hoxha, të dërgonte njerëzit e tij, t’ia mobilizonin armën. Më tha, se me policët do të shkonte edhe ai personalisht meqenëse ishte nip i Vraniqit dhe mua kjo më pëlqeu, ndërsa i kisha porositur, ti tregonin se kush i kishte dërguar dhe të mos zgjateshin shumë me të. Me tu kthyer nga atje më than: “Jo bre baca Skënder, atij ishin duke i dhimbtë këmbët”. “Mirë, ju thash, me bacën; Por, a ju dërgova t’ia merrni armën, apo ta pyesni, mos po i dhëmbin këmbët”? Herën tjetër- ishin të prerë, t’ua jepte armën ose të rreshtohej me ne dhe siç më than: “Ua kishte dhënë armën me shumë dëshirë”.

Kishte rastisë që në një ushtarë tonë, i cili sapo ishte rritur, të jetë dashuruar një vajzë. Me të kuptuar këtë, ashtu plot gëzim, i kishte treguar shokut të tij më të afërt, ndërsa që ky meqë po njihte rreptësinë time i kishte thënë: ”Kuku për ty, nëse e merr vesh baca Skender”; Dhe me kaq kishte përfunduar e tëra.

***

Kurbetçinjtë nga fshati Vraniq, në Zvicër, që në fillim të luftës së UÇK në Kosovë me qëllim ta ndihmonin luftën që po bënin bashkëfshatarët e tyre këtu; ju kishin dërguar 90.000 marka gjermane. Menjëherë pas ofensivës së parë të forcave serbe e meqenëse fshati ishte djegur në tërësi, kishte të tillë që kishin kërkuar t'ju ktheheshin mjetet e dhëna me arsyetimin se s'ishte mbrojtur fshati, ndërsa këta iu ishin përgjigjur se kishin dërguar mjete tamam sa për ta djegur atë.

***

Komandant Shaban Gashi, i kishte dhënë qëndrim korrierit të tij, Shani Canajt, që të mos ndahej e largohej për asnjë moment nga ai. Në një rast, kur ishin bashkë në shtëpinë e Shabanit, ndërsa, Shabani, përmendë se po shkonte në dhome të fjetjes për të ndërruar rrobat, Shaniu brofë në këmbë e i thotë: "Ani komandant" dhe niset pas tij, kurse në pyetjen e Shabanit se ku po shkonte? Shaniu ia kthen: "Me Ju komandant; A më keni thënë të mos ju lë vet asnjëherë"?

Rrethanat e luftës kishin bërë që në fshatin Vraniq, pos të tjerash të dëmtohej edhe rrjeti elektrik. Një i atij fshati, për të pasur qasje, detyrohet të zgjas kabllo çfarë i kishte qëlluar. Dhe meqenëse kjo kabllo ishte e hollë, nga ngarkesa fillon të digjet. Me të parë këtë, gruaja e tij e thërret me sa zë kishte: "O njeri u dogjëm", kurse ky ia

kthen me gjakftohtësi: “Mos u bej merak oj grua se s’kemi çka digjemi më”.

***

Në rrethana të rënda lufte kur po zhvilloheshin luftime të ashpra e të pareshtura të cilat të thuash s’po dinin të ndalur dhe s’po u shihej fundi, nën trysninë e forcave serbe, popullata jonë këtu ishte detyruar të zhvendosej dhe të merrte rrugë për në Shqipëri. Pasi të kenë arritur në Prizren, pas tri ditë udhëtimi edhe pse popullatë nga e gjithë Kosova po deportohej; këta të Vraniqit i kishin kthyer me qëllimin e vetëm të na i lenin “zorrë nëpër këmbë” meqë kështu, serbët, e kishin më lehtë me ne. Dhe derisa këta po ktheheshin, në kolonë, ashtu siç ishin nisur me makineri të shumtë për transport, ndërsa që kishte rënë muzgu dritat e shumta nga gjithë ajo autokolonë e meqë s’po e dinte se me se bëhej, e kishin bërë komandant Ademin të thoshte: “Mos pyet për ne. Kësaj radhe do ta kemi më vështirë se gjithë herëve të tjera”.

Në një rast kur isha në kompaninë tonë në Maqitevë e ngaqë ushtari, Haxhi Muqa, i ishte bërë i tepërt komandantit të tij, Halil Krasniqi, duke i përmendë babain e tijë plak e të sëmurë; Halili më kishte thënë: “Skender, Hagjiun merre menjëherë për Vraniq, s’mundem, burrë, me ia pas gajlen edhe babës tij”.

***

Ishte diku nga fundi i luftës. Kënga që Leonora Jakupi po i këndonte kësaj lufte ishte bërë hit prandaj e kishim mësuar dhe po e këndonim krahas sajë të gjithë. Ndërsa që unë duke aluduar në vetë- shkatërrimin e Shqipërisë të vitit '97 dhe në pjesëmarrjen tonë aq të ulët në luftë po thosha së kënduari se: "Është një popull që s'do liri, dhe Kosova është Shqipëri"

***

Në lokale të komandës së batalionit, krejt rastësisht, komandanti i batalionit, Fehmi berisha, më kishte pyetur: "Oooo Skender Basha, si i kemi punët"? Kurse Unë, aty për aty, ia kisha kthyer: "Oooo kurrë ma mirë s'i kemi pas oooo komandanti jem, bane men tremijë aeroplan i kemi, shkaut jemi duke ja thyer krytë me "Tomahok" e me raketa "Skud" ndërsa që s'kemi nevojë as "pullën" me prekë, sepse këtë të tjerët e bëjnë për ne". E meqë kjo i kishte pëlqyer tepër, sa herë lodhej ose i kishte punët pisk në vija të frontit, me sa zë kishte, do të ma shtroj të njëjtën pyetje, në mënyrë të njëjtë, kurse edhe unë i përgjigjesha gjithë herë njësojë, ndërsa që gjithëherë ma kthente: "Ani, Skender Basha, ani".

Lufta, sa s'kishte përfunduar. Ne ishim të tej-ngarkuar, veçmas me të plagosur të shumtë, ndërsa i kishim grumbulluar në ato pak zona të lira dhe sa më pranë stacionarëve dhe spitaleve ushtarake. Shumëçka nga ato që na duheshin mungonin. Ishte vërtetë kënaqësi e veçantë nëse të jepej rasti të haje çfarëdo pos bukës së zezë nga mielli i bluar në mulli të ujit, i pa situr fare, dhe të pije çfarëdo pos ujit. Hazirit të Talve ia do fati ta pyesin: nëse

donte kafe? Ky, për kënaqësinë e tij, shkon e pyet teknikun mjekësorë, Zymer Llugagjiun, nëse i lejonin plagët të pinte një kafe? Duke e ditur se Haziri po krekosej me ketë, Zymeri i thotë: "Po, veçse fillimisht duhej t'ia sillte kafen këtij në mënyrë që ky t'ia hiqte shkumën".

***

Ishte gati fundi i luftës dhe me të vërtetë ishin krijuar rrethana të rënda për ne, aq më tepër që pothuajse na ishte harxhuar municioni. Në këtë gjendje, kishim zgjedhur të rrinim në stanet mbi fshatin Vraniq. Një ditë, kur u kthyen nga një aksion "Gjahtarët" siç i quanim ne vëzhguesit, të cilët i kishim forcë goditëse për armikun; Dikush nga ne i pyet se si kishin kaluar dhe çka kishte të re? E kur përmendën se njërit nga civilët e strehuar te ne, "shkitë" ja kishin marrë kerrin dhe traktorin, të cilët i kishte ruajtur me gjithë mundin dhe përkushtimin, madje duke mos bërë asgjë për luftën, reagoi duke thënë: "Qohuni burra, ti biem shkaut, se s'durohet më kështu".

Kishte përfunduar lufta. Forcat pushtuese armike e me to edhe të gjithë serbët tjerë ishin kthyer andej kah kishin ardhur, ndërsa shumë nga ne, të etur për tu "hakmarrë gjithanshëm", kishin vërshuar fshatrat Popolan e Dvoran që aty të merrnin krejt çka kishte nga pasuri e tyre e lënë. Njëri prej tyre, pranë një ferme pulash, derisa po ndiqte për të zënë pulat; bie deri në qafë dhe falë shokëve mezi shpëton pa u mbytur në rezervuarin e plehut të tyre. Në lidhje me këtë, më pas, nga një i afërm i tij, isha pyetur se: "A do të ishte edhe ai dëshmorë"? Kurse, unë i

jam përgjigjur, me shaka: “Jo, në bazë të kësaj se si është duke u vepruar këtu te ne- do te ishte martir, ngase s’ishte me pushkë në dorë dhe se s’ka bërë rezistencë”.

***

Një ditë pasi që ishte çliruar Prizreni; Unë dhe Bislim Muqa, kishim shkuar atje, thjeshtë për të ndarë gëzimin e fitores e të çlirimit me sa më shumë njerëz. Për kënaqësinë, por edhe për befasinë tonë- takuam një shok tonë të vjetër, i cili vite më parë i kishte ikur terrorit e dhunës së pushtuesit këtu por edhe mundësisë së burgosjes; ndërkaq që për sa kohë kishte qëndruar jashtë, ishte shkolluar e përgatitur për kuadër të ardhshëm. Sapo ishim përshëndetur, deri sa po pinim kafe, e kisha pyetur: “Si kishte mundur ti rrijë gati të vinte kaq menjëherë”? E ai ma pat kthyer: “Pajë, e bëra mend; edhe lufta edhe paqja s’ju takojnë të dyja”.

Pasi të ketë përfunduar lufta, ndërsa vendi po qeverisej nga Qeveri e Përkohshme; më rastisi që me një grup shokësh të jem në Odën e Kadollëve në Bukosh për ti ngushëlluar në një rast vdekje. Meqë ishte krijuar rregull që në njëfarë mënyre të hyhej e dilej, sapo i kishim ngushëlluar, provuam të merrnim leje të shkonim. Në këtë, Sadik (Liman) Kadolli, kurbetçi prej kohësh e që ishte vëlla i të ndjerit na patë lutur të rrinim më gjatë. Kjo ngaqë kishte vërejtur se që të gjithë ishim ish të dënuar politik dhe pjesëmarrës aktiv në luftë e në shenje respekti për ne . Pas ndonjë bisede tonë me burrat aty, e kishim lutur Sadikun që edhe ai, meqë na kishte ndalë, të merrte fjalën

e të na thoshte ndonjë gjë. Burra, tha Sadiku, unë jam kurbetçi qe më shumë se tridhjetë vjet, dhe normalisht që duke mos qenë këtu për kaq vjet e kam vështirë t'ua qëllojë gjërave. Por, me sa më ka rënë të dëgjojë bisedat e njerëzve në këtë të pame; Ata thonë se: "Ju s'dini të menaxhoni e as me qeverisë e me udhëheqë"; Prandaj, siç thonë këtu: "Ju s'bën me qenë kryetarë, drejtorë, shefa, komandantë e të tjera". Pasi që kam menduar mirë, tha Sadiku, ju kam thënë që: "Juve sërish t'ju dërgojmë në burg, ngase atje dini të qëndroni mirë, ndërsa t'ju lirojmë vetëm nëse na paraqitet serish nevoja e luftës me Serbinë".

* * *

ALBUM ME FOTOGRAFI NGA KOHA E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (UÇK)

Lapidari kushtuar Dëshmorëve të Kombit, në fshatin Vraniq.

Momente nga rivarrimi i viktimave të luftës në fshatin Vraniq.

Varrezat e viktimave civile të luftës në fshatin Vraniq.

Pamje të pjesëve të fshatit Vraniq në pasluftë.

Skenderi, fotografuar në shtëpinë e tij, bazë e parë e njësitit të UÇK-së në Vraniq dhe në pjesën jug- lindore të Komunës së Suharekës, në dimër 1998-’99.

Komandant Sadik Halitjaha

Në nderim të flamurit: Hava Bytyqi, Skender Basha dhe Ramadan Haxhiaj.

Komandanti i Batalionit II, Fehmi Berisha dhe Zv. Komandanti, Bekim Arifi.

Në këmbë: Ramadan Haxhiaj dhe Skender Basha; Ulur: Xhemajli Kastrati, Bekim Arifi dhe Fehmi Berisha.

Nd. kom. Ramadan Haxhiaj dhe nd. kom. Skender Basha.

Enver Hoxha,Skender Basha,Shaban Gashi dhe Ramadan Haxhiaj.

Pjestarë të Batalionit II, gjat një vizite në Brigadën 161 "Ahmet Kaqiku", në Zonën Operative të Neredimës

Në këmbë: Ushtari Enver Halitjaha dhe Skender Basha; Ulur: Komandanti i batalionit, Fehmi Berisha dhe zv. Komandanti i batalionit, Bekim Arifi.

Skenderi, gjat kohës së punës në komandë, në dimër 1998- ’99.

Skenderi, fotografuar në oborrin e Qendrës së Kujdestarisë, në oborrin e Arif (Ramë) Kokollari; Në Budakovë, në pranverë 1999.

Skenderi, fotografuar në ballkonin e lokaleve të Komandës së Batalionit II, në shtëpinë e Hysen (Tahir) Kokollari në Budakovë, dimër 1999.

Skenderi fotografuar në shtëpinë e tij, dimër 1998-'99.

Skenderi me nënën Feride dhe djalin Meritoni.

Skenderi me vajzen e tij Hajrien.

Skenderi dhe vajza e tij Hajria, gjersa po recitonte poezi për lirinë.

Vëllezërit: Enveri dhe Skenderi.

Në këmbë: Bexhet (Nebih) Kolgeci dhe Skenderi;
Ulur: Rifat (Durak) Kolgeci.

Skenderi në vizitë familjarëve të tij, në Kukës, pasi të ketë përfunduar lufta.

Bislim Muqa, Azem Kolgeci, Skender Basha dhe Haxhi (Rrustem) Muqa, në pasluftë.

Bislim Muqa, Azem Kolgeci, Skender Basha dhe Sadri (Azem)

Adem (Brahim) Kolgeci, Komandant i Togës së I- rë në Vraniq

Sadri (Ramadan) Muqa, komandant skuadre, në Vraniq, në pranverë 1999.

Xhavit (Azem) Loshi, një nga ushtarët e rinj në Batalionin II.

Sejdi (Mehmet) Oruqi, një nga ushtarët tanë të rinj.

Haxhi (Muharrem) Muqa në vendroje, në Maqtevë, në dimër 1998- ’99.

Safet (Nazif) Muqa, në Vraniq, në verë 1998.

Shaqir (Jahir) Krasniqi dhe Bashkim (Ramush) Matoshi, në Maqtevë, në dimër 1998- '99.

Në këmbë: Bashkim Matoshi, Kom. Halil Krasniqi dhe Mehmet Mustafa; Shtrirë: Amet Ahmeti, Zejnulla Aliaj, Hamëz Krasniqi dhe Milazim Aliaj.

Haxhi M. Muqa dhe Bashkim R. Matoshi, i raportojnë Kom. Avdi A. Jakupi; Maqtevë, dimër 1998- '99.

Fshati Vraniq (Verë 2011)

~~~
~~~